

Universiteti i Tiranës  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

**Studime  
GJEOGRAFIKE  
22**

2019

***Drejtori i revistës:***

Prof. dr. Sabri LAÇI

***Kryeredaktor:***

Prof. dr. Romeo HANXHARI

Redaksia:

Prof. dr. Pal NIKOLLI

Prof. dr. Sokol AXHEMI

Prof. dr. Dhimitër DOKA

Prof. dr. Skënder SALA

Prof. dr. Merita DOLLMA

Prof. dr. Bilal DRAÇI

***Arti grafik:***

Gazmir Myteberi

***Përgatiti për botim:***

Ornela Hasrama

Kjo revistë është pronë e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të UT-së me VKM Nr.1066, datë 16.07.2008.

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Artikujt e kësaj reviste janë materiale të zgjeruara të referimeve të mbajtura në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Hapësirat Ndërkufitare. Dinamika dhe Sfida”. 01-02 Dhjetor 2017 Gjirokastrë, tek organizatorët në fund do shenosh : në bashkëpunim me Departamentin e Gjeografisë në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin e Gjirokastrës.

**ISSN: 1562-8183**

Shtypur nga “Jupiter Group”

Tiranë 2019

## Përmbajtja

### **1. Prof.Dr.Sokol AXHEMI**

Tendenca të zhvillimit të popullsisë dhe elementëve social të saj në hapësirën ndërkufitare Shqipëri-Mali i Zi.....5

### **2. Dr. Artemis Dralo**

Ruajtja e identitetit kulturor të pakicave kombetare.....13

### **3. Prof. dr. Pal NIKOLLI, Prof. dr. Bilal DRAÇI**

Ndikimi i emigracionit në plakjen e popullsisë së Shqipërisë pas viteve ‘90 .....21

### **4. Prof. asoc. Albina SINANI, Prof. dr. Gëzim SALA, Dr. Irena BOBOLI**

Efektet e migrimit në bashkinë Dropull .....33

### **5. Prof. asoc. dr. Valbona Duri, Dr. Msc. Gentian Ruspi**

Emigrimi i jashtëm i popullsisë në territorin, qarku Gjirokaster.....51

### **6. Msc. Aishe BEGU(BALLA), Dr. Elvira BOLLOBANI (DODOVECI)**

Roli i faktorëve fiziko – gjeografikë në zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë administrative Gjoricë.....60

### **7. Doc. dr. Albana KOSOVRASTI, Prof. asoc. dr. Sonila XHAFI**

Sfidat e riintegritimit të nxënësve të kthyer nga emigracioni në sistemin arsimor Shqiptar .....79

## **8. Dr. Mariglen SHERIFAJ**

Zonat e mbrojtura në hapësirën ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë dhe menaxhimi i integruar i tyre.....87

## **9. Prof. Asc. Dr. Jostina DHIMITRI**

Analiza e impaktit të katastrofave natyrore përmes simulimit dhe teknologjisë: mega shpërthimet e campi flegrei në Shqipëri.....102

## **10. Dr. Adela Dhromaj, Prof.asoc.dr. Kozeta Sala**

Roli i trashëgimisë kulturore në identitetin rajonal të qarkut Gjirokastrë.....118

## **11. Dr.Andri Hoxha**

Ndikimi i veçorive gjeomorfologjike në zhvillimin human të bashkisë së përrënjasit ..131

## **12. Msc. VIOLETA ALIAJ, Prof.asc.Dr. Merita KOKA KARAGUNI**

Potencialët urbanë dhe qasja krijuese si nxitëse e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal ..148

## **13. Msc. Ornela Hasrama**

Hapësira “ndërkufitare” mes Iranit dhe Shqipërisë: Të jetosh në dy shoqëri.....159

## **14. Mr.sc. Vloran CENAJ**

Opoja dhe Gora vend i hapur për turizëm ndërkufitar.....170

## **15. Dr. Sc. Tomor Çela, Dr. Sc. Hazer Dana, Msc. Bajram Kafexholli, Msc. Florend Krasniqi**

Kufiri i hapësirës gjeografike të Kosovës, sipas juridiksionit administrativ e politik në gjysmën e dytë të Shek. XX dhe në fillim të Shek. XXI.....183

## TENDENCA TË ZHVILLIMIT TË POPULLSISË DHE ELEMENTËVE SOCIAL TË SAJ NË HAPËSIRËN NDËRKUFITARE SHQIPËRI-MALI I ZI

**Prof.Dr.Sokol AXHEMI**

*Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Tiranës*

### **Shkurtesë**

*Hapësirat ndërkufitare dallohen sot për praninë e hulumtimeve ndërsiplinore nga studjues të ndryshëm dhe objektet e larmishme shkencore. Diversiteti shkencor i studimit ndikohet nga tematika të larmishme nga të cilat karakterizohen këto hapësira ndërkufitare, kontekstet historike të zhvillimit të tyre, gjeopolitike, ndryshimeve, transformimeve dhe evolucioneve ekonomike, karakteristikave sociale të popullsisë, çështjeve mjedisore, etj. Gjithnjë e në rritje evidentohet një bashkëpunim dhe hulumtim reciprok ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Në mënyrë të veçantë vlerësohen mjaft efektive maredhëniet dhe raportet studimore shkencore ndërmjet Universitetit të Shkodrës dhe atij të Podgorices, si dhe mjaft qendrave të tjera kërkimore shkencore në dy anët e kufirit.*

*Mjaft gjeografë me anë të pjesëmarrjes në projektet e ndryshme, botimeve shkencore në buletinet e Universiteteve respektive, konferencave apo në takimet e karakterit periodik, si rezultat i mjaft eventeve sociale të organizuara ne Shkoder, Podgorice, Ulqin, Guci, etj, kanë tentuar të japin analiza gjeografike mbi çështjet e ndryshme. Vlejnë të përmenden tematikat që kanë të bëjnë me zhvillimet ekonomike ndërkufitare, turizmit dhe rolit të tij në zhvillimet ekonomike në mes të dy vendeve, evolucionit të hapësirës sociogjeografike, raporteve ndërmjet grupeve të ndryshme sociale në të dy anët e kufirit, çështjet e migrimit dhe të lëvizjeve të popullsisë, problemeve mjedisore, etj.*

*Në materialin tonë tentojmë pikërisht të analizojmë dy tematika të rëndësishme dhe mjaft evidente në raportet ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, siç janë zhvillimet e popullsisë dhe tematikat sociale me të cilat shoqërohen ato në këtë hapësirë sociogjeografike ndërkufitare. Objekti i hulumtimit tonë në mënyrë të veçantë fokusohet në çështje të tilla, të cilat kanë të bëjnë me vështrimin e përgjith-*

*shëm mbi popullsinë ndërkufitare të bashkisë së Shkodrës dhe Malësisë së Madhe në pjesën e hapësirës ndërkufitare të Shqipërisë dhe popullsia e Krajës, Ulqinit, Plavës, Guxis edhe Tuzit në hapësirën ndërkufitare të Malit të Zi, tiparet dhe karakteristikat e tyre, motivet dhe faktorët që kanë ndikuar në evolucionin e tyre gjatë periudhave të ndryshme, tendencën që shprehin në të ardhmen, tematikat dhe problemet sociale që bashkëshqerojnë ecurinë e tyre në të dy anët e kufirit.*

**Fjalët kyçe:** *Shqipëri, Mali i zi, Tuzi, Kelmendi, Kraja, Plava, Gucia, Kastrati.*

### Hyrje

Hapesira sociogjeografike perfaqeson nje tematike interesante per tu njohur dhe analizuar. Ne menyre te vecante interesi i analizes shkencore pasurohet ne kuadrin e hapesirave nderkufitare ndermjet shteteve, lidhur ngushte me zhvillimet historike e politike respective. Nisur nga nje interes i tille kemi bere perpjekjet tona qe te marrim ne considerate hulumtimin e hapesires sociogjeografike nderkufitare Shqiperi-Mal i Zi, ne te cilin eshte e vendosur popullsia shqiptare.

### **Tipare te tematikes sociale ne hapesiren nderkufitare Shqiperi-Mal I Zi.**

Tematika sociale ne hapesiren nderkufitare qe po analizojme paraqitet teper e larmishme ne mjaft drejtime gjate periudhave te ndryshme historike. Evolucionin neper te cilen ka kaluar nje hapesire e tille sociogjeografike ka ndikuar dukshem ne lindjen, zhvillimin dhe ndryshimin ne vazhdimesi te hapesires sociale ndermjet njesive administrative ne te dy anet e kufirit. Situata te tilla ne ndryshim e transformim te vazhdueshem spikasin ne Anen e Malit, Shiroke, Zogaj, Bajze, Hot, Kelmend ne Shqiperi, si dhe ne Kraje, Ulqin, Tuz, Plave e Guxi ne Mal te Zi. Mjaft evidente dhe interesante jane zhvillimet sociale, ne menyre te vecante pas viteve 1990, kur intensifikohen maredheniet ne te dy anet e kufirit ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi.

Faktoret ndikues ne lindjen, zhvillimin dhe evolucionin e tematikave sociale ne kete hapesire nderkufitare kane luajtur rolin kryesor ne krijimin e karakteristikave themelore ne drejtim te grupeve sociale, vendeve dhe funksioneve sociale, si dhe politikave sociale ne seicilen nga pjeset nderkufitare ndershtetore. Nder to mund te permenden sidomos rolin e faktoreve historik, politik, ekonomik, natyroro-gjeografik, etj. Ne mjaft raste faktoret e mesiperm nuk shfaqen te vecuar, perkundrazi ne nje rol bashkepunues e ndikues ne

zhvillimet sociale te popullsise se ktyre hapësirave nderkufitare, duke krijuar efekte sociale te spikatura dhe mjaft te rendesishme per tesine e hapësires so-ciojeografike.

Roli i faktoreve historik dhe politik duhet marre ne considerate per tu anal-izuar ne kuadrin e nje bashkepunimi te ngushte dhe reciprok.Kontekti historik I ndarjes se pjeseve te kufirit shqiptar ne periudha te ndryshme te zhvillimit te his-tories se Shqiperise ka qene I ndikuar edhe nga zhvillimet e metejshme politike ndershteterore me ish Jugosllavine e dikurshme.Pas 1944,e ne menyre te vecante pas 1948 raportet dhe maredheniet e acaruara politike ndermjet dy shteteve qe ndanin kufirin shteteror kane pasur efekte jashtezakonisht te drejtperdrejta edhe ne sjelljen,maredheniet dhe raportet ndermjet popullsise shqiptare ne te dy anet e kufirit.Theksojme se deri ne fillimin e viteve 1990 raportet dhe maredheniet nder-mjet tyre,kontaktet dhe vizitat reciproke ishin krejtesisht tekufizuara dhe spora-dike. Ndonese nuk mungonin kontaktet ilegale ne te dy anet e kufirit vleresojme se ato paraqiteshin jashtezakonisht te rrezikshme,duke ndikuar edhe per krijimin e situatave dramatike dhe qe demtonin jeten dhe jetesen e familjeve te perfshira ne keto tip levizjesh(ndonese te kufizuara).

Vetem pas viteve 1990 kemi nje ndryshim te rendesishem ne raportet dhe maredheniet ndermjet shqiptareve ne te dy anet e kufirit.Krijimi i munde-sive per te levizur me lirisht ne Shqiperi dhe ish Jugosllavine e dikurshme,apo sot Mali i Zi beri te mundur qe familje te shumta shqiptare te bashkoheshin apo te rifitonin kontaktin e humbur me dekada.Ne menyre te vecante u shtuan kon-taktet me Ulqinin dhe ulqinaket,me Krajen dhe krajanet,Tuzin dhe Tuzjanet,si dhe me Kelmendasit dhe banoret e Plaves dhe te Guxise.Shkembime te tilla kane beret e mundur edhe lindjen e zhvillimin e lidhjeve martesore respektivisht ne te dy anet e kufirit.Tashme kemi edhe pranine dhe zhvillimin e mjaft festave te perbashketa sic jane ditet e liqenit,maratonat e ndryshme apo aktivitetet e larmishme sportive,hapja e sezoneve turistike respektive,festa e Krajes (qe mbledh migracionin krajan ne bote) ne Mal te Zi apo festa e geshtenjave ne Kra-je,Logu i Bjeshkeve ne Kelmend,panairet dhe festivalet e shumta muzikore, folk-lorike ne Plave e Guxi,etj,qe kane pasuruar jeten sociale te baoreve shqiptare ne te dy anet e hapësires nderkufitare ndermjet Shqiperise nga njera ane dhe Malit te Zi nga ana tjeter.

Roli dhe ndikimi i faktorit natyror gjeografik eshte i lidhur ngushte me resurset qe permbajne keto njesi administrative nderkufitare.Prania e nje relievi interesant me potenciale te rendesishme zhvillimi bujqesor e blegtoral nga njera ane dhe elemente te zhvillimit ekonomik ne kuadrin e shfrytezimit te elementeve gjeomorfologjike ne ndertimin e veprave te ndryshme hidroteknike,si dhe resur-seve turistike jane disa nga elementet kryesor te mundesive per zhvillim qe ofron

ky faktor gjeografik ne krijimin dhe gjenerimin e mundesive per zhvillimin e hapësirës nderkufitare. Ne menyre konkrete hapësirat fushore e kodrinore te Anes se Malit ne Shqiperi, Ulqinit e Tuzit ne Mal te Zi ka ndikuar per zhvillimin e kulturave te ndryshme bujqesore. Relievat malore te Kelmendit ne Shqiperi e te Plaves e Guxise ne Mal te Zi kane krijuar mundesi per shfrytezimin dhe ndertimin e veprave te ndyshme hidroteknike (hidrocentralet locale), etj. Njekohesisht mundesite e zhvillimit te turizmit malor jane mjaft te shprehura lidhur ngushte me pranine e mjet majave te larta e shpateve interesante per tu eksploruuar si ne anen shqiptare tekufirit, ashtu edhe pertej tij, ne Mal te Zi. Nga viti ne vit evidentohet rritje e fluksit turistik, me destinacion turizmin alpin, ecjet, hiking dhe aventuren ne bjeshket e Kelmendit dhe territoreve te Plaves dhe Guxise.

Njekohesisht roli dhe kontributi i faktoreve te tjere gjeografik si klima, hidrografia dhe tokat kane beret e mundur nje premise mjaft te rendesishme per zhvillimet e ktyre hapësirave nderkufitare ne ted y anet e kufirit. Mundesia per te kultivuar tokat bujqesore, per te realizuar ujitjen dhe vaditjen e tyre perfaqesojne impulse te rendesishme per nje zhvillim efektiv bujqesor te hapësirave nderkufitare, sidomos ne Anen e Malit, Sukobine e territoret prane tyre. Prania e nje hidrografie mjaft te pasur ne ujra, me detin adriatik dhe liqenin e Shkodres e te Shasit ne Mal te Zi, lumejte Buna e Cem, perrejnte e shumte malore ka beret e mundur zhvillimin e transportit uJOR, shfrytezimin per peshkim dhe aktivitet ekonomik hidroenergjitik ne ted y anet e kufirit. Kjo pasuri hidrografike, se bashku me klimen mesdhetare me dite te shumta me diell e kane shndrruar kete hapësire nderkufitare si potencial te rendesishem e destinacion te larmishem dhe mjaft te frekuentuar nga pikpamja turistike.

Faktori ekonomik eshte mjaft ndikues ne zhvillimet e popullsise dhe tematikave sociale qe lidhen me te ne hapësiren nderkufitare, respektivisht te banuar nga popullsia shqiptare ne Mal te Zi. Nje gje e tille eshte ndikuar nga lidhjet tradicionale qe kane ekzistuar ne raportet ekonomike te hapësirës se marre ne studim. Qendra e aktivitetit ekonomik ka qene Shkodra ne zhvillimet historike, ku rolin me te spikatur e ka luajtur pazari i Shkodres dhe lundrimi mbi lumin Buna dhe detin Adriatik. Me kalimin e viteve dhe krijimin e problematikave historike dhe politike, si rezultat i ndryshimit te kufijve te Shqiperise verehen edhe ndryshime ne aktivitetet ekonomike, permasat dhe raportet respektive ekonomike, tashme ted y shteteve qe i ndante kufiri. Megjithate u ruajten per njefare kohe raportet ndermjet Shkodres dhe Ulqinit e Krajes, male-sise se Shkodres dhe asaj te Tuzit, si dhe kelmendit me Plaven e Guxine. Kemi nje nderprerje te ktyre raporteve ne periudhen 1948-1991, ku ekonomia dhe tregtia e centralizuar dha efektet e veta si ne Shqiperi, ashtu edhe ne ish Jugosllavi, ku shteti organizonte dhe kontrollonte gjithshka. Ndryshimet e ndodhura

pas 1990 bene te mundur rifillimin e aktiviteteteve ekonomike ndermjet te dy aneve te kufirit.Nje gje e tille u realizua ne menre individuale dhe te organizuar nepermjet Dhomave te Tregtise te Shkodres dhe Podgorices,si dhe autoriteve shteterore lokale dhe qendrore te Shkodres dhe Podgorices ne aspektin local dhe Shqiperise e Malit te Zi,ne aspektin qendror.

Ne menyre individuale qytetare te ndryshem nga Shkodra,Ana e Malit,Kastrati,etj leviznin lirisht duke kryer maredhenie tregtare eksport-importi,sidomos ne Podgorice,Tuz,etj duke gjeneruar ne kete menyre funksionimin e nje potenciali te rendesishem punesimi ne fillimet e tranzicionit shqiptar. Lindja e aktiviteteteve te para private,dalja ne “arenen” ekonomike te firmave tregtare te para te bizneseve ne Shkoder e Malesi te Madhe filluan gradualisht te kerkonin partneret e tyre ne hapesiren nderkufitare shqiptare te Malit te Zi,kryesisht ne Tuz e Podgorice.Nje hap ne drejtimin e duhur ishte edhe organizimi I panajrove te shumta dhe realizimi I marreveshjeve te ndryshme ndermjet bizneseve respective ne ted y anet e kufirit.Hapja e vendkalimeve te reja kufiate ndermjet dy shteteve,sidomos ne hapesirat nderkufitare qe banoreshin nga shqiptaret perbente nje premise te rendesishme te impakteve qe perftonte ekonomia ne ted y anet e kufirit.Shume sinjifikate dhe e rendesishme per rritjen dhe zgjerimin e kontakteve sherbeu hapja e pikes se Muriqanit ne Shqiperi(Sukobines ne Mal te Zi) qe zgjeroi dukshem levizjen e popullise dhe aktivitetet ekonomike ndermjet dy vendeve,por sidomos Anes se Malit e Shkodres nga njera ane dhe dhe Ulqinit e Krajes ne anen tjetere te kufirit.Njekohesisht ndertimi I rruges se re Shkoder-Tamare-Vermosh dhe hapja e pikes kufitare ne fshatin Bashkim te Vermoshit ka zgjeruar komunikimin dhe aktivitetin ekonomik me Plaven e Guxine.

Duhet vleresuar ne analizen e tematikes sociale ne kete hapesire nderkufitare edhe pasurimi I ne vazhdimesi I vendeve dhe funksioneve sociale.Nje gje e tille paraqitet mjaft evidente ne teresine e njesive administrative si ne pjesen shqiptare te kufirit,ashtu edhe ne ate pjese shqiptare te Malit te Zi.Regjistrimet e fundit tregojne nje rritje konstante te vendeve sociale te banimit,prodhimit,shkembimit,argetimit ne teresine e njesive administrative te Shqiperise nderkufitare me Malin e Zi, spikasin ne menyre te vecante vendet e banimit,prodhimit ne Ane te Malit,sidomos ne Oblike dhe Muriqan,vendet e reja sociale sidomos te prodhimit dhe argetimit ne Shiroke e Zogaj.Situata te njejta te pasurimit me vende sociale ndeshim edhe ne hapesiren nderkufitare me Malin e Zi ne Hot e Bajze te Malesise se Madhe,ne Vermosh e Kelmend ku nga viti ne vit,si rezultat I faktoreve ndikues kemi pasurim ne vazhdimesi te ketij elementi te rendesishem te tematikes sociale ne gjeografi,sic jane vendet sociale. Krahas tyre evidentohet rritje dhe pasurim edhe I funksioneve sociale respective.Migracioni dhe vecorite

sociale dhe impaktet me te cilat ai shoqerohet,zhvillimi ekonomik,vecanerisht ai ne sherbim te turizmit, ka bere te mundur edhe zgjerimin dhe pasurimin e structures profesionale te banoreve te ktyre njesive administrative.Kane lindur e po zene gjithnje e me teper vend profesione te reja ne ndertimtari e punime ne fushen e sherbimeve,guidat turistike e sherbimet e hoteleri-turizmit,etj,te cilet kane ndikuar dukshem edhe ne gjallerimin dhe vitalizimin e jetes social ekonomike te ktyre hapësirave nderkufitare ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi.

Situata interesante paraqet edhe rritja dhe zhvillimi I hapësirave sociogjeografike nderkufitare te njesive administrative ne Mal te Zi.Ndikuar edhe nga zhvillimet ekonomike,kryesisht turistike kemi pranine e vendeve te larmishme sociale ne njesite administrative te Ulqinit,Krajes,Plaves,malesise se Tuzit apo Tuzit,Plaves dhe Guxise.Regjistrimi I fundit I banesave dhe popullsise ne Mal te Zi,na sjell nje panorama interesante te vendeve sociale te banimit,prodhimit,shkembimit dhe argetimit ne keto njesi administrative.Keshtu sipas te dhenave te MONSTAT ne Ulqin numerohen afro 20 mije vende sociale,ne Plav afro 1506 dhe Guxi 721.

### **Konluzione**

Hapesira nderkufitare ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi,perfaqeson nje objekt shkencor mjaft interesant per tu hulumtuar nga pikpamja gjeografike. Ne kuadrin e tematikave te larmishme gjeografike,analizimi I tipareve dhe karakteristikave te popullsise nderkufitare dhe elementeve social qe lidhen me te,perfaqeson nje rendesi te vecante.Kjo evidentohet ne dy drejtime themelore,-teorike nga njera ane dhe praktike nga ana tjetere.

Ne kendveshtrimin teorik ka rol te rendesishem sepse ne menyre konkrete pasurohet mendimi shkencor mbi studimet nderkufitare,konceptet dhe vizionet gjeografike mbi hapësira dhe karakteristikat qe shfaqen ne popullsi dhe tematikat sociale.Ne menyre te vecante jane teper te spikatura elemete te tille ne hapësiren nderkufitare Shqiperi-Mal i Zi,sidomos ne pasurimin e elementeve teorike qe lidhen me faktoret ndikues ne zhvillimet e popullsise,levizjet migrative dhe efektet social ekonomike me te cilat jane shoqeruar ato.

Ne aspektin praktik rendesia eshte e lidhur me mundesine qe u jepet studjuesve dhe hulumtuesve te tjere,me evidentimin e mjaft ceshtjeve te rendesishe qe lidhen me numrin e popullsise ne keto hapësira nderkufiate,shtrirjen dhe pozitiven e tyre,strukturat dhe faktoret ndikues,levizjet e popullsise dhe destinacionet e spikatura.Nje gje e tille ndikon dukshem ne krijimin e nje panorama te qarte dhe konkrete mbi hapësiren nderkufitare Shqiperi-Mal i Zi,kufizuar ne llojin dhe tipin e punimit,sic paraqitet ne kete rast referimi dhe artikulli shkencor.

Zhvillimi i popullsisë shqiptare në Shqipëri njihet karakteristika themelore të evolucionit të saj ndarjen në dy periudha të rëndësishme, atë deri në fillimin e viteve 1990 dhe periudhën e tranzicionit pas 1990. Gjatë periudhës së parë mbizotëron një popullsi e ‘mbyllur’ me ndikim dhe rol kryesor të raporteve lindje-vdekje në kuadrin e shtesës natyrore gjithnjë pozitive. Ndërsa periudha e tranzicionit shoqërohet me lindjen dhe zhvillimin e një tipi tjetër risi, që ka të bëjë me levizjet migrative, kryesisht të jashtëme (me destinacion kryesor Greqi, Itali, SHBA).

Një tipar tjetër interesant i kësaj popullsie është edhe migrimi nderkufitare në Mal të Zi. Në mënyrë të vecantë spikasin në këtë drejtim popullsia e njësive administrative të Anës së Malit, kryesisht në Ulqin dhe ato të njësive administrative të Kastratit në Tuz. Vitet e fundit në mënyrë sporadike evidentohen edhe rastisje të migrimit nderkufitar edhe nga njësia administrative e Kelmendit drejt Plavës dhe Guxisë. Kjo levizje migrative drejt Malit të Zi nga popullsia e këtyre njësive administrative është e ndikuar kryesisht nga oferta për punë ditore dhe sezonale përtej kufirit në sektore të ndryshme të ekonomisë. Në këtë drejtim vlerësojmë sektore të tilla si ndërtimtaria, turizmi dhe shërbimet e ndryshme turistike, bujqësia, blegtoaria, shërbimet familjare në familjet që kanë ikur në emigracion, etj.

### Literatura

- |  |   |
|--|---|
| Axhemi.Sokol   | Një veshtrim gjeografiko ekonomik mbi Ulqinin.      |
| ore,2002   | Buletini Shkencor i U.SH.,Seria Shkencat Shoqërore, |
| Camaj.A  | Veshtrim i përgjithshëm gjeografik                  |
|  | i komunes së Tuzit .Punim Diplome.Tirane 2013       |
| Draga.Nail   | Shqiptarët në Mal të Zi, Art Club, Ulqin 1994       |
| Haxhibrahimi.Maksut  | Detaria e Ulqinit neper shekuj.                     |
|  | Liber i botuar Ulqin 1994                           |
| MONSTAT  | CENSUS 2011 www.MONSTAT.cg                          |
| Ushaku.R   | Ulqini ne gjurmet e shekujve Ulqin 1991             |
| <a href="http://www.gazeta55online.al">Www.gazeta55online.al</a> | Shqiptaret e Malit te Zi 30.07 2011                 |

**TRENDS FOR THE DEVELOPMENT OF POPULATION AND ITS SOCIAL ELEMENTS IN THE TRANSBOUNDARY SPACE ALBANIA – MONTENEGRO****Prof.dr.Sokol AXHEMI****Abstract**

*Transboundary spaces are distinguished today for the presence of researcher from different disciplines and diverse scientific objects. The scientific diversity of the study is influenced by diverse themes from which these cross-border areas are characterized, historical contexts of their development, geopolitics, changes, transformations and economic evolutions, social characteristics of the population, environmental issues, etc. Increasingly, is evidenced a collaboration between Albania and Montenegro. Especially, the relations and scientific research reports between the University of Shkodra and Podgorica, as well as other research centers on both sides of the border.*

*Many geographers by participating in various projects, scientific publications in papers of respective Universities, conferences or periodical meetings, as a result of many social events organized in Shkodra, Podgorica, Ulcinj, Guci, etc., have attempted to provide geographic analyzes in different issues. Important items are topics related to cross-border economic development, tourism and its role in economic development between the two countries, the evolution of the sociogeographic space, the relations between different social groups on both sides border, issues of migration and population movements, environmental problems, etc.*

*In our paper, we are trying to analyze two important topics in the transboundary relations between Albania and Montenegro, such as population developments and the social themes with which they are associated in this trans-bound sociogeographic space. The focus of our research is particularly on such issues, as the general overview of the cross-border population of Shkodra and Malësia e Madhe in the part of the transboundary area of Albania and the population of Kraja, Ulcinj, Plava, Guci and Tuz in the cross-border area of Montenegro, their features and characteristics, their motives and factors that have influenced their evolution during different periods, the tendency they express in the future, the themes and social problems that accompany their progress in two sides of the border.*

**Key words:** Albania, Montenegro, Ulcinj, Tuz, Kelmend, Kraj, Plav, Guci, Kastrat.

## RUAJTJA E IDENTITETIT KULTUROR të PAKICAVE KOMBETARE

Dr. Artemis Dralo

Zv Ministre

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

### Abstrakt

*Shqipëria prej dekadash, ka shfaqur një bashkëjetesë harmonike në rradhët e një diversiteti etnik që e karakterizon, por jo vetëm brenda kufijve të saj. Faktet e deritanishme, janë, pa dyshim dëshmi të mirëfillta të një bashkë-ekzistence shumëvjeçare të pakicave kombëtare në territorin shqiptar e më gjerë. Kjo nënkupton më së miri se identiteti kulturor, etnik, historik dhe tradicional, i pakicave kombëtare, është ruajtur dhe forcuar si një e drejtë e padiskutueshme e tyre. Republika e Shqipërisë ka një angazhim të përhershëm, për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe të drejtat e pakicave. Vendi ynë është palë në një sërë konventash mbi të drejtat e njeriut në kuadër të OKB-së, Këshillit të Evropës, përfshirë edhe Konventën Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”. Në Shqipëri i kushtohet një vëmendje e veçantë marrëdhënieve të mira, tolerancës, bashkëpunimit, bashkëjetesës dhe mirëkuptimit të shqiptarëve me pakicat që jetojnë në territorin e saj, por edhe në rajon a më gjerë. Shteti shqiptar ka një balancë pozitive përsa i përket çështjes së respektimit të të drejtave të pakicave, duke u renditur ndër shtetet, që janë angazhuar në përmbushje të standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes së pakicave. Në asnjë rast nuk është ushtruar ndonjë lloj presioni mbi nryshime, apo mos njohje të identiteteve etnike dhe kulturore të pakicave kombëtare. Liria e ruajtjes dhe vetëdeklarimit të kombësive të ndryshme, bazuar në të dhëna tradicionale apo trashëguese, ka qenë një ndër të drejtat themelore të ekzistencës të të gjitha grupimeve minoritare. Pa cënuar masat e marra në përputhje me politikën e integritit të përgjithshëm të pakicave kombëtare, ndalohen politikat apo praktikrat që synojnë asimilimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre.*

**Fjalët kyçe:** minoritete, identiteti, barazi, gjuhë, kulturë, ligji.

## “RUAJTJA E IDENTITETIT KULTUROR TË PAKICAVE KOMBËTARE”

Diversiteti kulturor, toleranca dhe bashkëjetesa midis pakicave dhe komuniteteve të ndryshme fetare, janë model pozitiv i shoqërisë shqiptare dhe në këtë kuadër shprehet vullneti dhe angazhimi për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Duke e konsideruar respektimin e të drejtave të pakicave, jo vetëm si një detyrim që buron nga angazhimi i institucioneve shqiptare në organizatat ndërkombëtare, por edhe si një realitet, vlerësojmë se ruajtja dhe shprehja e identitetit kombëtar fetar e kulturor të pakicave, përbën një element të rëndësishëm të shoqërisë sonë. Ndër objektivat kryesore në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut është përmirësimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të pakicave, në përputhje me standardet evropiane dhe konform angazhimeve në kuadër të organizatave ndërkombëtare, si dhe zbatimi në praktikë i këtyre të drejtave.

Në opinionin e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër, është evidentuar si çështje shqetësuese, mungesa e një ligji për pakicat, dhe miratimi i një ligji për pakicat është planifikuar në kuadrin e Zbatimit të Planit Kombëtar mbi Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit të vitit 2006. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve si një organ këshillimor pranë Kryeministrit dukej se përfaqësonte vetëm disa pakica, i mungonte pavarësia e nevojshme dhe nuk mund të konsiderohej si një mekanizëm efektiv konsultimi.<sup>1</sup> Progres Raportet e Komisionit Evropian kanë evidentuar plotësimin e 5 prioriteteve kyçe të përcaktuara për Shqipërinë, ndër të cilat edhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe pakicave.

Në progres raportin e Komisionit Evropian (2016) evidentohet se për sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve, janë ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e kuadrit ligjor. Është zhvilluar një proces i gjerë konsultimesh me përfshirjen e institucioneve të pavarura, shoqatat e minoriteteve, organizata të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare. Marrëdhëniet me vendet e rajonit kanë njohur rritje cilësore në interes të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit rajonal dhe perspektivës së përbashkët euro-atlantike. Së fundmi, qeveria shqiptare është angazhuar me përparësi në institucionalizimin e mekanizmit të takimeve të rregullta ndërqeveritare me vendet fqinje, Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

**Ligji përmirëson ndjeshëm kuadrin ligjor të mbrojtjes së pakicave në vendin tonë<sup>2</sup>. Ndër aspektet më pozitive të këtij ligji mund të përmendim faktin që ai:**

1. European Convention on Human Rights, 3 September 1953
2. Ministry for Europe and Foreign Affairs (Albania)

- parashikon përkufizimin e pakicave kombëtare;
- listimin e tyre, në pakica kombëtare;
- përcaktimin e kriterëve ligjore për njohjen si pakicë kombëtare, bazuar në kriterin objektiv që lidhet me vetë-identifikimin mbi përkatësinë ose jo në një pakicë kombëtare, si dhe kriteret subjektive që lidhen me: lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.
- përfshirjen e të drejtave të tyre në përputhje me Konventën Kuadër “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”
- rregullimin ligjor mbi të drejtat specifike të pakicave (vetë-identifikimi, të drejtat arsimore, kulturore, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të tyre, përfaqësimi në jetën ekonomike, sociale, publike, etj),
- kuadrin institucional për zbatimin në praktikë të të drejtave.

### **Në hartimin e këtij ligji janë analizuar me kujdes dhe ndjeshmëri te veçantë elementët e mëposhtëm:**

- identifikimi dhe analizimi i modeleve ligjore dhe praktikave të mira, lidhur me rregullimin ligjor, institucional dhe adresimin e çështjeve mbi pakicat në vendet e rajonit dhe Evropës Juglindore, analizë kjo dhe në dritën e veçorive të kontekstit të Shqipërisë.
- rregullimi ligjor në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe rekomandimet specifike të organizatave ndërkombëtare.
- rregullimi ligjor mbi zbatimin në praktikë të këtyre të drejtave në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- ekspertiza ndërkombëtare dhe argumentet e ofruara nga Këshilli i Evropës dhe Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së.

### **Argumenti për secilën pakicë:**

*Pakica greke:* Është një pakicë e njohur tradicionalisht që në deklaratën e vitit 1921 për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, njëkohësisht e evidentuar në të gjithë censuset e kryera në Shqipëri.

*Pakica maqedonase:* Është një pakicë e njohur tradicionalisht dhe e evidentuar në të gjithë censuset e kryera në Shqipëri.

*Pakica serbe:* Ka qenë tradicionalisht pjesë integrale e pakicës ser-

bo-malazeze. Në censusin e fundit të vitit 2011 nuk ka të dhëna për personat e vetedeklaruar si të pakicës serbe por vetëm malazezë. Në projektligj janë përfshirë si pakicë për shkak të ekzistencës historikisht si pjesë integrale e pakicë serbo-malazeze dhe ndarjes së shteteve Serbi dhe Mali i Zi. Sipas rekomandimeve të KiE BE censusi nuk duhet të jetë i vetmi element për mbledhjen e të dhënave.<sup>3</sup> Nga të dhënat alternative të organeve shtetërore (prefekturat) ka individë që vetëdeklarohen si përfaqësues të këtij komuniteti. Gjithashtu ka pasur rekomandim të posaçëm nga KiE për ndarjen e evidentimit të pakicave në serbe dhe malazeze bazuar në mundësinë e vetëdeklarimit të shumëfishtë si pjesëtar i pakicës.

*Pakica malazeze:* Është evidentuar tradicionalisht si pakicë, pjesë e pakicës serbo-malazeze gjithashtu e evidentuar në censusin e fundit 2011.

*Pakica boshnjake:* Ka qenë tradicionalisht e evidentuar në Shqipëri që në fillimet e shek. 20. Nuk janë vetëidentifikuar në censuset e mëparshme, por janë të përfaqësuar me shoqata dhe është një komunitet i mirëintegruar në shoqërinë shqiptare. Kjo pakicë është evidentuar si e tillë nga hulumtimet e organeve shtetërore. Ka pasur, gjithashtu, rekomandim të posaçëm nga KiE për evidentimin e kësaj pakice.

*Arumunët:* Janë evidentuar tradicionalisht si pakicë etno-gjuhësore. Gjithashtu ka vijimësi në qëndrimet dhe deklaratimet e mëparshme për njohjen e kësaj pakice si pakicë etno-gjuhësore. Rekomandimi i AP të KiE 1333 (1997) përdor termin “arumun”.

*Pakica egjiptiane:* Pavarësisht se nuk njihet nga Egjipti si pakicë që ka lidhje me këtë shtet projektligji nuk bazohet në parimin e lidhjes së pakicës me një kin-state. Ky komunitet ka ekzistuar tradicionalisht, evidentuar dhe në censusin e fundit, por e veçanta është që nuk karakterizohet nga asnjë prej kritereve të njohjes. Evidentimi si pakicë është rekomanduar nga KiE dhe BE. Ekzistenca e kësaj pakice përbën një fenomen mbarë-europian dhe të dallueshëm nga komuniteti rom. Përfshirja e kësaj pakice në projektligj është vlerësuar dhe nga ekspertiza e KiE.

*Pakica rome:* Është një fenomen europian dhe është evidentuar në Shqipëri si pakicë deri dje etno-gjuhësore. Bazuar në rekomandimet e KiE/BE, nisur dhe nga eksperiencia e vendeve të tjera është konsideruar si pakicë kombëtare<sup>4</sup>.

3. Burimi: Censusi i vitit 1989, Publikim i Drejtorisë së Statistikave, raportuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, raporti i Parë i Dorëzuar nga Republika e Shqipërisë në kuadër të Artikullit 25, paragrafi 1 i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, 2001 Komentet dhe përpunimi: ODA

4. Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, të miratuar me VKM nr.633 datë 18.09.2003, dhe në Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, “Dekada e Përfshirjes së Romëve”

*Pakica bullgare:* Është një pretendim i parashtruar nga shoqatat që pretendojnë se kanë prejardhje etnike bullgare (komunitet që banon kryesisht në zonën e Gollobordës dhe Gores). Gjatë procesit të konsultimit dhe diskutimit në Kuvend janë parashtruar edhe këto pretendime. Njohja si pakicë kombëtare bazohet në qasjen tonë ndaj standarteve ndërkombëtare dhe Konventës Kuadër dhe bazohet në kriteret objektive dhe subjektive që parashikohen nga Konventa Kuadër mbi pakicat dhe kriteret ligjore që përcakton ligji i miratuar.

Këto pakica të evidentuara ndër vite dhe tashmë edhe të përfaqësuara zyrtarisht me një ligj të posaçëm, kanë qenë një pjesë e mirëfilltë e integruar dhe në një qasje pa dallime, me shtetin Shqiptar. Pavarësisht faktit të ngjyrimëve etnike në Republikën e Shqipërisë, fakt shumë i rëndësishëm është pa dyshim edhe largimi i shtetasve shqiptarë, përtej kufijve, pa dallim etnik, kulturor, fetar apo dhe më gjerë karakteristika të një origjine të përcaktuar. Migracioni dhe flukset e refugjatëve, kanë paraqitur mundësi për bashkëpunime të rinovuara rajonale dhe ndërkombëtare, për manaxhimin e situatave të krijuara por edhe të trashëguara të vendit tonë. Procesi i globalizimit kompakt, efektivisht e kërkon këtë. Por sa më shumë të ketë bashkëpunim, aq më tepër të mundësojmë në adresimin e problematikave tona të përbashkëta. Shtetet e BiE, në vazhden kohore, prej disa dekadash, kanë treguar respekt dhe angazhim kundrejt të drejtave të emigrantëve, apo më konkretisht të marrëdhënieve të ndërsjellta të shtetit tonë me shtetet fqinje e më tej i kanë akomoduar ato, sipas mundësive të veta, në një shoqëri interkulturore, ku të gjithëve ju mundësohet akses për të njëjtat mundësi, të drejta e detyra. Ky model është një brand European dhe inspiron botën, duke bërë fushën e BiE një fushë ndërveprimi për hapësirat ndërkufitare, drejt integritit, ku individit mund të triumfojë pavarësisht kombësisë, apo diversitetit kulturor. Pavarësisht këtij fakti, kjo nuk nënkupton se aspekti i sigurisë dhe konkretisht sigurimi i brendshëm, përsa i përket kufijve të BE dhe zonës Shengen, duhet neglizhuar. Por përkundrazi, masat parandaluese janë të fokusuara mbi masat tashmë të radikalizuara, ose duke përqafuar ideologjitë ekstreme të një spektri të gjerë, të përcaktuara dhe të përforcuara. Sfidat e përbashkëta të potencialeve ndërkufitare, si edhe të krizave të emigrimit, duhen adresuar në një ortakëri marrëdhëniesh mes partnerësh. Na nevojitet një bashkëpunim konkret që të mundësojë përgjegjësitë kolektive në veprime kolektive. Ne besojmë se një strategji e mirëkuptueshme, që të çrrënjos këtë fenomen, duhet marrë në konsideratë, po aq sa dimensionet e veta sociale dhe ekonomike. Gjithashtu ne duhet të integrojmë grupe të marxhinalizuara, të cilat janë shpesh të armiqësuara nga rryma sociale dhe të cilat marrin pjesë në konflikte të huaja, më tepër për arsye financiare sesa për ideologji apo besime.

Shqipëria do të vijojë të fuqizojë marrëdhëniet me vendet e rajonit në

interes të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit rajonal dhe perspektivës së përbashkët euro-atlantike, në bazë të të dhënave prej Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, por edhe të Komitetit European.

### **Këshilli i Evropës.**

Në Opinionin e tretë për Shqipërinë të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (nëntor 2011) dhe rezolutën mbi zbatimin e Konventës Kuadër (miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, shkurt 2014) evidentohen rekomandimet e mëposhtme:

- Miratimi i kuadrit ligjor gjithëpërfshirës mbi pakicat, duke eliminuar çdo shkak për trajtimin e diferencuar midis kategorive të pakicave kombëtare dhe etno-gjuhësore. Rekomandohet miratimi i një ligji specifik për pakicat për të qartësuar politikën ndaj pakicave, veçanërisht duke përcaktuar kritere të qarta ligjore të kërkuara për njohjen si një pakicë kombëtare. Një ligj për pakicat do të plotësonte mangësinë ekzistuese dhe do të ndihmonte për qartësimin e politikave ndaj tyre.

- Kuadri institucional për trajtimin e çështjeve të pakicave dhe për strukturimin e dialogut me përfaqësuesit e tyre.

- Përpunimi i të dhënave të censusit në përputhje të plotë me parimin e vetëdeklarimit, procedura të përshtatshme, si dhe forma të tjera të klasifikimit së të dhënave, me qëllim që të ofrohen të dhëna të besueshme.

- Masat që do të mundësonin ndërmarrjen e nismave që kanë si synim mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor dhe gjuhëve të pakicave kombëtare.

- Sigurimi i aksesit të personave që u përkasin pakicave kombëtare, përfshirë edhe grupeve më të vogla në numër, në programet televizive dhe radiofonike në gjuhën e tyre.

- Përmirësimet e nevojshme për përdorimin e gjuhëve të pakicave në marrëdhëniet me autoritetet e administratës, përdorimi i tabelave dygjuhëshe dhe emërtimeve të vendeve në gjuhët e pakicave.

- Vendosja e dialogut të plotë dhe të efektshëm me organizatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe etno-gjuhësore; konsultim për çështje që kanë të bëjnë me to.

- OSBE/ Komisionerja e Lartë për Minoritetet Kombëtare.

Evidentohet mbizotërimi i klimës së respektit dhe tolerancës në Shqipëri.

Lidhur me pakicat, Kushtetuta garanton mbrojtjen e identitetit, kulturës, gjuhës amtare, pjesëmarrjes në jetën publike të tyre. Inkurajohen autoritetet për të përmirësuar kuadrin institucional për adresimin e çështjeve të pakicave dhe forcimin e dialogut me pakicat. Autoritetet shqiptare mund të qartësojnë politikën lidhur me minoritetet duke harmonizuar terminologjinë dhe kriteret ligjore për njohjen si pakicë kombëtare apo komunitet i jo shumicës. Gjithashtu evidentohet progresi i arritur në ngritjen e Grupit të Punës “Për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për pakicat”.

### **REFERENCAT**

1. European Convention on Human Rights, 3 September 1953
2. Ministry for Europe and Foreign Affairs (Albania)
3. Censusi i vitit 1989, Publikim i Drejtorisë së Statistikave, raportuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, raporti i Parë i Dorëzuar nga Republika e Shqipërisë në kuadër të Artikullit 25, paragrafi 1 i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, 2001. Komentet dhe përpunimi: ODA
4. Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, të miratuar me VKM nr.633 datë 18.09.2003, dhe në Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, “Dekada e Përfshirjes së Romëve”
5. Fred, Abrahams (1996). Human rights in post-communist Albania. Human Rights Watch/Helsinki. ISBN 978-1-56432-160-2
6. Minahan, James (2002). Encyclopedia of the stateless nations: ethnic and national groups around the world. Greenwood Publishing Group. p. 218. ISBN 0-313-32384-4.
7. Rexhep Qosja, La question albanaise, Fayard, Paris, 1995.
8. International Herald Tribune. 2008-01-09. Retrieved 2008-03-06

**THE PRESERVE OF CULTURAL IDENTITY OF NATIONAL MINORITIES**

**Dr. Artemis DRALO**

*Deputy Minister, Ministry of Europe and Foreign Affairs*

**Abstract**

*For decades, Albania has shown a harmonious coexistence in the ranks of its ethnic diversity, but not just within its borders. The facts so far are, without doubt, true evidence of a multi-year coexistence of national minorities in Albanian territory and beyond. This best means that the cultural, ethnic, historical and traditional identity of national minorities has been preserved and strengthened as an indisputable right of them. The Republic of Albania has a permanent commitment to the continuous improvement of standards, protection and the respect of human rights, integral part of which are also the rights of minorities. Our country is a party to a number of human rights conventions within the UN, the Council of Europe, including the Framework Convention "On the Protection of National Minorities."*

*In Albania, special attention is paid to good relations, tolerance, cooperation, coexistence and understanding of Albanians with minorities living in its territory, but also in the region or beyond. Albanian state has a positive balance regarding the issue of respect for minority rights, ranking among the states that are engaged in the fulfillment of international standards of minority protection. In no case has any kind of pressure been imposed on changes or non-recognition of ethnic and cultural identities of national minorities. Freedom of expression and self-declaration of different nationalities, based on traditional data or inheritance, has been one of the fundamental rights to existence of all groups minoritare. Pa prejudice to measures taken in accordance with the general policy of integration of national minorities, prohibited policies or practices aimed at assimilation of persons belonging to national minorities against their will.*

**Key words:** *minorities, identity, equality, language, culture, law.*

## NDIKIMI I EMIGRACIONIT NË PLAKJEN E POPULLSISË SË SHQIPËRISË PAS VITEVE '90

Prof. dr. Pal NIKOLLI, Prof. dr. Bilal DRAÇI

### Shkurtesë

Në punim vlerësohen treguesit e plakjes të popullsisë së Shqipërisë (përqindja e të moshuarve, raporti i varësisë së të moshuarve, indeksi i plakjes, moshë medianë, moshë mesatare dhe jetëgjatësia mesatare) për periudhën 1990 - 2060. Këta tregues janë llogaritur në kushtet e ekzistencës së migrimit (Shqipëria përbën rast tipik), ku është marrë parasysh norma e migrimit neto, si dhe në kushtet e supozuara të mungesës së migrimit.

Përveç lindshmërisë dhe vdekshmërisë në rënie, në strukturën e popullsisë së Shqipërisë pas viteve '90 kanë ndikuar fuqishëm edhe proceset përbërëse të emigracionit të vazhdueshëm. Në punim vlerësohet se treguesit e plakjes së popullsisë, do të kishin qenë deri në 4 % - 5% më të ulët, nëse procesi i emigrimit do të kishte qenë i kufizuar dhe i kontrolluar.

Nga analiza e treguesve statistikorë vërehet se, gjatë gjithë periudhës nga viti 2001 deri në projektionin<sup>1</sup> e vitit 2060, rritja mesatare vjetore e popullsisë vlerësohet negative (- 0.7%), ndërsa rritja vjetore e popullsisë së moshës mbi 65 vjeç (65+) vlerësohet pozitive (+ 0.5%).

Me qëllim ngadalësimin e dukurisë së plakjes të popullsisë së Shqipërisë dhe zbutjen e pasojave negative të kësaj plakje, rekomandohet hartimi dhe përpunimi rigoroz dhe i vazhdueshëm *i politikave të emigracionit dhe atyre familjare.*

### 1. Plakja e popullsisë dhe migrimi

Plakja e popullsisë, e njohur edhe si plakje demografike (moshënim demografik; vjetërim i popullsisë, etj), është një term përmbledhës për ndërrimet apo zhvendosjet në shpërndarjen e moshës (në strukturën grupmoshore) së popullsisë

1. Projektionet e popullsisë japin informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit social ekonomik dhe studimin e tregut.

drejt moshave më të vjetra. Niveli dhe ritmi i plakjes së popullsisë ndryshojnë shumë ndërmjet rajoneve dhe brenda rajoneve gjeografike (Samuel H., Himes and Eggers, 1989), si dhe ndërmjet kategorive social-ekonomike. Por, pothuajse të gjitha kombet, aktualisht po përjetojnë një rritje të numrit të banorëve të moshuar të tyre. Si pasojë e drejtpërdrejtë e vazhimit të tranzicionit global të fertilitetit (rënies) dhe rënies së vdekshmërisë në moshat më të vjetra<sup>2</sup>, plakja e popullsisë po ecën me shpejtësi në shumë vende të zhvilluara (industrializuara) dhe në ato në zhvillim. Ky model pritet të vazhdojë përgjatë disa dekadave të ardhshme, duke ndikuar të gjithë botën (Samuel H., Heuveline, and Guillot. 2001).

Sipas parashikimeve aktuale, plakja e popullsisë në gjysmën e parë të këtij shekulli duhet të kalojë atë të gjysmës së dytë të shekullit të XX-të. Për botën si një e tërë, numri i të moshuarve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë do të rritet nga 6.9 % në vitin 2000, në një vlerë të projektuar 19.3% në vitin 2050. Të gjitha rajonet pritet të shohin një rritje, edhe pse më e zbutur në disa prej tyre, si Afrika, ku rritja e parashikuar është nga 3.3 % në vitin 2000 në 6.9 % në vitin 2050, etj. Por, në Amerikën Latine dhe në Karaibe, numri i të moshuarve parashikohet të arrijë në 16.9 % në vitin 2050 (më e lartë se mesatarja aktuale evropiane ) nga 5.4 % që ishte në vitin 2000. Rritja parashikohet të jetë edhe më shqetësuese në Kinë: nga 6.9 % në vitin 2000 në 22.7 % në vitin 2050 (Wolfgang, Sanderson and Scherbow, 2001).

Plakja e popullsisë ka pasoja të rëndësishme socio-ekonomike dhe shëndetësore. Ajo paraqet sfida për shëndetin publik (shqetësime rreth falimentimit të mundshëm të mjekësisë dhe programeve që lidhen me të), si dhe për zhvillimin ekonomik (ngushtim dhe plakje të fuqisë punëtore, falimentim të mundshëm të sistemeve të sigurimeve shoqërore, etj). Me moshimin e kombeve, pritet të rriten në mënyrë dramatike prevalenca e aftësisë së kufizuar, dobësia dhe sëmundjet kronike (sëmundjet Alzheimer, kanceri, sëmundjet kardiovaskulare, etj). Disa ekspertë ngrenë shqetësimin se njerëzimi mund të bëhet një “shtëpi globale pleqsh” (Eberstadt, 1997).

Shkalla e plakjes së popullsisë mund të modelohet gjithashtu edhe nga migrimi. Efektet e migrimit në plakjen e popullsisë janë zakonisht më të ndjeshme në popullsitë më të vogla, për arsye të peshës relative (përqindjes) më të lartë të migrantëve në popullsi të tilla.

Emigracioni<sup>3</sup> e ka shpejtuar dukurinë e plakjes së popullsisë në Shqipëri, për shkak se emigrantët kanë qenë të moshës së re dhe me shumë fëmijë. Nga ana tjetër, edhe emigrimi i të rriturve në moshë pune e ka përshpejtuar plakjen e popullsisë.

2 Nga rënia e mëtejshme e vdekshmërisë, gjithnjë përfitojnë moshat më të vjetra. Ky ndryshim dhe rënia e lindshmërisë kontribuojnë në strukturën moshore si një proces i dyfishtë i plakjes së popullsisë. Rënia e vdekshmërisë, e cila është e përqëndruar në grupmoshat e mëdha, po bëhet një përcaktues i rëndësishëm i plakjes së popullsisë, veçanërisht tek gratë.

3 Vlerësohet se rreth 30% e popullsisë së Shqipërisë (1989) ka emigruar nëpër botë.

Plakja e popullsisë në Shqipëri, është përshpejtuar edhe nga kthimi i pensionistëve të moshuar nga vendet e tjera dhe kthimi i ish emigrantëve të cilët janë mbi moshën mesatare të popullsisë.

Migrimi do të ketë një rol më të rëndësishëm në plakjen e popullsisë dhe në disbalancat grupmoshore në të ardhmen, krahas nivelit të ulët të fertilitetit<sup>4</sup>, të mortalitetit dhe rënies së numrit të popullsisë.

## 2. Treguesit statistikorë të plakjes së popullsisë së Shqipërisë dhe vlerësimi i tyre

### 2.1 Konsiderata teorike

Studimi i plakjes së popullsisë është i motivuar ekonomikisht edhe nga shqetësimi në lidhje me rëndimin e sistemeve të pensioneve. Nga ky aspekt, plakja e popullsisë matet shpesh me rritjen e përqindjes të të moshuarve pensionistë dhe individëve në moshën e daljes në pension si dhe me rritjen e treguesit të varësisë. Moshja e daljes në pension mund të jetë e ndryshme për vende të ndryshme, por ajo më tipike është moshja 65 vjeç. Në ditët e sotme një shoqëri konsiderohet relativisht e vjetër, kur numri i të moshuarve 65+ vjeç kalon 10% (8-10%) të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Me këtë standard, shoqëria amerikane (SHBA) konsiderohet relativisht e vjetër, pasi që nga viti 2000 përqindja e njerëzve të moshuar<sup>5</sup> ishte 12.6% (Kevin and Velkoff. 2001).

Një tregues që lidhet me plakjen së popullsisë është edhe raporti i varësisë së të moshuarve - *“numri i të moshuarve mbi 65 vjeç në raport me numrin e popullsisë në grupmoshën e punës”*. Për lehtësi, moshja e punës mund të supozohet të fillojë në 15 vjeç, megjithë numrin në rritje të personave që ndjekin studimet e tyre edhe pas kësaj moshe e që mbeten, ndërkohë, financiarisht të varur, ose nga shteti, ose gjithnjë e më shumë, nga prindërit e tyre apo menaxherët e bankës. Raporti i popullsisë së moshuar ndaj popullsisë ekonomikisht aktive (të punësuar) njihet edhe si raporti i varësisë së pleqërisë, raporti i varësisë së moshës, ose barra e varësisë së të moshuarve dhe përdoret për të vlerësuar transfertat-kalimet e gjeneratave, politikat tatimore dhe sjelljen ndaj kursimeve.

Një tregues tjetër i strukturës moshore është indeksi/treguesi i plakjes (nga një herë i referuar si raport i numrit të të moshuarve ndaj numrit të fëmijëve), i përcaktuar si numri i të moshuarve mbi 65 vjeç për 100 të rinj nën moshën 15 vjeç. Referuar organizmave dhe autorëve studiues të fushës, deri në vitin 2030 indeksi i

<sup>4</sup> Aktualisht norma e fertilitetit është 1.7 fëmijë për grua, nën nivelin e zëvendësimit.

<sup>5</sup> Numri i të moshuarve në SHBA, në vitin 1900 përbënte vetëm 4.1% të popullsisë, ndërsa në vitin 2030 parashikohet të arrijë në 20%.

plakjes është parashikuar të kalojë 100 në të gjitha vendet e zhvilluara dhe në disa vende evropiane dhe Japoni pritet të kalojë edhe 200. Deri më sot, indeksi i plakjes është shumë më i ulët në vendet në zhvillim se sa në botën e zhvilluar, por rritja proporcionale e indeksit të plakjes në vendet në zhvillim pritet të jetë më e madhe se sa në vendet e zhvilluara.

Këta tregues të plakjes së popullsisë janë thjesht raporte njehsimi, që do të thotë se ato, thjesht kanë të bëjnë me numrin e individëve në kategoritë e moshave të mëdha. Këta tregues nuk arrijnë të marrin në konsideratë shpërndarjen moshore brenda këtyre kategorive, në mënyrë të veçantë brenda kategorisë së të moshuarve. Kur tendencat e fertilitetit dhe mortalitetit, përgjegjëse për plakjen e popullsisë, janë mjaft të rregullta me kalimin e kohës, rritja e popullsisë lidhet pozitivisht me moshën (d.m.th., grupmoshat më të vjetra janë në rritje më të shpejtë). Kjo do të thotë se në qoftë se është në rritje përqindja e popullsisë 65+ vjeç, atëherë brenda kësaj popullsie, rritet shumë edhe përqindja e nën grupeve të popullsisë 65+ vjeç. P.sh., themi se, numri i të moshuarve 80+ vjeç është gjithashtu në rritje. Ashtu siç ndryshojnë në masë të madhe shëndeti, gjendja financiare dhe modelet e konsumit në mes të 65 vjeçarëve dhe 80 vjeçarëve, ashtu edhe raportet e thjeshta fshehin heterogjenitet të rëndësishëm në popullsinë e moshuar. Vëmendje i kushtohet gjithnjë e më shumë “moshës më të vjetër” (në mënyrë tipike moshës 80+ vjeç). Për kuriozitet, numri i njëqindvjeçarëve është në rritje edhe më të shpejtë. Vlerësuar në 180.000 në gjithë botën në vitin 2000, ai mund të arrijë në 1 milion deri në vitin 2030 (*Kombet e Bashkuara, 2001*).

Për të marrë në konsideratë shpërndarjen moshore brenda kategorive, përdoret klasa e dytë e treguesve të plakjes së popullsisë ose ndryshe, grupi i masave statistikore të vendndodhjes (mediana, mesatarja dhe mosha modale e popullsisë). Mosha medianë<sup>6</sup>, mosha në të cilën, saktësisht, gjysma e popullsisë është më e vjetër dhe gjysma është më e re, është ndoshta treguesi gjerësisht më i përdorshëm. Për të studiuar dinamikën e plakjes së popullsisë më e preferuar është mosha mesatare e popullsisë.

Meqenëse plakja e popullsisë i referohet ndryshimeve të ndërlidhura në të gjithë shpërndarjen e moshës, çdo tregues i vetëm është i pamjaftueshëm për ta matur atë. Gjithashtu, shpërndarja e moshës së popullsisë është shpesh shumë e parregullt dhe reflekton shenjat e ngjarjeve të kaluara, prandaj kjo shpërndarje nuk mund të përshkruhet vetëm nga një numër/tregues pa humbje të konsiderueshme të informacionit.

Kështu, qasja më e përshtatshme për të studiuar plakjen e popullsisë është shqyrtimi i shpërndarjes moshore përmes:

<sup>6</sup> Për vitin 2000, mosha medianë në Shtetet e Bashkuara ishte 36 vjeç, një moshë tipike për vendet më të zhvilluara dhe dy herë sa mosha medianë për Afrikën (Kombeve të Bashkuara 2001).

- (a) përqindjes së të moshuarve mbi 65 vjeç;
- (b) raportit të varësisë të të moshuarve - raporti i numrit të të moshuarve mbi 65 vjeç ndaj numrit të popullsisë ekonomikisht aktive (të punës);
- (c) indeksit të plakjes - numri i të moshuarve mbi 65 vjeç për 100 të rinj nën moshën 15 vjeç;
- (d) Moshës medianë;
- (e) Moshës mesatare;

### 2.1. Llogaritja e treguesve të plakjes dhe korrelacionit<sup>7</sup> të tyre me migracionin

Për llogaritjen dhe analizën e treguesve të plakjes së popullsisë së Shqipërisë janë përdorur të dhënat e mëposhtme:

- (a) Numri i popullsisë sipas grupmoshave në vite të ndryshme deri në parashikimin e vitit 2060 (tab. 2.2.1);

*Tab. 2.2.1. Popullsia e Shqipërisë sipas grupmoshave (në - mijë banorë) (1990 - 2060). Për periudhën 2015 – 2060, parashikimet janë llogaritur sipas skenarit të mesëm*

Vitet	1990	1995	2000	2005	2010	2015	2020
<b>0 - 14 vjeç</b>	1 073	1 014	945	812	657	538	534
<b>15 - 64</b>	2 028	1 892	1 956	1944	1 948	2 000	1 981
<b>65+</b>	181	200	220	263	314	359	421
<b>Total</b>	3 282	3106	3121	3019	2919	2 897	2 935

Vitet	2025	2030	2035	2040	2045	2050	2055	2060
<b>0 - 14 vjeç</b>	568	552	501	442	404	390	386	374
<b>15 - 64</b>	1 891	1 823	1 788	1 765	1 740	1 679	1 562	1 416
<b>65+</b>	501	579	626	648	641	642	687	763
<b>Total</b>	2 960	2 954	2 915	2 855	2 785	2 710	2635	2 554

**Burimi:** United Nations, Population Division, Department of Economic and Social Affairs. INSTAT, 2014

- (b) Norma e migrimit neto (për 1000 banorë) në vite të ndryshme deri në parashikimin e vitit 2060 (tab. 2.2.2)

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

Tab. 2.2.2. Norma e migrimit neto (për 1000 banorë). Për periudhën 2015 – 2060, jepet parashikimi sipas skenarit të mesëm

Varianti	1990-1995	1995-2000	2000-2005	2005-2010	2010-2015	2015-2020	2020-2025
Mesatar	-27.8	-11.5	-11.3	-16.9	-6.3	-3.4	-3.4

Varianti	2025-2030	2030-2035	2035-2040	2040-2045	2045-2050	2050-2055	2055-2060
Mesatar	-3.4	-3.4	-3.5	-3.5	-3.6	-3.6	-3.5

**Burimi:** United Nations, Population Division, Department of Economic and Social Affairs.

Nga përpunimi i të dhënave të tabelave 2.2.1 dhe 2.2.2 janë llogaritur treguesit numerik të plakjes së popullsisë<sup>8</sup> (tab. 2.2.3), të cilët jepen edhe në figurat/grafikët 2.2.1:

Tab. 2.2.3. Treguesit e plakjes së popullsisë (1990 – 2060)

Vitet	% e të moshuarve	Raporti i varësisë së të moshuarve (%)	Indeksi i plakjes	Moshë medianë		Moshë mesatare	Jetëgjatësia mesatare
1	2	3	4	5	6	7	8
1990	5.5	8.9	16.9	24.1	Pa migracion	26	71.96
1995	6.4	10.6	19.7	24.7			72.24
2000	7.0	11.2	23.3	27.1		30.1	74.27
2005	9.1	13.5	32.4	29.3			76.09
2010	10.9	16.1	47.8	33.1		34.8	77.04
2015	12.4	17.9	66.7	34.3		34.3	37.2
2020	14.4	21.2	78.8	35.2	34.9	38	78.89
2025	16.9	26.5	88.2	37	36.5	40	79.82
2030	19.3	31.8	104.9	39	38.4	42.5	80.72
2035	21.5	35.0	124.9	41.5	40.6	45	81.61
2040	22.7	36.7	146.6	43.9	42.7	47	82.49
2045	23	36.8	158.7	46.2	44.6	49	83.31
2050	23.6	38.2	164.6	47.6	45.5	50.5	84.07
2055	26.1	44.0	178	48.1	45.3	51	84.79
2060	39.9	53.9	204	48.2	45.9	51.5	85.42

Përpunuar në bazë të të dhënave të “United Nations, Population Division, Department of Economic and Social Affairs”.





Fig. 2.2.1. Varësia grafike e treguesve të plakjes së popullsisë së Shqipërisë (1990 – 2060)

Për të parë ndikimin e migrimit në treguesit e plakjes së popullsisë (1990 – 2060) janë llogaritur koeficienti i korrelacionit<sup>9</sup> (r) dhe gabimi i këtij koeficienti ( $m_r$ ) ndërmjet çdo treguesi dhe normës së migrimit neto (NMN) me formulat:

$$r = \frac{n \sum_{i=1}^n x_i y_i - \sum_{i=1}^n x_i \sum_{i=1}^n y_i}{\sqrt{(n \sum_{i=1}^n x_i^2 - (\sum_{i=1}^n x_i)^2)(n \sum_{i=1}^n y_i^2 - (\sum_{i=1}^n y_i)^2)}}$$

$$m_r = [(1-r^2)/\sqrt{n}]$$

Ku:  $x_i$  – vlerat e treguesve të plakjes së popullsisë,  
 $Y_i$  – vlerat e Normës së Migrimit Neto (NMN),  
 $n$  – numri i të dhënave, rezultateve të matjeve  
 Rezultatet e llogaritjeve jepen në tabelën 2.2.4.

Tab. 2.2.4.

Treguesit e plakjes (1990 – 2060)	NMN (1990 – 2060)	Koeficienti Korelacionit (r)	Gabimi $m_r$ i r
Përqindja e personave të moshuar	NMN (për 1000 banorë)	0.73	0.12
Raporti i varësisë së të moshuarve	NMN (për 1000 banorë)	0.74	0.11
Indeksi i plakjes	NMN (për 1000 banorë)	0.77	0.10
Mosha medianë	NMN (për 1000 banorë)	0.79	0.09
Mosha mesatare	NMN (për 1000 banorë)	0.81	0.08
Jetëgjatësia mesatare	NMN (për 1000 banorë)	0.68	0.13

### 3. Analizë e treguesve të korrelacionit: disa përfundime dhe rekomandime

Plakja e popullsisë është një fenomen shqetësues në pjesën më të madhe të Botës, e veçanërisht në vendet e zhvilluara me lindshmëri të ulët.

Rënia e lindshmërisë poshtë nivelit të zëvendësimit (2.3 fëmijë për nënë), ka rritur frikën se shumë vende nuk do të kenë numër të mjaftueshëm punonjësish për të mbajtur një numër gjithnjë e në rritje të moshuarish.

Vlerat e koeficienteve të korrelacionit (tab. 2.2.3) tregojnë për një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të fortë pozitive të migrimit me plakjen e popullsisë në Shqipëri. Meqenëse, në të gjitha rastet,  $r > m_r$ , lidhja ndërmjet treguesve të plakjes dhe shkallës së emigracionit, është e qëndrueshme.

Por, rritja e treguesve të plakjes së popullsisë së Shqipërisë ka ndodhur për

disa arsye kryesore:

- Ulja drastike e fertilitetit, si prirje botërore në fazat e fundit të tranzicionit demografik, ku përfshihet dhe Shqipëria. Në vitin 2015, norma e lindshmërisë ishte 1.67 fëmijë/grua. Ky tregues është nën normën e zëvendësimit (2.1 fëmijë/grua). Në vitin 1960, ky tregues kishte vlerën max (7 fëmijë/grua); në vitin 1970, 5 fëmijë/grua; në vitin 2001, 2.3 fëmijë/grua; në vitin 2012, 1.72 fëmijë/grua. Me këto ritme në rënien e lindshmërisë, Shqipëria është vendi i tretë në Botë me plakjen më të shpejtë të popullsisë, pas Koresë dhe Rusisë. Në Francë, u deshën 2 shekuj që lindshmëria të binte nga 5 fëmijë/grua në nën normën e zëvendësimit të popullsisë. Në Shqipëri kjo ndodhi në vetëm 34 vite.
- Emigracioni luan rol të rëndësishëm në procesin e plakjes së popullsisë, pasi pjesa më e madhe e emigrantëve janë të rinj (mesatarisht); flukset dalëse migratore, prekin popullsinë e moshës 20 – 40 vjeç (0- 14 vjeç, ≈ 14.34 % e emigrantëve, 15 – 64 vjeç, ≈ 80.66 % dhe 65+ vjeç, ≈ 5 %); popullsia jonë është reduktuar për shkak të këtij fenomeni. Emigracioni e shpejton plakjen e popullsisë.
- Rritja e jetëgjatësisë çon në plakjen e popullsisë.

Nëse llogaritet parashikimi i dinamikës së grup moshave kryesore të popullsisë për periudhën 2001 - 2020, duke marrë për bazë të dhënat e regjistrimit të vitit 2001 dhe duke supozuar Vdekshmëri të Ulët<sup>10</sup> (VU), Lindshmëri të Ulët<sup>11</sup> (LU) dhe mungesë Migracioni<sup>12</sup> (PaM) (tab. 3.1), do të kemi treguesit e mëposhtëm të plakjes së popullsisë në % (në kushtet e ekzistencës së migracionit duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë të matur nga INSTAT – i, dhe të mungesës së migracionit duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë nga tab. 3.1) (tab. 3.2):

*Tab. 3.1. Popullsia e supozuar (projektuar) sipas grupmoshave në kushtet e mungesës së migracionit, llogaritur në bazë të regjistrimit 2001*

<b>Grup moshat</b>	<b>2001</b>	<b>2005</b>	<b>2010</b>	<b>2015</b>	<b>2020</b>
<b>0-14</b>	<b>(Popullsia nisëse)</b> 905131	847881	774334	723235	683349
<b>15-64</b>	1930755	2084410	2253343	2389864	2469018
<b>64+</b>	227432	266186	316308	352700	402330
<b>Popullsia gjithsej</b>	3063318	3198477	3343985	3465799	3554697

Burimi: INSTAT

Tab. 3.2. Treguesit e plakjes së popullsisë në kushtet e ekzistencës së migracionit (të dhënave të matura) dhe të mungesës së migracionit (vlerave të projektuara të popullsisë).

Treguesit	Kushtet	2005	2010	2015	2020
Përqindja e personave të moshuar	Me emigracion	9.1	10.9	12.5	14.4
	Pa emigracion	8.3	9.4	10.2	11.3
Raporti i varësisë së të moshuarve	Me emigracion	13.5	16.1	18.3	21.0
	Pa emigracion	12.8	14.1	14.8	16.3
Indeksi i plakjes	Me emigracion	32.4	47.7	72.2	85
	Pa emigracion	31.4	40.8	48.8	58.9

Nga analiza e tabelës 3.2. shihet se si rezultat i emigracionit masiv të shqiptarëve, treguesit statistikorë të plakjes së popullsisë janë rritur:

- Përqindja e personave të moshuar, deri në 3 %
- Raporti i varësisë së të moshuarve, deri në 4 %
- Indeksi i plakjes, deri në 20 %

Plakja e popullsisë është e pashmangshme edhe në të ardhmen, por rritja e normës së lindshmërisë dhe zvogëlimi i migrimit neto me politika rregulluese, do ta ngadalësonin ndjeshëm atë. Prandaj, duhen marrë masa në drejtim të *përmirësimit të politikave të emigracionit dhe atyre familjare*.

### Literatura

1. Draçi Bilal, Nikolli Pal. Albanian Migration to the U.S.A. Geo-Historical Research Contributions. The Mediterranean Journal of Social Sciences in the Vol. 5, No. 1, January 2014. Romë. Italy.
2. Eberstadt, N. 1997. "World population implosion?" Public Interest, 129: 3-22.
3. INSTAT. Projektionet e popullsisë, 2011-2031, Maj, 2014.
4. Kinsella Kevin and Victoria A. Velkoff. 2001. An Aging World: 2001. U. S. Census Bureau, Series P95/01-1, Washington, DC: U.S. Government

Printing Office.

5. Lutz Wolfgang, Warren Sanderson and Sergei Scherbow. 2001. "The end of world population growth." *Nature* 412: 543-545.
6. Preston Samuel H., Patrick Heuveline and Michel Guillot. 2001. *Demography. Measuring and Modeling Population Processes*. Oxford: Blackwell.
7. Preston Samuel H., Christine Himes and Mitchell Eggers. 1989. "Demographic conditions responsible for population aging." *Demography* 26: 691-704.
8. Sheri F. Popullsia e botës. Nëntor 2006. Shtëpia botuese Albpaper. Tiranë.
9. Tirta M. Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Lëvizjet migruese të shqiptarëve, tëbrendshme në më të afërt. Tiranë 2013.
10. United Nations 2001. *World population prospects: the 2000 revision*. New York: United Nations.
11. United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Population Division (2015). *World Population Prospects: The 2015 Revision*, DVD Edition.

## THE IMPACT OF EMIGRATION IN THE AGING OF ALBANIAN POPULATION AFTER THE 90s OF THE XX CENTURY

### Abstract

The paper evaluates the indicators of aging of the Albanian population, (percentage of older people, dependency ratio of older people, aging index, median age, average age and average life expectancy) for the period 1990 – 2060. These indicators are calculated in terms of the existence of migration (Albania is a typical case), where the net migration rate is taken into account, as well as the assumed conditions of lack of migration. In addition, to declining fertility and mortality, the structure of Albania's population after the 1990s has been strongly influenced by the constituent and continuous processes of emigration. The paper estimates that the indicators of population aging would have been up to 4% - 5% lower, if the emigration process had been limited and controlled. Refer to the analysis of statistical indicators it is noticed that, throughout the period from 2001 to the projection of 2060, the average annual population growth is estimated negative (- 0.7 %), while the annual growth of the population over the age of 65 (65+) is assessed as positive (+ 0.5 %). In order to slow down the phenomenon of aging of the Albanian population and to mitigate the negative consequences of this aging, it is recommended to design and elaborate rigorous and continuous immigration and family policies.

## EFEKTET E MIGRIMIT NË BASHKINË DROPULL

Prof. asoc. Albina SINANI<sup>5</sup>, Prof. dr. Gëzim SALA<sup>6</sup>, Dr. Irena BOBOLI<sup>7</sup>

### Abstrakt

*Popullsia e bashkisë Dropull ka pësuar ndryshime të thella gjatë më shumë se dy dekadave të fundit të një procesi të gjatë tranzicioni. Ky referat analizon efektet e migrimit, modelin e tij dhe fokusohet në impaktin e emigrimit në regjimin demografik të hapësirës në studim. Emigrimi ka startuar herët në bashkinë Dropull (fund-viti 1990). Kjo dukuri si shkak dhe pasojë ka përcaktuar reduktimin numerik të kësaj popullsie si dhe modifikime në përbërjen e saj strukturore (me tendenca moshimi). Sipas Regjistrimit të fundit të popullsisë (2011), bashkia ka humbur 80.4% të popullsisë së vitit 1989. Forca më e madhe e emigrimit evidentohet në vendbanimet rurale të lartësive të mëdha hipsometrike (Pogon). Si dukuri shumëdimensionale, emigrimi është shoqëruar me efekte pozitive dhe negative në këndvështrimin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor. Në vitet e para ky fenomen rezultoi intensiv, tipar të cilin nuk e ruan më pas. Emigrimi është një fenomen i pandërprerë (për aq kohë sa ekzistojnë pabarazitë në zhvillim) e në këto rethana, menaxhimi i tij përbën një domosdoshmëri. Në këtë aspekt nevojitet rishikimi i politikave të zhvillimit rajonal nëpërmjet strategjive për uljen e varfërisë, nxitjen e rritjes ekonomike, integrimin e emigrantëve të kthyer etj. Ky punim synon të shpjegojë rolin që ka luajtur ky fenomen në drejtim të burimeve njerëzore të bashkisë, nivelit të papunësisë, parametrave demografikë, ekonomikë etj. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar, sintetizuar e komentuar në funksion të arritjes së objektivave të studimit, me një larmi metodash kërkimore-studimore. Dukuria e emigrimit është komplekse dhe e vështirë për tu administruar. Gjithsesi nuk duhet të lihet spontaniteti, por domosdoshmërisht të jetë e kontrolluar.*

5. Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Gjirokastrës.

6. Departamenti i Historisë, Universiteti i Gjirokastrës.

7. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Universiteti i Gjirokastrës.

**Fjalët kyçe:** migrim, punësim sezonal, remitanca, tranzicion, politika zhvillimore.

### Hyrje dhe një vështrim i përgjithshëm

*“Migrimi paraqet sfidat e politikave – por gjithashtu përfaqëson një mundësi për ti dhënë shtysë zhvillimit njerëzor, aktiviteteve me vlerë si dhe konsolidimin e bashkëpunimit” (Ban Ki-moon)*


Përgjatë historisë, sidomos pas vitit 1990, si pasojë e ndryshimeve politike dhe social-ekonomike ndodhi lëvizja e pashmangshme e forcës punëtore. Efekti migrues u ndje fuqishëm edhe në vitin 1997, me falimentimin e firmave piramidale. Ky proces ka qënë i vazhdueshëm në këto tri dekadat e fundit, në formën e një lavjerrësi duke sjellë një ndikim të dukshëm në formimin e identitetit në rrugën e vështirë të integritit. Pas vitit 2011 u shfaq dukuria e migrimit të kthimit, për shkak të krizës ekonomike në Eurozonë (Greqi). Studimi i literaturës dhe komponentët e vjelë në terren janë përdorur për të hartuar strategji në nivel vendor, për të forcuar marrëdhëniet e komuniteteve ndërkuftare. Studimi thekson gjithashtu rolin që ka qeverisja vendore në këtë proces kompleks dhe zbulon premisat e nevojshme në gjetjen e formave efektive të bashkëpunimit ndërkuftar, si hallkë e rëndësishme në krijimin e një eurorajoni strategjik në Ballkanin Jugor.

### 1. Metodologjia

Studimi është realizuar në disa faza: *gjatë fazës së parë* u mbledh një informacion i bollshëm, raporte, studime ekzistuese dhe një sërë materialesh vjelë nga Instat dhe zyra e bashkisë, në Jorgucat; *gjatë fazës së dytë* u realizuan hulumtime në terren, u mbledhën të dhëna sasiore, u përdorën shënime etnografike dhe hulumtime arkivash, nga interneti si dhe publikime të shtypit, ndërsa *gjatë fazës së tretë*, u bë analiza dhe interpretimi i të dhënave dhe hartimi përfundimtar i studimit. Kombinimi i vrojtimit në terren me literaturën e shqyrtuar bënë të mundur gërshetimin e të dhënave cilësore dhe sasiore, organizimin, studimin dhe interpretimin e tyre për përgatitjen finale të punimit, duke mundësuar hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të duhura.

## 2. Bashkia Dropull, jeta e re në rrugën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar

Me ndarjen e re administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, në 1 shtator 2014, bashkia Dropull përfaqëson një nga 7 bashkitë e qarkut Gjirokastrër, në jug të Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup>, me sipërfaqe prej 466.7 km<sup>2</sup> dhe dendësi 7.9 b/km<sup>2</sup>.



Harta 1. Pozita gjeografike e bashkisë Dropull (A. Sinani)

Qendra e bashkisë u zgjodh Jorgucati: me pozicion gjeografik të përshtatshëm në qendër të Dropullit; në degëzimin e rrugëve nacionale Gjirokastrër-Kakavie dhe Gjirokastrër- Sarandë; si qendër e hershme administrative që në vitet 1923 dhe deri në ditët e sotme. Bashkia shtrihet përgjatë luginës së Drinos dhe Pogonit dhe kufizohet në veri me bashkitë Libohovë dhe Gjirokastrër. Ajo përbëhet nga 3 njësi administrative (Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogon) dhe ka nën administrimin e saj 41 fshatra: 16 në Dropullin e Poshtëm; 18 në Dropullin e Sipërm dhe 7 në Pogon dhe shtrihen në relievin kodrinor; mjaft i përshtatshëm për zhvillimin e ekonomisë bujqësore.




Foto 1. Fshati Goranxi Foto 2. Fshati Jorgucat Foto 3. Fshati Poliçan (A. Sinani)

Minoriteti Grek identifikohet me krahinën e Dropullit, një trevë e pasur etnokulturore, me tradita të lashta folklorike, monument i rëndësishëm i identitetit etnik. *Bashkëpunimi ndërkuftar* konsiderohet mjetei efektiv në zhvillimin ekonomik rajonal, ku nuk mungojnë programet dhe përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve vendore (shoqërisë civile dhe bashkësisë akademike).



Foto 4. Pika doganore e Kakavies (A. Sinani)

Në këtë kuadër, afërsia e dy universiteteve kufitare, Universitetit të Janinës dhe Universitetit “Eqrem Çabej”, përbën një avantazh të rëndësishëm në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional përballë sfidave të mijëvjeçarit të ri dhe procesit të integritimit evropian të rajonit. Në integrimin ndërkuftar, shumë i rëndësishëm është kontributi i medias vendore, përmes tematikave të trajtuara dhe përcjelljes së informacioneve të bollshme mbi marrëdhëniet ndërkufitare dhe mirëkuptimin reciprok. Aspekt tjetër i bashkëpunimit dhe burim i madh të ardhurash është tregtia ndërkufitare, lidhjet ekonomike dypalëshe, nismat e suksesshme ndërkufitare në fusha me interes të përbashkët si: fusha e turizmit, mbrojtjes së mjedisit, biznesit, agrobiodiversitetit, traditave të hershme artizanale, zejeve të ndryshme, arsimit, kulturës etj.

### 3. Njohuri të përgjithshme mbi fenomenin e migrimit në bashkinë Dropull

*3.1. Fenomeni i migrimit, si dukuria më karakteristike në këtë gjeohapsirë, me profil të qartë emigrator.*

Si dukuri shumëdimensionale, emigrimi në bashkinë Dropull përfaqëson forcën historike, e cila e formësoi fizionominë e saj. Ai është manifestuar në dy forma kryesore: emigrim i përhershëm me familjen ose për bashkim familjar dhe emigrim i përkohshëm (afatshkurtër ose sezonal). Ky fenomen kompleks është produkt i faktorëve tërheqës (afërsia me një vend të BE-Greqinë; ribashkimi familjar; vështirësitë ekonomike; problemet e pronësisë mbi tokën; vështirësitë në zhvillimin e bujqësisë dhe aktiviteteve jobujqësore; rënia ekonomike, nivel i ulët i të ardhurave, vështirësi në aksesin e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale) dhe afërsia kufitare me Greqinë (aksesi për informacionin e shpejtë, kontaktet me familjarët apo miqtë e rretheve shoqërore; ribashkimi familjar; përvoja dhe tradita e hershme e emigrimit; lidhjet etnike, historike, kulturore, gjuhësore, fetare dhe shpirtërore; diferencat në paga; nevoja për fuqi punëtore stinore; mundësitë e legalizimit të dokumentacionit; mundësitë e integritimit; distanca gjeografike e vogël; ekzistenca e komuniteteve të migrantëve etj). Greqia ka shërbyer për banorët e bashkisë si trampolinë për të migruar në vende të tjera të destinacionit si: Itali, Kanada, Francë, Gjermani, Mbretëri e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por pas vitit 2011 njihet edhe kthimi vullnetar, kryesisht i meshkujve, për shkak të krizës ekonomike në Eurozonë (Greqi). Në valën e emigrimit është përfshirë popullsia e re në moshë, krahu i aftë për punë dhe intelektualët, të gatshëm ta braktisin bashkinë. Edhe pse “kthimi i trurit dhe kulturës” përbën një “slogan”, banorët e bashkisë kanë krijuar ndër shekuj një pasuri kolosale intelektuale, profesionale, shpirtërore dhe materiale kudo ku ata kanë emigruar. *Bilanci negativ i migrimit pasqyrohet në aspektin demografik: humbjen e popullsisë në moshë pune, shpopullimin e fshatrave malore, deformimin e strukturës gjinore, moshore, cilësore, uljen e aftësisë riprodhuese të popullsisë, përshpejtimin e plakjes demografike; aspektin ekonomik: dëmtimin dhe amortizimin e infrastrukturës, rritjen e papunësisë, braktisjen e tokës bujqësore, uljen e sipërfaqes së punëshme, rënien e prodhimit bujqësor, uljen e të ardhurave në njësitë ekonomike familjare; aspektin social-psikologjik dhe kulturor: uljen e nivelit arsimor, vështirësi në integrimin e popullsisë së zhvendosur; aspektin mjedisor: ndërtime spontane, zënie të tokave bujqësore, degradim të mjedisit e biodiversitetit etj.*

**3.2.** Dinamika e popullsisë në bashkinë Dropull, analizuar në retrospektivë

Në këto tri dekadat e gjata të tranzicionit, krahinës së Dropullit i është rikthyer plaga e vjetër e emigrimit, një kalvar i dhimbshëm i humbjes së buri-meve njerëzore të bashkisë. Kthehemi në retrospektivë dhe kujtojmë se që pas vitit 1840, varfëria e thellë e detyroi popullsinë të mërgonte (Pogon në masën 70%), ku meshkujt përbënin 99% të *emigrantëve të jashtëm* (mosha 18-35 vjeç). Rreth 70% e të emigruarve i takojnë periudhës 1920-1938, kryesisht në SHBA dhe Australi (2500 veta). Vetëm në vitin 1939 kishte në mërgim: nga Bularati mbi 500 veta; Derviciani 410; Sopiku 200; Poliçani 280; Goranxia 110<sup>9</sup>, por kishte edhe shpërngulje nga fshatrat malore të njërive Pogon dhe Dropull i Sipërm drejt fshatrave fushore të fushës së Dropullit, përgjatë luginës së Drinos, madje kishte fshatra si fshati Katund i njësisë Jorgucat, i cili me Dekretin e ndarjes së re administrative, nr. 546, dt 06.11.1947, nuk figuroi më si fshat. Pas 1990, u kalua në shoqëri të hapur, e cila i hapi rrugën lëvizjes së lirë të njerëzve, transformimeve të thella social-ekonomike e kulturore.

*Dinamika e numrit të përgjithshëm të popullsisë në bashkinë Dropull në periudhën 1923-2011*

*Pasqyra 1*

Vitet	1923	1945	1969	1989 <sup>10</sup>	2001 Instat <sup>11</sup>	2011 Instat <sup>12</sup>
Bashkia Dropull	15735	11862	15763	17877	16990	3503
Dropull i Poshtëm	3310	2774	6524	7587	7558	2100
Dropull i Sipërm	7482	5843	6894	7819	8525	971
Pogon	4943	3245	2345	2471	907	43

Burimi: *Regjistrimet e popullsisë 1923, 1945, 1969, 1989; Instat 2001 dhe 2011 (popullsi prezente).*

*Gjatë periudhës 1989-2011, bashkia humbi 80.4% të popullsisë së 1989 (81.2% elementi mashkull, i cili dominon emigrimin e jashtëm), me shifra rekord Dropulli i Sipërm dhe Pogoni, përkatësisht -88.4% dhe -84%.*

#### *Popullsia gjithsej dhe dinamika e saj, 1923-2011*

10. *Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave 1989*, Tiranë 1991.


11. Instat, *Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2001, Popullsia e Shqipërisë*, Gjirokastër 6, 2001, Tiranë 2004, faqe 108-140.

12. *Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011*, Gjirokastër 2011, Instat 2013, faqe 84-104.

Pasqyra 2

Viti	Popullsia gjithsej	Dinamika (%)
1923	15735	100
1945	11862	75.4
1969	15763	100.2
1989	17877	113.6
2001	16990	108.0
2011	3503	22.3


Burimi: Regjistrimet e popullsisë 1923, 1945, 1969, 1989; Instat 2001 dhe 2011.



Nga të dhënat e pasqyrës dhe grafikut të mësipërm rezulton se gjatë periudhës 1923-2011, bashkia i ka kaluar të gjitha fazat e tranzicionit demografik: popullsia rritet me ritme të ulëta sepse lindshmëria dhe vdekshmëria janë të larta; popullsia rritet sepse lindshmëria është e lartë dhe vdekshmëria është e ulët dhe popullsia ka ulje për faktin se lindshmëria dhe vdekshmëria janë në nivele të ulëta<sup>13</sup>.

*Ndryshimi absolut i popullsisë në bashkinë Dropull*

Grafiku 1



13. Revista Demografia, Nr. 1, Viti 2014, Tiranë 2014, faqe 5-22.

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

Burimi: *Regjistrimet e popullsisë 1923 dhe 1989 (popullsi banuese dhe prezente), Instat 2001 dhe 2011 (popullsi prezente).*

Gjatë periudhës 2001-2011, bashkia njohu ritmin më të lartë të emigrimit (79.4%), sidomos Dropulli i Sipërm dhe i Poshtëm, ndërsa Pogoni e ka njohur gjatë periudhës 1989-2001 (popullsia mesatare për një vendbanim, në njësinë Pogon është përgjysmuar me 53.5% krahasuar me 1923). Diferenca midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Census (2001 dhe 2011) tregon në mënyrë të tërthortë popullsinë e përfshirë në procesin e emigrimit, ku duket qartë fluksi i lartë i emigrimit në periudhën 2001-2011, me 87.7% e të emigruarve. Tregues i këtij ndryshimi negativ është ritmi mesatar vjetor i ndryshimit të popullsisë.

*Ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë në bashkinë Dropull (në %)*

*Pasqyra 3*

Periudha	1923-1945	1969-1989	1989-2001 Instat	2001-2011 Instat	1989-2011 Instat	1923-2011 Instat
Bashkia Dropull	-1.3	0.6	-0.4	-14.6	-7.1	-1.7
Dropull i Poshtëm	-0.8	0.8	-0.03	-12.0	-5.7	-0.5
Dropull i Sipërm	-1.1	0.6	0.72	-19.5	-9.0	-2.3
Pogon	-1.9	0.3	-8.01	-26.3	-16.8	-5.2

Burimi: *Regjistrimi i popullsisë 1989, Instat 2001 dhe 2011 (popullsi prezente).*

Analiza e pasqyrës tregon shifra të frikshme në gjithë periudhat (veçanërisht periudha 2001-2011), sidomos për Pogonin, njësia me ritmin mesatar vjetor më të ulët në vend, me shtim natyror të ulët 2.93‰ (nga 11‰ para 1990) dhe indeks vitaliteti 1.6, edhe pse gjatë këtij 10-vjeçari nuk ka më flukse të larguarish si ai i fillimit të viteve 1990.

Faktori emigrim ka sjellë ndryshime në treguesin e dendësisë mesatare të popullsisë, ku përsëri njësia e Pogonit dhe Dropullit të Sipërm kanë vlerat më të ulëta, përkatësisht 0.3 dhe 6.4 b/km<sup>2</sup>.

*Dendësia mesatare e popullsisë në bashkinë Dropull (në b/ km<sup>2</sup>)*

*Pasqyra 4*

Periudha	1923	1945	1969	1989	2001 Instat	2011 Instat
Bashkia Dropull	35.7	26.9	35.7	40.5	38.5	7.9
Dropull i Poshtëm	27.2	22.8	53.6	62.4	62.1	17.3
Dropull i Sipërm	49.2	38.5	45.4	51.5	56.1	6.4
Pogon	29.5	19.3	14.0	14.7	5.4	0.3

Gjithashtu, gjatë periudhës së dy regjistrimeve të fundit, numri i banesave është rritur 12.9% dhe ai i ndërtesave me 17% (24% në Dropullin e Poshtëm), për dy arsye kryesore: *së pari*, në kushtet e veprimit të emigrimit të kësaj popullsie, kjo shpjegohet me lidhjen shpirtërore të emigrantëve, për ti restauruar dhe për ti patur këto banesa si rezidenca dytësore (efekt i remitancave) dhe *së dyti*, kjo rritje i dedikohet uljes së numrit të banesave të banuara dhe rritjes së atyre të pabanuara. Kështu, numri i banesave të banuara është ulur 3 herë (4 herë në Dropullin e Sipërm), ndërsa i banesave të pabanuara është rritur me afro 6 herë (14 herë në Dropullin e Poshtëm dhe 7 herë në të Sipërmin). Vlen për tu theksuar fakti se, gjatë periudhës 2001-2011, nga të dhënat e Gjendjes Civile, numri i popullsisë rezulton me rritje sepse emigrantët figurojnë ende të paçregjistruar, por nuk përjashtohet fakti që ata janë punëtorë stinorë në shtetin fqinj, ndërsa gjatë periudhës 2011-2015, numri i popullsisë rezulton i ulur me (-590 banorë), si rrjedhim i bllokimit në Regjistër, të emigrantëve të hershëm (në Amerikë), të cilët u çregjistruan.

### 4. Efektet dhe pasojat e migrimit në bashkinë Dropull

#### *4.1. Analiza e përbërjes grupmoshore dhe gjinore*

Treguesit statistikore si: ulja e popullsisë nën moshën e punës; rritja e popullsisë mbi moshën e punës; rritja e indeksit të plakjes; rritja e moshës mesatare dhe medianë dhe treguesit e varësisë paraqesin moshimin e popullsisë në bashkinë Dropull<sup>14</sup>, ku faktorë përcaktues janë ulja e lindshmërisë dhe emigrimi.

*Treguesit statistikore të strukturës moshore në bashkinë Dropull (në %)*

14. *Migracioni në Shqipëri*, Census-Al 2011, Instat 2014, faqe 13-41.

Pasqyra 5

Grupmoshat	0-14 (%)		15-64 (%)		Mbi 65 (%)		Indeksi i plakjes (%)	
	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011
Vitet	28.5	7.7	63	58.5	8.5	33.8	29.9	439.8
Bashkia Dropull	28.9	9.3	62.3	63.7	8.8	27.0	30.3	290.8
Dropull i Poshtëm	29.2	6.0	63.3	53.3	7.5	40.7	25.8	681.0
Pogon	19.3	3.7	64.9	45.1	15.8	51.2	81.7	1381.3


Grupmoshat	Moshë				Treguesi i varësisë së					
	mesatare		medianë		përgjithshme		të rinjve		të moshuarve	
Vitet	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011
Bashkia Dropull	33.9	51.5	31.7	50.4	58.9	70.8	45.4	13.1	13.5	57.7
Dropull i Poshtëm	33.9	48.1	31.6	46.3	60.6	57.0	46.5	14.6	14.1	42.4
Dropull i Sipërm	33.3	55.1	31.1	55.4	58	87.5	46.1	11.2	11.9	76.3
Pogon	40	60.3	38.2	65.8	54	121.5	29.7	8.2	24.3	113.3

Burimi: *Instat 2001 dhe 2011.*

Nga pasqyra shihet se struktura moshore e bashkisë Dropull ka pësuar ndryshime të dukshme, pasha e grupmoshës deri 15 vjeç është ulur në 7.7%, si rezultat i uljes së lindshmërisë dhe grupmosha mbi 65 vjeç është rritur në 33.8% si rezultat i emigrimit të jashtëm (kryesisht meshkujt e moshës 18-35 vjeç), çka tregon se territori është në shkallë të lartë shpopullimi dhe popullsia është e plakur, e tipit regresiv. Indeksi i plakjes është më i larti se në çdo regjistrim të mëparshëm të kryer në Shqipëri çka ka reduktuar shkallën e aktivitetit dhe plakur popullsinë ekonomikisht aktive. Ky indeks jo vetëm e kalon kufirin 40%, por madje është 11 herë më i lartë (34 herë për Pogonin dhe 17 herë për Dropullin e Sipërm). Nga analiza e hartës së indeksit të plakjes në rang garku, shikojmë se në vitin 2011, mbi 50% e njësive të qarkut rezultojnë me një shkallë të indeksit të plakjes që e kalon shifrën 90% (Pogon, Dropull i Sipërm,

Zagorie, Dropull i Poshtëm, Odrje, Çarçovë, Qendër Libohovë, Cepo etj).

Nëse shohim edhe indeksin e plakjes sipas gjinisë, në vitin 2001 qarku kishte një strukturë gjinore disi të ekuilibruar, ndërsa në vitin 2011, struktura gjinore paraqitet e deformuar. Pothuajse në të gjitha njësitë, më i plakur dominon seksi femër, pasi dihet që femrat biologjikisht jetojnë më gjatë, përveç një-sive Dropull i Sipërm, Odrje, Frashër, Çarçovë, Lopës dhe Memaliaj Fshat, ku më i plakur është seksi mashkull (emigrimi).



Harta 2. Harta e indeksit të plakjes në qarkun Gjirokastrë, Instat 2001-2011 (A. Sinani)

Indeksin më të lartë të plakjes në rang vendi e ka njësia Pogon, me 1381.3%, kur në 1985 ishte 45%. Treguesi i moshës mesatare, që në 2001 e ka kaluar kufirin mbi 30 vjeç, me vlerën më të lartë në Pogon, 60.3 vjeç. 50% e popullsisë në vitin 2011 ishte deri në 50.4 vjeç, kur në 2001 ishte 31.7 vjeç dhe në 1989, 28.6 vjeç<sup>15</sup>. Vlerën më të lartë të moshës medianë e mban Pogoni: 50% e popullsisë është deri në 65.8 vjeç, kur në 1985 ishte 30 vjeç. Në treguesit e varësisë, të rinjtë përbëjnë 13% të popullsisë në moshë pune (8.2% në Pogon), ndërsa të moshuarit përbëjnë afro 60% të popullsisë në moshë pune (113% në Pogon), shifra këto alarmante për burimet njerëzore dhe vënien në efikasitet të territorit. *Struktura gjinore* e bashkisë paraqet një model me specifika gjinore,

15. Sheri, F., *Mosha e tretë në Shqipëri në këndvështrimin demografik, socio-ekonomik e shëndetësor*, Tiranë 2001.

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

ku emigrimi përbën faktorin kryesor të diferencimit gjinor, me ndikim në potencialin e krahut të punës dhe shkallën e aktivitetit ekonomik. Pasqyra e mëposhtme tregon ulje të koeficientit gjinor, si rrjedhim i emigrimit të jashtëm (elementit mashkull). Sipas grupmohave, koeficienti për grupmoshën 15-64 vjeç është rritur, por njësitë Pogon dhe Dropull i Sipërm kanë ulje, rrjedhim i emigrimit, ndërkohë që për grupmoshën mbi 65 vjeç është ulur, me uljen më të madhe (njësia Pogon).

### *Koeficienti i maskulinitetit në bashkinë Dropull (në ‰)*

*Pasqyra 6*

Viti	1940 <sup>&lt;?&gt;</sup>	1989	2001 Instat	2011 Instat
Bashkia Dropull	775	1021	992	944
Dropull i Poshtëm	907	1027	994	989
Dropull i Sipërm	776	1017	989	893
Pogon	694	1017	993	854

Grupmoshat	0-14		15-64		Mbi 65	
	2001	2011	2001	2011	2001	2011
Bashkia Dropull	1023	1023	990	1001	903	837
Dropull i Poshtëm	1024	1191	1001	1024	857	853
Dropull i Sipërm	1024	568	975	962	975	863
Pogon	1011	1286	1038	950	810	754

*Burimi: Regjistrimet e popullsisë 1989, Instat 2001 dhe 2011.*

### *4.2. Struktura familjare*

Niveli i lartë i emigracionit, kryesisht në moshën riprodhuese dhe ndryshimet e shpejta demografike, politike, social-ekonomike dhe kulturore krijuan modelin e ri të familjes në përbërje, strukturë dhe profil. Në aspektin e madhësisë dhe strukturës së familjes, prirja kryesore gjatë tranzicionit ka qënë pakësimi i numrit të familjeve (me 67.2%) dhe pjesëtarëve të tyre (nga 4.2 në 2.7), ku mbi 66% e njësive ekonomike familjare të bashkisë rezultojnë me një bërthamë familjare. Në pasqyrën e mëposhtme duket qartë ulja e numrit të të martuarve (75%), si rrjedhim i emigrimit selektiv apo familjar dhe lindshmërisë së ulët, të cilët kanë rritur moshën e hyrjes në martesë (numri i familjeve me fëmijë është ulur në 83.7%).

Numri i familjeve që kanë kryefamiljare femra përfaqësojnë 24.7% të familjeve, tregues ky që është më i larti në vendin tonë<sup>16</sup>.

*Numri i njësive ekonomike familjare, sipas llojit të bërthamës familjare dhe pjesëtarëve për familje në bashkinë Dropull*

*Pasqyra 7*

Emërtimi	NJEF:		Çift pa fëmijë		Çift me fëmijë		Pjestarë për familje			I/E martuar	
	2001	2011	2001	2011	2001	2011	1940 <sup>67</sup>	2001	2011	2001	2011
Bashkia Dropull	4003	1314	491	555	2548	415	5.2	4.2	2.7	8384	2111
Dropull i Poshtëm	1733	665	174	245	1117	308	5.2	4.4	3.2	3670	1191
Dropull i Sipërm	1986	439	214	199	1319	85	5.0	4.3	2.2	4208	620
Pogon	284	210	103	111	112	22	5.3	3.2	2.1	506	300

*Burimi: Regjistrimet e popullsisë, Instat 2001 dhe 2011.*

### **4.3. Migrimi dhe zhvillimi social-ekonomik i bashkisë Dropull**

Nga analizat e mësipërme theksojmë se numri i popullsisë, strukturat moshore, gjinore dhe familjare nuk mbështesin zhvillimin ekonomik, sidomos ekonominë bujqësore. Një popullsi në moshën e punës, në nivelin më të ulët kombëtar, një popullsi mbi moshën e punës afro 40% dhe një popullsi nën moshën e punës nën 8% tregojnë se zhvillimi human nuk është faktor mbështetës për zhvillimin ekonomik. Sipërfaqja bujqësore në Dropullin e Poshtëm dhe të Sipërm zë përkatesisht 70.5% dhe 42.4% të sipërfaqes totale dhe 80% e saj shtrihet në relievin fushor, por mungesa e krahut të punës ka bërë që 87.1% e saj të mos mbillet. Braktisja, degradimi dhe tjetërsimi i tokës bujqësore, problemet gjatë përmbytjeve në dimër dhe ujitjes në verë, mosfunksionimi i sistemeve ujtëse dhe kulluese kanë bërë që aktiviteti bujqësor të pësojë një rënie drastike. Territori i bashkisë ka një vlerë të madhe për ekonominë lokale pasi posedon resurse të shumta natyrore, që ofrojnë mundësi për larmi të aktiviteteve ekonomike nëpërmjet formave të ndryshme të ekoturizmit. Prodhimet lokale të çertifikuara “bio”, të ndërthurura me etnografinë e pasur tradicionale, kulturore dhe historike ofrojnë kushte ideale për zhvillimin e agroturizmit. Zona është e pasur me burime hidrike, burimet natyrore Manxifa, Selo, Gryka, që shërbejnë për furnizimin më ujë të pijshëm të popullatës lokale dhe përfitime social-ekonomike përmes menaxhimit të qëndrueshëm të tyre. *Po cili ka qënë kuadri ekonomik i bashkisë Dropull?* Në retrospektivë kujtojmë se qysh në 1929, Jorgucati dhe Poliçani ishin qendra komunash me rëndësi tranziti. Tregtia e

16. Akademia e Studimeve Politike, Plani operacional i zhvillimit vendor, Bashkia Dropull, Mars 2016, faqe 15. [www.al.undp.org/docs>Bashkia Dropull](http://www.al.undp.org/docs/Bashkia Dropull)

brendshme bëhej në pazaret javore të Dropullit, ndërsa tregtia e jashtme zhvillohej kryesisht me Greqinë, nëpërmjet qendrës kryesore tregtare të hapësirës, qytetit të Janinës. Eksportohej një gamë e gjerë artikujsh: drith, duhan, qymyr, fara liri, guna prej leshi, pëlhura, valanidh, bimë ngjyrosëse, djathë, gjalp, dyll, lëkurë, kuaj e kafshë të tjera transporti, qé, mëndafsh, mjaltë, bagëti, dru, perime të freskëta e të konservuara dhe importoheshin mallra ushqimore; artikuj zbukurimi, veshmbathje, gurë të çmuar, argjendari, lëkurë të përpunuara, gëzofe etj. Shkëmbimi i prodhimeve bujqësore e ble-torale me tregun e Janinës bëhej nëpërmjet rrjetit rrugor Janinë-Gjirokastër. Hapja e doganës së Kakavies (1984) krijoi kushte për zhvillimin e tregtisë ndërkuftare midis qyteteve Janinë, Korfuz, Gjirokastër. Krijimi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë (1987), e quajtur “Gjirokastër Impex” favorizoi bashkëpunimin ekonomik, marrëdhëniet treg-tare dhe eksport-importin ndërkuftar me Greqinë. Aktualisht, në Dropull funksionojnë 122 biznese të vogla dhe 54 biznese të mëdha, disa prej të cilëve me rëndësi jo vetëm rajonale, por edhe kombëtare e ndërkuftare, 64% e tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Dropullin e Poshtëm, në mademet e gurit për ndërtim, prodhim, transport, tregti dhe shërbime, si: Glina, Anonime Kakavie, Elka, Petrol Gaz, Boukas, Fresh, Kalimera etj. Kjo ka sjellë që në këtë zonë të ketë një numër të konsiderueshëm fuqie punëtore të an-gazhuar prej bashkive fqinje. Shoqata e Grave Artizane, Terihat i Dropullit të Poshtëm ka marrë pjesë në panaire rajonale dhe kombëtare me produkte artizanti, që shiten në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në vitin 2016, në kuadrin e projekteve ndërkuftare Shqipëri-Greqi u promovuan prodhimet e traditës dhe bizneset artizanale, ku partner ishte edhe Bashkia Dropull<sup>17</sup>.

*Remitancat* përfaqësojnë 58.5% të të ardhurave familjare dhe kanë përmirësuar gjendjen social-ekonomike, kanë mbështetur investimet në pemëtari; pajisje dhe mekanikë bujqësore; tregti; sferën e shërbimeve; ndërtimin e objekteve artizanale dhe industriale dhe kanë modifikuar mënyrën e jetesës.

Të ardhurat nga punësimi dhe vetpunësimi përfaqësojnë 33.8% të buri-meve për të ardhurat familjare të bashkisë. Si rrjedhim i emigrimit, *tregu i punës* ka humbur mbi  $\frac{3}{4}$  (emigrantët zënë 80.8% të pjesës më aktive të tregut të punës) e popullsisë në moshën e punës<sup>18</sup>. Nisur nga burimet e të ardhurave familjare, ndihma sociale dhe përfitimet e natyrës sociale zënë një përqindje të ulët, 7.7% (përfiton vetëm 0.03% e popullsisë<sup>19</sup>). Indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjeç) paraqitet i lartë, 51.1% ndërsa papunësia te femrat 20%. Ekonomia lokale ka natyrë mikse dhe banorët e punësuar në sektorin bujqësor zënë 10.2% e forcës aktive të punës, industri, 32.4% dhe shërbime, 57.3%). Bashkia ka nivel

17. <https://www.mjedisot.info>tags>tag>

18. Akademia e Studimeve Politike, *Plani operacional i zhvillimit vendor, Bashkia Dropull*, Mars 2016, faqe 15.

19. [www.sherbimisocial.gov.al>2016/11](http://www.sherbimisocial.gov.al>2016/11)

të lartë të papunësisë së fshehtë agrare (shembull tipik është njësia malore e Pogonit)<sup>20</sup>, e cila karakterizohet nga një papunësi në masën 74.6%, por shkalla e papunësisë paraqitet e ulët, 21.7% (mesatarja për vendin është 29.3%)<sup>21</sup>. Emigrimi dhe ulja e peshës së grupmoshës 0-14, në masën 7.7% kanë kushtëzuar rentabilitetin e shërbimeve publike, infrastrukurore dhe social-kulturore (ujin e pijshëm, transportin, shërbimin postar, shërbimin arsimor dhe shëndetësor).

*Popullsia banuese sipas nivelit të shkollimit në bashkinë Dropull (në ‰)*

*Pasqyra 8*

Emërtimi	Gjithsej	Nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën					Kanë ndjekur ose janë duke ndjekur shkollën					
		Dinë shkrim e këndim		Analfabetë		9-vjeçar	I mesëm		I lartë			
Vitet	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011	2001	2011
Bashkia Dropull	15231	3343	2336	51	225	63	9820	1944	2589	894	261	341
Dropull i Poshtëm	6753	1984	1012	26	129	18	4294	1030	1195	601	123	278
Dropull i Sipërm	7642	937	1191	16	74	17	4995	662	1261	185	121	46
Pogon	836	422	133	9	22	28	531	252	133	108	17	17

*Burimi: Regjistrimet e popullsisë, Instat 2001 dhe 2011.*

Nga pasqyra shikojmë gjatë periudhës 2001-2011, ndjekja e shkollës në të gjitha ciklet rezulton me ulje, si rrjedhim i emigrimit. Numri i shkollave është ulur nga 22 në 7, numri i nxënësve nga 212 në 197 dhe numri i mësuesve dhe edukatorëve nga 130 në 104. Kështu, shkolla e vogël e Sotirës, fshatit buzë kufirit shqiptaro-grek në vitin 2004 kishte tre nxënës dhe dy mësues<sup>22</sup>, ndërsa sot kjo shkollë me një histori disa qindvjeçare është mbyllur. Në territorin e bashkisë ushtrojnë funksionin tri qendra shëndetësore, 11 ambulanca, 5 mjekë dhe 33 infermierë, por rritja e burimeve dhe investimeve për sistemin e kujdesit shëndetësor, aksesin e popullsisë në shërbimet e përkujdesjes shëndetësore, mbulimin më të mirë shëndetësor në fshatrat malore, uljen e çmimeve dhe rrit-

20. Instat, *Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Bujqësore*. Prefektura Gjirokastrë, 1998, Tiranë 2001.

21. ASH e RSH, Bërçholi, A., *Ristrukturimi agrar postkomunist në Shqipëri dhe implikimet e tregut të punës*, Tiranë 2005.

22. *Mjedisi sot*, nr 88, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) për Evropën Qëndrore dhe Lindore, maj 2004. faqe 9.

jen e cilësisë së barnave janë nevoja primare në këtë drejtim.

### 5. Fokusi i politikave të migrimit në bashkinë Dropull

Në epiqendrën e strategjive të zhvillimit social-ekonomik është popullsia, pasi ajo përbën faktorin kryesor të prodhimit dhe shërbimit dhe në të njëjtën kohë, prodhimi dhe shërbimi realizohen për të plotësuar kërkesat e ndryshme të popullsisë. Prandaj, krijimi i një baze të dhënash statistikore mbi flukset migratore dhe ofrimin e mbështetjes për studiuesit që hulumtojnë problemet dhe nevojat e grupeve të ndjeshme të popullsisë do të lehtësojë dhe informojë krijuesit e politikave dhe do të ndihmojë në identifikimin e grupeve të prekura nga migrimi. Shfrytëzimi sa më shumë të jetë i mundur i potencialit të burimeve njerëzore të bashkisë jashtë kufirit (*diplomacia ekonomike*) do të inkurajojë përdorimin e kanaleve zyrtare për remitancat dhe investimet e tyre në zonë. Krijimi i programeve të mirëqënies sociale, trajnimit profesional janë strategji efikase, të cilat minimizojnë rrezikun e konsiderimit të kthimit si një dështim personal dhe jo si një nënprodukt i migracionit me sfidat që ai vendos në jetën e të kthyerve. Theksi vihet te përfshirja e migrimit në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale, programe dhe masa që të promovojnë vlerat, meritokracionë<sup>23</sup>, konkurrencën dhe respektin ndaj arsimimit dhe kapitalit human të specialistëve të kualifikuar, sidomos jashtë vendit. Mbështetje institucionale pas kthimit dhe gjithëpërfshirje në sektorin e bujqësisë, industrisë dhe shërbimit duhet të ofrojnë Zyra Rajonale e Punësimit dhe Qendra e Formimit Profesional. Vizioni i specialistëve në zhvillimin social-ekonomik të bashkisë do të fokusohet më tepër në ndërhyrjet prioritare si: *rikonstruksione të rrjetit rrugor* (Kërrë, Peshkëpi e Sipërme-Radat, Pogon, Glinë-Vrahogoranxi, Bularat-Bodrishtë); *rikonstruksione ujësjellësash* (Peshkëpi e Sipërme, Selo, Llovinë, Krioner, Sotirë, Dervician, Sofratikë, Poliçan); *rikonstruksione qendrash shëndetësore* (Dervician, Sofratikë, Poliçan); *rikonstruksione shkollash* (Bularat, Poliçan, Dervician); *infrastrukturë bujqësore* (pastrimi dhe rehabilitimi i rrjetit ujitës dhe kullues në fushën e Dropullit dhe 19 rezervuareve). Hartimi i politikave mbështetëse për fermerët do garantojë një burim të qëndrueshëm të ardhurash për familjet e tyre. Krijimi i Zonave të Lira, në brezin kufitar do të krijojë kushte për tregti me efektivitet të lartë, përfitime social-ekonomike, lehtësi tatimore, doganore dhe financiare, duke e bërë atë tërheqëse për investitorët vendës dhe të huaj. *“Gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm bashkia Dropull do të ketë vlera të përtëritura kulturore, arsimore dhe shëndetësore, një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, një industri bashkëkohore të përpunimit të prodhimeve bujqësore, për të mundësuar punësimin e të rinjve dhe ruajtjen e harmonisë së bashkëjetesës për një standart evropian jetese<sup>24</sup>”*.

23. *Fletore Zyrtare* 2015, Nr. 222, faqe 48-72.

24. Akademia e Studimeve Politike, *Plani operacional i zhvillimit vendor, Bashkia Dropull*, Mars 2016, faqe 10-

### Burimet e shfrytëzuara

1. Akademia e Studimeve Politike, *Plani operacional i zhvillimit vendor, Bashkia Dropull*, Mars 2016, faqe 10-32. [www.al.undp.org/docs/Bashkia Dropull](http://www.al.undp.org/docs/Bashkia_Dropull); <https://www.mjedisot.info/tags/tag; www.sherbimisocial.gov.al/2016/11>
2. AQSH, *Fondi 490, Dosja 376*, 30.XI.1945.
3. ASH e RSH, Bërxfholi, A., *Ristrukturimi agrar postkomunist në Shqipëri dhe implikimet e tregut të punës*, Tiranë 2005.
4. *Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, Gjirokastrë 2011*, Instat 2013.
5. *Fletore Zyrtare 2015*, Nr. 222.
6. *Fletore Zyrtare*, Nr. 137, Viti 2014, faqe 6371-6378: [www.planifikimi.gov.al/default/files](http://www.planifikimi.gov.al/default/files)
7. Instat, *Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Bujqësore*. Prefektura Gjirokastrë, 1998, Tiranë 2001.
8. Instat, *Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2001, Popullsia e Shqipërisë*, Gjirokastrë 6, 2001, Tiranë 2004.
9. Mema, B., Shahu A., *Prefektura e Gjirokastrës 1920 – 1924*, “Jolanda”, Tiranë 2001.
10. *Migracioni në Shqipëri*, Census-Al 2011, Instat 2014.
11. *Mjedisi sot*, nr 88, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) për Evropën Qëndrore dhe Lindore, maj 2004.
12. *Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave 1989*, Tiranë 1991.
13. *Revista Demografia*, Nr. 1, Viti 2014, Tiranë 2014.
14. Selenica, T., *Shqipëria më 1927*, Tiranë 1928.
15. Sheri, F., *Mosha e tretë në Shqipëri në këndvështrimin demografik, socio-ekonomik e shëndetësor*, Tiranë 2001.

## MIGRATION IMPACT IN DROPULL MUNICIPALITY

Assoc. Prof. Dr. Albina SINANI<sup>25</sup>, Prof. PhD. Gëzim SALA<sup>26</sup>, PhD. Irena BOBOLI<sup>27</sup>

### Abstract

*Population of Dropull Municipality has had deep changes during the last two decades of the long lasting transition period. This paper analyzes the migration impact on demographic issues for the area part of this study. Migration has begun early in the Dropull municipality (late 1990). This phenomenon as cause and impact has determined the numerical reduction of this population as well as modifications to its structural composition (with aging tendencies). According to the latest population Census (2011), the municipality lost 80.4% of the population of 1989. The largest emigration force is evidenced in rural hypsometric high-altitude settlements (Pogon). As a multidimensional phenomenon, migration has been associated with positive and negative effects from an economic, social and environmental perspective. In the first years this phenomenon results intense, but this feature does not retain later. Migration is an uninterrupted phenomenon (as long as there are inequalities in development) and in these domains, its management is a necessity. In this regard, it is necessary to review regional development policies through strategies to reduce poverty, promote economic growth, and integrate emigrants who come back to their home place, and so on. This paper aims to explain the role played by this phenomenon in terms of municipality human resources, unemployment rate, demographic and economic parameters etc. The collected data are processed, synthesized and commented in function of achieving the study objectives, with a variety of research methods. The phenomenon of emigration is complex and difficult to administer. However, this should not be left to spontaneity, but it must be controlled.*

**Key words:** migration, seasonal employment, remittances, transition, development policy.

---

25. Department of Geography, University of Gjirokastra.

26. Department of History, University of Gjirokastra.

27. Department of Economic Policies and Tourism, University of Gjirokastra.

## EMIGRIMI I JASHEM I POPULLSISE NE TERRITORIN, QARKU GJIROKASTER

Prof. asoc. dr. Valbona Duri<sup>28</sup>, Dr. Msc. Gentian Ruspi<sup>29</sup>

### Shkurtesë

*Fenomeni i migrimit është një proces objektiv i cili ka qenë karakteristikë e të gjitha fazave evolucionit të historisë njerëzore. Dimensionet, intensiteti, drejtimet dhe motivet që e kanë kushtëzuar atë, kanë qenë të disa llojeve në faza të ndryshme.*

*Niveli i zhvillimit ekonomik, në etapa të ndryshme të ngjarjeve politike dhe historike që kanë ndodhur, kanë përcaktuar tipologjinë dhe thelbin e tipareve të tij.*

*Rajoni i Gjirokastrës (në jug të Shqipërisë), pas vitit 1990 është karakterizuar nga lëvizje të mëdha demografike brenda vendit (drejt rajonit qendër-bregdetar) a sidomos jashtë vendit drejt shtetit fqinjë, Greqisë. Për një evidentim më të mirë të dukurisë së emigrimit është analizuar në dy drejtime: kohor dhe hapësinor sipas vendbanimeve urbane dhe rurale.*

*Emigrimi jashtë qarkut është një ndër faktorët kryesorë me ndikim në evolucionin demografik dhe ekonomik të territorit në studim.*

*Ky studim fokusohet në evidentimin statistikor dhe analizën e emigrimit të jashtëm në qarkun Gjirokastrë pas viti 1990. Faktorët, përmasat, drejtimet, motivet, tipet sipas llojeve të realizimit individual ose familjar dhe emigrantëve (sipas moshës, gjinisë, edukimit, statusit civil, etnisë etj. Emigrimi në këtë rajon është shoqëruar nga disa rrjedhime pozitive dhe negative në këndvështrimin socio – ekonomike (fuqia punëtore), demografik (grupmoshave, gjinisë, riprodhimin etj); mjedisor në planifikimin urban, shkallën e ndotjes etj.*

*Ky studim shoqërohet në fund nga disa konkluzione dhe sugjerime.*

28. University of “E Cabej”, Geography Department, Gjirokastrë

29. University of “E Cabej”, Geography Department, Gjirokastrë

### HYRJE

Emigrimi i jashtëm pas vitit 1990, përbën një nga dukuritë me prezente të jetes ekonomike dhe sociale të vendit për më tepër të hapësirës në studim. Marrja në studim i fenomenit emigrimi mbart interes të vecantë me vlerë kombëtare dhe rajonale

Punimi ka si qëllim të evidentojë emigrimin si një faktor kryesor shkak dhe pasoje njëkohësisht në evolucionin demo-ekonomik e social në territorin në studim, qarkun Gjirokastrë.

Emigrimi është studiuar në dy aspektet: kohor dhe hapësor me qëllim që të evidentohen qartë efektet: ekonomike, demografike, sociale, ambientale etj.

Burimet statistikore mbështeten në të dhënat statistikore tërhequr në zyrat arkivore të gjendjeve civile në tri rrethet e qarkut dhe të dhënat e INSTAT (Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, Prill 2001 dhe 2011).

#### 1. Emigrimi i jashtëm (*faktorët, rifillimi*).

Shqipëria në fund të viteve 80 dhe fillim të viteve 1990 u mbërthye nga një krizë e thellë ekonomike me parametra që tregonin ekzistencën e një ekonomie të dështuar, në sensin e pamundësisë për plotësimin e kërkesave të konsumatorit shqiptar.

Filluar si një protestë ndaj ish sistemit komunist ("fenomeni i ambasadave"), emigrimi stimulohet më së shumti si një **nevojë ekonomike dhe lirie**. Kalimi i Shqipërisë nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut u shoqërua me vështirësi të mëdha ekonomike dhe sociale (as ekonomitë e planifikuara dhe as ekonomitë e tregut, mungesë besimi dhe pasiguri për të sotmen dhe të nesërmen). Një situatë e tillë shërbeu si pikënisje për krijimin dhe forcimin e mendimit për tu larguar sa më parë jashtë vendit duke aspiruar një jetë më të mirë për vete dhe familjet e tyre.

Pra paqëndrueshmëria politike, gjëndja e vështirë ekonomike në vend, treguesit e lartë të papunësisë, mundësitë tepër të kufizuara për punësim, etj, provokuan dhe stimuluan valët emigrative në popullsinë tonë në vitet 1990.

Emigrimi i jashtëm i popullsisë në vendin tonë (për më tepër dhe në hapësirën në studim) që nga viti 1990 ka përbërë **dukurinë më komplekse dhe më tipike, me ndikim të shumanshëm në rregjimin demografik dhe situatën social-ekonomike të vendit, kuptueshem dhe të qarkut në studim.**

Shqyrtimi i dinamikës së emigracionit, dëshmon se në vitet e para ai ka

qënë **Intensiv**.

Si i tillë ai ka shërbyer **si një amortizator në mospërputhjen** e thellë (të trashëguar) **ndërmjet shtesës së lartë natyrore të popullsisë dhe mundësive të pakta për punësim**.

Nga anketimimi i realizuar në këtë kontekst rezulton se për pjesën më të madhe të qarkut, ky proces starton në fillim të vitit 1991 kur haset dhe fluksi më i madh i të emigruarve drejt Greqisë.

Ky proces ka qënë i vazhdueshëm duke shënuar kuota të larta sidomos vitet e para të viteve 1990.

Ky proces vazhdon duke arritur një tjetër kulm në vitin 1997. Pas ngjarjeve të 1997 lidhur me rënien e shtetit, u verejt nje rigjallërimi i ndjeshem i emigrimit për shkaqe të pasigurisë, mungesës së qetësisë, rendit në vend etj

Kjo situatë u bë shkak i një vale të re masive të emigrimit të jashtëm. Ndonëse më vonë nuk flitet për **eksode masive si ato të 1990, 1991 dhe 1997**, kjo hemoragji, nuk është ndërprerë asnjëherë.

## 2. Studimi dhe evidentimi i tipareve te emigrimit

- Ky proces ka qënë i vazhdueshëm duke shënuar kuota të larta sidomos vitet e para të viteve 1990 dhe rënie në vitet në vazhdim.

Nga anketimimi i realizuar në këtë kontekst rezulton se për pjesën më të madhe të fshatrave në qark dhe sidomos në rrethet Gjirokastër dhe Përmet, ky proces starton në fillim të vitit 1991 kur haset dhe fluksi më i madh i të emigruarve drejt Greqisë. Ky proces vazhdon duke arritur një tjetër kulm në vitin 1997. Pas ngjarjeve të 1997 lidhur me rënien e shtetit, u verejt nje rigjallërimi i ndjeshem i emigrimit për shkaqe të pasigurisë, mungesës së qetësisë, rendit në vend etj. Kjo situatë u bë shkak i një vale të re masive të emigrimit të jashtëm. Pra valet masive të emigrimit kanë ndjekur zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale në vend.

- Nisur drejt vendit fqinjë Greqisë, më pas drejt vendeve të Evropës perendimore dhe me large duke marre **karakterin e një emigrimi të largët**.


- Sipas vendeve pritëse, **struktura e emigracionit** dëshmon se numri më i madh i të emigruarve jashtë vendit ( rreth 84.0%) gjendej i vendosur në shtetin Grek.

- Emigracioni në masën dërmuese ka qënë një fenomen **illegal** . Për këtë arsëye të dhënat zyrtare nuk mund të korespondojnë me flukset emigrimi.

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

Në arritjen e nje sere evidentimesh, si bazë referuese kane qënë vleresimi e të dhënave të tërhequra prej anketimit , rregjistrimeve te popullsise dhe informacioneve te tjera.

### Ndryshimet ne numrin e popullsise dhe familjeve ne qark analizuar nen ndikimin e emigrimit.



Referuar materialit të grumbulluar nga anketimet evidentojne se mbi 1/2 e popullsisë së qarkut është përfshirë në emigrimin e jashtëm.

## 2. Permasat e emigrimit

Referuar të dhënave të grumbulluara, procesi i emigrimit ka prekur një pjesë të rëndësishme të popullsisë së qarkut. Sipas INSTAT-it, *gjatë periudhes 1989-2001* qarku ka nivel te larte migrimi (6.8% të migrimit total të brendshem të vendit). Emigrantët e brendshem të ikur nga qarku përbëjnë 11.0% të popullsisë së 1989-s, ndërsa emigrantët e jashtëm përbëjnë 25.3% të numrit të popullsisë së qarkut në 1989-ën. Ndërsa referuar të dhënave të grumbulluara prej anketimit, situata rezulton edhe më e renduar. Pas viteve 1990, rreth 1/2 e popullsisë rurale të qarkut ose 60 635 vetë rezultojnë të emigruar jashtë vendit. Pakësimi i popullsisë rezulton në masën 49.2% dhe i numrit te familjeve me 45.4%, kundrejt vitit 1989. Në hapësirën rurale të qarkut pas 15 vjetësh kanë mbetur rreth 51.0% e popullsisë dhe rreth 55.0% e familjeve të vitit 1989.


Në vështrimin territorial, Gjirokastra evidentohet për peshën më të madhe (55.0%) të të emigruarve, Përmeti për peshën më të madhe (44.0%), të familjeve të përfshira në emigrim

Popullsia në Tepelenë rezulton e përfshirë më shumë në levizjet drejt rajonit qëndror dhe bregdetare të vendit (Tr,Sr, Vl, etj).

Të dhënat statistikore gjithashtu videntojne se popullsia e territoreve të larta hisometrike rezulton më emigrative. Me saldo migruese shume negative

paraqiten ish komunat : Buz(-46.3‰), Lopes, Kurvelesh, Suke, Dëshnice, Ballaban etj, te njohura si komunat me malore te qarkut(me fond te kufizuar të tokës bujqesore 0.27 ha/b, infrastrukturë problematike etj).

### Treguesi I migrimit neto në qarkun Gjirokastrër



Referuar analizës së burimeve statistikore arrihet në përfundimin se qarku Gjirokastrër ka një profil të qartë emigrator.

### 3. Tipet e migrantëve

- Moshës
- Gjinisë
- Nivelit arsimor-profesional
- Madhësisë së familjes
- Tipit të vendbanimit(urban, rural).
- Përbërjes etnike.

Në analizën e emigrimi të jashtëm rëndësi gjithashtu paraqet struktura e tij sipas moshës së popullsisë, gjinisë, nivelit të arsimit, vendbanimeve etj.,

**a. Struktura moshore e migrantëve.** Struktura moshore tek migrantët përgjithësisht është e re. Në të gjitha flukset migruese personat në **grupmoshën**

15-45 vjeç përbëjnë pjesën dërmuese 69.0%, të të emigruarve. Migrimi si një proces selektiv ka prekur grupmoshën e re (përpjesën aktive të saj).

**b. Struktura e migrantëve sipas gjinisë.** Emigrantët meshkuj përbëjnë mbi 50.0% të të larguarve gjithsej nga qarku kundrejt 46.4% të të larguarve femra.

**c.** Sipas nivelit arsimor 26.0% e emigrantëve janë me arsim fillor dhe 8 vjeçar, 53.0% me të mesëm dhe 21.0% me të lartë. Përgjithësisht ajo që rezulton prej anketimeve në këtë kontekst, shumica dërmuese e të larguarve i përgjigjen nivelit të mesëm arsimor të ndjekur nga ata me arsim 8 vjeçar dhe të lartë.

**d. Sipas statusit civil dhe madhësisë së familjes.** Fillimisht përbëria e migrantëve sipas statusit civil dominohej nga persona të pa hyrë në lidhje martesore, dukuri kjo që më pas zëvendësohet nga rritja e kontigjentit të të martuarve. Mbi 31.0% të numrit të total e përbëjnë familjet me 4-5 pjesëtarë të cilat dominojnë përkundrejt familjeve me deri në 3 pjesëtarë që përbëjnë vetëm 10.0%.

**e. Migrantë sipas tipit të vendbanimeve.** ruralët rezultojnë jo vetëm më lëvizës por dhe më emigrativë se urbanët. Koefficienti i emigrimit në fshat rezulton 29.1‰ nga 15.6‰ në qytet.

**f. Sipas grupeve etnike.** Sipas etnise me emigrative rezultojnë minoriteti grek dhe ai vllah krahasimisht me popullsinë shqiptare. Madje dhe midis tyre, ajo arumune rezulton më emigrative se pakica etnike greke.

#### 4. Rrjedhimet dhe efektet prej emigrimit

Emigrimi si dukuria më prezente pas vitit 1990, në vendin tonë është shoqëruar me rrjedhime dhe efekte që mbartin avantazhe dhe disavantazhe në spektrin ekonomi, social, demografik, ambiental të vendit.

- **Rrjedhimet(pasojat) pozitive**
- **Emigrimi ka ndihmuar në rritjen e kursimeve** të investuara në disa forma aktiviteteve ekonomike në Shqipëri në sektorin e shërbimeve, ndërtimtarisë, turizmit, transportit etj, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë, përmirësimin e jetesës së shumë familjeve por edhe në stabilizimin e konomik të vendit.
- **Me efekte për të rejat teknologjike.** Emigrantët kanë kontribuar në transmetimin e njohurive dhe ideve të reja, duke nxitur futjen e teknikave të reja në industrinë përpunuese të vreshtave, perimeve, produkteve blegtorale etj), qe ka ndikuar në rritjen e të ardhurave.
- Dërgesat në valutë të emigrantëve kanë ndihmuar për të **zbutur**

**koston sociale** që shkaktojnë reformat ekonomike brenda vendit.

- Ka ndihmuar në mënyrë të dukshme **në zbutjen e pasojave prej rënies së prodhimit dhe pagës së ulet.**

- Emigrimi **ka luajtur rolin e një amortizatori** të papunësisë në qark, duke ul numrin e të papunëve.

- Emigrantët **siguruan përgjithësisht nivel jetësor më të lartë për vete dhe për familjet e tyre**, duke luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të vendit.

- **Rrjedhimet negative**

- Pas vitit 1990, duket qarte se emigrimi bëhet faktori determinues në rregjimin rriprodhues

në këtë territor. Rënia e rritmeve të rritjes së popullsisë në qark - **2.9 %** nga 1.5%, para viteve 1990. **Emigrimi ka përbërë faktorin kryesor shkak në reduktimin e lindshmërisë pas vitit 1989**

- Një shtim natyror më shumë se të përgjysëmuar **6.5 ‰** nga **18.0 ‰**(1989).

- Rritje me **13.4% të grupmoshës së tretë ndërsa grupmosha e parë nën 15 vjeç** u pakësua me **20.3%**.

- Rritje të moshës mesatare të popullsisë në **39 vjeç** nga 26.0 vjeç në 1989.

- Ulje të treguesit të martesave me 40.0% kundrejt vitit 1989.

- Rritja e peshës së banesave të pabanuara (28% të numrit total).

Referuar përlllogaritjeve statistikore bazuar në projeksionet e popullsisë, qarku Gjirokastrë do të vazhdojë të **karakterizohet nga një evolucion deficitar popullimi.**

Dukuria e emigrimit është komplekse dhe e vështirë për tu administruar, gjithësesi nuk duhet t'i lihet spontanitetit, por domosdoshmërisht të jetë e kontrolluar

Një perceptim i gabuar është mendimi se emigrimi mund të zhduket, kur të përmirësohet ekonomia. Karakteri i tij është i tillë **që paraqet një proces**

të pafrenueshëm në evolucionin e përgjithshëm të njerëzimit. Por njohja reale e këtij fenomeni, eventualisht mbart rëndësi , në formulimin e politikave të duhura për realizimin e një zhvillimi të qendrueshëm e afatgjatë.

**Në kontekst të tille përbën domosdoshmëri që në të gjitha projektet dhe strategjitë për zhvillimin, të merren parasysh ndryshimet dhe efektet e sjella prej emigrimit**

### **Bibliografia**

1. Bërxfholi A. Mbi disa aspekte të zhvillimit ekonomik dhe të shpërndarjes gjeografike të popullsisë dhe vendbanimeve në territorin e përfshirë nga rrethet Gjirokastër, Përmet dhe Tepelenë. Studime gjeografike 1. Tiranë 1985

2. Bërxfholi A. Migrimet drejt rajonit Tiranë-Durrës. Studime gjeografike Nr. 14 Tiranë, 2001

3. Bërxfholi A. Ndryshime ne gjeografinë e popullsisë në Rajonin Vjosë-Deti jon (Monografi). Tr.1987

4. Doka Dhimitër Zhvillime socio-ekonomike dhe rajonale të Shqipërisë gjatë periudhës së tranzicionit Potsdam-Gjermani, 2005.

5. Draçi B. Potenciali turistik i rajonit Vjosë- Deti Jon(studim monografik) Tiranë, 1999.

6. Drejtoria statistikore e Rretheve Gjirokastër, Permet, Tepelene 1995-2004.

7. Dumani B. Statusi i zhvillimeve demo-ekonomike dhe sociale të popullsisë në pellgun e Mesdheut dhe Evropën Lindore. Studimet e popullsisë Buletin Nr.2 Tiranë,1995.

8. Dumani B.StringaA. Elemente të demografisë(Popullsia dhe zhvillimi) Tiranë, 1997.

9. Gërdeshi I. Mara H. Dhimitri R. Krisafi K. Emigrimi i Elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit Luarasi Tiranë, 1999.

10. Gjirokastra Analizi ed indirizzi per lo sviluppo futuro Grotammare 2002

11. INSTAT Migracioni në Shqipëri 2001

12. INSTAT Niveli i jetesës dhe pabarazitë në Shqipëri 2001

13. INSTAT Njerëzit dhe puna në Shqipëri 2001

14. INSTAT Popullsia e Shqipërisë në 2001 Rezultatet e rregjistrimit të popullsisë dhe banesave

15. INSTAT Popullsia e Shqipërisë. Gjirokastër 2001/ 6.

### Abstract

*The migration phenomenon of is an objective process which has been a characteristic of all human historical evolution phases. Dimensions, intensity, area of spread, and motifs, that have conditioned it, have been of Several kinds in different phases.*

*The socio economical development Levels, in different historical Stages, Political and historical events that have happened, **have determined typology and essential types of it.***

*The area of Gjirokastra region (in the south of Albania), After 1990 is characterised by big demographic movements within the country (central and coastline Regions) and especially outside the Country to the neighbourhood country in Greece. For a better evidence of the migration phenomena , it is seen and taken under researches and analyses in two dimensions: time (periods of time) and in space. That is a more complex in form and content (seen According to communes and Villages).*

*Emigration Outside, the country (Especially to Greece), from the region is one of the main factors based on the impact it has in all socio demo - economic evolution in Gjirokastra region. This research is focused in statistical evidence and the analyse of outside migration (emigration) in Gjirokastra region, after 1990's: Factors, dimensions, directions, motifs and typology of Migrations (causes, ways of organizing timelines, distance, realizing ways having chain, individual or familiar phases) and emigrants (according to age gender, educational and professional level, civil status and size of the the family, type of dwelling place, Ethnic belonging group etc). Emigration in this region is accompanied with several positive and negative consequences in these directions: Socio Economic direction (Labour power in our region) demographic direction (a limited Increase of Regional Population, Decrease of population index, reducing up to its half of Reproduction index, content of population age groups, etc.); Environmental direction (in urban plan of the city, its pollution level etc.).*

*This research will be accompanied, at the end, by some conclusions and suggestions.*

**Key words:** population decline, socio economical regres, **typology**, district, consequences.

## ROLI I FAKTORËVE FIZIKO – GJEOGRAFIKË NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE GJORICË

Msc. Aishe BEGU(BALLA)<sup>30</sup>, Dr. Elvira BOLLOBANI(DODOVECI)<sup>31</sup>

### Shkurtesë

Njësia administrative Gjoricë shtrihet në krahinën malore qendrore, në pjesën lindore të saj, në kufi me Republikën e Maqedonisë. Pozita gjeografike e saj si zonë kufitare, si dhe faktorët fiziko – gjeografikë kanë ndikuar në zhvillimin e kësaj njësie. Territori karakterizohet nga një reliev i larmishëm me shkallë të madhe të copëtimit vertikal dhe horizontal.

Qëllimi i artikullit është të evidentojë rolin e faktorëve fiziko – gjeografikë në perspektivën e zhvillimit të njësive administrative Gjoricë, si pjesë përbërëse e bashkisë Bulqizë. Në punim analizohen ndërtimi litologjik, tektonika, veçoritë morfologjike e morfogjenike, si dhe proceset modeluese të relievit, të cilat favorizohen nga pjerrësia e terrenit. Njësia Gjoricë ka potenciale të konsiderueshme ujore, bimore, që duhet të shfrytëzohet me efikasitet nga banorët. Vlerat e elementëve klimatikë favorizojnë rritjen e disa kulturave bujqësore, kultivimi i të cilave janë aktiviteti primar për banorët. Banorët e njësive Gjoricë merren me bujqësi, blegtori, pylltari etj. Por zhvillimi i qëndrueshëm kërkon zbatimin e disa kritereve shkencore të veprimtarisë humane, duke e drejtuar popullsinë për të shfrytëzuar me efikasitet pasuritë natyrore.

Po ashtu, për vetë specifikat që ka zona do të evidentohen faktorë të marrëdhënieve ndërkufitare në zhvillimet e sotme dhe të perspektivës, si për çështje të ujrave, shkëmbimit të mallrave etj.

Për realizimin e artikullit janë shfrytëzuar burime të shkruara, informacione të siguruar në njësine administrative Gjoricë dhe në terren, si dhe

30. Gjumnazi "Sami Frashëri" Tiranë

31. Pedagogje e jashtme në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës

konsultime me specialistë dhe banorë të zonës.

**Fjalë kyçe:** faktorë fiziko – gjeografikë, njësi administrative, zhvillim i qëndrueshëm.

### Hyrje

Njësia administrative e Gjoricës është një ndër tetë njësitë e Bashkisë Bulqizë. Në njësinë administrative të Gjoricës bëjnë pjesë vendbanimet Gjoricë e Poshtëme, Gjoricë e Sipërme, Çerenec i Poshtëm, Çerenec i Sipërm, Viçisht i Poshtëm, Viçisht i Sipërm, Lubalesh<sup>32</sup>.

Gjorica ka klimë të shëndetshme, ujëra të bollshme, bimësi të larmishme etj.

Potencialët njerëzore të trevës (5859 banorë ) janë të mjaftueshme për zhvillimin social dhe ekonomik. Popullsia është e re (grupmosha deri në 18 vjeç zë 31.3%) dhe ajo në moshën e punës (grupmosha 19-65 vjeç zë 55.7%).

Në Gjoricë dhe fqinjët e saj ka dëshmi të popullimit të hershëm, përpjekjeve për liri, të zhvillimit social-kulturor dhe ekonomik etj. Treva është dalluar vazhdimisht në luftërat për mbrojtjen e trojeve, sidomos përmendim betejën e vitit 1844 kundër serbëve, kontributet në Luftën Nacional-Çlirimtare. Ka pasuri të shumta natyrore si: ujëra për vaditje dhe energji, pyje etj.

Të gjitha sa më sipër do të trajtohen nga ana jonë, me synimin për t'i analizuar si premisa për zhvillimin e kësaj njësie, sot dhe në të ardhmen.

### ***1.Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore***


Njësia administrative Gjoricë<sup>33</sup> ndodhet në pjesën lindore të Rajonit Verilindor të Republikës së Shqipërisë. Ka sipërfaqe 34.8 km<sup>2</sup> dhe popullsi 5670 banorë. Shtrihet në pjesën verilindore e lindore të Bashkisë Bulqizë, në anën e majtë të rrjedhjes së lumit të Drinit të Zi.

Kufizohet në lindje me ish Republikën e Maqedonisë (3 km lumor), në veriperëndim me njësine administrative të Shupenzës, perëndim me njësine Zerqan, veri me njësine Maqellarë (Bashkia Dibër) dhe në jug me njësine Ostren

32.

33. Qendra e njësise Gjoricë është në fshatin Gjoricë e sipërme.

i Madh(Bashkia Bulqizë)Gjorica është 25 km larg nga Bulqiza<sup>34</sup>.



Harta 1. Pozita gjeografike e Bashkisë Bulqizë

Harta 2. Njësitë administrative të Bashkisë Bulqizë.

Në Gjoricë takohen formacione gjeologjike, forma të relievit, lloje tokash, bimësh dhe kafshësh të shumta, duke krijuar një mjedis natyror të larmishëm.

Territori i Gjoricës shtrihet në *zonat tektonike*: Korabi, Krasta dhe Mirdita, ku ndërthuren shkëmbinjtë gëlqerorë me ata terrigjenë (kryesisht flishe). Kjo zonë ndërtohet nga shkëmbinj karbonatikë të kornizës karbonatike, nga shkëmbinjtë ofiolitike dhe depozitimet sedimentare.<sup>35</sup>

Lëvizjet diferencuese tektonike, veçanërisht ato neotektonike, kanë luajtur rol kryesor në formimin e malësive dhe konkretisht dhe atë të Gollobordës. Një sërë prishjesh tektonike shkëputëse, të lidhur me përmbysjen dhe zhvendosjen e kulmeve të strukturave kryesore në drejtim të perëndimit, kanë kushtëzuar asimetrinë e shpateve. Për t'u përmendur është thyerja Vlorë-Dibër, me të cilën lidhet zhvendosja e strukturave në formë mbulese si dhe aktiviteti sizmik i herë pas hershëm.<sup>36</sup> Ndaj dhe territori në studim, nëpër të cilin shtrihet kjo thyerje, përfshihet nga lëvizje sizmike si ato të dhjetorit 1967, shtatorit 2009 etj., ku edhe në fshatrat Gjoricë e Çerenec pati dëme të kosiderueshme materiale.

34. Vjetari statistikor 2015, për Bashkinë Bulqizë. Zyra e INSTAT, Bulqizë

35. Melo.V. Buletini i Shkencave Gjeologjike, nr.2.bot.viti 1990.

36. Sulstarova.E, Aliaj.Sh..etj. Rajonizimi Sizmik i RPSSH.fq.26.Tiranë,1980.



Foto 1. Fshati Gjoricë(Gropa e Dibrës) Burimi: A.Begu

Gjorica shtrihet në luginën e Drinit të Zi dhe në malësinë e Gollobordës.

Pjesa më e madhe e Gjoricës shtrihet në gropën e Dibrës(lugina e Drinit të Zi), që u formua në etapën pliokuaternare, kohë në të cilën u bënë zbrazje të kalimeve liqenore, zbrazjes në drejtim të juglindjes. Këtë e dëshmojnë depozitimet liqenore pliocenike.(Gjoricë e Shupenzë zënë pjesën jugore.) Në anën verilindore të pellgut të Dibrës, midis Gjoricës së Poshtëme dhe urës së Topojanit, lugina zgjerohet në depozitimet molasike. Ky zgjerim krahas strukturës grabenore lidhet dhe me grykëdhjen e zallit të Bulqizës, i cili ka krijuar këtu një kon depozitimi. Tarracat lumore shtrihen tek depozitimet liqenore pliocenike.Dallohen dy nivele tarracash në lartësitë absolute 459 m dhe 465 m nga e majta e luginës.<sup>37</sup>



Foto2. Rrugë rurale e asfaltuar në Gjoricë

Foto 3. Rrugë rurale e përfshirë nga rrëshqitjet e tokës

37. Gjeografia Fizike e Shqipërisë. SHBU,Tiranë, 2006.fq.137.

Territori kodrinor i Gjoricës i përket malësisë së Gollobordës dhe zalli i Okshtunit e ndan atë me malësinë e Martaneshit. Në përgjithësi ka relief tipik karstik dhe erozivo–denudues. Shtresat kanë qëndrueshmëri të vogël, deformim të lartë, rezistencë me shtypje njëboshtore dhe gërryhen lehtë nga ujërat. Tipik është rasti i rrëshqitjes në Mallkastër (Çerenec). Formacionet flishore Çerenec – Gjoricë u përfshinë nga lëvizje masive rrëshqitëse. Kjo veprimtari u shfaq më intensive në vitet 2004-2005. Si rezultat u bënë zhvendosje masive dherash-shkëmbore gjatë të gjithë shpateve, që ndërpritën nga rrjeta ujore e zallishteve, përrrenjve, rrëkeve dhe e shpërlarjeve intensive ujore sipërfaqësore. Për rrjedhojë, u dëmtuan objektet e banimit në lagjen Mallkastër, Çerenec i Poshtëm dhe Gjoricë e Sipërme.

Gjorica lidhet me rrugën nacionale nëpërmjet urës së Çerencit. Ka edhe një mundësi për këmbësorët vendas të kalojnë nga ura e varur që lidh shkurt Shupenzën me Gjoricën.

Gjorica shtrihet në zonën mesdhetare paramalore, (nënzona mesdhetare paramalore veriore)<sup>38</sup>. Kjo pasqyrohet në rezervat ujore, rrjedhjet sipërfaqësore<sup>39</sup> dhe regjimin vjetor klimatike të tyre, llojet e tokave, bimësisë dhe faunës, të cilat janë të larmishme dhe të vendosura në kate, në varësi të lartësisë mbi nivelin e detit.

## 2. Kushtet natyrore, faktorë të rëndësishëm zhvillimi

*Relievi* është i larmishëm. Fakti që ka relief që nga ai fushor (fusha e Gjoricës), kodrinor e malor, krijon mundësi për zhvillimin e vendbanimeve, infrastrukturës, të përdorimit të territorit, zhvillimin e bimësisë dhe faunës së egër dhe të kultivuar etj.

Në varësi të relievit janë krijuar tre tipa vendbanimesh:

*fushore*, fshatrat Gjoricë e Poshtëme, Gjoricë e Sipërme;

*kodrinore*, fshatrat Çerenec i Poshtëm, Çerenec i Sipërm, Lubalesh;

*kodrinor-malore*, fshati Viçisht.

Pas viteve '90 megjithë tendencën e madhe të migrimit të popullsisë, përsëri mund të themi se në Gjoricë ka patur ndërtime, por është zbehur tradita e ndërtimit të shtëpisë për banim në rrëzën e kodrës. Prerjet e vazhdueshme e pa kriter të pyjeve e të bimësisë në tërësi kanë rezultuar po ashtu me shtimin e dukurive të erozionit, rrëshqitjeve, shembjeve etj.

38. Klima e Shqipërisë. Instituti i Hidrometeorologjisë, fq. 143, Tiranë 1975.

39. Ujërat që rrjedhin nëpër territorin e Gjoricës i përkasin pellgut të Drinit të Zi.



Në të ardhmen duhet të ndërmerren iniciativa zhvillimi, duke investuar sidomos në hapësira me vlera të larta rekreative e bujqësore me objektiv, ndërtimin e pritave, ripjellëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, hartimin e politikave të zhvillimit urban.

*Relievi* ka kushtëzuar që pjesa e fushës së Gjoricës të përdoret për mbjelljen e bimëve të arave, foragjereve, dru frutorë etj..., si dhe pjesa kodrinore e përshtatshme për *pyje, shkurre dhe kullota*. Vetëm sipërfaqet me pjerrësi të vogël në afërsi të rrjedhjes së zallit të Okshtunit dhe shpatet e buta të kodrave përdoren për *veprimtari* Foto 4.Fshati Gjoricë e poshtëme. Burimi autori 2017. *bujqësore*, kryesisht për drithëra dhe foragjere, drufrutorë dhe vreshta, perime, zarzavate dhe fasule.

Struktura e sipërfaqes së përgjithshme është: 1336 ha *tokë bujqësore*; 2555.35 ha *pyje* dhe 525.65 ha *tokë joprodhuese*, zallishte dhe në zonën kodrinore-malore.

*Klima* është mesdhetare paramalore, (në zona mesdhetare paramalore veriore) <sup>40</sup> Dallohet për klimë të larmishme. Vera është e nxehtë dhe e thatë, ndërsa dimri i ftohtë dhe i lagësht.



Grafik 1. Burimi: Njësia administrative Gjoricë

<sup>40</sup> "Klima e Shqipërisë" Instituti i Hidrometeorologjisë, fq. 143, Tiranë 1975.

Ka minimume të orëve me ndriçim diellor(2000 orë), të rrezatimit diellor(1205 kj/m<sup>2</sup>).

*Temperatura* mesatare shumëvjeçare është 11°C, ndërsa amplituda vjetore (midis dimrit dhe verës) është 20°C. Temperatura mesatare vjetore në Gjoricë 11°C, (janar 0.3°C, korriku 20.4°C). Ngricat fillojnë nga 10 ditëshi i parë i nëntorit deri në javën e parë të prillit. Thellësia e ngrirjes së tokës është 20-30cm. Bryma e parë mund të bjerë që me 15 shtator, por zakonisht bije nga 1- 15 tetor.<sup>41</sup>Temperaturat dhe diellzimi mundësojnë zhvillimin intensiv të veprimtarive të shumëllojshme jetësore dhe ekonomike në territorin e Gjoricës.

*Era* fryn kryesisht nga verilindja dhe lindja, duke ndjekur korridoret natyrore, luginat e lumenjve Drini i Zi dhe Radika. Shpejtësia arrin deri në 15-20m/s, sidomos në periudhën e dimrit. Të ekspozuara ndaj erërave të ftohta(Murlani)janë territoret përgjatë rrjedhjes së Drinit të Zi dhe Zallit të Bulqizës, ku gjatë gjysmës së ftohtë (nëntor-prill), ato shkaktojnë ulje të temperaturave dhe dëmtojnë kulturat bujqësore.

*Reshjet* në Gjoricë janë nën mesataren e Republikës, deri në 800 mm/vit, ku bien kryesisht në periudhën nëntor-maj.<sup>42</sup>Kjo lidhet me shtrirjen në lindje dhe pengesat e vargjeve malorë në perëndim. Muajt më të thatë janë korriku dhe gushti. Një pjesë e reshjeve bien në formën e dëborës. Bora nga dhjetori në shkurt arrin trashësi deri 75 cm.<sup>43</sup> Sasia e reshjeve gjatë verës nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të bimësisë së kultivuar ndaj është e domosdoshme vaditja. Në këtë zonë periudha më e përshtatëshme, për zhvillimin e shumicës së bimëve është nga 1 prilli deri më 30 shtator, por ka raste që në kushte atmosferike të përshtatshme fillon më parë, rreth 20-25 marsit.

*Hidrografa.* Gjorica është e rrethuar nga lumenjtë Drini i Zi, Zalli i Bulqizës, Zalli i Okshtunit. Ka një rrjet të dendur kanalesh ujitëse e kulluese. Ushqimi i lumenjve është i përzier: shirat, shkrrirja e borës dhe burimet. Për vetë karakterin mesdhetar lumenjtë si ushqim kryesor kanë ujërat sipërfaqësorë në 69% dhe ato nëntokësorë në 31%. Regjimi është mesdhetar me prurje minimale në verë (korrik-shtator 20%) dhe maksimum në (tetor-qershor 80%). Prandaj, vërehen ndryshime në koeficientin dhe modulën e rrjedhjes. Maksimumi i prurjeve është në vjeshtë, në fillimin e dimrit dhe në fillimin e pranverës. Koeficienti i rrjedhjes në Drinin e Zi dhe zallin e Bulqizës është nga 080-082.<sup>44</sup> Moduli i rrjedhjes mesatarisht është 30.2 litra/sek/km<sup>2</sup>.Drini në Urën e Topojanit e ka modulën e rrjedhjes

41. Staconi Meterologjik Peshkopi(2015)

42. Po aty

43. Ndërmarja e Ujrave Bulqizë."Studim për pellgun e zallit të Bulqizës viti 1999"(Arkivi)

44. Ndërmarja e Ujrave Bulqizë."Studim për pellgun e zallit të Bulqizës viti 1999"(Arkivi)

16.3 litra/sek/km<sup>2</sup>.<sup>45</sup>

Për shkak të pjerrësisë përrrenjtë e lumenjtë e zonës gërryejnë, transportojnë e akumulojnë (në Gjoricë) materiale të ngurta duke krijuar edhe forma të ndryshme në relievin ku ato kalojnë. Rrjeti hidrologjik i zonës i përket pellgut ujëmbledhës të Drinit të Zi, (3km gjatësi përshkon njësinë administrative Gjoricë). Arteria kryesore e tij është Zalli i Bulqizës, i cili gjatë rrugës, nga burimi (liqenet akullnajore të Balgjajt) deri në derdhje (Drini i Zi), në afërsi të urës së Topojanit, merr nga të dy anët shumë përrenj të vegjël e përroska dhe ka gjatësi 46.5 km.<sup>46</sup> Derdhjen më të madhe në Zallin e Bulqizës (djathtas) e bën Zalli i Okshtunit, që rrjedh në luginën me të njëjtin emër me gjatësi 17km. Buron në lindje të malit të Mirakës dhe bashkohet me zallin e Bulqizës në afërsi të urës së Çerenecit. Ujërat kanë përdorim të shumëfishtë për popullsinë dhe ekonominë si: për prodhimin e energjisë elektrike (HEC-et që po ndërtohen në zallin e Okshtunit), ujitjen e kulturave bujqësore, rritjen e peshkut dhe të shpendëve ujorë, si ujë i pijshëm etj.

*Tokat.* Në tokat e zonës kodrinore vendin kryesor e zë brezi i tokave të kafenjta. Tokat e kafenjta malore (600-1000 m), që vërehen në Çerenec, Mallkastër, Viçisht etj.<sup>(86)</sup> Për shkak të mbulesës së dendur pyjore, këto toka janë të pasura me humus. Zënë rreth 50% të sipërfaqes dhe është e veshur me dushqe në përgjithësi. Kërkojnë masa kundër erozionit dhe rritjen e pjellorisë.<sup>47</sup>

Tokat e hirta kafe, shtrihen në lartësinë deri 500 m dhe formohen në kushte të klimës mesdhetare, verë të thatë, toka thahet, cahet, tjetërsohet, si pasojë ndodh frenimi deri zhdukja e mbulesës bimore. Përmban 2–4% humus.<sup>48</sup> Kanë reaksion bazik. Janë karakteristike në konet e depozitimit.



Foto2.Ndërtimi i argjinaturave në lumin Drin (Gjoricë)2017.Burimi:Ora News.

45. Po aty

46. Po aty

47. Ndërmarrja Gjeologjike Bulqizë (Arkivi 2015)

48. Po aty

Nisur nga gjendja aktuale e tokave konkludojmë se ka një nivel të ulët të mirëmbajtjes të veprave mbrojtëse të tokave nga ujrat sipërfaqësor, erozioni, rrëshqitjet etj. Parandalimi i depozitimeve të materialeve inerte të sjella mund të bëhet i mundur dhe efektiv vetëm nëpërmjet ndërtimit të veprave mbrojtëse (pritave tip rezervuar) për gjatë gjithë gjatësisë së lumenjve. Rastet e vërshimit të Drinit në vitet '60, apo dhe vitin 2016 dhe mbulimi me zhavore të një sipërfaqeje të madhe toke, tregojnë se masat për mbrojtjen e tokës duhet të jenë prioritare për institucionet. Ndërtimi gjatë vitit të kaluar i pritave në lumin Drin si dhe gjatë këtij viti tek ura e Çerenecit në Zallin e Bulqizës, tregon se po merret seriozisht problemi.

Po ashtu në masat parandaluese ndaj përmbytjeve edhe në të ardhmen kërkohet kontroll i rreptë dhe strikt i shfrytëzimit pa kriter të materialeve inerte; Pyllëzim sa më i shpejtë dhe ngritja e veprave hidroteknike me qëllim disiplinimin e rrjedhës së ujit; Eliminimin e ndërhyrjeve mekanike në afërsi të shtratit të lumenjve dhe urave si ajo e Çerenecit që rezikon të dëmtohet.

*Bimësia* është e shumëllojshme dhe e tipit mesdhetar dhe katëzim vertikal të qartë.<sup>49</sup>

*Shkurret* (gjenden në lartësinë 500-600 m deri 700-800 m) në lloje si: gorrice (Pyrus amydoliformis, murrizi etj. Është brez i degraduar nga prerja, dje-gia, mbikullotja etj.

*Brezi i dushkut* (deri në 800 m) me llojet kryesore: Shkoza e zezë (Carpinus orientalis), panja (Acer obtusatum), frashëri i bardhë (Fraxinus ornus), bliri gjethegjërë (Tilia platyphyllos), pisha e zezë (Pinus nigra arnold), shparthi (Quercus frainetto Ten), qarri (Quercus Cuis L.), gështenja (Castanea sativa Miller), shkoza (Carpinus betulus L.). Dushqet e kësaj zone i ngjajnë atyre të Europës Qëndrore e Ballkanit verior (bunga, qarri)<sup>50</sup>. Përmendim në këtë brez pyjet me gështenja të kultivuara e natyrale në Gjoricë të Sipërme, Çerenec. Ky brez përdoret për kullotje, dru zjarri, bimë mjeksore. Janë mbjellë dhe pemë të shumta drufutrore si molla, kumbulla, dardha, qershia etj. Ripërtëritja e këtij brezi është bërë pas viteve 1990.

Bimësia ndikon pozitivisht në mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe në të njëjtën kohë sigurohet lëndë drusore për ngrohje, ndërtim etj. Në këto pyje rriten shumë bimë medicinale si: dëllinja, trëndafili i egër, çaji i malit, lule bliri, zhumblica, mëllaga, lule basani, lule shtogu sherebela, trumza, kamomili, luleshtrydhja, lulëkuqja etj. Në kullota rriten bimë me vlera ushqimore për

49. Gjeografia fizike e Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Qendra e Studimeve Gjeografike, vol.I, fq.211. Tiranë, 1991.

50. Po aty

bagëtinë, të tilla si: tërfili, grami, talla, shpatorja. Në kuadër të rritjes së kujdesit ndaj pyjeve me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 375 datë 27.03.2008, kanë kaluar në administrim të njësisë administrative Gjoricë 2555.35 ha pyje e kullota.

*Fauna* është e pasur në lloje. Në zonën kodrinore malore rriten kafshë të egra si: dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër dhe shpendët si thëllëza, shkurtëza, shapka, fazani, mëllenja etj. Specie me rrezik zhdukje janë: Mëllenja, gala, laraska, bufi, qyqja dhe sidomos thëllëza është më e rrezikuara nga gjuetia pa kontroll, ndërsa po kaq i rrezikuar është dhe pëllumbi i egër që mund të konsiderohet i zhdukur. Në ujërat e Drinit, rriten ballëgjeri, qefullietj. Ndërsa në ujrat e Zallit të Okshtunit gjendet trofta.

Bota bimore dhe shtazore kanë qenë dhe mbeten një premisë e rëndësishme për zhvillimin e blegtorisë, industrisë së drurit apo të bletarisë, gjuetisë, grumbullimi e përpunimi i bimëve mjekësore dhe aromatike.

*Infrastruktura rrugore*, konsiderohet si mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social. Gjorica lidhet me rrugën nacionale me rrugë të asfaltuar. Po ashtu janë asfaltuar rrugët brenda fshatrave Gjoricë e Poshtëme dhe e Sipërme. Rrugët lidhëse të fshatrave Viçisht, Lubalesh, Çerenec i Sipërm, janë në gjendje jo të mirë dhe sidomos në dimër bëhen gati të pakalueshme për makina. Në fondin e rrjetit rrugor rezultojnë 25 km rrugë nacionale e pa asfaltuar (pjesë të segmentit Ura e Çerenecit –Librazhd), 10 km rrugë e asfaltuar brenda fshatit Gjoricë dhe 30 km rrugë në gjendje të keqe sidomos në stinën e dimrit janë të pakalueshme.<sup>51</sup> Rruga Çerenec-Lubalesh kërkon investime më të mëdha për kushtet e vështira të relievit nëpër luginën e zallit të Okshtunit.


### 3. Popullsia dhe roli i saj në zhvillimin ekonomik

Territori i Gjoricës daton të ketë qenë i populluar që në kohët e lashta, kjo e bazuar në gjetje të ndryshme arkeologjike, në dokumenta historik dhe në ato gjuhësore. Vazhdimësia vërtetohet nga toponimet, si dhe gjetjet e shumta arkeologjike që nga antikiteti e në vazhdimësi, brenda territorit dhe tek fqinjët, si në Burim, Gradec, Topojan, Strikçan, Kojovec. Fakt i rëndësishëm është se banorët e kanë ruajtur fort identitetin e tyre. Tregues është ruajtja e traditave kulturore, gjuhës e zakoneve në shekuj.

Sipas të dhënave Gjorica dhe fshatrat e tjerë, kanë popullsi 5670 banorë dhe 1459 familje (dhjetor 2015). Ndërsa në disa vite numri i banorëve dhe familjeve në grafikon 2.

51. Bashkia Bulqizë.(2015)

Popullsia në disa vite: Graf. 2 Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, bashkia Bulqizë, 2015.



Siç shihet dhe nga grafiku popullsia ka rënie. Nga viti 2003 në vitin 2015 popullsia ka pësuar rënie me 164 banorë. Kjo e lidhur me rënien e lindjeve, emigracionin e moshave të reja brenda e jashtë vendit, faktorë social dhe ekonomik etj. Ndërsa është rritur numri i familjeve (90 familje), që lidhet me faktin e ndryshimeve graduale edhe të konceptit mbi familjen në përgjithësi dhe atë patriarkale në veçanti. Kjo duket në rënien e numrit të antarëve për familje. Nëse në vitin 1993 familja kishte mesatarisht 4.3 antarë, në vitin 2015 ka 3.6 antarë.

Gjorica ka potencial njerëzor të mjaftueshëm për shfrytëzimin e resurseve, zhvillimin e ekonomisë shumëdegëshe dhe të veprimtarive social-kulturore. Po ashtu vlerësohet si relativisht e përshtatshme për jetesë dhe veprimtari ekonomike nga banorët e saj. Natyrisht që zhvillimi i infrastrukturës rrugore, sidomos me ndërtimin e rrugës së Arbërit që e përshkon Gjoricën mes për mes do të kthehet në faktor zhvillimi ekonomik, rikthimin e njerëzve, kujdesin për tokën etj.

Në strukturë, popullsia paraqet *ekuilibër gjinor* dhe një *piramidë moshore afër normales*. Përsa përfaqësohet relativisht e madhe e grupmoshës 0-18 vjeç tregon se janë ruajtur ritme të kënaqshme të shtimit natyror të popullsisë, megjithëse prirja e pakësimit të lindjeve është e evidente, po ritmet ende garantojnë furnizimin normal të grupmoshës së punës, për dekadën në vijim. Pavarësisht emigracionit të një pjese të rëndësishme të popullsisë së re 18-40 vjeç, mund të përballohen kërkesat për fuqi puntore në ekonominë bujqësore, sektorin e shërbimeve, turizmit, ndërtimit, artizanatit etj.

Tabela 1. Popullsia sipas vendbanimeve<sup>52</sup>

Vendbanimi	Popullsia gjithsej	Fëmijë 0-1 vj.	Fëmijë 1-14 vj.	Invalid	Pensionist	Gra shtatzëna
Gjoricë e Sipërme	2091	42	430	44	350	40
Gjoricë e Poshtëme	1443	19	367	10	117	32
Çerenec i Sipërm	539	10	140	3	33	13
Çerenec i Poshtëm	653	11	196	8	40	10
Viçisht	599	11	154	10	60	4
Lubalesh	345	3	84	2	25	2
<b>TOTAL</b>	<b>5670</b>	<b>96</b>	<b>1371</b>	<b>77</b>	<b>625</b>	<b>101</b>

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Bulqizë, 2015

Popullsia ka tradita arsimdashëse. Funkcionojnë 3 shkolla 9-vje-care dhe 3 shkolla vartëse të C-U. Shkollën e mesme nxënësit e ndjekin në Shupenzë. Japin mësim 44 mësues. Në të gjitha fshatrat ka kopshte fëmi-jësh. Mësojnë në kl.I-V, 425 nxënës, në kl.VI-IX, 387 nxënës.<sup>53</sup> Braktisja e shkollës dhe analfabetizmi janë dukuri të rralla, që lidhen kryesisht me rastet e varfërisë ekstreme apo të distancës së madhe të shkollës nga vendbanimi, sidomos për nxënëset vajza në klasat e larta. Shërbimi shëndetësor realizohet nga 1 mjekë, 11 infermiere dhe mami,<sup>54</sup> që kryejnë shërbim në të gjitha fshatrat. Banorët shërbimet më të specializuara i marrin në spitalin e Bulqizës dhe Spitalin Rajonal të Peshkopisë.

#### 4. Zhvillimi ekonomik e kulturor

Njësia Gjoricë është krijuar si njësi administrative në vitin 1991 (komuna Gjoricë). Bën pjesë në Bashkinë e Bulqizës, e cila është pjesë e Qarkut të Dibrës.

Territori i Gjoricës ndodhet në pozicion të përshtatshëm të rrugëve kombëtare dhe ndërkombëtare. Vetëm 25 km larg Peshkopisë, 15 km larg doganës së Bllatës. Rëndësia e pozitës së njësisë do të shumëfishohet me ndër-timin e rrugës së Arbërit, pasi do të kalojë nëpër Gjoricë, në doganën e Bllatës e më tej në Peshkopi e Maqedoni, Kosovë. Po ashtu kjo do të afronte shkëmbimin e mallrave e të njerëzve me kryeqytetin, portin e Durrësit, Shëngjinit etj.

Në Shupenzë ku ndodhet një nga tregjet e hapura më të mëdha të bashkisë me rolin kryesorë në tregëtimin e produkteve bujqësore blegtorale e luan popullsia e Gjoricës. Tregu që funksionon çdo të diel u sjell të ardhura të kon-

52. Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Bulqizë, 2015.

53. Zyra Arsimore Bulqizë, statistika(2015)

54. Drejtorja e Shëndetit Publik, statistika(2015)

siderueshme.

Pozita në luginën e Drinit dhe Zallit të Bulqizës dhe Okshtunit ka mundësuar shfrytëzimin e inerteve për ndërtim.

Gjorica dallohet për kulturë, tradita, zakone, veshje, folklor etj. Për këtë arsye, ajo ka të ardhme të turizmit kulturor .

*Ekonomia e Gjoricës* mbështet në prodhimin bujqëor; blegtoral, pentari, pyje etj. Gjorica ka kushte natyrore të përshtatshme për bimët e arave si grurë, misër, fasule, foragjere, perime etj. Ka tradita për kultivimin e specit. Vitet e fundit janë mjellë parcela me pemë frutore si mollë, dardhë, rrush, lajthi, arrë, gështenjë etj. Toka ka nevojë për vaditje. Ndaj janë hapur kanale vaditëse si: Lubalesh-Çerenec i poshtëm 13 km, Gjoricë e Sipërme – Gjoricë e Poshtme, kanali i Zallit (mullirit), kanali i Drinit, kanali Tuçep-Çerenec i Sipërm-Viçisht 14 km etj.

*Tabela 3. Prodhimet bujqësore*

Kulturat bujqësore	Sasia në ha	Rendimenti kv	Totali në kv	Totali në ton
Grurë	508	45	22860	2286
Misër	604	55	33220	3322
Foragjere	26.6	25	665	66.5
Fasule	604	1.5	9060	906
Frutikulturë	38	10	380	38
Perime	25	30	750	75

Burimi: *Njësia administrative Gjoricë, 2015*

#### 4. Numri i krerëve në Gjoricë Burimi: *Njësia administrative Gjoricë, 2015*

Vendbanimi	Gjedh	Lopë	Njëthundrak	Dele	Dhi	Shpend	Bletë
Gjoricë e Sipërme	524	390	97	295	97	2550	20
Gjoricë e Poshtëme	452	309	78	95	17	2100	25
Çerenec i Sipërm	197	119	49	380	110	1170	10
Çerenec i Poshtëm	205	125	56	325	153	1110	50
Lubalesh	203	147	75	330	165	880	40
Viçisht	139	110	46	215	155	840	25
<b>TOTAL</b>	<b>1720</b>	<b>1200</b>	<b>401</b>	<b>1640</b>	<b>697</b>	<b>8650</b>	<b>170</b>

Toka e Gjoricës ka nevojë për kullim të vazhdueshëm. Prandaj në mënyrë

sistematike duhet të pastrohen kanalet kullues të parë të dytë e të tretë.

Pjesa fushore mbarështon gjedhët, ndërsa ajo kodrinore dele, dhi, njëthundrak, bletë etj. Në Gjoricë ushtrojnë aktivitetet thertore, njësi tregtare shumice e pakicë, etj.



Foto 2. Pemtore e re në Gjoricë

### 4.1 Perspektiva turistike e Gjoricës, faktor i rëndësishëm zhvillimi

Kushtet e veçanta natyrore, kulturore e historike, janë faktorë të rëndësishëm, në të ardhmen turistike të zonës.

Në trashëgiminë historike dhe kulturore të Gjoricës objekte, ngjarje dhe figura, që e rendisin atë ndër trevat më të pasura të Bulqizës. Treva është shquar për atdhedashuri dhe rol të veçantë në mbrojtjen e kufijve nga shovinizmi. Në luftën e Drinit(1844), popullsia e kësaj zone dha kontribut të veçantë, ndaj edhe sot këndohet kënga:“*Nanqind vorret kush i bani,/të nantë malet e sheh Zerqani*”(popullore e zonës).

Në zonë dhe afër saj gjenden shumë objekte historike si në: Strikçan, Sofraçan (Zerqan), Çerenec(labidari i Tercilio Cardinalit)etj.Vendbanimet ruajnë gjurmë të popullimit të periudhës ilire ndërsa varrezat antike dhe mesjetare, si dhe objektet shoqëruese, të zbuluara në Burim, Topojan, Strikçan etj, por mbeten ende të pastuduara si duhet.

Po ashtu në zonë, Pazari i Shupenzës është tregu i hapur më i madh për gjithë Bashkinë e Bulqizës. Çdo të diel aty vijnë tregtarë dhe blerës nga një hapësirë e gjerë, që përfshin Shupenzën, Gjoricën, Zerqanin, Bulqizën, Fushë Bulqizën, Ostrenin, Trebishtin etj. Pazari gjallëron jetën social-ekonomike të

banorëve. Përveç tregëtimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe artizanale, tregu realizon një komunikim ndërkrahinor, social-kulturorë dhe bashkëpunim të gjithanshëm me të gjithë fshatrave e krahinave.

Ndër *banesat private* dallohen shtëpitë 1 – 2 kate. Bien në sy sidomos ndërtimet e reja tip vile. Ndërtimet e vjetra po shkatërrohen nga largimet e viteve `90, por me siguri me ndërtimin e rrugës së Arbërit, nga të larguarit brenda e jashtë vendit do të investohet edhe në këtë fushë të ripërtëritjes së vlerave të trashëgimisë që edhe në këtë zonë nuk janë të pakta që mund të kthehen në potenciale turistike.

*Veshjet* dëshmojnë kulturë dhe larmi, si edhe zakonet dhe traditat, ceremonitë dhe ritet, këngët dhe vallet, kanë elemente origjinale dhe autentike të trevës.

Gatimet bazohen në prodhimet e dhe traditat blegtorale dhe bujqësore të banorëve. Ato janë të thjeshta, me miell misri dhe gruri, mish, bulmetin, perimet dhe frutat. Përdoret gjerësisht djathi i dhisë, qumështi i lopës, kosi i deles, gjalpi etj. Krahas perimeve dhe zarzavateve tradicionale si: qepa, hudhra, fasulja, patatja, lakra, speci dhe preshi, përdoret edhe domatja, kastravec, patëllxhani etj. Rakia e prodhuar në mënyrë tradicionale nga rrushi, kumbulla, thana, është cilësore dhe e kërkuar në treg.

#### 4.2. Marëdhëniet ndërkufitare, faktorë zhvillimi.

Para viteve `90, Gjorica ishte e shpallur “Zonë kufitare”, ndaj aty mund të futeshe vetëm me leje nga Dega e Punëve të Brendshme dhe familjarëve edhe kur u vinin mysafirë në shtëpi duhet të raportnin në postën kufitare. Në vitet 1990-1991 shumë të rinjë në përpjekje për të kaluar kufirin, për një jetë më të mirë, u vranë e u varrosën me duar të lidhura me tela me gjemba. Kjo mbyllje brenda kufirit të rrethuar me tela natyrisht ndikoi dhe në zhvillimin ekonomik e atë social. Ndërsa sot, pozicioni gjeografik si zonë kufitare me Maqedoninë, është shndërruar për Gjoricën një ndër faktorët e zhvillimit tani e në të ardhmen. Gjorica është fqinje me njësinë e Maqellarës, doganën Bllatë dhe pikën e kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar “Xhepisht-Trebisht” (Njësia administrative Trebisht).

Shkëmbehen mallra dhe njerëzit lëvizin lirshëm vetëm me kartë identiteti. Ka bashkëpunim kulturor e arsimor me komunat me popullsi shqiptare. Me dhjetra të rinjë vazhdojnë studimet në Universitetin e Tetovës e shkolla të tjera në Strugë, Ohër etj. Ka martesë sporadike të vajzave në Dibër, Tetovë, Kërçovë, Gostivarë etj. Megjithatë ka edhe problem që kërkojnë zgjidhje.

Lumi Drin i Zi është përcaktuar si kufiri ndarës mes Shqipërisë dhe Maqedonisë në Gjoricë. Por ky lumë në 15 vitet e fundit nga vërshimet e gërryerjet, ka marrë tokë në pjesën shqiptare. Kjo ka ndodhur pasi nuk u investua për mirëmbajtjen e ndërtimin e argjinaturave dhe Drini i “dhuron” tokë shtetit maqedonas. Vetëm vitin e fundit, falë investimeve kanë filluar punimet në argjinaturën e Drinit të Zi, për të eliminuar fryrjen dhe devijimin e tij në tokën shqiptare. Nga spostimi i Drinit të Zi, piramida 16, ka hyrë 500 metra në territorin shqiptar. Kjo sipas banorëve ka ndodhur se shteti Maqedonas, ka mundësuar devijimin e Drinit të Zi, duke ndërtuar mure me blloqe betoni mbrojtës, që lumi, e për pasojë kufiri, të shtyhet në brendësi të tokës shqiptare. Drini buron nga liqeni i Ohrit, depoziton prurjet në H/C të Dibrës së Madhe, duke u bërë shkak për luhate të theksuara të prurjeve në maksimume apo minimum të reshjeve. Po ashtu edhe perpjekja për të devijuar rrjedhën e lumit Radika (degë e Drinit), në Vardar, do të ndikonte në prurjet normale të Drinit dhe direkt në kaskadën e prodhimit të energjisë elektrike në H/C.

Për të realizuar një bashkëpunim të ndërsjellë mes dy vendeve janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e bujqësisë(1998), transportin ndërkombëtar të udhëtareve dhe të mallrave(1998), hapjen e pikës së kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar midis dy vendeve “Xhepisht-Trebisht” (2005), luftën ndaj terrorizmit, krimin të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope, migracionit të paligjshëm.(2007) lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve (2008) etj.Në të ardhmen, me ndërtimin e rrugës së Arbërit që kalon nëpër Gjoricë, do të ndërtohet dhe ura mbi lumin Drin, gjë e cila do të bëjë të mundur që territori të jetë largë nga dogana e Bllatës 2-3 km.Kup-tohet se kjo do të sjellë impakte të reja zhvillimi edhe për Gjoricën.

### **Përfundime dhe sugjerime**

Argumentet sa më sipër na çojnë në përfundimin se Gjorica ka pasuri natyrore dhe humane të mjaftueshme për zhvillim ekonomik dhe social në vitet që vijnë.

Këtë e bazojmë në:

Pozitën e favorshme gjeografike, në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme Bulqizë-Peshkopi, Bulqizë – Dibër e Madhe si dhe afërsia gjeografike me pikat doganore të Bllatës dhe Trebishtit; Ndërtimi i rrugës së Arbërit që sipas projektit kalon nëpër Gjoricë do të kthehet në faktor i rëndësishëm zhvillimi.

pozitën afër tregjeve rajonale të Shupenzës, Peshkopisë, Dibër e Madhe;

Ka linja të rrugëve lidhëse të fshatrave që mund të zgjerohen dhe asfal-

tohen, me pak investime;

Klimë e shëndetshme dhe sistem kanalesh vaditëse të mjaftueshëm për ujitje;

pasuritë pyjore, kryesisht shkurreve, dushqeve;

bimësinë barishtore të pasur dhe të shumëllojshme, sdomos në zonën kodrinore e përshtatshme për mbarështimin e blegtorisë;

Potencial për agroturizëm, turizëm rural, sportiv etj;

Njerëz punëdashës, me tradita të pasura në bujqësi, blegtori, zeje;

Mendojmë se për t'i kthyer sa më sipër, në faktorë të rëndësishëm zhvillimi kërkohet:

Përmirësimi i infrastrukturës së ujësjesve, rrjetit elektrik dhe asfaltimi i rrugëve në trasenë e atyre ekzistuese: Çerenec-Lubalesh, Çerenec-Viçisht, Çerenec i poshtëm-Çerenec i sipërm.

Furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, duke shfrytëzuar burimet ujore të krahinës.

Përmirësimi i infrastrukturës sociale si: kopshte, shkolla, qendra kulturore dhe sportive për të rinjtë.

Ruafta e pasurimi i trashëgimisë kulturore, si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit social dhe kulturor.

Veprimtari e gjithanshme ekonomike në turizëm, artizanat, pyje, shtimi i sipërfaqeve me vreshta, arra, gështenja, pemë frutore, perime etj. Për turizmin e natyrës ekzistojnë potenciale të mëdha si lumenjtë Drin, Zalli i Okshtunit, Zalli i Bulqizës, luginat e tyre, mundësi për plazh gjatë verës, sporte etj.

Hartimi i strategjive për zhvillim, me financime lokale, qeveritare apo individë, subjekte, fondacione etj.

Vazhdimi i investimeve për ndërtimin e argjinaturave në lumin Drin dhe zalli i Bulqizës.

Prezantimi dhe afirmimi i produkteve kudo në tregje e panairë si: mishi i qengjit, viçit, djathi, frutat, perimet sidomos speci, tradita gastronomike etj.

Natyrisht që vitet e fundit një pjesë e banorëve të larguar në emigracion po kthehen për të mbjellë parcela me pemë frutore sipas standarteve bashkëkohore, vreshta, drithëra, foragjere, perime e zarzavate; për të hapur restorante e biznese të tjera, për t'u kujdesur për pyjet.

### **Burimet e shfrytëzuara**

- Grup autorësh, ASHSH, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë 1991.
- Grup autorësh, ASHSH, FESH, Vëllimi I, II, III, Tiranë 2008 dhe 2009.
- Theodor Ippen. Mbretëria Shqiptare në 1267-1373 tek revista "Dituria", dhjetor 1928, nr.12, fq.376
- Melo.V. Buletini i Shkencave Gjeologjike, nr.2.bot.viti 1990.
- Sulstarova.E, Aliaj.Sh..etj. Rajonizimi Sizmik i RPSSH.Tiranë,1980.
- Klima e Shqipërisë.Instituti i Hidrometeorologjisë. Tiranë 1975.
- Gruda Gj., (2011). Vlerësimi i potencialit natyror e njerëzor në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës së Martaneshit, Studime albanologjike nr.4, Tiranë.
- Begu(Balla). A, Lugina e Bulqizës(Studim rajonal për Msc, 2011)
- Bollobani(Dodoveci).E,(2015) Vlerësimi i burimeve natyrore të malësisë së Gollobordës në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm, Studime gjeografike nr.19, Tiranë.
- Bollobani (Dodoveci) E., (2015). Shfrytëzimi ekonomik i mjedisit natyror në malësitë Çermenikë – Gollobordë – Martanesh, Studime gjeografike nr. 18, Tiranë.
- Akademia e Shkencave (1988). Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë.
- Pano N., (2008). Pasuritë ujore të Shqipërisë, Tiranë.
- Staconi Meteorologjik Peshkopi(2015)
- Ndërmarja e Ujrave Bulqizë."Studim për pellgun e zallit të Bulqizës viti 1999" (Arkivi)
- Zyra Arsimore, Bulqizë, 2015.
- Drejtoria e Shëndetit Publik, Bulqizë, 2015
- Vjetari statistikor 2015, për Bashkinë Bulqizë.Zyra e INSTAT, Bulqizë
- Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Bulqizë, 2015.

## THE ROLE OF PHYSICO-GEOGRAPHIC FACTORS IN THE SUSTAINABLE DEVELOPMENT OF THE GJORICA ADMINISTRATIVE UNIT

### Abstract

*The Gjorica administrative unit lies in the central mountainous province, in the eastern part of it, bordering with the Macedonian republic. Its geographic position as a border area as well as the physical-geographic factors have influenced the development of this unit. The territory is characterized by a varied relief with a large degree of vertical and horizontal fragmentation.*

*The purpose of the article is to highlight the role of physico-geographic factors in the perspective development of the Gjorica administrative unit as an integral part of the Bulqiza municipality.*

*The lithology, tectonics, morphologic and morphogenetic features, as well as the modeling processes of the relief, which are favored by the slope of the terrain, are analyzed in the work. Gjorica has considerable water potential, which should be efficiently utilized by the inhabitants. The climatic elements values favor the growth of some agricultural crops whose cultivation is the primary activity for the inhabitants.*

*Residents of the unit Gjorica deal with agriculture, forestry, animal husbandry etc. But sustainable development requires the implementation of some scientific criteria of human activity, directing the population to efficiently exploit natural resources.*

*Also, for the area specifics there will be identified factors of cross-border relations in today's and prospective developments, as well as on water issues, commodity exchange etc.*

*For the realization of this article, have been used written sources, information provided in the Gjorica administrative unit, as well as consultations with specialists and residents of the area.*

**Key words:** *physico-geographic factors, administrative unit, sustainable development.*

## SFIDAT E RIINTEGRIMIT TË NXËNËSVE TË KTHYER NGA EMIGRACIONI NË SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR

Doc. dr. Albana KOSOVRASTI<sup>55</sup>

Prof. asoc. dr. Sonila XHAFA<sup>56</sup>

### Shkurtesë

*Për shumë emigrantë të kthyer në shtetin amë, riintegrimi shpesh paraqitet më i vështirë dhe se emigrimi. Rikthimi në atdhe shoqërohet me shumë karakteristika e veçori të panjohura për emigrantët e larguar vite më parë. Dhe, akoma më i vështirë është ky riintegrim për fëmijët, sidomos për ata të lindur në një shtet tjetër. Ky studim ka në fokusin e tij politikën që ka ndërmarrë MAS dhe institucionet e tjera arsimore në Shqipëri, për t'ju mundësuar fëmijëve të kthyer nga emigracioni një riintegrim sa më të shpejtë. Në këtë studim do të evidentojmë numrin e nxënësve të kthyer në Shqipëri vitet e fundit në bashki të ndryshme, masat që janë marrë nga institucionet arsimore për riintegrimin e tyre në shkollë, si dhe problematikat e shumta që kanë hasur këto institucione në këtë proces.*

*Nëpërmjet analizës së pyetorit të realizuar me prindër e fëmijë emigrantë të kthyer në Shqipëri do të evidentojmë se sa ata kanë arritur të riintegrohen, dhe nëse këta fëmijë mendojnë të qëndrojnë përfundimisht në Shqipëri apo të largohen përsëri në shtetin ku kanë qenë apo në një shtet tjetër më të zhvilluar. Kjo analizë do të na ndihmojë të nxjerrim përfundime të sakta mbi ecurinë e procesit të riintegrimin të tyre në Shqipëri, por dhe cila do të jetë e ardhmja e këtij brezi që jeta i përballi me një sfidë të tillë.*

**Fjalët kyçe:** riintegrim, azilkërkues, udhëzim, strategji, sistem arsimor.

### Riintegrimi si fenomen shumëdimensional

55. Pedagoge, Departamenti i Gjeografisë, UT

Riintegrimi është një fenomen shumëdimensional i lidhur me jetën ekonomike, politike e sociale të emigrantit të kthyer në vendin e tij. Kështu riintegrimin e emigrantëve shqiptarë duhet ta shohim si një proces gjithpërfshirës dhe shumë dimensional duke nisur nga riintegrimi kulturor, ekonomik, social deri te ai politik.

Rikthimet në Shqipëri kanë nisur në vitet 2008-2009. Ato përkojnë me fillimin e krizës ekonomike globale në Botë dhe në Europë. Si rezultat shohim se kthimet janë më të shpeshta nga vëndet më të prekura prej krizës ekonomike siç janë Greqia dhe Italia.

Nga një studim i ndërmarrë nga INSTAT dhe IOM në vitin 2014, vetëm gjatë periudhës 2009-2013, në Shqipëri janë kthyer 133.544 emigrantë dhe shumica e tyre janë vendosur në Tiranë, Durrës, Shkodër etj<sup>57</sup>. Dhe vendosja e tyre në një nga këto qytete, pra jo në qytetin e tyre të lindjes apo të origjinës, kërkon një periudhë përshtatje apo ambientimi. Dhe kjo madje nuk është e lehtë për shkak të mentaliteteve apo kulturave të ndryshme. Vështirësi paraqiten dhe në punësimin e të kthyerve apo arsimin e fëmijëve të tyre. Prandaj mund të themi që ky proces është i vështirë dhe përbën një riintegrim të dyfishtë.

### **Kategoritë kryesore të nxënësve të kthyer nga emigracioni**

*Evidentojmë tri kategori kryesore të nxënësve të kthyer nga emigracioni:*

Nxënës që kanë lindur në Shqipëri, kanë emigruar për disa vite dhe për arsye të ndryshme janë rikthyer në Shqipëri.

Nxënës që kanë lindur në emigracion dhe janë kthyer në Shqipëri me familjet, kryesisht në sistemin 9-vjeçar.

Nxënës që kanë emigruar në Gjermani (2014-2015), por që janë kthyer brenda vitit ose pas një periudhe të shkurtër kohore.

### **Masat që janë marrë për riintegrimin**

*Në aspektin ligjor, ndër masat që janë marrë për një riintegrim të qëndrueshëm të nxënësve të kthyer nga emigracioni në Shqipëri përmendim hartimin e një sërë strategjive si:*

Strategjia për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, e cila trajton çështje që lidhen me ri-integrimin në procesin mësimor të nxënësve të kthyer.

57. INSTAT dhe IOM, Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2013


Strategjia Kombëtare për Punësim e Aftësi 2014-2020, ndër të tjera i kush-ton vëmendje edhe politikave aktive për ri-integrimin e emigrantëve të kthyer.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, me qëllim riinteg-rimin e të rinjve të kthyer nga emigrimi. Ky plan veprimi parashikon njohjen e certifikatave apo diplomave për kurset e formimit profesional të zhvilluara në vendet e emigrimit,


Ligji nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" parashikon ngritjen e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore.

*Shkresa Nr.9242 e MAS datë 10.11.2015 "Për regjistrimin dhe trajtimin e nxënësve që kthehen" u drejtohet të gjitha DAR/ZA lidhur me nxënësit, të cilët kthehen nga emigrimi dhe kërkojnë të regjistrohen në institucionet arsimore parauniversitare etj.*

Në tabelat e mëposhtme janë pasqyruar numri i nxënësve të kthyer nga emigracioni në vite si në sistemin arsimor të detyrueshëm 9-vjeçar po ashtu dhe në arsimin e mesëm për gjithë Shqipërinë.



*Tab. 1 Numri i nxënësve të kthyer nga emigracioni në arsimin bazë 9-vjeçar në vite (publik+privat) MAS nëntor 2016<sup>58</sup>*



*Tab. 2 Numri i nxënësve të kthyer nga emigracioni në vite në arsimin e mesëm në vite (publik+privat) MAS nëntor 2016<sup>59</sup>*

### **Numri i nxënësve të kthyer nga emigracioni në Bashkinë Tiranë (qytet)**

58. Zyra e statistikës në MAS

59. Zyra e statistikës në MAS

*Bashkia Tiranë* ka numrin më të madh të nxënësve të kthyer nga emigracioni për vitin 2015-2016 me 356 nxënës, Shkodra 177 nxënës, Durrësi me 133 nxënës etj.

Në arsimin e mesëm vetëm në gjimnazet shtetërore të qytetit të Tiranës, gjatë vitit 2015-2016 janë regjistruar 101 nxënës të ardhur nga emigracioni.

*Tab.3 Numri i nxënësve të kthyer nga emigracioni sipas zyrës së statistike në Dar Tiranë në vitet e fundit në sistemin 9-vjeçar<sup>60</sup>*

Vitet	2013-2014	2014-2015	2015-2016	Shtator 2016
Nr. nxënësve	475	185	356	260

### **Analiza e pyetsorit të realizuar me nxënës të kthyer nga emigracioni në qytetin e Tiranës**

*Pyetsori u realizua me nxënës të arsimit 9-vjeçar, në shkollën Kongresi i Përmetit dhe Gjon Buzuku si dhe në gjimnazin A.Z.Cajupi në qytetin e Tiranës. Plotësuan pyetsorin 40 nxënës gjithsej, 15 në arsimin bazë 9-vjeçar e 25 nxënës në arsimin e mesëm. Nga këta 36 nxënës kanë lindur në Shqipëri dhe 12 jashtë vendit.*

Pyetjes nëse kthimi e fillimi i shkollës në Shqipëri ishte i vështirë 75% e tyre e kanë cilësuar si shumë të vështirë (30nx) dhe 65% prej tyre kanë evidentuar ngarkesën e madhe në mësimet (26 nx.) si shkakun kryesor të kësaj vështirësie.

*Arsimi parauniversitar shqiptar në 26 vite demokraci i është nënshtruar disa reformave, por pa arritur të jetë efikas dhe cilësor. Është e domosdoshme jo vetëm për këta nxënës, por për të gjithë lehtësimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar.*

Për të evidentuar se sa shkolla iu ka ardhur në ndihmë, u pyetën nëse kanë marrë pjesë në konsultimet e organizuara në shkollë dhe: 30% kanë marrë pjesë vetëm në konsultimet e organizuara në shkollë, 42.5% krahas konsultimeve në shkollë kanë marrë dhe mësimet private, dhe 27.5 % nuk kanë patur nevojë pasi kanë ardhur në moshë të vogël apo shkolla nuk ka organizuar konsultime.

*Pothuajse në të gjitha shkollat janë organizuar konsultime sidomos për gjuhën shqipe apo lëndët ekzakte, por jo gjithmonë kanë funksionuar. Këto orë janë mbi ngarkesën mësimore të mësuesve dhe nuk janë të paguara. Sugjerohet që këto orë të pasqyrohen si orë mbi normë dhe të jenë të pagueshme. Në këtë mënyrë këto orë bëhen dhe me efikasë.*

Në shkollë ofrohet shërbimi i psikologut dhe në lidhje me këta nxënës  
60. Zyra e statistikës në DART

ato hartojnë plane të veçantë ku përcaktohen qartë masat që duhen marrë për riintegrimin e shpejtë të tyre, si dhe për të zgjidhur konfliktet midis tyre e bashkëmoshatarëve.

Nga nxënësit që plotësuan pyetsorin: 95% janë kontaktuar nga psikologu i shkollës, por nuk kanë patur probleme. Vetëm 2 prej tyre kanë patur nevojë për ndihmë: 1për shkak të problemeve familjare dhe tjetri për komunikimin me shokët.

*Shërbimi i psikologut në të gjitha shkollat iu ofrohet nxënësve të kthyer nga emigrimi. Ato evidentojnë rastet dhe mbi bazën e tyre hartojnë plan pune për të bërë të mundur ri-integrimin e shpejtë të tyre. Sugjerojmë që të zhvillohen më shumë biseda informuese në lidhje me qëndrimet ndaj fenomeneve shqetësuese si duhanit, drogës, mënyrës së organizimit të aktiviteteve etj.*

Për të parë se sa këta nxënës janë integruar iu drejtua pyetja:

**A mendoni të ktheheni përsëri në vendin ku keni qenë apo në një vend tjetër?**

97.5% përgjigjen po. Vetëm një nxënëse e lindur në Florida të Amerikës, e ardhur në moshë të vogël 6- vjeçe dhe që ishte në klasë të tetë mendonte të rrinte në Shqipëri dhe mendonin të riktheheshin në Shqipëri pas mbarimit të studimeve vetëm 3 prej tyre.

*Nga këto rezultate shohim qartë se riintegrimi i tyre jo vetëm ka qenë një proces i vështirë, por dhe rezulton jo i sukseshëm.*

**Analiza e pyetsorit të realizuar me prindër të kthyer nga emigracioni në qytetin e Tiranës**

*Plotësuan pyetsorin 50 prindër, të kthyer nga emigracioni që kishin lindur në vende të ndryshme të Shqipërisë, por që aktualisht jetojnë në Tiranë.*

*Disa nga gjetjet janë....*

60% e tyre ishin kthyer nga emigracioni për shkak të krizës ekonomike, kryesisht nga Greqia dhe Italia;

80% e tyre mendojnë që gjendja në Shqipëri është më e keqe se në emigracion;

76% e tyre janë të vetëpunësuar. Vetëm 2 prej tyre punonin në sektorin shtetëror.

92 % e tyre mendojnë që do ti arsimojnë fëmijët e tyre jashtë Shqipërisë;

84 % e tyre mendojnë që është më mirë që fëmijët e tyre të mos kthehen në Shqipëri pas mbarimit të studimeve.

### **Përfundime**

Kurrikula e rënduar, infrastruktura jo e mirë, ndryshimet e shpeshta në sistemin arsimor në Shqipëri kanë vështirësuar shumë riintegrimin e nxënësve të kthyer nga emigracioni.

Nxënësit që kanë kaluar më shumë vite në emigracion dhe që kanë ardhur më të rritur e kanë patur më të vështirë procesin e riintegrimin.

Shumica e tyre mendojnë të largohen përsëri nga Shqipëria jo vetëm për tu arsimuar jashtë, por dhe për të jetuar atje.

Në shkolla duhet krijuar një klimë më pozitive, si nga mësuesit dhe nga nxënësit për të pranuar natyrshëm riintegrimin e nxënësve të kthyer nga emigracioni.

### **Rekomandime**

Është e rëndësishme jo vetëm hartimi i politikave e strategjive gjithpërfshirëse, e ndër to me shumë rëndësi dhe në sistemin arsimor, por duhet punuar më shumë e konkretisht për të siguruar një riintegrim të qëndrueshëm të emigrantëve dhe fëmijëve të tyre të kthyer në Shqipëri.

Duhet të ekzistojë një data-base i plotë dhe i detajuar për të gjithë këta nxënës të kthyer nga emigracioni, si në arsimin 9-vjeçar, por dhe në atë të mesëm.

Të identifikohen nevojat që kanë këta nxënës dhe të organizohen më shumë konsultime e aktivitete kulturore që do ta bënë më të lehtë riintegrimin e tyre.

*E rëndësishme:* rritja e cilësisë së arsimit shqiptar në të gjitha nivelet e tij si dhe reforma të qëndrueshme në të gjitha fushat për të rritur nivelin ekonomik e kulturor të popullsisë në Shqipëri.

**Burimet e shfrytëzuara**

INSTAT dhe IOM, *Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri*.  
Tiranë 2013

Sëiss Agency for Development SDC, Cooperation Regional Research, UNIFR, IDM *Riintegrimi i azilkërkuesve të rinj në sistemin arsimor shqiptar. Letër politikash*

Ministria e Arsimit dhe Sporteve. *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parau-niversitar (2014-2020)*. Tiranë, 2014.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. *Strategjia Kombëtare për-Punësim e Aftësi (2014-2020)*. Tiranë, 2014.

UNICEF dhe Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë. *Raport mbi projektin "Ngritja e Kapaciteteve të Këshilluesve Shkollorë mbi dhunën me Bazë Gjinore. Tiranë, 2014.*

Vathi , Zana, Veronika Duci and Elona Dhembo. *"Homeland (dis)integrations: Educational Experience, Children and Return Migration to Albania," International Migration, 2016.*

## REINTEGRATION CHALLENGES OF STUDENTS RETURNING FROM EMIGRATION INTO THE ALBANIAN EDUCATION SYSTEM

Doc. dr. Albana KOSOVRASTI<sup>61</sup>

Prof.Asc. Dr. Sonila XHAFA<sup>62</sup>

### Summary

*For many emigrants returning to the motherland, reintegration often shows to be much harder than emigration. Returning to motherland is accompanied with many characteristics and peculiarities unknown to the emigrants who left the country years ago. And, even harder is this reintegration for children, especially for those born in a foreign country. This study focuses on the politics that MAS and other education institutes in Albania have undertaken to provide to the children returning from emigration a faster reintegration. In this study, we will be highlighting the number of students returned to Albania in the last years in several municipalities, provisions taken for their reintegration by education institutes, and also numerous problems that these institutions have faced during this process.*

*Through analysis of the questionnaire conducted with emigrant parents and children returned to Albania we will highlight in how much they have managed to reintegrate, and if these children think they will permanently stay in Albania or return to the country they have lived or in another more developed country. This analysis will help us gather accurate conclusions on the performance of their reintegration process in Albania, but also which will be the future of this generation that life confronted them with such challenge.*

**Key words:** *Reintegration, asylum seekers, directive, strategy, education systems.*

---

61. Department of Geography, University of Tirana

62. Department of Geography, University of Tirana

## ZONAT E MBROJTURA NË HAPËSIRËN NDËRKUFITARE MIDIS SHQIPËRISË DHE GREQISË DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I TYRE

Dr. Mariglen SHERIFAJ<sup>63</sup>

### Abstrakt

*Rënia e barrierave ideologjike në Europë në fillim të viteve 1990-të hapi një faqe të re në historinë e marrëdhënieve ndërkufitare në gadishullin ballkanik pjesë e të cilit janë Shqipëria dhe Greqia. Mbi rrënojat e “Perdes së Hekurt” e cila ndante vendet kapitaliste dhe ish komuniste po lulëzon Brezi i Gjelbër i cili promovon paqen, krijimin e urave lidhëse midis popujve, njëkohësisht pasurinë mjedisore dhe kulturore që zonat kufitare trashëgojnë nga e kaluara. Qasja europiane e Shqipërisë e ka përballur atë me shumë sfida si: zhvillimi*

*ekonomik, menaxhimi i integruar i kufijve, ruajtja e biodiversitetit, plotësimi i standarteve mjedisore etj.*

*Në kuadrin e bashkëveprimit ndërkufitar me Greqinë një ndër prioritetet kryesore është krijimi i zonave të mbrojtura të përbashkëta. Kjo kërkon bashkëveprim institucional midis dy vendeve, kohezion të komuniteteve lokale, asistencë europiane nëpërmjet projekteve si Interreg IPA I, Interreg IPA II, Natura 2000, etj. Krijimi i parkut ndërkufitar “Baseni Ohër–Prespë” i cilësuar si Rezervë Europiane e Biosferës është një shembull suksesi që duhet të merret në konsideratë për zonat e mbrojtura përgjatë kufirit greko-shqiptar.*

*Zgjerimi i zonave buferike, krijimi i korridoreve ekologjik, menaxhimi i përbashkët i zonave të mbrojtura, aplikimi i standarteve të njëjta mjedisore etj do të përmirësojë cilësinë e mjedisit gjithashtu do të krijojë shance më të mëdha në zhvillimin e qëndrueshëm të hapësirave ndërkufitare.*

63. Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, mariglens@yahoo.com

*Megjithëse ekzistojnë kontraste zhvillimi midis dy vendeve, në përdorimin e resurseve, menaxhimin e zonave të mbrojtura konkludojmë se e ardhmja e përbashkët shtron si domosdoshmëri zhvlerësimin e kufijve, integrimin e hapësirave ndërkufitare, lejimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerzve, zhvillimin e botës së gjallë në kushte natyrale dhe pa pengesa të krijuara artificialisht nga shoqëria njerëzore.*

***Fjalë kyçe:** Perde e Hekurt, Brezi i Gjelbër, zonë e mbrojtur, korridor ekologjik, Rrjet Ekologjik Europian, hapësirë ndërkufitare, biodiversitet*

### **Kuptimi rreth kufijve dhe rajoneve ndërkufitare**

Koncepti kufi dhe zonë kufitare janë të hershme sa vetë shoqëria njerëzore. Ato kanë evoluar në mënyrë të vazhdueshme. Njeriu si çdo specie ka vendosur kufij në raport me të tjerët apo mjedisin rrethues.

Historikisht kufijtë kanë dy funksione kryesore: **ndarës** midis shteteve për të siguruar e kontrolluar sovranitetin kombëtar dhe trafiqet e paligjshme, si dhe **funksionin e lidhjes** dhe të komunikimit e bashkëpunimit midis vendeve dhe popujve. Në procesin e zgjerimit të mardhënieve bashkëpunuese dhe të kontrollit të paqes e të konfliktëve nga institucionet ndërkombëtare funksioni i parë po zbehët gradualisht dhe kufijtë priren të bëhen formal (vendet Shengen) ndërkohë intensifikohet lëvizja e lirë dhe bashkëpunimi i gjithanshëm<sup>64</sup>.

Megjithatë, akoma në mentalitetin e njerzve ekziston koncepti se vija kufitare më shumë ndan sesa bashkon dy vende apo rajone të ndryshme pasi e kaluara historike ku shtetet bënin ekspansion ndaj njëra tjetrës për territore, burime etj është e freskët (p.sh Lufta e II Botërore). Pjesë e këtij mentaliteti janë edhe kufijtë ideologjik që kanë diferencuar shtete me filozofi të ndryshme; kapitaliste dhe komuniste.

Vitet e fundit Shqipëria dhe shtetet europiane po i shohin në një prizëm të ri kufijtë dhe mardhëniet me fqinjët. Tashmë vendet kufitare konsiderohen partner dhe jo kundërshtar apo urzupator territorial, politik, ekonomik, etj

Në kuadër të zgjerimit të BE-së drejt vendeve të Ballkanit një ndër objektivat e këtij unioni është pakësimi i kontrasteve në zhvillim midis vendeve aspirante dhe anëtare, ku në fokus janë hapësirat ndërkufitare midis shteteve. Në rajonet ndërkufitare synohet; të aplikohen standarte të njëjta në ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit, zhvillimi social-ekonomik të jetë pa diferenca të

64. Ziu.T, Geografia e rregullimit të territorit, fq 148, Pegi, Tiranë 2009

theksuara, të ndërtohet një infrastrukturë e cila lehtëson komunikimin midis tyre sikur të ishin ndarje administrative brenda një shteti etj. Programe të tilla si IPA I (2007-2013) dhe IPA II (2014-2020<sup>65</sup>) të cilat mbështeten në dokumentat strategjike europiane “Strategjia e Europës 2020” dhe “Strategjia e BE për megarajonin Adriatiko-Jonian” etj kanë dhënë një ndihmë shumë të madhe në integrimin e hapësirave kufitare të vendit tonë me shtetet kufitare një ndër të cilat është edhe Greqia.

Çështje tjetër e rëndësishme është përcaktimi i hapësirës ndërkufitare midis shteteve. Në rregulloren për vendet Shengen ku aderon fqinji jugor i Shqipërisë, Greqia, hapësira ndërkufitare midis dy shteteve shkon deri në 50 km ose 31 milje larg nga vija e kufirit<sup>66</sup>.

Duke iu referuar kësaj rregulloreje si dhe programit Interreg IPA I (2007-2013) hapësira ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë zë një sipërfaqe në total prej 21,588 km<sup>2</sup>, ku përfshihen 3 qarqe në Shqipëri dhe 6 prefektura në Greqi<sup>67</sup>, në të cilat bashkëveprimi ndërkufitar ka impakt të drejtpërdrejt dhe më të madh. Shih hartën nr =1

Shënim: Përfshirja e njësive administrative të sipërpërmendura në hapësirën ndërkufitare midis Greqisë dhe Shqipërisë mbështetet në rregulloren e BE 231/2014 neni 27 pika a) e cila e ndan BE sipas Nomenklaturës së Territorit për Statistikat (NUTS) në tre nivele rajonesh. Prefekturat në Greqi dhe ekuivalentet e tyre qarqet në Shqipëri konsiderohen si rajone të nivelit të tretë. Ato janë njësitë më të vogla rajonale sipas standartit european ku mund të bëhen ekspertiza specifike dhe zbatime të projekteve në kuadër të bashkëveprimit ndërkufitar<sup>68</sup>

65. <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/bashkepunimi-nderkufitar-dhe-transnacional/programi-interreg-ipa-greqi-shqiperi>, Tetor 2017

66. [https://en.wikipedia.org/wiki/Border\\_area](https://en.wikipedia.org/wiki/Border_area), Tetor 2017

67. EU, Anex 1, «Greece – Albania IPA Cross-border Programme 2007-2013» fq 9, May 2015. <http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/3/2016/EN/3-2016-3100-EN-F1-1-ANNEX-1.PDF>

68. <http://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts>



Hapësira ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë sipas Programit Ndërkufitar IPA (2007-2013)<sup>69</sup>

### Mardhëniet ndërkufitare midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe qasja europiane

Me krijimin e shtetit shqiptar në 1912 deri në fillim të viteve 1990-të mardhëniet ndërshtetërore dhe ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë nuk kanë qenë në nivelin e duhur. Veçojmë disa momente kyçe të historisë si konferenca e Ambasadorëve në Londër në 1913, përcaktimi i kufijve Korrik 1926 (Protokolli i Firences), lufta Italo-Greke 1940-1941 dhe së fundmi aderimi i Shqipërisë në Bllokun Lindor dhe Greqisë në Bllokun Perëndimor, të cilat krijuan ndasi midis tyre. Krijimi i Perdes së Hekurt midis dy kampeve me ideologji të ndryshme pati pasoja të rënda në mardhëniet e shumanshme midis këtyre vendeve. Këto pasoja u ndjenë në bashkëveprimin e dobët midis rajoneve ndërkufitare dhe më së shumti përgjatë vijës kufitare e cila ndante dy shtete si dy botë të ndryshme. Gjatë periudhës 1945-1990 hapësira ndërkufitare greko shqiptare ka qenë tepër e monitoruar duke minimizuar në maksimum aktivitetin e shoqërisë njerëzore. Përgjatë kufirit përveç infrastrukturës për mbrojtjen e tij si; posta kufitare, gardheve me tela me gjemba, repartave ushtarake, forcave ushtarake, rrallë herë migrantë të paligjshëm që kalonin kufirin, nuk hasje prezencë tjetër të shoqërisë njerëzore. Veprimtaria e kontrolluar e shoqërisë njerëzore, dendësia e vogël e popullsisë, ishte karakteristikë për zonat kufitare, ku përveç vendasve që kanë jetuar historikisht atje, askush nuk preferente të shkonte në këto territore aspak mikpritëse. Mardhëniet e ftohta midis këtyre shteteve u reflektuan edhe në

69. EU, Anex 1, «Greece – Albania IPA Cross-border Programme 2007-2013» fq 10, 28/12/ 2015  
<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/3/2016/EN/3-2016-3100-EN-F1-1-ANNEX-1.PDF>

zhvillimin e pakët të ekonomisë, bashkëveprimin e dobët social midis hapësirave ndërkufitare por edhe impaktin e vogël në mjedis. ku biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura u ruajtën të paprekura. Nuk është e rastësishme që pikërisht në vijën kufitare midis Bllokut Lindor dhe Perëndimor nga deti Barenç deri në Bosfor që përshkon 24 shtete, ndër to Shqipërinë dhe Greqinë, me gjatësi 12500 km në ditët e sotme Europa trashëgon Brezin i Gjelbër i cili dallohet për pasuri të madhe të biodiversitetit, 3,272 zona të mbrojtura dhe 40 parqe kombëtare (nga të cilët 16 janë ndërkufitar)<sup>70</sup>. Kjo pasuri e madhe natyrore e trashëguar nga Lufta e Ftohtë është një thesar i vërtetë me vlera ekologjike, shkencore, estetike, burimore për të tashmen por edhe në të ardhmen. Ruajtja, menaxhimi dhe përdorimi i zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit për qëllime ekologjike, ekonomike, turistike etj është një vlerë e shtuar për kontinentin evropian dhe vendet si Shqipëria dhe Greqia ku-firi i të cilave kalon përgjatë Brezit të Gjelbër. Ai shërben si korridor ekologjik midis zonave të mbrojtura në hapësirat ndërkufitare ku migrojnë kafshë të tilla si ujku, ariu i murrmë, rrëqebulli etj<sup>71</sup>.

Pas viteve 1990-të filloi një epokë e re në marrëdhëniet ndërkufitare midis Greqisë dhe Shqipërisë. Sinjale pozitive në këtë drejtim janë vënë re në mes të viteve 1980 me rihapjen e kufirit greko-shqiptar ku u lejuan shkëmbimet tregtare dhe kulturore<sup>72</sup>, u përmirësuan marrëdhëniet politike, u intensifikuan lidhjet ekonomike, e ndër të tjera filloi menaxhimi i përbashkët i kufijve dhe zonave të mbrojtura një pjesë e të cilave janë jo larg kufirit.

Hapja e pikave doganore si Kakavie, Qafë Boti, Tri Urat, Kapshtica etj ndër-timi i rrugëve automobilistike që garantonin lëvizjen e mallrave dhe njerëzve në dy anët e kufirit, migrimi ilegal, shtimi i aktivitetit të njerëzor, patën ndikim tek biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore jo vetëm pranë vijës kufitare por edhe në hapësirën ndërkufitare midis këtyre shteteve. Aktivitete të tilla si; kalimi i paligjshëm i kufirit, zjarret, depërtimi në zonat strikte të mbrojtura, shpyllëzimet nga banorët vendas, hapja e tokave të reja, mbikullotja nga bagëtitë që kalonin nga njëra anë e kufirit në tjetrën, prerja e paligjshme e pyjeve, gjuetia e pakontrolluar, ndotja etj janë disa nga problemet që kanë shoqëruar rajonet ndërkufitare.

70. European Commission, Linking Natura 2000 and cultural heritage, pg 68, Year 2017, [http://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/pdf/case\\_study\\_natura2000\\_cultural\\_heritage.pdf](http://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/pdf/case_study_natura2000_cultural_heritage.pdf), Tetor 2017

71. <http://www.europeangreenbelt.org/projects/balkan/balkan-green-belt-as-ecological-corridor.html>, Nëntor 2017

72. Gasparini, A, Bianco D, Strategies and Euroregions for Cross-border Co-operation in Balkan and Danube European Countries fq 112, Italy, Gorizia 2011

### Zonat e mbrojtura në hapësirën ndërkufitare

Shqipëria dhe Greqia si vende mesdhetare të ndodhura në kryqëzimin e rrugëve floristike, me larmi kushtesh natyrore, me reliev kodrinor-malor, dalje të gjerë në dete dhe pasuri hidrografike etj dallohen për biodiversitet të lartë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Sipas studimeve të fundit rezultojnë se flora greke përbëhet nga 5752 lloje, 1893 nënloje nga të cilat 1278 janë bimë endemike, 452 subendemike renditet si një ndër vendet me të pasura në botë. Pasuria e botës së gjallë vihet re edhe tek fauna e cila përbëhet nga 3130 specie shtazore, ndërsa në mjediset detare janë zbuluar rreth 3500 specie<sup>73</sup>. Tab nr =1

Shqipëria, megjithëse një vend i vogël, shquhet për biodiversitet të pasur. Numërohen rreth 3300 lloje bimë enësore, 2400 lloje bimore jo enësore, nga të cilat 27 janë endemike, 110 lloje subendemike<sup>74</sup>. Flora përfaqëson rreth 30% e florës europiane. Tab nr =1

Tab Nr=1. Flora dhe fauna në Shqipëri dhe Greqi (mjedisë tokësore dhe ujëra të ëmbla)							
	Kërpudha	Bimë	Peshq	Amfibë	Reptilë	Zogj	Gjitarë
Shqipëria	800	3651	66	16	37	323	83
Greqia	3000	5752	110	23	79	436	116

Duke parë larminë e biodiversitetit në këto vende dhe rritjen progresive të aktivitetit të shoqërisë njerëzore dekadat e fundit e cila përbën kërcënim për peisazhet natyrore dhe botën e gjallë, bëhet i domosdoshëm krijimi i zonave të mbrojtura. Kështu në Greqi në vitin 2017 figurojnë 1260 zona të mbrojtura të cilat zënë rreth 34.97% e sipërfaqes tokësore dhe 1.46% e sipërfaqes ujore<sup>75</sup> duke përmbushur standartin europian prej 20% të territorit.

Edhe Shqipëria ka bërë progres në drejtim të shtimit të sipërfaqes së zonave të mbrojtura këto 10 vitet e fundit. Megjithatë ajo përsëri mbetet mbrapa vendeve europiane ku zonat e mbrojtura zënë 16% të territorit ose 460000 ha<sup>76</sup> Parashikohet që kjo sipërfaqe në fund të vitit 2020 të arrijë në 17 % të territorit të vendit në përputhje me objektivat e Strategjisë së Biodiversitetit të BE-së (2011-2020) si dhe në kuadër të zbatimit të 'Aichi targets' të Konventës së Biodiversitetit<sup>77</sup>. Sot Shqipëria

73. Convention on Biological Diversity 5th National Report of Greece, pg 2 Year 2014 <https://www.cbd.int/doc/world/gr/gr-nr-05-en.pdf>, Nëntor 2017

74. [http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=183&Itemid=376&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=183&Itemid=376&lang=en) Biodiversiteti dhe habitatet, Tetor 2017

75. <https://protectedplanet.net/country/GRC>, Nëntor 2017

76. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, [http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=83&Itemid=379&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=83&Itemid=379&lang=en), Tetor 2017

77. Drejtoria e Biodiversitetit, Raport Arritjet dhe Mangesite ne Ruajtjen e Natyres, Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura (2009-2013) fq 16, Tiranë 2013

ka 799 Zona të Mbrojtura. Spikasin në këtë rrjet, 15 parqe kombëtare me mbi 205 mijë ha<sup>78</sup>, dhe 750 Monumente të Natyre.

Pas anëtarësimit të Shqipërisë dhe Greqisë në UNESCO, me nënshkrimin e konventave si ajo Ramsar, Konventa për Biodiversitetin, etj këto vende kanë filluar të jenë më aktive dhe më bashkëpunuese në mbrojtjen, menaxhimin e trashëgimisë natyrore e cila shihet si një burim i fuqishëm ekonomik gjatë shekullit XXI. Dekadat e fundit kanë bërë përpjekje serioze jo vetëm veçmas por edhe në bashkëpunim për ruajtjen e mjedisit dhe elementëve të tij si dhe krijimin e zonave të mbrojtura të përbashkëta në hapësirat ndërkufitare. Janë marrë masa për evidentimin, shpalljen, ruajtjen, menaxhimin, e trashëgiminë e natyrore duke parandaluar degradimin e siteve natyrore të cilat paraqiten tepër të fragmetarizuara dhe nën presion të madh nga aktiviteti i shoqërisë njerëzore. Një punë e mirë është bërë edhe në diferencimin e zonave të mbrojtura në 6 lloje sipas kriterëve të IUCN. Kështu në hapësirën ndërkufitare si rezultat i ekzistencës së një natyre të paprekur gati gjysëm shekulli, gjenden një numër i madh i zonave të mbrojtura rreth 86 nga të cilat; 2 Rezervate Shken-core, 12 Parqe Kombëtare, 7 Monumente Natyre (areale), 52 Rezervate të Menaxhuara, 5 Peisazhe të Mbrojtura, 8 Zona të Burimeve të Menaxhuara duke zënë rreth 27% të këtij territori. Shih tab nr =2

Qark/ Pref	Tab Nr=2 Zonat e Mbrojtura në hapësirën ndërkufitare greko-shqiptare										
	Shqipëria				Greqia						
	Vlorë	Gjiro- kastër	Korçë	Sip km <sup>2</sup>	Korfuzi	Thesprotia	Jani- na	Kosturi	Follo- rina	Grebene	Sip km <sup>2</sup>
<b>I</b>	-	<sup>179</sup>	-	<b>18</b>	-	-	-	-	1	-	<b>2.76</b>
<b>II</b>	3	1	2	<b>863.53</b>	-	-	<sup>380</sup>	1	1	1	<b>299.09</b>
<b>III</b>	1	2	-	<b>34.2</b>	-	<sup>181</sup>	1	1	1	-	<b>2.85</b>
<b>IV</b>	2	-	3	<b>223.3</b>	2	8	14	6	7	10	<b>1074.18</b>
<b>V</b>	1	-	2	<b>475.71</b>	-	-	-	2	-	-	<b>39.69</b>
<b>VI</b>	-	-	2	<b>76</b>	-	1	4	-	1	-	<b>3238.78</b>
<b>Totali Km<sup>2</sup></b>				<b>1690.74</b>							<b>4657.35</b>

Në hapësirën ndërkufitare gjenden disa parqe kombëtare si: parku kombëtar i Butrintit, Prespës, Hotovë-Dangëlli, Bredhi i Drenovës, Parku Etnik i Pin-

78. Bino. T, Zonat e Mbrojtura me te rrezikuarat tek ne, <https://www.shqiperia.com/Zonat-e-Mbrojtura-me-te-rrezikuarat-tek-ne!.28411/12/03.2015>


79. Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, [http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=item&id=181:lista-e-zonave-te-mbrojtura&Itemid=477&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&id=181:lista-e-zonave-te-mbrojtura&Itemid=477&lang=en), Nëntor 2017

80. [https://protectedplanet.net/search?country=Greece&iucn\\_category=II&main=country](https://protectedplanet.net/search?country=Greece&iucn_category=II&main=country), Nëntor 2017

81. [http://www.geogreece.gr/fysis\\_en.php](http://www.geogreece.gr/fysis_en.php), Tetor 2009

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

dit, Parku Prespës etj si dhe numër i madh sitesh me nivel më të ulët mbrojtje. Shih hartën nr =2. Krijimi i zonave të mbrojtura në të dyja anët e kufirit rrit qendrueshmërinë e biodiversitetit, zgjeron arealet për një jetesë më të natyrshme të botës bimore dhe shtazore, promovon paqen midis dy shteteve gjithashtu siguron të ardhura dhe përfitime të shumëanshme për vendet kufitare. Ato krijojnë ura lidhëse midis njerzve me kombësi, kultura apo nivel të ndryshme zhvillimi, gjithashtu prishin barrierat e ngritura nga njerëzit duke unifikuar habitatet dhe arealet ku gëlon bota e gjallë.



**Menaxhimi i zonave të mbrojtura në rajonin ndërkufitar greko-shqiptar**

Kur flasim për menaxhimin e zonave të mbrojtura ndërkufitare, nënkuptojmë bashkëpunimin mes palëve i cili shtrihet, prej nivelit 1) **të mos ekzistencës** cili karakterizonte Greqinë dhe Shqipërinë gjatë periudhës 1945-1990, 2) **në komunikimin**, 3) **konsultim**, nivele bashkëpunimi që vihen re midis dy vendeve pas viteve 1990, 4) **bashkëveprim ose koordinim planifikim**, deri në nivelin më të lartë që është 5) **bashkëpunimi i plotë** i cili pritet të ekzistojë në të ardhmen.

Menaxhimi i zonave të mbrojtura në hapësirën ndërkufitare midis Greqisë dhe Shqipërisë kushtëzohet nga: faktori politik, legjislacioni, niveli i zhvillimit ekonomik, shkalla e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale, koordinimi institucional angazhimi i pushtetit lokal, standartet mjedisore etj. Greqia është më e avancuar në përmbushjen standarteve, strukturat menaxhuese, burimet njerëzore të kualifikuara, falë mbështetjes financiare, logjistike, ligjore etj nga BE, ndërsa Shqipëria si një vend aspirant për në BE mbetet më mbrapa. Kësajsoj edhe implemtimi projekteve të përbashkëta midis këtyre shteteve has pengesa në këtë drejtim.

Gjatë 25 viteve të fundit ka pasur zhvillime pozitive midis dy vendeve fqinje që kanë të bëjnë me mjedisin, mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore. Janë realizuar disa programe ndërkufitare të sponsorizuara nga BE ku synohet integrimi i zonave e mbrojtura, ruajtja me menaxhimi i tyre. Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe programet zhvilluese janë fokusuar: në krijimin e koridoreve ekologjike midis zonave të mbrojtura, krijimin e zonave buferike përreth kufirit të cilat shërbejnë si amortizuese për zona strikte, integrimin e zonave të mbrojtura, zgjerimin e territorit të tyre dhe në perspektivë krijimin e një rrjeti ekologjik që lidh hapësirat e mbrojtura ndërkufitare në shtetet përkatëse.

Rasti i zonës së mbrojtur “Baseni Prespë-Ohër” e cila u krijua pas nënshkrimit të marrëveshjes midis kryeministrave të Greqisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë në vitin 2000 dhe u ratifikua në 2010 është një shembull suksesi. Krijimi i një megazone të mbrojtur me sipërfaqe 446,244.52 ha. si e para në gadishullin e Ballkanit e cila cilësohet si Rezervë e Biosferës Ndërkufitare tregon bashkëpunimin e mirë midis vendeve ballkanike ku përfitimet janë reciproke. Në “Basenin Ohër-Prepë” ndodhen 14 zona të mbrojtura nga të cilat 4 parqe kombëtare, 1 Rezervat Shkencor dhe 9 zona me nivel më të ulët mbrojtje.

Shqipëria përfaqësohet nga Parku Kombëtar i Prespës prej 13,500 ha, Maqedonia nga Parku Kombëtar Galiçiça, Parku Kombëtar Pelister, Zona e Ruajtjes Strikt të Natyrës së Ezeranit, e shpallur me 1996, ndërsa Greqia nga parkut kombëtar i Prespës.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe për Mbrojtjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Parkut të Prespës mes Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë në shkurt 2010, Komiteti për Menaxhimin e Parkut të Prespës, zyrtarizoi ekzistencën e tij dhe punën e bërë duke u kthyer në një institucion fuqiptotë në menaxhimin e kësaj zone të mbrojtur. Kjo iniciativë e ndërmarrë nga këto shtete shërben si një ogur i mirë për bashkëpunimin e mëtejshëm në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë, fuqizimin e shumëllojshmërisë biologjike përmes përmirësimit të aktivitetit monitories, identifikimin e llojeve dhe habitateve ndërkufitare.

Në zonën e Prespës bashkëpunimi ndërkufitar vihet re edhe në sfera të tjera të aktivitetit human sidomos në ekonomi saqë është hedhur ideja për krijimin e Eurorajonit midis Korçës, Follorinës dhe Manastirit. Prezenca e investimeve të shumta greke në zonën e Korçës është dëshmi e këtij bashkëpunimi.

Shembuj të tjerë që mund të ndiqen në këtë drejtim janë psh krijimi i një zonë buferike apo një korridori ekologjik midis zonave të mbrojtura të cilat gjenden në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit Vjosa ku ndodhen një sërë zonash të mbrojtura si Rezervati Shkencor i Kardhiqit (kat I), Bredhi Hotovës (park kombëtar kategoria II) Piskal-Sheqeri ( Kat VI), Bredhi i Sotirës në Shqipëri, parku kombëtar Parku Etnik Pindit, (përbëhet nga tre parqe kombëtare; Vikos-Aos,Zagori, Tympi) një sërë monumentesh natyre dhe një sërë zonash të mbrojtura të katgerisë IV,V, VI të cilat gati janë bashkuar plotësisht me këtë park kombëtar i cili është më i madhi në Greqi.

Në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës Vjosës me sipërfaqe 314843.1 ha gjenden 28 zona të mbrojtura nga të cilat 25 në Greqi dhe 3 prej tyre në territorin shqiptar.

Krijimi i kësaj zone të mbrojtur midis Greqisë dhe Shqipërisë do të mbrojë biodiversitetin, do të krijojë kushte për evoliminin në gjendje natyrale të ekosistemeve tokësore dhe ujore të kësaj hapësire gjithashtu do të garantojë rezervat hidrike të lumit Vjosa i cili cilësohet si lumi i vetëm i egër në Europë në pellgun ujëmbledhës të së cilit gjendet një sërë biomonumentesh, gjeomonumentesh Gryka e Këlcyrës, kanioni i Lengaricës, hidromonumete (burimet termale të Bënjës, Uji i Zi i Këlcyrës). Krijimi i një zone të mbrojtur ndërkufitare në rrjedhën e sipërme të Vjosës do të jetë një hap vendimtar në mbrojtjen e diversitetit të pasur të kësaj hapësire duke synuar në të ardhmen krijimin e parkut të Vjosës i cili do të ketë një shtrirje nga burimi deri në grykëderdhjen e këtij lumi. Kështu lugina e sipërme e Vjosës dhe Drino do të shërbejnë si biokoridore të rëndësishme për migrimin e florës dhe faunës jo vetëm në zonat që do të shpallen të mbrojtura në të dyja

anët e kufirit Shqipëri-Greqi por edhe ato tashmë të shpallura të cilat konsiderohen si bioqendra të biodiversitetit në pellgun ujëmbledhës të Vjosës.

Edhe shpallja e parkut natyror rajonal Cangonj-Shelegur në 1996 është një avancim i mëtjeshëm në krijimin e koridoreve ekologjike që lidhin zonat e mbrojtura të vendit tonë me Greqinë. Ky park rajonal shërben si një stacion tranzit në migrimin e shumë gjitarëve si arinjtë, rrëqebujt, ujqërit nga parku kombëtar i Drenovës me zonat e mbrojtura që gjenden në Basenin Prespë-Ohër.

Nëse do të analizojmë mënyrën e menaxhimit të parqeve kombëtare në hapësirën ndërkuftare midis Shqipërisë dhe Greqisë duke u mbështetur në klasifikimin e Timothy (1999) konstatojmë se në këtë hapësirë ekziston tipi II dhe III i zonave të mbrojtura. Pra parqet kombëtare shtrihen në njërën anë të kufirit por shumë afër me kufirin ku shteti në të cilin gjendet parku është përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e tij pavarësisht faktit se edhe shteti tjetër kufitar i duhet angazhim direkt apo indirekt në këtë drejtim. Këtu mund të përmendim parqet kombëtare si Bredhi i Drenovës, Butrinti, Bredhi Hotovë-Dangëlli, në territorin shqiptar dhe Parku Etnik i Pindit ku janë bashkuar 2 parqe kombëtare Vikos-Aos (Zona IA, IB, IC), Parku Peristeri (Zona IA, IB), si dhe zona e mbrojtur e liqenit të Kosturit.

Dhe rasti tjetër kur parqet kombëtare shtrihen në të dyja anët e kufirit por menaxhohen nga shtetet respektive duke pasur përgjegjësi secili shtet për pjesën e tij si parku kombëtar i Prespës në territorin shqiptar dhe parkut kombëtar të Prespes në pjesën greke. Sigurisht që të dyja llojet e menaxhimit të parqeve kombëtare kanë probleme. Ato nuk duhet të konsiderohen si dy pjesë të shkëputura midis shteteve por si një zonë integrale pa kufij artificial qofshin ata administrative apo politik. Gjithashtu duhet të apikohen të njëjtat standarde dhe kritere në zonimin e tyre, duhet angazhim maksimal dhe i njëjtë jo vetëm nga institucionet, grupet e interesit, pushteti lokal por edhe banorët në ruajtjen dhe menaxhimin e tyre. Vetëm në këtë mënyrë shtetet kufitare kanë arritur të sfidojnë pengesat që kanë krijuar midis tyre duke pasur përfitime të shumëanshme nga mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi racional i zonave të mbrotjura.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Hapësira ndërkuftare midis Greqisë dhe Shqipërisë e cila shtrihet në biorajonin mesdhetar ka florë dhe faunë të pasur dhe një numër të madh të zonave të mbrojtura.

Perdja e Hekurt gjatë periudhës 1945-1990, prezenca e pakët e shoqërisë njerëzore në hapësirat ndërkuftare ka ndikuar në ruajtjen e natyrës e cila

po rrezikohet pas viteve 90-të .

Zëvendësimi i Perdes së Hekurt me Brezin e Gjelbër European, në vitin 2003, hapi një perspektivë të re midis vendeve ish komuniste dhe kapitaliste në fushën e mjedisit. Brezi i Gjelbër, shërben si promovues i paqes, si laborator për zhvillimin e qëndrueshëm, parandalimin e krizave, ruajtjen e biodiversitetit, shërbimet e ekosistemit etj.

Rritja e sipërfaqes së zonave buferike, krijimi i korridoreve dhe rrjeteve ekologjike në hapësirën ndërkufitare midis dy vendeve duhet synojë jo vetëm komunikimin e zonave të mbrojtura me Brezin e Gjelbër por bashkimin dhe integrimin e tyre

Krijimi i Rezervës së Biosferës “Ohër–Prespë” është shembull që duhet të nxisi vendet ballkanike drejt projekteve të përbashkëta ndërkufitare, ku synohet ruajtja, menaxhimi, pse jo edhe bashkimi i zonave të mbrojtura dhe aplikohen standarte të njëjta mjedisore.

Krijimi i Parkut Etnik të Pindit në Greqi ku janë integruar 3 parqe kombëtare dhe disa zona me nivel më të ulët mbrojtje është arritje e madhe në fushën e mjedisit në hapësirën ndërkufitare greke e cila duhet të pasohet me bashkimin e zonave të mbrojtura në hapësirën shqiptare me perspektivë krijimin e Parkut të Vjosës në pellgun ujëmbledhës të këtij lumi gjenden rreth 29 zona të mbrojtura.

Në vendet fqinje zonat e mbrojtura funksionojnë si ndërmarrje më vete, me buxhet vjetor, ku të ardhurat nga vizitorët përkthehen në paketa zhvillimi. Tek ne organizimi i zonave të mbrojtura nuk mund të jetë më eksperimentale. Menaxhimi i zonave të mbrojtura është më i lehtë nëse punohet sipas një modeli, që njihet dhe ekziston në njërin nga vendet, për të evituar përfshirjen e strukturave të ndryshme organizative të vendit fqinj, politikat e ndryshme, apo kultura të ndryshme.

Zonat e mbrojtura në hapësirën ndërkufitare greko shqiptare janë kthyer në strehë për speciet e rrezikuara. Në malet e Pindit strehohen; ariu i murrmë, ujku, rrëqebulli, macja e egër, derri i egër, dreri etj. Këto specie në fillim të shek XX-të ekzistonin gati në gjithë Greqinë më pas u detyruan të migrojnë drejt veriut për shkak të aktivitetit njeriut. Edhe në zonat e mbrojtura në Shqipëri si Bredhi Hotovës-Dangëlli, Bredhi Drenovës, Rezervati Shkencor i Kardhiqit gjenden popullata të reduktura të tyre .

## Literatura

Drejtoria e Biodiversitetit, Raport Arritjet dhe Mangesite ne Ruajtjen e Natyres, Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura (2009-2013), Tiranë 2013

Gasparini. A, Bianco D, Strategies and Euroregions for Cross-border Co-operation in Balkan and Danube European Countries, Italy, Gorizia 2011

[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=183&Itemid=376&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=183&Itemid=376&lang=en)

[http://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/pdf/case\\_study\\_natura2000\\_cultural\\_heritage.pdf](http://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/pdf/case_study_natura2000_cultural_heritage.pdf)

<http://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts>

<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/3/2016/EN/3-2016-3100-EN-F1-1-ANNEX-1.PDF>

[http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/Axhende-Shqiptare-per-Sigurine-Rajonale-IDM\\_NATO\\_2006.pdf](http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/Axhende-Shqiptare-per-Sigurine-Rajonale-IDM_NATO_2006.pdf)

<http://repository.biodiversity-info.gr/bitstream/11340/938/1/827.pdf>

[http://www.azht.gov.al/files/pages\\_files/17-06-07-01-32-12PPK\\_Harta\\_e\\_Zonave\\_me\\_Rendesi\\_Kombetare\\_ne\\_Planifikim.pdf](http://www.azht.gov.al/files/pages_files/17-06-07-01-32-12PPK_Harta_e_Zonave_me_Rendesi_Kombetare_ne_Planifikim.pdf)

<http://www.europeangreenbelt.org/projects/balkan/balkan-green-belt-as-ecological-corridor.html>

[http://www.geogreece.gr/fysis\\_en.php](http://www.geogreece.gr/fysis_en.php) , Tetor 2009

<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/bashkepunimi-nderkufitar-dhe-transnacional/programi-interreg-ipa-greqi-shqiperi>

<http://www.lajme.gen.al/2014-10-14/rezerva-nderkufitare-e-biosferes-oher-prespe-baseni-oher-prespe-nje-kapital-i-vertete.html>, 14 Tetor 2014

[http://www.parnitha-np.gr/index\\_fauna.htm](http://www.parnitha-np.gr/index_fauna.htm)

[https://en.wikipedia.org/wiki/Border\\_area](https://en.wikipedia.org/wiki/Border_area)

<https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2011-025-Sq.pdf>

<https://protectedplanet.net/search?country=Greece&main=country>

[https://s3.amazonaws.com/academia.edu.documents/35072316/International\\_Parks\\_Chapter.pdf?AWSAccessKeyId=akiaiwowyygz2y53ul3a&Expires=1507586785&Signature=tK1iOr7VsCU%2F-](https://s3.amazonaws.com/academia.edu.documents/35072316/International_Parks_Chapter.pdf?AWSAccessKeyId=akiaiwowyygz2y53ul3a&Expires=1507586785&Signature=tK1iOr7VsCU%2F-)

5BHN2aB%2FviUtvQ%3D&response-content-disposition=inline%3B%20-filename%3DTourism\_and\_international\_parks.pdf

<https://www.cbd.int/doc/world/gr/gr-nr-05-en.pdf>

<https://www.shqiperia.com/Zonat-e-Mbrojtura-me-te-rrezikuarat-tek-ne!.28411/>

Mullaj. A, Hoda.P, Shuka. L, Miho. A, etj, About green practices for Albania, year 2017

Shumka. S, Bego.F etj, Current Knowledge of Biodiversity in Vjosa River System Counting Threats that Jeopardise Species and Ecosystems Survival, The Vjosa Science Conference, **The Vjosa-A unique opportunity for European River Science**, Albania June 8<sup>th</sup>, 2016

Ziu.T, Gejografia e rregullimit të territorit, Pegi, Tiranë 2009

## THE PROTECTED AREAS IN THE CROSS-BORDER SPACE BETWEEN ALBANIA AND GREECE AND THEIR INTEGRATED MANAGEMENT

Dr. Mariglen SHERIFAJ

### Abstract

The collapse of ideological barriers in Europe in the early 1990s opened a new page in the history of cross-border relations in the Balkan peninsula, part of which are Albania and Greece. On the ruins of the “Iron Curtain” dividing the capitalist and ex-communist countries is booming the Green Belt which promotes peace, the creation of bridges between peoples, at the same time the environmental and cultural wealth that the border areas inherit from the past. Albania’s European approach has faced it with many challenges such as: economic development, integrated border management, biodiversity conservation, meeting environmental standards, etc.

In the framework of cross-border co-operation with Greece, one of the main priorities is the creation of joint protected areas. This requires institutional interaction between countries, cohesion of local communities, European assistance through projects such as Interreg IPA I, Interreg IPA II, Natura 2000 etc. The establishment of the cross-border park “Ohrid-Prespa Watershed”, designated as the European Biosphere Reserve, is a success story to be considered for protected areas along the Greek-Albanian border.

The expansion of buffer zones, the creation of ecological corridors, the joint management of protected areas, the application of the same environmental standards etc. will improve the quality of the environment and will also create greater opportunities for sustainable development of cross-border areas.

Although there are inequalities of development between the two countries in resource use, the management of protected areas, we conclude that the common future raises the necessity of border devaluation, the integration of cross-border spaces, the free movement of goods and people, the development of living world in natural and unobstructed conditions artificially placed by human society.

**Key words:** Iron Curtain, Green Belt, protected area, ecological corridor, European Ecological Network, cross-border space, biodiversity

**ANALIZA E IMPAKTIT TË KATASTROFAVE NATYRORE  
PËRMES SIMULIMIT DHE TEKNOLOGJISË:  
MEGA SHPËRTHIMET E CAMPI FLEGREI NË SHQIPËRI**

Prof. Asc. Dr. Jostina DHIMITRI

**Përmbledhje**

*Katastrofat natyrore kanë një impakt të konsiderueshëm në shoqërinë njerëzore dhe aktivitetet e saj. Ndikimet gjeografike janë shprehur nëpërmjet pasojave në territore në shkallë lokale, rajonale dhe madje globale. Vlerësimi i proceseve dhe pasojave të katastrofave natyrore mbetet një detyrë për shoqërinë e sotme. Të tilla vlerësime do të ishin efektive si në drejtim të menaxhimit të rreziqeve të mundshme, vlerësimin e DRR, si dhe zhvillimin e metodologjive efektive për vlerësimin e ndikimit të katastrofave natyrore të konsiderueshme. ArcGIS Online është një teknologji e cila ofron avavantzhe gjeografik dhe është përdorur në këtë studim. Duke përdorur GIS teknologjinë ne mund të japim zgjidhje dhe mund të jemi më efektivë në procesin e vendimmarrjes.*

*Në këtë studim synohet të analizohet dhe vlerësohet rreziku natyror nëpërmjet një stimulimi mega shpërthyes vullkanik dhe vlerësimin e impaktit të tij në territorin e Shqipërisë. Janë përdorur një seri hartash të sakta në ArcGIS Online me qëllim llogaritjen e nivelit total të riskut në 10 lokacione të ndryshme të Shqipërisë. (Pukë, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Kucovë, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë). Janë vlerësuar faktorë të tillë si: lartësia e lokacioneve të zgjedhura, dendësia e popullsisë, distanca nga qendrat shëndetësore, temperatura, etj. Rezultatet e përfituara vlerësojnë impaktin e cdo lokacioni dhe faktori, por edhe të rajoneve të ndryshme brenda territorit të Shqipërisë. Gjithashtu studimi prezanton analizën e rezultateve të një pyetësi të kryer me pjesëmarrjen e 26 studentëve, të vitit të parë, në ciklin e studimeve Bachelor. Ata marrin informacion mbi vullkanet gjatë vitit të parë akademik në kursin: "Gjeografia fizike e përgjithshme". Është përdorur metodologjia pre dhe posttest. Studentet u pyetën rreth: 1. Vlerësimin e ndërveprimit të GIS dhe njohurive në gjeografi; 2. Përcaktimin e efektivitetit të aktivitetit për formimin dhe zhvillimin e tyre shkencor.*

## 1. Hyrje

Katastrofat natyrore kanë impakt të konsiderueshëm në shoqërinë humane. Ndikimet gjeografike të tyre janë të mëdha, afektojnë territore dhe shpesh sjellin pasoja globale. Procesi i vlerësimit të katastrofave natyrore mbetet një detyrë e shoqërisë së sotme. Veprime dhe studime të tilla do të ndihmonin në drejtim të menaxhimit të rreziqeve të mundshme, vlerësimit të reduktimit të rreziqeve të katastrofave, si dhe zhvillimit të metodologjive efikase të nevojshme për vlerësimin e ndikimit të një katastrofe natyrore të konsiderueshme. Dëshmi të shumta të katastrofave natyrore si cuname, tërmete, përmbytje etj. janë të shpeshta në cdo pjesë të gjeosistemit. Shpërthimet vullkanike janë një prej katastrofave natyrore ku dimensionet dhe intensiteti janë të mëdha. Ato mund të rezultojnë me efekte katastrofike për shoqërinë dhe planetin.

Përse një mega shpërthim? Sa të mëdha janë risqet? Bazuar në ekstremitetet e tyre, ato janë të krahaseshme me mega katastrofat nga përmbytjet, thatësitat dhe impaktet e asteroideve. Ekspertët e European Science Foundation, (2015) paralajmërojnë se ka rreth 5% deri në 10% mundësi të një shpërthimi të madh vullkanik në fund të këtij shekulli që mund të shkaktojë humbje të jetës së miliona njerëzve dhe mund të shkatërrojë shumë nga shoqëria e sotme moderne. Megjithëse në pak dekadat e fundit shkaku i dëmeve të mëdha kanë qënë tërmetet, rreziku global kryesor mbeten shpërthimet e mëdha vullkanike që janë më pak frekvente por më shumë të ndikueshme sesa tërmetet e mëdha. Kur diskutohen të tilla fenomene, sigurisht që kostot janë shumë më të mëdha sesa fondet qeveritare financiare. Si pasojë e shpërthimeve të tilla vullkanike janë vënë re pasoja në modifikime klimatike si psh: shpërthimi vullkanik në Toba, Sumatra, Indonezi, 70 000 vite më parë, shkaktoi një dimër vullkanik, një periudhë ftohjeje klimatike. I njëjti impakt ndodhi nga super shpërthimi vullkanik 600 000 vjet më parë nën Parkun Yellowstone dhe nga shpërthimi në malin Pinatubo, Philippine në 1982. Ato mund të shkaktojnë humbje jetësh njerëzore dhe dëme në burimet natyrore.

Sipas Montgomery 1995, llava përgjithësisht nuk e kërcënon jetën. Shumica e llavave rrjedhin me shpejtësi vetëm pak kilometra në një orë ose më pak, kështu që njerëzit mund të largohen nga llava që përparon edhe duke ecur. Për të mbrojtur pronat, thjesht nuk duhet të ndërtohet pranë pjerrësive të vullkanit. Por njerëzit kanë ndërtuar pranë vullkanve, duke shpresuar se vullkani nuk do të shpërthejë sërisht. Tokat e formuara nga shkëmbinjtë vullkanik janë shumë prodhuese. Toka të tilla të pasura, përfshirë Vezuvin, janë përdorur për bujqësi (Eyre, Goëer 1986). Hiri vullkanik është një rrezik për shëndetin,

si rrezikshëm për frymëmarrjen. Për shembull, gjatë shpërthimit të malit Shën Helena në 18 maj 1980, re gazi super të nxehta dhe hi vullkanik u lëshuan gjatë shpatit të malit duke vrarë 60 njerëz, rreth 2 milion zogj dhe duke shkatërruar mijëra hektarë pyje. Ndërkohë Muller, Oberlander 1984, thekson se hiri vullkanik mund të jetë toksik për njerëzit, kafshët dhe bimët dhe pesha e tij mbi catitë e shtëpive mund t'i shkatërrojë ato. Gjithashtu Hess 2016 shprehet se fragmente të mëdha të shkëmbinjëve vullkanik, të quajtura bomba vullkanike, bien në tokë menjëherë pranë vullkanit; fragmente më të vogla të hirit vullkanik dhe pluhurat formojnë një re të madhe shpërthimi nga e cila sasi të mëdha hiri vullkanik mund të bien në sipërfaqen e tokës. Shtresa e trashë e hirit mund të dëmtojë kulturat bujqësore dhe madje të rrëzojë ndërtesat. Por Self 2006, vlerëson: "Në varësi se ku është lokalizohet vullkani, pasojat do të ndihen globalisht ose së paku në një atmosferë të tërë. Sipërfaqe të mëdha do të shkatërrohen nga depozitimet e rrjedhjeve piroklastike dhe shpërndarja e hirit vullkanik do të zërë sipërfaqe të mëdha madje edhe sa të një kontinenti. Christopherson, Birkeland 2015, vlerësojnë se në prill 2010, shpërthimi i vullkanit Eyjafjallajökull në jug të Islandës tërhoqi vëmendjen e botës për pasojat e tij në transportin ajror. Shpërthimi i parë i këtij vullkani qysh në 1820 prodhoi një re hiri që u ngrit në 10 600m dhe u përhap shpejt në drejtim të Europës dhe korridoreve të linjave ajrore tregtare. Aeroporti u mbyll për 5 ditë duke anuluar më shumë se 100 000 fluturime.

Mega shpërthimet vullkanike konsiderohen katastrofa natyrore të cilat mund të shkaktojnë shkatërrime globale, me probabilitet të ulët ose me pasoja të mëdha. Ata janë të vështira për tu parashikuar dhe parandaluar.

Sipas European Science Foundation (2014), gjatë Holocenit, kanë ndodhur së paku shpërthime me VEI 7 (VEI: Volcanic Explosively Index). Me një popullsi rreth 7 miliard banorë e cila tenton të arrijë në 12 miliard banorë, ndodhja e një shpërthimi vullkanik me VEI 7 ose më të madh mund të ketë pasoja ekstreme.

Simulimi i këtyre katastrofave ekstreme duke vlerësuar kushtet e tashme mund të ndihmonte në përcaktimin e mundësive të shkatërrimeve dhe menaxhimin e tyre. "Ash cloud Apocalypse" ishte një simulim për menaxhimin e riskut duke përdorur ArcGIS online organizuar në nëntor 2015. Studentët e geografisë kontribuan në krijimin e një harte rreziku dhe krijuan modele për vlerësimin e territorit duke përdorur GIS. Analizimi i riskut u arrit duke përdorur dhe analizuar të dhëna ekonomike dhe natyrore në të. <http://gisevent.wixsite.com/gisday2015>

Mr. Raphael Heath, Drejtori për gjeografinë në Royal High School, Bath shprehet se: "...Unë besoj me pasion në rëndësinë e zhvillimit të aftësive

hapësinore të studentëve dhe në përdorimin e GIS për t'i aftësuar ata me të menudarit kritik përmes problemeve gjeografike, komplekse të botës reale”.

### 2. Qëllimi dhe metodologjia

Artikulli ka si qëllim të prezantojë gjetjet e një studimi mbi vlerësimin e faktorëve të riskut të një mega shpërthimi në një territor. Ai analizon një model të krijuar, për territorin e Shqipërisë duke përdorur teknologjinë ArcGIS Online, gjatë simulimit “Ash Cloud apocalypse-GIS Day”. Studimi gjithashtu ka si synim ndërgjegjësimin e studentëve në përdorimin e GIS dhe kontributin e tij në vendimmarrje.

**Metodologjia.** Janë vlerësuar 9 faktor risku, duke përdorur ArcGIS Online. “Ash Cloud Apocalypse-GIS Day” ishte një aktivitet global mbi hartat në të cilin morën pjesë 10 studentë shqipëtar, me tematike mbi mega shpërthimet vullkanike. Ata u instruktuan për përdorimin e serive të hartave me saktësi të lartë në ArcGIS Online me qëllim që të llogaritnin nivelin e riskut në 10 lokacione të ndryshme në të gjithë Shqipërinë (Pukë, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Kucovë, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë). Këto harta u ofruan nga ESRI, UK. Të dhënat për 10 lokacionet u futën në formularin e siguruar online. Rezultatet e nxjerra vlerësojnë një rezultat të përgjithshëm risku për 10 lokacionet gjeografike.

Cdo shtresë paraqet një faktor risku. Pasi aktivizohet shtresa, merret vlera për faktor në cdo pikë lokacioni të zgjedhur.(shihni Fig.5). Gjithashtu është arritur një vlerësim total i riskut për cdo lokacion gjeografik si dhe për 9 faktorët e riskut. Analiza e rezultateve është bërë duke vlerësuar: 1. Faktorin me risk më të lartë nga të 9 faktorët e cila përfaqëson një studim horizontal dhe 2. është vlerësuar lokacioni gjeografik me risk më të lartë si dhe janë dhënë profilet cilësore të cdo lokacion gjeografik. Kjo analizë i ndihmon vendimmarresit, në rastin e marrjes në konsideratë të kësaj katastrofe natyrore.

Faktorët e riskut të vlerësuar janë: distanca nga mega shpërthimi; lartësia e lokacionit; klima; dendësia e popullsisë; të ardhurat mesatare; kaosi në trafik; të dhëna mbi astmën; shpirti i bashkëpunimit i komunitetit; mbështetja emegjente; të cilat janë konvertuar në 9 harta tematike.

Të gjitha rezultatet iu prezantuan 26 studentëve të gjeografisë të cilët studionin në vitin e parë të sistemit të studimeve Bachelor. Ata mësojnë për vullkanet gjatë kursit “Gjeografi fizike e përgjithshme”, në po këtë vit akademik. 26 studentet plotësuan pyetësorët duke përdorur metodologjinë pre dhe posttest, ku disa nga pyetjet e fazës së parë u përsëritën në fazën e dytë dhe më

pas u bë statistikisht krahasimi. Fig. 1




Fig 1. Metodologjia e aplikuar pre and posttest

Të dhënat u analizuan në programin SPSS 20. E njëjta metodë mund të gjendet në studime dhe artikuj të ndryshëm (Klonari, EJG, Volume 3, Issue 2: 43-53; Shuttleworth M, Pretest-Posttest Design, Explorable Psychology Experiments; Hantrakul et al, 2013 ; Ok, Onkol, 2007 ; Kerenxhi, Gjoci, 2013 ).

Mega vullkani më i afërt është Vulkano i Campi Flegrei, në Itali. Ai është një vullkan aktiv dhe ka një lartësi prej afërsisht 458m. Në studimin e SELF , 2006, ai paraqiti një hartë skicë të depozitimeve të hirit vullkanik të lidhura me formimin e volumeve të medha të depozitimeve piroklastike, nga shpërthimi Campanian afërsisht 39 000 vjet më parë, krijuar nga kaldera e Campi Flegrei, Itali, nëpërmjet paraqitjes së izolinjave me trashësi të njëjtë të depozitimeve të hirit të ruajtur në tokë dhe në koren e detit Mesdhe (në cm). Kjo trashësi arrin në rreth 10 cm për territorin e Shqipërisë. Sipas Corbellini 1994, në këtë zonë janë vënë re fenomene dytësore vullkanike. Ndërsa gjeofizikanti Enzo Boschi 2017, thekson se: “Vullkani është në vite në alarm me ngjyre të verdhë (shkalla 2 nga 4). Italia është vendi i vetëm i Europës kontinentale që ka vullkane aktive.

### 3. Rezultatet

Faktorët e riskut tregojnë rezultate të ndryshme për 10 lokacionet gjeografike të zgjedhura.

*Faktori i riskut – distance nga mega vullkani.* Nëse mega vullkani më i afërt shpërthen, impakti direkt i llavës dhe depozitimeve të hirit vullkanik do të jetë më i madh tek ata që jetojnë më afër tij. Disa banorë duhet të largohen nga shtëpitë e tyre. Është përdorur një shkallë me 5 nivele, ku: risku më i ulët vlerësohet me shkallën 1 për distancën mbi 3001 km larg; risku i ulët vlerësohet me shkallën 2 për distancën 1501 deri në 3000 km larg risku mesatar vlerësohet me shkallën 3 për distancën 501 deri në 1500 km larg risku i lartë vlerësohet me shkallën 4 për distancën 151 deri në 500 km larg risku shumë i lartë vlerësohet me shkallën 5 për distancën deri në 150 km larg. Duke aktivizuar shtresën e këtij

faktori në ArcGIS online vihet re se rezultati i riskut të përgjithshëm për këtë faktor është 3.5 që do të thotë që niveli i rrezikut për 10 lokacionet gjeografike të zgjedhura është *mesatar* për lokacionet në pjesën lindore të Shqipërisë dhe *lartë* për lokacionet në pjesën perëndimore të saj. (Fig. 2, gjithashtu Fig 5)




Fig. 2 Distanca nga mega shpwrthimi

Faktori i riskut 2 – Lartësia absolute e lokacionit gjeografik (tokes). Ai përshkruan faktin që me rritjen e lartësisë, temperatura ulet. Nën kushte të tilla, me cdo gradë të ulur, bëhet më ftohtë dhe kushtet e jetesës bëhen më të kërcënuara. Aktivizimi i shtresës së këtij faktori, tregon një mesatare risku prej 3.4 për të gjithë lokacionet gjeografike së bashku. Për shembull lartësia mbi nivelin e detit të lokacionit për Tiranën është 136 m, i cili do të thotë që niveli i riskut është 3. (Fig.3, also see Fig 5.)




Fig. 3 Lartësia në metra e lokacionit gjeografik për Tiranën.

Faktori 3 i riskut vlerëson rolin e klimës. Harta online tregon tempera-

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

turën mestare vjetore në zonë. Ndërsa dioksidi i squfurit ( $\text{SO}_2$ ) dhe hiri në atmosferë bllokojnë rrezet e Diellit, temperaturat fillojnë në të bien.. Sa më ftohtë të bëhet aq më i keq është impakti. Rezultati mesatar për të gjitha pikat ishte 2.7. Për lokacionin gjeografik të Tiranës, temperatura mesatare vjetore është  $15^\circ\text{C}$ . (Fig.4 gjithashtu Fig. 5)




Fig. 4 Temperatura mesatare në lokacionin gjeografik për Tiranën. (në  $^\circ\text{C}$ ).

*Faktori i riskut 4 - Dendësia e popullsisë.* Kjo është një nga shtesat (harte online) më të detajuara në botë e cila vlerëson dendësinë e popullsisë për cdo  $250 \text{ m}^2$ . Sa më i madh numri i popullsisë që jeton në një sipërfaqe të dhënë aq më i madh është ndikimi i mundshëm. Niveli mesatar për të gjitha lokacionet gjeografike është 2.5. (shihni Fig. 5)

Risk score	Score = 1 (very low risk)	Score = 2 (low risk)	Score =3 (medium risk)	Score =4 (high risk)	Score = 5 (very high risk)	Enter your score here
<b>Distance from mega eruption</b>	Very far from eruption, over 3,001 km away	Far from eruption, 1,501 to 3,000 km away	Medium distance from eruption, 501 to 1500km away	Near eruption, 151 to 500km away	Very near eruption, within 150km	3.5
<b>Land height</b>	Very low land, 0-50m high	Low land, 51 to 100m high	Medium height, 101 to 200m high	High land, 201 to 400m high	Very high land, over 401m high	3.4
<b>Climate</b>	Very warm, over 25°C	Warm, 15 to 24°C	Mild climate, 10 to 14°C	Cool climate, 1 to 9°C	Very cold climate, under 0°C	2.7
<b>Population density</b>	Very few people, less than 25	Few people, 26 to 100 people	Medium crowding, 101 to 150 people	Highly crowded, 151 to 300 people	Very highly crowded, over 301 people	2.5
<b>Income</b>	Very wealthy (blue on map)	Wealthy (green on map)	Medium wealth (yellow on map)	Low level of wealth (orange on map)	Very low wealth (red on map)	3.7
<b>Traffic chaos</b>	Free flowing traffic (all green lines)	Some minor delays (some orange and yellow lines)	Some traffic delays (some red lines)	Major traffic delays (one yellow or red circle)	Very severe traffic delays (several yellow or red circles)	2.7
<b>Health score</b>	No asthma		Occasional asthma		Regular asthma	3
<b>Community spirit</b>	Very close community links	Good community links	Average community links	Limited community links	Very limited community links	1.8
<b>Distance to emergency centre</b>	Very close, under 2 km away	Close, 2 to 3.9 km away	Medium distance, 4 to 5.9 km away	Far away, 6 to 8.9 km away	Very far away, over 9km away	3.5

Fig 5. Regjistrimet e mesatares së rezultateve të riskut për cdo faktor risku në territorin e Shqipërisë.

Faktori i riskut 5 – niveli i pasurisë. Cmimet e ushqimeve dhe energjise rriten si rrjedhojë pakësimit të burimeve të tyre dhe kjo shoqërohet me panik në blerje. Sa më të pasur të jenë njerëzit aq më te lehte do e ken perballimin e situates. Ky faktor risku është vlerësuar me 3.7, si mesatar në risk të lartë. (shihni Fig 5)

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22


Faktor risku 6 – Kaosi në trafik. Kjo shtrese (harte online) tregon të dhëna mbi trafikun duke përfshirë aksidentet rrugore dhe lëvizjet e ngadalta. Ajo tregon sesa e vështirë mund të jetë të lëvizësh në rast emergjence dhe kur ju nevojitet ndihme. Gjithashtu incidente dhe rradhë trafiku mund të shkaktohen si rrjedhojë e depozitimeve të hirit vullkanik. Monitorimi i kaosit të trafikut në një shpërthim real është një indikator i dobishëm i përcaktimit sesa zona është e ndikuar direkt prej shpërthimit. Rezultati është 2.7 i vlerësuar si *i ulët deri në risk mesatar.* (shihni Fig 5)

Faktor risku 7 – Eksperiencia me Astmën për 10 lokacionet egjeografike. Njerëzit të cilët vuajnë nga astma janë më të prirur të ndikohen nga prezenca e hirit në mjedisin e tyre rrethues. Zonat me përqëndrim të të sëmurëve nga astma është e nevojshme të njihen me qëllim që të asistohen me ndihmë mjekësore. Mesatarja për 10 lokacionet gjeografike është 3 vlerësuar si *risk mesatar.* (shihni Fig 5)

Faktor risku 8 – Shpirti i bashkëveprimit të komunitetit. Ky është një faktor i cili mund të bejë ndryshim kur njerëzit kujdesen ndaj njëri-tjetrit dhe ofrojnë ndihmën e tyre. Ajo është vlerësuar me një mesatare prej 1.8, që tregon që komuniteti njihet midis tyre dhe mund të asistojnë njëri –tjetri. (*risk i ulët*) (shihni Fig 5)

Faktor risku 9 – Ndhma në emergjence Vlerëson gatishmërinë dhe mundësinë e dhënies së ndihmës njerëzve në vështirësi duke shpërndarë ushqime dhe nevoja të tjera nëpërmjet qendrave të emergjencës. Ky faktor është verësuar me një mesatare 3.5 cilësuar si *risk mesatar në të lartë.* (shihni Fig 5).

a)



Të gjithë faktorët e riskut janë dhënë në figurën 5. Nëpërmjet saj vlerësohet si *risk mesatar në risk të lartë* impakti nga: distanca nga mega shpërthimi; lartësia nga niveli i detit; distanca nga qendrat e emergjences. Ndërsa shpirti i bashkëveprimit të komunitetit; dendësia e popullsisë dhe klima vlerësohen si *risk i ulët në mesatar*. Gjithashtu fig 6, tregon qendren e Shqipërisë si zonën më të rezikuar referuar modelit të krijuar ku të gjitha shtresat janë të aktivizuara.

b)




Fig. 6 a, b. Rezultati final dhe modeli i fituar kur shumica e shtresave janë wtw aktivizuara.

Nga modeli i përftuar mund të gjenerohen vlerësime të tjera të riskut. Kështu është realizuar një kërkim (query) sistemit ArcGIS, ku kriteri i atributit është: *rezultati i riskut të përgjithshëm më i madh së 25*. Rezultati i kërkimit tregoi 6 lokacione gjeografike nga 10 të tilla të cilat kanë vlerën më të lartë se 25. (Fig 6,b). Territoret me interval të rrezikut të lartë (26-44) na shfaqen lokacioni gjeografik i Tiranës dhe Lushnjës (simbolizuar me ngjyrë të kuqe në hartë); Durrësi dhe Kucova simbolizuar me ngjyrë të portokalli në hartë; Shkodra dhe Elbasani simbolizuar me ngjyrë të bardhë në hartë, këto të fundit si lokacione gjeografike më pak problematike.

Studimi ndalet dhe në përcaktimin e nivelit të riskut të çdo faktori për secilin lokacion gjeografik.

Kështu Saranda, Puka, Durrësi, Elbasan kanë nivel të lartë risku vlerësu-

*ar sipas faktorit-distance nga qendra e emergjencave; Lushnja adhe Tirana kanë nivel të lartë risku sipas faktorit - kaos nga trafiku; Korca dhe Puka kanë nivel të lartë risku sipas faktorit –lartësia mbi nivelin e detit.*

Elbasan, Korca dhe Kucova kanë kanë *nivel të lartë risku sipas faktorit – distance nga mega shpërthimi*

Lushnja, Durresi dhe Tirana kanë *nivel të lartë risku sipas faktorit – densiteti i popullsisë.*

Duke marrë në konsideratë faktorët dhe nivelet e tyre të riskut, del e nevojshme rekomandimi i nje plani menaxhimi në rastet e ndodhjes së mega shpërthimeve, duke evakuuar popullsinë nga shtëpitë e tyre, monitorimin e trafikut dhe të ndihmës për burime ushqimore etj.

Këto rezultate dhe një analizë e përgjithshme për përdorimin e GIS në gjeografi iu prezantua 26 studentëve të cilët studionin në vitin e parë te ciklit të studimeve Bachelor - Gjeografi. 76.9% e tyre ishin 18 vjec dhe pjesa tjetër 19 vjecare. 76.95 % ishin të gjinisë femerore dhe të tjerët meshkuj. Gjatë fazës së parë atyre iu kërkua të vlerësonin rëndësinë e teknologjisë GIS në Gjeografi. Nivelet e rëndësisë ishin: pak e rëndësishme, mesatarisht e rëndësishme, e rëndësishme dhe shumë e rëndësishme. 34.6% dhe 30.8% e tyre e vlerësonin ndërveprimin ndërmjet GIS dhe gjeografisë si *mesatarisht të rëndësishme dhe të rëndësishme*, rezultat i nxjerrë nga infomacioni që zotëronin para fillimit të trajnimit dhe leksionit. Pas zhvillimit të leksionit 38.5% dhe 30.8% prej tyre e vlerësonin këtë ndërveprim *si të rëndësishmë dhe shumë të rëndësishëm*.

Studentët e vlerësuan aktivitetin si *të dobishëm* në 30.8% të të pyeturve dhe *shumë të dobishëm* në 53.8% prej tyre, si pjesë e inkurajimit shkencor.

U testua pyetja e vlerësimit të ndërveprimit ndërmjet GIS dhe gjeografisë duke përdorur informacionin e pyetësorëve të studentëve. U aplikua “Paired sample test”.

**Hipotezat:** Hipoteza Nul: Nuk ka ndryshim domethenës në mesataret për pyetjen mbi ndërveprimin e GIS dhe gjeografisë. Hipoteza alternative: Ka një ndryshim në mesataret për pyetjen rreth ndërveprimit të GIS dhe gjeografisë. Fig.7

		Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
		Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
					Lower	Upper			
Pair 1	Evaluate the relation between GIS and geography using your information up to now: 1 - Evaluate the relation between GIS and geography using your information up to now: 2	- .65385	1.52184	.29842	-1.28645	-.03924	-2.191	25	.038

Fig.7 Rezultatet e Paired Samples Test

**Rezultatet:**

Nga rezultatet e Paired sample t-test u vu re se vlera e t së observuar = -2.191, dhe  $p = 0.038$ ; (t critic e nevojitur për të rrëzuar Hipotezën NUL = 2.064 ,). Hipoteza nul rrezohet pasi  $p < 0.05$  (në fakt  $p = 0.038$ ) dhe vlera e t së observuar është më e madhe se vlera e t-kritike.

**Konkluzioni:** Ka një evidencë të fortë ( $t = 2.191, p = 0.038$ ) e cila tregon se studentet e kampionuar vlerësojnë ndërvepimin ndërmjet GIS dhe gjeografisë më shumë sesa ata e besonin para se të degjonin leksioni dhe informacionin, në koefidencë prej 95% (95% CI, Confidence Interval).

**Hipotezat:** *Hipoteza Nul:* Leksioni dhe aktiviteti nuk ishin të dobishëm për shumicën e studenteve mbi inkurajimin e tyre shkencor. *Hipoteza Alternative:* Leksioni dhe aktiviteti ishin të dobishëm për shumicën e studentëve mbi inkurajimin e tyre shkencor. Realizohet One-Sample Test me vleren e testit 5. Fig. 8.

	Test Value = 5					
	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Lower	Upper
How useful was this activity in your scientific encouraging? Rate from 1 to 5	-3.340	25	.003	-.73077	-1.1814	-.2802

Fig.8 Rezultatet e One-Samples Test

### Rezultatet

Nga rezultatet e One Sample Test vihet re se vlera e t së vrojtuar  $= -3.340$ ; Hipoteza Nul rrëzohet. **Konkluzioni:** Ky test tregoi se vlera t e observuar është më e madhe se vlera e t kritike  $3.340$  ( $t > 1.640$ ) në një nivel konfidence prej 95%. Leksioni ishte i dobishëm për studentët e kampionuar në inkurajimin e tyre shkencor sepse ata kanë zgjedhur alternativën 5 (alternative korresponduese për vlerësimin maksimal të aktivitetit dhe leksionit).

### Përfundime

Mega shpërthimet janë pjesë e katastrofave natyrore. Të tilla shpërthime kanë frekuencë të ulët por impakt shkatërrues të madh. Meqënëse kanë frekuencë të ulët, ka mungesa të matjeve dhe vendimarrje nga ana e politikbërësve. Ka vështirësi dhe ndeshen dështime për të zhvilluar njoftime të popullsisë për të tilla raste ekstreme. Me qëllim minimizimin e impaktit të një shpërthimi vullkanik, është i nevojshëm hartimi i një plani emergjencash civile për njoftimin dhe mbrojtjen e popullsisë në zonat e afektuara. U vlerësuan 9 faktorë risku të cilat krijuan një hartë komplekse indekse për vlerësimin e impaktit të mega shpërthimit në territorin e Shqipërisë. Shqipëria ka një rezultat të përgjithshëm të riskut të barabartë me vlerën 26 (26-45 është intervali me i lartë për rrezikshmerinë)

Për faktorët e riskut si, distanca nga mega shpërthimi, vecanërisht për lokacionet gjeografike në pjesën perëndimore të Shqipërisë; lartësia mbi nivelin e detit për Korcën, Gjirokastrën, Pukën dhe distanca nga qendrat e emergjencave për Sarandën, Pukën vlerësohen me rezultate të lartë, ndaj duhet t'i kushtohet vëmendje e vecantë.

Popullsia duhet trajnuar mbi rreziqet me origjine nga katastrofat natyrore, për të mbrojtur veten dhe për të vepruar në situata emergjence. Organet e përgjegjëse duhet të jenë të afta të marrin përgjegjësitë e tyre, menaxhojnë dhe minimizojnë, situatat në kushtet ekstreme si përmbytjeve, tërmete, proceseve gravitative të shpatit, shpërthimeve vulkanike, etj.

Teknologjia ArcGIS Online është një teknologji që i ofron popullsisë avantazhe gjeografike. Duke e përdorur atë në aktivitetet e përditshme ne bëhemi më efektiv në marrjen e vendimeve. Ky simulim dhe rezultatet e tij u prezantuan gjatë një leksioni me studentët që studiojnë në vitin e parë në ciklin e studimeve Bachelor.

34.6% dhe 30.8% e tyre e vlerësonin nderveprimin ndërmjet GIS dhe

gjeografisë si *mesatarisht të rëndësishme dhe të rëndësishme* rezultat i nxjerrë nga infomacioni që zotëronin para fillimit të trajnimit dhe leksionit. Pas leksionit 38.5% dhe 30.8% prej tyre e vleresonin këte nderveprim *si të rëndësishmë dhe shumë të rëndësishëm*.

Studentët e vlerësuan aktivitetin si *të dobishëm* në 30.8% të të pyeturve dhe *shumë të dobishëm* në 53.8% prej tyre, si pjesë e inkurajimit shkencor. Studentet ndiheshin me të lidhur me teknologjine GIS pas leksionit.

Ata mendonin se GIS dhe gjeografia janë në sinkronizim me njëra-tjetrën. Duke analizuar të dhënat në programin SPSS, është vënë re se ka një evidencë të fortë ( $t = 3.068$ ,  $p = 0.005$ ) që leksioni mbi faktorët e riskut dhe vlerësimi i një territori nga impakti i një mega shpërthimi të mundshëm dhe aplikimi i GIS përmirësoi përfshirjen e studentëve në teknologji në një konfidencë prej 95% Confidence Interval (95% CI). Studentët e vlerësuan këtë aktivitet si të dobishëm 30.8% e tyre dhe shumë të dobishëm në 53.8% të tyre (84.6% in total) për inkurajimin e tyre shkencor.

Ky simulim krijon një mundësi të mirë duke krijuar modele me të cilat ne mund të raportojmë, analizjmë, përgatisim, menaxhojmë në raste te situatave ekstreme në niveleve lokale dhe deri kombetare. Gjithashtu simulimi sjell impakt positive tek të nxënëit e studenteve, të cilët synojne të rritin përdorimin e teknologjisë në funksion të zhvillimit të tyre profesional dhe shkencor.

### Burimet e shfrytëzuara

1. Abramo 2017 = E. Abramo, Enzo Boschi: *Attenzione ai Campi Flegrei, l'Ingv non trivelli quella zona*, *Blasting news*, 18 February 2017.
2. Christopherson, Birkeland 2015, = R.W.Christopherson, G. H. Birkeland, (9 ed.) *Geosystems an Introduction to Physical Geography*, England, Ashford Colour Press Ltd, 2015, pp. 410.
3. Corbellini 1994 = G. Corbellini, *Il marcopolo Strumenti*, Marietti scuola, 1994, pp. 60-61.
4. European Science Foundation, GHCP, GEO, 2015, = *Extreme Geohazards: Reducing the Disaster Risk and Increasing Resilience* <https://marketbusinessnews.com/volcanic-eruptions-could-devastate-modern-society-5-to-10-risk-say-scientists/56753>, pdf, pp. 8.
5. Eyre, Gower 1986 = P.M.Eyre, G.J.Gower, *Basics processes in Physical Geography*, Bell & Hyman Limited, 1986, pp.13, 17.

6. Hatrakul et al 2013 = P. Hatrakul, S. Saengthong, S. Vongkanjan, 2013, *Development strategy for health behaviour of the elderly*, Mediterranean Journal of Social Science, Volume 4, No.1, 141-145.

7. Hess 2016, = D. Hess, D. Tasa, *Physical Geography a landscape appreciation*, USA, Pearson education, 2016, pp. 424.

8. <http://www.castonline.ilstu.edu/mccaë/hpr445/classmaterials/IndepTtests/overheads/Critical%20values%20for%20töo-tailed%20t-test.jpg>

9. Kerenxhi, Gjoci 2013 = S. Kerenxhi, P. Gjoci 2013, *A new methodical treatment for math teaching and its effect on math learning*, Conference Proceeding ICHSS 2013, 3 International Conference on Human and Social sciences, September 20-22, 2013, Rome, Italy, 662-670.

10. Klonari I. A, *Primary school pupils' ability to use areal photographs and maps in the subject of geography*, European Journal of Geography, Volume 3, Issue 2:42-53.

11. Montgomery 1995 = C. W. Montgomery (4 ed.), *Environmental geology*, USA, Wm.C. Brown Communications, Inc., 1995, pp. 95.

12. Muller, Oberlander 1984, = R.A.Muller, Th. M. Oberlander, (3 ed.), *Physical Geography Today a Portrait of a planet*, New York, Random House, 1984, pp. 422.

13. Ok, Onkol 2007 = A. Ok, P. Onkol, 2007, *A study on pre-service teacher education students' value profile, Education and values in Balkan countries*, education and Pedagogy in Balkan countries, No 7, 256-259.

14. Salkind 2000 = N. J. Salkind "Statistics for people who (they think) hate statistics", *Saga Publication* pp. 171-191, 334

15. Self 2006, = S. Self, *The effects and consequences of very large explosive volcanic eruptions*, Philosophical transaction of Royal Society, the Royal Society Publishing, June 2006. <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.666.8439&rep=rep1&type=pdf>, pp. 2084-2085.

16. Shuttleworth M, *Pretest-Posttest Design*, Explorable Psychology Experiments, <https://explorable.com/pretest-posttest-designs>

17. The economist 2015 = *Volcanoes and climate, After Tambora, Two hundred years ago the most powerful eruption in modern history made itself felt around the world. It could happen again at almost any time.* <http://www.economist.com/news/briefing/21647958-two-hundred-years-ago-most-powerful-eruption-modern-history-made-itself-felt-around>

## Summery

*Natural hazards are disasters which have a considerable impact in human society and its properties. Their geographical impacts are huge, affecting territories and often also bringing global consequences. The evaluation process of natural hazards remains a task of nowadays society. Undergoing such a procedure would be efficient in terms of management of possible dangers, counting the reduction of disaster risks (DRR), as well as the development of effective methodologies needed for the evaluation of the impact of a considerable natural hazard. ArcGIS Online is a technology used in this paper which offers people a geographical advantage. By using GIS technology we can be more effective in the decision-making process.*

*This paper aims at analyzing and evaluating the natural risk of a stimulated mega eruption and its impact in Albania territory by using simulation and GIS technology. There are used a series of particularly accurate online maps in ArcGIS Online in order to calculate the level of risk in 10 different locations around Albania (Puke, Lezhe, Tirane, Durres, Elbasan, Lushnje, Kucove, Korce, Gjirokaster, Sarande). There are evaluated the risk factors such as: the height of the land, the density of population, wealth, distance from hospitals, etc. The given feedback estimated an overall risk score for 10 locations based on the potential impacts of a mega volcanic eruption.*

## ROLI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË IDENTITETIN RAJONAL TË QARKUT GJIROKASTËR.

Dr. Adela Dhromaj

Prof.asoc.dr. Kozeta Sala

### Abstrakt

*Trashëgimia kulturore në mbarë botën përfaqëson një aset të çmuar për identitetin kulturor të një rajoni. Ruajtja, pasurimi dhe promovimi i kësaj trashëgimie përbën instrumentin kyç në afrimin e komuniteteve ndërajonale, ndërkufitare dhe përmirësimin e dialogut integritet mes kulturave të ndryshme.*

*Qarku i Gjirokastrës disponon një diversitet të madh kulturor me vlera të shumanshme rajonale, kombëtare, por edhe ndërkufitare. Kjo për faktin e pozicionit gjeografik, afërsisë kulturore me shtetin fqinjë-Greqinë, prezencës së minoritetit, etj.*

*Në punim një vend të veçantë i lihet vlerësimit të potencialeve kulturore që disponon ky qark, me qëllim evidentimin dhe ndikimin e tyre në identitetin rajonal dhe zhvillimin e turizmit.*

*Me historinë dhe trashëgiminë kulturore, territori në studim ofron veçantësinë e tij. Promovimi i traditave, zakoneve, valleve e këngëve popullore etj, në qarkun e Gjirokastrës do të shërbejnë si përpjekje të integritet të trashëgimisë kulturore me zhvillimin e turizmit, si mundësia e duhur për ruajtjen e identitetit rajonal të qarkut.*

*Në punim rëndësi i kushtohet gjithashtu dhe marrëdhënieve bashkëpunuese ndërkufitare në këtë drejtim nëpërmjet projekteve të ndryshme si : “Dixhitalizimi dhe rrjetëzimi i kështjellave në funksion të përcimit të vlerave historike e kulturore, rinovimit dhe përmirësimit të trashëgimisë kulturore- historike me impakt të drejtpërdrejtë në nxitjen e industrisë së turizmit”; “Promovimi i ve-*

*primtarive kulturore artistike në të dy anët e kufirit, garanci për një identitet të përbashkët”.*

*Punimi kërkon të tërheq vëmendjen në nevojën për menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, nëpërmjet kordinimit të sektorit publik dhe privat për promovimin real të potencialeve turistike.*

*Fjalet kyçe: trashëgimi historike-kulturore, identitet kulturor rajonal, ri-jetëzim i kalave, turizmi kulturor.*

### **1. Roli i etno-kultures në identitetin dhe koshiencën rajonale.**

Etno-kultura, apo kultura popullore, përbën një sistem të komplikuar dhe kompleks vlerash, veprimtarish e marrëdhëniesh shoqërore të formuara dhe të zhvilluara historikisht në lidhje të ngushtë me jetën e bashkësisë sonë etnike e kombëtare. Ajo ka qenë prodhim i zhvillimit të kësaj bashkësie por edhe një mjet i formimit, konsolidimit dhe zhvillimit të saj.

Ajo paraqitet si: kulturë materiale, shpirtërore, shoqërore dhe artistike që përbën një aset themelor në studimet etno-gjeografike, në sqarimin e problemeve të ndryshme dhe zbrërthimin e tyre, në evidentimin e rajoneve kulturore më të vegjël (siç është rasti i rajonit të Gjirokastrës).

Etno-kultura është shprehje e qartë dhe më e gjerë e tipareve të një rajoni kulturor gjeografik, që evidenton të veçantat dalluese nga popujt e tjerë, po edhe të përbashkëtat me popujt fqinj.

Si një mjet i fuqishëm integrimi i rajoneve të veçantë gjeografik, e në tërësi etnik, ajo ka qenë dhe mbetet një faktor lidhës e komunikimi dhe në mes visesh shumë të largëta të etnisë arbërore-shqiptare. Me elementët e saj më të qenësishëm e më shprehës ndihmon në përforcimin e psikologjisë etnike, përmes ndërtimitarisë dhe organizimit urban, veshjeve me pasuritë e tyre artistike, artit popullor, këngëve dhe valleve, dokeve të drejtës zakonore, kulteve të ndryshme etj. Etnokultura në vetëdijen e njerëzve unifikon të kaluarën e largët me të tashmen. Etno-kultura është një pjesë e rëndësishme e kulturës në tërësi ndërsa pjesën tjetër e përbën kultura e kultivuar, sidomos në qendrat urbane e cila ndikon në identitetin rajonal. Etno-kultura në mjedisin rural ruan tipare më të fuqishme dhe prirje më të mirëfillta, në kontekstin këto të fundit si mjedise të mbyllura dhe më pak të prekuara nga modernizimi.

Ndërsa qyteti ndikohet më shumë nga rrymat e ndryshme të kulturës reflekse dhe është më i ekspozuar ndaj ndikimeve të huaja që dobësojnë kom-

paktësinë etnike. Etno-kultura ndikon në kulturën reflekse për ti dhënë kësaj të fundit veçantinë etnike. Kështu p.sh letërsia, muzika, urbanistika, artizanati etj, ushqehen nga elementë të folklorit dhe në këtë rrugë zhvillohen dhe ruajnë identitetin unik dhe kombëtar.

Zhvillimi i saj ndër shekujsh është bashkëshoqëruar me një larmi të theksuar elementesh, shfaqesh sipas krahinave dhe shtresave shoqërore, sipas llojit të urbanizimit ose të veçimit mes zonash rurale. Sikurse egziston gjuha me dialekte të ndryshme po ashtu na shfaqen edhe dukuritë e etno-kulturës. Këto veçori janë të lidhura me tradita të vjetra krahinore, me mjedisin gjeografik, me lidhjet apo veçimin nga qytetet, me burimet natyrore dhe format e organizimit të ekonomisë. Etno-kultura i plotëson funksionet e saj etnike nëpërmjet larmisë dhe diversitetit.

Si një komponent i rëndësishëm i diferencimit social, në relacione të caktuara me mjedisin natyror, ajo i jep tiparet themelore unitetit rajonal të një hapësire gjeografike. Në këto kritere është evidentuar edhe rajoni etno-gjeografik i Gjirokastrës, që shprehet në trashëgiminë e kulturës materiale, shpirtërore, shoqërore dhe artistike.

### **2. Trashëgimia kulturore në qarkun Gjirokastrë**

Qarku i Gjirokastrës disponon një potencial të madh të trashëgimisë kulturore, përfaqësuar nga trashëgimia kulturore materiale (monumentet arkeologjike, arkitektonike, të kultit, etnografike, etj) dhe trashëgimia kulturore shpirtërore (folklori, këngët, vallet, zejet, festat, gastronomia, etj. Numërohen gjithsej në qark rreth 189 monumente kulturore me vlera të padiskutueshme për identitetin e qarkut, nga të cilat 147 monumente janë në rrethin e Gjirokastrës, 26 në rrethin e Përmetit dhe 16 monumente në rrethin e Tepelenës, të pasqyruara në hartën e mëposhtme. Të gjitha këto përbëjnë fondin kulturor të zonës me karakter të vizitueshëm. *Harta e trashëgimisë kulturore e qarkut Gjirokastrë*

Ky potencial i kulturës materiale dhe shpirtërore dëshmon për vijimësi të vendbanimeve dhe popullsisë në këtë hapësirë. Popullimi i hershëm dhe veprimtaritë e larmishme ekonomike të zhvilluara këtu që nga kohët antike, krijuan një aset të çmuar, që përbën trashëgiminë kulturore të qarkut në studim si një potencial eficient në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor. Po bëjmë një prezantim të shkurtër të këtij potenciali në qarkun Gjirokastrë.

### 2.1. Monumente arkeologjike

Numri objekteve arkeologjike është i madh por në këtë studim do të ndalemi në veçanti, në ato të cilat përbëjnë ose ofrojnë mundësi për t'u shndërruar në atraksione turistike; vendbanime, fortifikime (kala), tuma, që krahas vlerave arkeologjike, mbartin vlera të rëndësishme turistike duke i dhënë qarkut një identitet rajonal të padiskutueshëm.

Qarku i Gjirokastrës është i pasur me monumente e zona arkeologjike. si të tillë përmendim qytetin antik të Antigones, i cili përfaqëson historinë sfiduese me gjetjet arkeologjike nga shekulli i III-II para.k. Qyteti antik shtrihet në një pozicion gjeografik zotërues dhe strategjik në luginën e Drinos, me një sipërfaqje që llogaritet të ketë qenë 60 ha. Qyteti antik i Antigonesë është një destinacion tërheqës për turizmin historiko- kulturor, pasi aty dokumentohet jeta e paraardhësve tanë.

Vlerat e trashëgimisë arkeologjike dëshmojnë dhe me qytetin antik të Hadrianopolit (shek II pas krishtit), qytet ky me një stil romak (sipërfaqje 16 ha), dhe teatrin e tij antik me 4 mijë vende. Këto qytete dëshmojnë më së miri marrëdhëniet e shumta që ato kishin me qytetet antike helene, për shkak të afërsisë me rrugët më të rëndësishme tregtare të kohës.

Gërmimet arkeologjike kanë zbuluar tuma në Vodhinë, varrezat antike në verilindje të fshatit Sofratik, si dhe rrënojat e teatrit antik po aty. Rajoni i Gjirokastrës karakterizohet nga një numër i madh kalash me vlera historike kulturore që mund të shërbejnë si destinacione turistike për të tërhequr turistë vendas dhe të huaj si: Kalaja e Gjirokastrës (shek XII-XIII), që është dhe më e madhja në rajon, kalaja e Melanit, e Labovës së Kryqit, e Selos, kalaja e Shtëpëzës, kalaja e Jermës, kalaja e Kardhiqit, kalaja e Libohovës, kalaja e Shën Triadhës, kalaja e Palokastrës.

Në zonën e Përmetit materialet arkeologjike paraqesin interes dhe përbëjnë një ofertë të pasur për zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik, sepse dhe këtu janë një sërë monumente kulture si: Shpella e Pëllumbave e Katiut të cilat kanë qenë vendbanime për një kohë të gjatë (periudha e bakrit dhe bronxit te hershëm). Një tjetër vendbanim me formë patkoi është zbuluar në shpellën e Bënjës, ku janë zbuluar fragmente qeramike (fund neolitit hershëm), fortifikimi i Dedejanit në fshatin Draçovë, kalaja e Këlcyrës, varrezat Piskovë-Rapçkë ku nga gërmimet u gjet një tumë 23 m e lartësi 3m, kalaja e Limarit në fshatin Malishovë, kalaja e Bolengës mbi qytetin e Përmetit, si dhe Guri i qytetit i cili ndodhet në hyrje të Përmetit dhe ka formë karakteristike.

Zbulimet arkeologjike në Tepelenë kanë evidentuar qendra të fortifi-

kuara si: Lekli vendbanim ilir i shek VI-V p.e.s; Kështjella Matohasanajt shek V-I p.e.s. me sipërfaqje 3 ha. Kalaja e Nivicës shek III-II p.e.s, kalaja e Zharës në fshatin Dukaj, kalaja në fshatin Horë, kalaja në fshatin Kalivaç, vendbanimi antik në fshatin Qesarat dhe rrënojat e urës antike mesjetare mbi lumin e Vjosës. Por ajo që evidenton qytetin e Tepelenës është Kalaja e Ali Pashës, megjithëse jo më madhe sa kalaja e tij në Janinë mbetet një strukturë mjaft tërheqëse.

### 2.2. Monimente arkitekturore dhe historike

Trashëgimia arkitekturore përbën një pasuri të madhe historike për zonën, por dhe për gjithë vendin tonë. Elementi më i rëndësishëm arkitekturor në qark është banesa, nëpërmjet stilit të tyre Gjirokastra është qyteti shqiptar me një arkitekturë shumë të pasur origjinale, me ndërtime karakteristike me vepra arti dhe druri, që shquhen për bukurinë dhe larminë e tyre. Banesat e kësaj qendre janë simbolet e një arkitekture mesjetare të përkryer dhe paraqesin vlera të veçanta në aspektin arkitekturor dhe turistik.

Rreth 200 shtëpi karakteristike, në zonën historike të qytetit që kanë statusin “shtëpi muze”, mbrohen nga shteti në bashkëpunim me UNESCO. Këto shtëpi kanë vlera të rralla arkitekturore, si Angonatë, Zekatë, Skëndulatë, Karagjozatë, Topullaraj etj. E veçanta tek këto banesa qëndron tek mënyra e ndërtimit të tyre, ku elementët kryesor janë: guri, druri dhe balta. Unik në llojin e vet paraqitet dhe pazari i vjetër me objektet dhe kalldrëmet e zbukuruara me mozaik.

Krahas banesës gjirokastrite, me tipare të veçanta arkitekturore, të trasmetuara deri në ditët tona, janë dhe banesat e krahinës së Lunxhërisë, Zagorisë Përmetit dhe krahinës së Labërisë. (Kurvelesh).

Vlera arkitektonike të spikatura paraqesin dhe urat prej guri. Ato shërbenin për të lidhur fshatrat dhe krahinat



Punoi: Adela Dhromaj

midis tyre, duke mundësuar zhvillimin e marrëdhënieve social-ekonomike. Ndër to përmëdim: Ura e Katiut (shek XVIII), ura e Petranit, e Çarçovës, ura e Këlcyrës, rrënojat e urës antike mesjetare mbi lumin e Vjosë në Tepelenë, ura e ujësjellësit të Sopotit në Gjirokastër (1812), tre urat mbi përroin e Zerzebilit, ura e gurit të Hoshtevës, ura e Nivanit, ura e Zonjës në Labovë, ura e madhe e Gurit të Kaçarevos, ura në fshatin Grapsh, në Haskovë, në Subash etj.

Në fondin e objekteve historike në qark bëjnë pjese si: Muzeu Kombëtar Armëve brenda kështjellës, muzeu Etnografik, shtëpia e Ismail Kadarese, monumenti i Çerçiz Topullit, etj. Të gjitha këto objekte janë të vizitueshme dhe ngjallin interes për kategori të ndryshme turistësh me interesa kulturore dhe historike. Numri i tyre sa vjen e rritet nga viti në vit, ku për vitin 2015 rezultojnë në rrethin e Gjirokastrës 34923 vizitorë.

Për vlerat e papërsëritshme që mbart qytetet i Gjirokastrës, organizmi kryesor i trashëgimisë kulturore botërore UNESCO e merr në mbrojtje më 15 korrik 2005.

### 2.3 Objektet të kultit

Një rol të rëndësishëm në identiteti rajonal të qarkut luajnë dhe monumentet e kultit, të cilat paraqesin interes në arkitekturën, stilin, mozaikët, pikturat e ndryshme etj. Në të gjithë qarkun ndodhen një numër i madh objekte kultesh fetare.

Në rrethin e Tepelenës përmëdim teqeja e Gusmarit, rrenojat e kishës së Dashajt, teqeja e Hormovës, etj.


Në rrethin e Përmetit janë, kisha e Shën Premtes(1772), kisha e Shën Mërisë në Leusë(XVIII), kisha e Shën Mërisë në Kosinë (XII), kisha e Shën Mërisë në Bënjë(1879), teqeja e Frashërit.

Ndërsa në rrethin e Gjirokastës inventari i monumenteve të kultit është i madh, ato të mahnisin me stilin e ndërtimit dhe me ansamblet e afreskeve unike të tyre ku përmëdim disa; Manastiri i Shën Qirjakut dhe Julitës ne Dhuvjan, manastiri i Shën Mërisë në Goranxi, kisha e Manastirit të Shën Mëhillit (Nivan), kisha e Profetit Ilias në fshatin Stegopul( 1624) , gjithashtu këtu gjenden dhe teqeja e Melanit, xhamia e Gjirokastrës etj. Gjurmët kulturore të këtyre besimeve, përveçse janë dëshmi e kultivimit të besimit fetar por përfaqësojnë edhe vlera të jashtëzakonshme artistike dhe kulturore për qarkun dhe për gjithë trashëgiminë kulturore. Restaurimi dhe përfshirja e këtyre objekteve në itineraret turistike do të ndikojë në zhvillimin e turizmit fetar.

#### 2.4 . *Trashëgimia etnografike*

Trashëgimia etnografike përbën një pjesë të trashëgimisë kulturore në qark, pasi ajo paraqet vlera të jashtëzakonshme nëpërmjet larmisë së madhe të kostumeve popullore që manifestojnë origjinalitetin e tyre. Vlen të përmendim veshjen popullore të grave në krahinën e Lunxhërisë e cila është mjaft e bukur dhe përbën një vepër arti në aspektin etnografik, jo vetëm në rajon por dhe më gjerë. Kostumi i Gjirokastrës “pirpiri” është më i bukur, pas atij të Lunxhërisë. Ndërsa kostumet e zonës së Pogonit dhe Përmetit kanë karakteristika të përbashkëta të motiveve etnografike. Në krahinën e Kurveleshit përmendim veshjet popullore labe për burra që janë: kostumi me fustanellë, veshja me pouture, kostumi me këmishë të gjatë, guna, jeleket, xhamadani, brruci. Ato janë trashëguese e transmetuese të shumë elementëve tradicionale të veshjeve kombëtare, që nga lashtësia e deri në ditët tona. Prandaj kjo pasuri etnografike dhe artistike duhet ruajtur dhe kultivuar si dëshmi autentike e origjinalitetit kombëtar dhe autoktonisë shqiptare në këtë hapësirë. Ky fond i madh kulturor (trashëgimia materiale), objektet arkeologjike, kështjellat, muzeumet, zonat muzeale, ndërtesat karakteristike, objektet e kultit, duhet të vihet në shfrytëzim turistik dhe të kthehen në burim të ardhurash të rëndësishme për komunitetin.

**Artizanati** në qarkun e Gjirokastrës i ka fillimet që në kohët më të vjetra. Mjeshtëritë tradicionale janë punimet e gurit dhe drurit. Guri është elementi kryesor i muraturës mbajtëse në Gjirokastër dhe druri elementi bazë në mobilim, por nuk përjashtohet as tavani i dekoruar bukur dhe me shije nga artizanët e kohës, në shtëpitë gjirokastrite. I gjithë qyteti historik e muzeal zotërohet nga mjeshtëria e ndërtimit me gur e dru.



Në qendrën e artizanatit që gjendet në pazarin karakteristik ku artizanët promovojnë punimet e tyre krahas mjeshtërive tradicionale apo të rejtat e gdhendjes (në dru dhe gur), ka dhe përpunim metali (hekur, bakër dhe argjend), endje tekstilësh dhe qilimash, qëndisje, vizatime dhe piktura. Në zonën muzeale në bashkinë e Gjirokastrës operojnë 62 biznese, në të cilën 8 biznese janë biznese krijuese si: qëndistari, prodhim qilimash, prodhime druri, guri, piktur etj. Në Gjirokastrë është bërë traditë të zhvillohet çdo fundshtatori panairi i trashëgimisë, artizanatit dhe turizmit ku marrin pjesë artizanë nga gjithë Shqipëria dhe nga vendet fqinje, ku ka shqiptarë për të promovuar punimet karakteristike të zonave të tyre.

## 2.5. Trashëgimia shpirtërore

Trashëgimia kulturore historike e një populli paraqet tërësinë e vlerave shpirtërore dhe materiale të krijuara gjatë historisë së tij, pasqyron zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik, fetar e kulturor në të kaluarën e tij, paraqet luftën e tij shekullore për ruajtjen e identitetit të tij etnik, gjuhësor dhe kulturor. Popujt e ndryshëm gjatë zhvillimit të tyre historik, përkatësisht, gjatë zhvillimit ekonomik, shoqëror, politik, fetar e kulturor ishin në kontakte të përhershme me popujt e tjerë, pa marrë parasysh karakterin miqësor apo armiqësor të këtyre kontakteve dhe, si rrjedhojë e kësaj, patën ndikime të ndërsjella në njeri tjetrin. Prandaj, trashëgimia kulturore historike e një populli paraqet edhe kontributin e saj në thesarin e kulturës së përgjithshme botërore.

Trashëgimia kulturore materjale nuk mund të mos shoqërohej me tra-

shëgiminë shpirtërore falë së cilës ajo u ndërtua. Në krye të listës së trashëgimisë gojore dhe shpirtërore, komiteti i kësaj trashëgimie ka shpallur Iso polifoninë si kryevepër e mbrojtur nga UNESCO në 25 nëntor 2005. Polifonia me iso si kulturë jetësore dhe muzikore ka në thelb të kënduarin në grup dukë përbërë kështu një tregues të fuqishëm të jetesës në bashkësinë njerëzore. (marrësi, prerësi, kthyesi). Në trevat folklorike të qarkut muzika instrumentale bëhet me instrumente tradicional si fyelli, dyari, zilet, këmborët dhe sazet. Përveç iso polifonise e spikatur është dhe vallja e vajzave Dropullite, folklor instrumental dhe koreografik. Tipologji e trashëgimisë shpirtërore të minoritetit grek që është pjesë e diversitetit kulturor në Shqipëri.

Një tjetër element i rëndësishëm në trashëgimin jomaterjale është dhe e folmja e toskërishtes jugore. Në këtë qark ka një diversitet gjuhësor përse i përket larmisë të të folmeve. Këto të folme dallohen nga njëra tjetra. E folmja e labërishtes (krahinës së Kurveleshit) ka elemente të veçanta, ashtu si dhe e folmja e Zagorisë ndryshon nga e folmja dhe zhargonit qytetar i këtyre trevave siç është e folmja e Gjirokastrës dhe e Përmetit.

Element tjetër janë dhe vallet ku secila nga krahinat përfaqësohet me vallet e veta, përmendim vallen labe e cila kërcëhet në grup të zënë dorë për dorë dhe diktohet nga kënga polifonike. Ndërsa vallet përmetare kërcëhen të shoqëruara nga sazet. Të gjitha këto elemente të trashëgimisë shpirtërore të qarkut por dhe të të gjithë zonave e trojeve shqiptare shpalosen bukur në Festivalin Folklorik Kombëtarë që organizohet çdo 4 vjet në kalanë e Gjirokastrës. Tradita e festivaleve që starton që nga viti 1968 tregon një dëshmi të gjallë të larmisë së kulturës popullore shqiptare. Ky festival gjallëron sa jetën kulturore ashtu dhe atë turistike të qarkut, u jep gjallëri shumë pikave turistike, historike, monumenteve kulturore, gjallëron biznesin lokal dhe demonstroi mikpritjen me prodhimet tradicionale të zonës. Pasi arti i kulinarisë gjirokastrite është i lashtë dhe këtë e dëshmojnë objektet që ndriçojnë mënyrën e jetesës dhe kulinarinë në qytetin antik të Antigones dhe më vonë në kalanë e Gjirokastrës. Nga gatimet është mrekulluar dhe Bajroni kur vizitoj Lunxhërinë dhe Libohovën. Por edhe sot tradita e kulinarisë vazhdon për plotësimin e kërkesave të vendasve, e sidomos të turistëve të huaj për gatimet tradicionale, si pjesë e kulturës së qytetarisë gjirokastrite, bashkangjitur vlerave kulturore të trashëgimisë kombëtare.

Unikaliteti i qarkut Gjirokastrë qëndron në bashkëjetesën harmonike të komuniteteve linguistike dhe kombëtare të cilat kanë bashkëjetuar në mënyrë të sukseshme përgjatë rrjedhës së historisë, duke kontribuar në zhvillimin social ekonomik e ndërkufitar të qarkut.

### 3. Trashëgimia kulturore e qarkut të Gjirokastrës si pjesë e projekteteve bashkëpunuese ndërkuftare

Qarku i Gjirokastrës disponon një diversitet të madh kulturor me vlera të shumanshme rajonale, kombëtare, por edhe ndërkuftare. Kjo për faktin e pozicionit gjeografik, afërsisë kulturore me shtetin fqinjë-Greqinë, prezencës së minoritetit, etj.

Pasuritë historiko kulturore të Qarkut kanë vlerë në bashkëpunimin ndërkuftar, pasi historia ka dhenë shembuj në të kaluarën ku kufiri i sotëm nuk shërbente si barrierë ndarëse, përkundrazi popujt kanë pasur përafrime kulturore në këto zona të kontaktit të kulturave. Një shembull i tillë i përcjellë nga historia është dhe periudha e Ali Pashë Tepelenës, periudhë në të cilën pashallëku i tij përfshinte nën sundim rajonet kuftare në të dy anët dhe si rrjedhim shumë objekte historiko-kulturore (kalatë) hasen si në rajonin e Epirit ashtu dhe në atë të Gjirokastrës. Këto pasuri përbëjnë një resurs ende të pashfrytëzuar për guidat e përbashkëta turistike, ndaj nevojiten studime dhe projekte të përbashkëta për të nxitur bashkëpunimin ndërkuftar.

Në qarkun e Gjirokastrës objektet më sinjifikative të trashëgimisë kulturore historike janë kalatë, gjeneza e të cilave pasqyrojnë qartë historinë e këtij rajoni. Është kjo arsya pse Prefektura e Gjirokastrës dhe Qendra UET u bë pjesë e një projekti ndërkuftar Shqipëri- Greqi, si partner lider, projekt i cili u financua nga BE-IPA. Ky projekt “Krijimi i Rrjetit dhe Promovimi i Kështjellave” konsistonte në dixhitalizimin dhe promovimin e rrjetit të kalave në rajonin e Gjirokastrës( 12 kala, Gjirokastër; Tepelenë; Libohovë; Kardhiq; Këlcyra; Shtëpëzë; Melan; Shën Triadhe; Selo; Palokastër; Antigonea; Labova e Kryqit), rajonin e Epirit(njësinë rajonale të Thesprotisë 5 kala), rajonin e ishujve Jonian(njësinë rajonale të Korfuzit 5 kala). Objektivi i këtij projekti ishte kontributi në fuqizimin e turizmit me synim zhvillimin ekonomik ndërkuftar nëpërmjet promovimit të kështjellave nga teknologjitë e reja duke paraqitur një produkt kulturor të përbashkët që synon fuqizimin e industrisë turistike, nxitjen e bashkëpunimit kulturor si dhe solidaritetin mes dy popujve. Teknologji të cilat do të do të mundësojnë promovimin e kështjellave historike dhe zhvillimin e turizmit elektronik. Pasi këto kështjella i përkasin jo vetëm trashëgimisë kulturore shqiptare e greke, por dhe trashëgimisë europiane e botërore.

Një projekt tjetër ndërkuftar i mbështetur nga BE-IPA me partner Qarkun Gjirokastër dhe rajonin e Epirit (Bashkia e Zagorit) me temë “Promovimi i veprimtarive kulturore artistike në të dy anët e kufirit, garanci për një identitet të përbashkët”, u realizua në kuadrin e programit të fqinjësisë së mirë. Qëllim i projektit ishte nxitja e zhvillimit të kulturës dhe artit në trevën jugore të

Shqipërisë dhe veriut të shtetit Helen si dhe njohja e urave kulturore që lidhin krahinat përgjatë vijës kufitare. Ky projekt hodhi bazat për një integrim të mëtejshëm midis dy anëve të kufirit për të siguruar në vazhdimësi një bashkëjetese ndëretnike dhe kulturore.

#### **4. Përfitimet nga ruajtja e Trashëgimisë Kulturore**

Prezenca e një trashëgimie të pasur kulturore në qarkun e Gjirokastrës si dhe bashkëpunimi në projekte të ndryshmet si Tid, ose Rijetëzimi në qytetet historike, financuar nga BE, do të sjellin një mori mundësish dhe përfitimesh ekonomike, shoqërore e kulturore.

##### ***Përfitimet ekonomike***

Rijetëzimi i qendrave urbane historike dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore do të kontribuojë në krijimin e bizneseve dhe rritjes ekonomike nëpërmjet:

- nxitjes së bizneseve lokale perms rinovimit të strukturës historike;
- vënies në efijencë të ndërtesave të vjetra të restauruara të cilat ofronë vende të veçanta për bizneset (p.sh. industria krijuese);
- angazhimit të mjeshtrove, për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve dhe turistëve, të siguruara përmes atraksionit dhe origjinalitetit të vendit;
- investimeve publike në sitet e trashëgimisë, si një katalizator për rijetëzimin edhe në zonën përreth, duke tërhequr investime private vendase e të huaja dhe duke stimuluar zhvillime të reja rajonale.

Qendra historike e Gjirokastrës tashmë e përfshirë në restaurim nga projekti “Tid Gjirokastra” (Fondacionit Shqiptaro –Amerika, Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia Gjirokastër) përfshin elemente të trashëgimisë kulturore, pjesa më e madhe e të cilave ishin të dëmtuara, të pa promovuara dhe të panjohura për shumë vizitorë të qytetit të Gjirokastrës. Këto projekte përfshijnë jo vetëm përmirësime të rëndësishme në infrastrukture, por në veçanti përfshijnë vizionin sesi administrohet zona për ta bërë më tërheqëse për zhvillimin e biznesit dhe të turizmit.

### • *Përfitimet shoqërore dhe kulturore*

Rijetëzimi i qendrave urbane historike dhe ruajtja e pasurive të trashëgimisë kulturore do të kontribuojnë në:

- krijimin e një mjedisi për aktivitetet kulturore dhe krijuese;
- krijimin e identitetit lokal, krenarisë dhe shpirtit të bashkësisë për vendin ku jetohej dhe punohej;
- ripërtëritjen e vlerave trashëgimore të zonës;
- aktivizimin e qytetarëve për t'u përfshirë në zhvillimin urban;
- forcimin e bashkëpunimit ndërkomunal.

Të gjitha këto do të konsistojnë në angaxhimin dhe krijimin e një "obligimi të përbashkët" social që do të fuqizojë ndjenjën e identifikimit me qytetin dhe qendrën e tij historike.

### **Literatura**

1. Agjencia e të ardhurave, Zyra e taksave, Bashkia Gjirokastër 2017
2. Antigonea, park arkeologjik. 2010: Guidë turistike, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Bashkia Gjirokastër 2017
4. Berxholi; A. Guidë turistike, "Lunxhëria", fq 38, Tiranë 2008
5. Cana; J. Alite; L. Vendlindja ime Tepelena, fq 40 Tiranë 2008.
6. Cana; J. Monografi "Labëria vështrim etnografik historik" fq 68, Gjirokastër 2014
7. Dollma; M. "Trevat Shqiptare", fq 115, Tiranë 2008
8. Gazeta "Gjirokastra magjike 10 vjet në UNESCO" dt 15.07 2015, Botim i Bashkisë Gjirokastër fq 1.
9. Guidë, Gjirokastra qyteti i festivaleve dhe monumenteve, Ministria e Kulturës Tiranë 2014
10. Kasarhuo; N. "Mes kengëve dhe valleve të Dropullit", fq 34, Tiranë 2003
11. Koto; P. Qyteti i trëndafilave, fq 23, Tiranë 2012
12. Peri,E, "Zagoria zakone dhe tradita" fq 74, Tiranë 2001

13. Petifer; J. Petifer; J. Butrinti rrethinat e tij dhe bregdeti jugor i Shqipërisë, Udhërrëfyes për vizitorët, fq 89, Tiranë 2007
14. Prefektura e Gjirokastrës 2016
15. Qarku Gjirokastrë 2006
16. Sala; G. Potenciali i turizmit historiko- kulturor ne Luginen e Drinos, Studime albanologjike IV, Gjeografi, fq 103, Viti XIV, 2009/4.
17. Sinani; A. Duri; V. “Oferta kulturore turistike në qarkun e Gjirokastrës”, Kërkime universitare nr 36, Universiteti “Eqerem Çabej” fq157, Gjirokastrë 2004
18. Vjetari statistikor i rrethit Gjirokastrë fq 147, Gjirokastrë 2015.
19. Vjetari statistikor, rrethi Gjirokastrë, fq 27-28, Gjirokastrë 2015

### Abstract

*Cultural heritage around the world represent a valuable asset about regional cultural identity. Preservation, enrichment and its promotion its a key instrument for the friendship relation of boarder interregional communities and improvement of integration dialogue between different cultures.*

*Gjirokastra region possess a great cultural diversity with great regional national and inter-border values. This related to geographic position, cultural closeness with neighbor country Greece and minority presence in the region, etc.*

*In this article a special space it is let to the cultural evaluation that possess this region in order to make evident their impact in regional identity. Related to history and cultural heritage territory under this study offers its distinctive features. Promotion of traditions, rituals, folk dances and songs etc in Gjirokastra region will serve as an attempt of heritage integration in tourism developments as the proper possibility to preserve regional identity of our region.*

*In this article a great importance it is paid also to inter border collaborative relation toward different projects such are :“Digitalization of castles in function of transmitting historical and cultural values with direct impact in tourism industry encouraging process”;“Promotion of artistic and cultural activities in both border areas as a guarantee for a common identity”.This article is paying attention to the need for management and preserving of cultural heritage through coordination of public and private sector in order to promote really all tourism potentials.*

*Key words: cultural historical heritage, regional cultural identity, revitalization of the castles, cultural tourism*

**NDIKIMI I VEÇORIVE GJEOMORFOLOGJIKE  
NË ZHVILLIMIN HUMAN TË BASHKISË SË PËRRENJASIT**

Dr.Andri Hoxha

**Abstrakt**

*Bashkia e Përrenjasit shtrihet në pjesën lindore të Republikës së Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 322.95 km<sup>2</sup>. Nënnyësia qendrore dhe kryesore morfologjike është fushëgropa e Përrenjasit, me origjinë grabenore, e cila shërben si mjedis më i rëndësishëm për zhvillimin human në territorin e bashkisë, për shkak të pranisë së gjerë të depozitimeve kuaternare. Në sajë të ndërtimit të larmishëm litologjik prej ultrabazikëve, gëlqerorëve të Kretakut e të Triasit, të molasave të Neogjenit dhe të depozitimeve kuaternare, si dhe të tektonikës mjaft të ndërlikuar shkëputëse e rrudhosëse, janë zhvilluar intensivisht format e relievit strukturor, ku spikasin rrëpirat tektonike, veçanërisht ato që shtrihen gjatë shpateve kufizuese të luginës së Shkumbinit dhe të fushëgropës së Përrenjasit. Në sektorët me përbërje gëlqerore, janë zhvilluar dendur, proceset karstike, sidomos në sektorin jugor të kurrizit të Bërzeshtës. Në luginën e Shkumbinit, në sajë të zhvillimit aktiv të infrastrukturës rurale, janë riaktivizuar intensivisht proceset shpatore, veçanërisht rrëshqitjet e shpërlarjet sipërfaqësore. Në sajë të kushteve të favorshme fiziko-gjeografike, duke përfshirë dhe elementët e biodiversitetit, disa sektorë, kanë statusin e zonës së mbrojtur, si në Shebenik-Jabllanicë, Stravaj dhe Sopot. Në aspektin administrativ, në përbërje të bashkisë së Përrenjasit, përfshihet qyteti i Përrenjasit me fshatrat përreth, si dhe njësitë administrative Stravaj, Qukës-Shkumbin dhe Rajcë. Ndërtimi litologjik prej gëlqerorëve ka ndikuar në rezervat masive të mineralit të hekur-nikelit, ndërsa në shkëmbinj të ultrabazikë që ndodhen në malin e Shebenikut, ndodhen vendburime të mineralit të kromit. Vendbanimet kryesore rurale janë ndërtuar në fushëgropën e Përrenjasit, në sektorin e sipërm të luginës së Shkumbinit, luginën e Bushtricës, të Radiçinës dhe të Lingajcës.*

**Fjalë kyçe:** reliev, procese shpatore, minerale, biodiversitet, vendbanime.

## Hyrje

Në kuadrin fiziko-gjeografik të vendit tonë, Bashkia e Përrenjasit shtrihet në pjesën lindore të territorit të Republikës së Shqipërisë. Territori ka një ndërtim litologjik të larmishëm, me një larmi të shkëmbinjve sedimentarë dhe magmatikë të moshave të ndryshme që nga triasiku i sipërm e deri në depozitimet e reja kuaternare. Tipet gjenetike të relievit me evolucionin përkatës deri në stadin aktual, janë relievi strukturor, karstik, relievi lumor dhe ai akullnajor. Në sajë të faktorëve e kushteve të evolucionit morfotektonik e morfoklimatik të relievit shfaqet një larmi e trajtave, duke u mbështetur në proceset e formimit të tyre.

### 1. Pozita gjeografike

Bashkia e Përrenjasit ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 322.95 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 33031 banorë. Territori ka gjatësi maksimale 33.9km dhe gjerësi nga 11.3km deri në 18km. Bashkia ka shtrirje jugperëndim – verilindje dhe kufizohet me Bashkinë e Librazhdit në veri e veriperëndim, me Bashkinë e Elbasanit në perëndim, Bashkinë e Gramshit në jugperëndim, Bashkinë e Pogradecit në jug e juglindje dhe Republikën e Maqedonisë Veriore në lindje e verilindje. Në kuadrin e organizimit administrativ përbëhet nga qyteti i Përrenjasit, si dhe njësitë administrative Stravaj, Qukës-Shkumbin dhe Rrajcë. Në kuadrin fiziko-gjeografik të vendit tonë, territori përfshihet në Krahinën Malore Qëndrore, përkatësisht në sektorin qëndror të tij. Duke u ndodhur përgjatë Korridorit 8 dhe linjës hekurudhore Elbasan-Pogradec, ky territor merr një rëndësi mjaft të madhe për transportin rrugor kombëtar e ndërkombëtar. Vendosi e rrjetit rrugor përgjatë luginave kryesore të Shkumbinit të Sipërm, të Radiçinës, Bushtricës, Lingajcës dhe të Gostimës së Sipërme, ka ndikuar në lidhjet me trevat fqinje kufizuese. Pasuritë gjeologjike, gjeomorfologjike dhe hidrografike paraqesin vlera të mëdha ekonomike.




Harta.Nr.1 Harta administrative e Bashkisë së Përrenjasit.

### 2. Ndikimi i ndërtimit litologjik në reliev

Ndërtimi i larmishëm litologjik me deformimet e strukturave rrudhosëse e shkëputëse, ka përcaktuar evolucionin morfotektonik e morfoklimatik të relievit. Shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut shtrihen ne Gafer, Sopot, Bërzështë e Stranik. Shkëmbinjtë gëlqerorë të triasit ndërtojnë kryesisht kurrizet malorë të Jabllanicës e Belicës. etj. Depozitimet e flisheve të Oligocenit të sipërm, shfaqen në Bërzështë dhe Stranik, ndërsa shkëmbinjtë ultrabazikë ndërtojnë kryesisht kurrizin malor të Shebenikut. Në shkëmbinjtë e neogjenit, përfshihen gjerësisht molasat e Tortonianit, të cilat përbëhen nga suita e kuqërremtë e Librazhdit përgjatë sektorit të sipërm të luginës së Shkumbinit, nga Qukës-Skënderbej deri në Fanjë. Depozitimet e kuaternarit të ri ose holocenit, përbëhen nga depozitimet deluviale, proluviale e aluviale, kryesisht në sektorin e sipërm të luginës së Shkumbinit, Radiçinës, Bushtricës dhe ne fushëgropën e Përrenjasit.

### 3. Pasuritë ujore

Bashkia e Përrenjasit karakterizohet për pasuri të mëdha ujore sipërfaqësore e nëntokësore me një shpërndarje jo uniforme, e cila kushtëzohet nga raporti i ngushtë i faktorëve litologjikë, tektonikë, karstikë dhe klimatikë. Prurjet mesatare mujore të pellgut të Shkumbinit arrijnë vlerën e tyre më të lartë në muajt nëntor e dhjetor, si pasojë e rolit të reshjeve të shiut, ndërsa maksimumi i dytë shfaqet kryesisht në muajin maj si pasojë e shkrirjes së borës. Territori përmban një numër të konsiderueshëm të burimeve ujore, me prurje të vogël dhe mesatare. Në lidhje me rregjimin e burimeve karstike, niveli i tyre është më i lartë në dhjetor e janar, kurse në muajin shkurt, sasi të mëdha të borës të rëna gjatë stinës së dimrit, vazhdojnë të jenë ende të ngrira. Në muajin mars e prill, niveli i ujërave rritet gradualisht nga reshjet e pranverës dhe nga shkrirja e borës, kurse në muajt e verës, burimet pësojnë një rënie të ndjeshme të prurjes. Sektorët e daljes së këtyre burimeve, janë pranë shkëputjeve tektonike dhe luginave lumore, në rrëzë të shpateve të kurrizeve, në afërsi të grykave dhe në kontaktin e shkëmbinjve të përshkueshëm me ato të papërshkueshëm.



Grafik. Nr.1 Shpërndarja e rrjedhjes ujore brenda vitit e lumit Shkumbin dhe Bushtricë në (m<sup>3</sup>/sek) për periudhën 1961-1975 .


#### 4. Veçoritë morfogjenetike

Territori i Bashkisë së Përrenjasit, karakterizohet për disa komplekse gjenetike dhe procese modeluese të relievit. Në sajë të faktorëve e kushteve të evolucionit morfotektonik e morfoklimatik të relievit shfaqet një larmi e trajtave, duke u mbështetur në proceset e formimit të tyre. Relievi strukturor ka përhapje të gjerë, në varësi të larmisë së përbërjes litologjike dhe tektonikës së ndërlikuar rrudhosëse e shkëputëse. Format e relievit të zhvilluara në strukturat shkëputëse janë rrëpirat strukturore, të cilat janë formuar nga erozioni selektiv gjatë brezit të shkatërrimit tektonik ndërmjet ultrabazikëve e gëlqerorëve dhe ultrabazikëve me molasat. Në kompleksin gjenetik të relievit karstik shfaqen trajta të tilla si ulluqet, brazdat, zgavrimit, hinkat, dolinat, uvalat e poljet në përmasa e drejtime të ndryshme. Poljet karstike janë ato të Sopotit, Kalivaçit dhe Stranikut, të cilat paraqiten të thata e me fund të çrregullt. Mbizotërimi i lëvizjeve të reja tektonike ngritëse është pasqyruar në përmasat e luginave dhe në thellimin e shtretërve lumorë deri në masën e depozitimeve lumore të Kuaternarit. Veprimtaria lumore ka formuar kompleksin përkatës gjenetik të relievit, të përbërë nga luginat, zallishtet, tarracat lumore dhe glacis-konet. Tarracat lumore shfaqen kryesisht në sektorin e poshtëm të lumit Shkumbin, sidomos në Fanjë, Qukës e Bërzeshtë, ku takohen deri në 3 nivele tarracore. Në kompleksin e formave të erozionit akullnajor bëjnë pjesë cirqet, lugjet e shpatullimet akullnajore, ndërsa format e depozitimit janë fragmentet e kufizuara të morenave. Njësitë kryesore morfologjike të territorit në Bashkinë e Përrenjasit janë, fushëgropa e Përrenjasit, sektori i sipërm i luginës së Shkumbinit (Gradishë-Qukës) dhe kurrizet malorë të Shebenikut, Jabllanicës, Belicës e Bërzeshtës.

#### 5. Fushëgropa e Përrenjasit

Fushëgropa e Përrenjasit, karakterizohet për shtrirje të gjerë dhe për ti-paret morfologjike mjaft të theksuara në raport me kurrizet kodrinorë e malorë kufizues. Fushëgropa ka një drejtim gjatësor me shtrirje përgjithësisht verilindje-jugperëndim, me gjatësi 5-6km dhe gjerësi nga 1.6km në segmentin Ballol-orvë-Rajcë-Urakë në lindje, deri në 2-2.5 km në segmentin Kotodesh-Përrenjas. Ndërsa vlerat e lartësisë absolute ndryshojnë nga 600-630m në perëndim deri në 550-600m në pjesën lindore të fushëgropës. Ajo dallohet për kufij të plotë morfotektonikë, për shkak se në veri e verilindje, kufizohet me shkeputje tektonike me kurrizin malor të Shebenikut, në lindje me pragun strukturor të Qafës së Thanës, në jug me kurrizin kodrinor të Kotodeshit e në perëndim me kodrat e Reshtanit dhe sektorin e sipërm të luginës së Shkumbinit. Kufijtë morfotektonikë, shfaqen në segmentin verior, verilindor, lindor e jugor, që paraqesin rrëpira kufizuese me origjinë të linjës së shkëputjes, shoqëruar me pjerrësi përgjithësisht vertikale dhe me lartësi relative 200m, deri në 350m. Kjo dukuri, shpjegohet me strukturat horstike e rrudhosëse, që kufizohen me strukturën grabenore të Përrenjasit, të cilat kanë pësuar lëvizje tektonike intensive ngritëse gjatë Kuarternarit. Fushëgropa e Përrenjasit është vendosur në bazamentin strukturor grabenor me përbërje kryesisht ultrabazike dhe pjesërisht flishore, molasike e gëlqerore.

Profil gjeomorfologjik i kurrizit të Dardhës



Profil gjeomorfologjik Nr.1. Sektori Gurrë Qukës - Skënderbej - Gjeologjia sipas Melo.V.

Përmasat e thellësisë së bazamentit strukturor të grabenit të Përrenjasit janë të vogla, për shkak të pranisë së vlerave të vogla të trashësisë së depozitimeve kuarternare kolumiale e proluviale, madje në disa fragmente shfaqen dhe depozitime kënetore. Në skajet kufizuese lindore, pranë Rajcës, gjatë kontaktit tektonik me kurrizin malor të Shebenikut, me përbërje prej shkëmbinjve ul-

trabazikë, shfaqen depozitimet proluviale. Evolucioni morfologjik i fushëgropës së Përrenjasit është zhvilluar në saje të faktorëve tektonikë, gjatë periudhës së Kuarternarit, që kanë krijuar kushtet e favorshme për zhvillimin e regjimit tektonik në tërheqje dhe të formimit të strukturës grabenore. Periudha e Kuarternarit është karakterizuar për dominim të regjimit të lëvizjeve tektonike ulëse, të cilat çuan për pasojë në formimin e tipareve të mirëfillta morfologjike të fushëgropës, që u krijuan mbi bazamentin e strukturës grabenore. Mjaft prej fragmenteve kufizuese të fushëgropës së Përrenjasit vazhdojnë që t'i nënshtrohen lëvizjeve tektonike ulëse, të cilat janë vërtetuar nëpërmjet identifikimit të fundit të cekët të shtratit të përrenjve të Ballës, Gurit të Zi, Shkallës së Urakës dhe të Zhellarit si dhe të krijimit të mikropellgjeve të vogla ujore të përkohëshme të tipit kënetor. Pjesa më e madhe e procesit të tërheqjes së ujërave liqenore, është realizuar gjatë periudhës së Kuarternarit të ri, në saje të lëvizjeve tektonike intensive ngritëse, që kanë pësuar strukturat kufizuese horstike e antiklinale, ku për pasojë është intensifikuar veprimtaria morfologjike erozive e rrjedhjeve ujore sipërfaqësore, duke çuar në transportimin e akumulimin e depozitimeve kuarternare. Ndonëse faza e kushteve kënetore me qëndrim periodik të ujërave në Domosdovë, është ruajtur në fragmente të kufizuara të fushëgropës, për shkak se fundi i saj është mbuluar nga depozitimet kuarternare. Aktiviteti intensiv i erozionit regresiv të përroit të Lingajcës, në sektorin Plishtës-Pishkash deri në Frashnjel që shtrihet në periferinë perëndimore të qytetit të Përrenjasit ka shfrytëzuar shkëputjen tektonike lokale tërthore, duke mundësuar tërheqjen e vazhdueshme të ujërave liqenore nga fushëgropa. Në JP të kësaj fushëgropë shtrihet një prag strukturor kryesisht terrigjen me lartësi relative 60-80 m, i cili ka diferencuar segmentin e Katjelit me gjatësi rreth 2.5 km e gjerësi afro 1.5 km me relief relativisht më pak të rrafshët, deri në kufi me kurrizin kodrinor të Reshtanit. Rritja e vlerave të lartësisë relative në kodrën e Kalasë në pjesën qendrore të fushëgropës dëshmon për praninë e pragut strukturor ndërmjet sektorit të Domosdovës në lindje dhe atij të Katjelit në perëndim. Në plan, fushëgropa paraqitet në formën e harkut, ku lugëzimi shfaqet në skajin verior, ndërmjet fragmentit të Hundës së Domosdovës dhe rezervuarit që ndodhet në lindje të qytetit të Përrenjasit, gjatë të cilit dallohet një shkëputje tektonike tërthore lokale me drejtim afërsisht veri-jug. Fushëgropa e Përrenjasit, ka filluar të formohet që në periudhën e Pliocenit dhe në vazhdim, gjatë Kuarternarit, ka arritur të paraqesë tiparet më të plota morfologjike, të cilat ruhen edhe gjatë Holocenit deri në periudhën e sotme.

Veprimtaria e lëvizjeve tektonike ulëse, që ka pësuar struktura grabenore e Përrenjasit, ka çuar për pasojë në formimin e trajtës së relievit të tipit të fushëgropës me formë përgjithësisht më të rregullt, në raport me kurrizet ku-

fizuese kodrinore e malore. Këto kurrize të formuar në strukturat horstike e antiklinale, duke u shoqëruar me praninë e shkëputjeve tektonike lokale gjatësore e tërthore, karakterizohen për relief më të çrregullt. Në aspektin e tipareve morfologjike, fushëgropa e Përrenjasit karakterizohet për kontraste të theksuara në raport me kurrizet kodrinore e veçanërisht me kurrizet malore. Kjo shfaqet më qartë në skajin verilindor të fushëgropës, që kufizohet me shpatet pothuajse vertikale. Ndryshimet e menjëhershme të elementëve morfologjikë ndërmjet fushëgropës e kurrizeve përreth saj, lidhen ngushtë me dominimin e procesit të akumulimit, në kushtet e lëvizjeve tektonike ulëse që ka pësuar bazamenti i strukturës, mbi të cilën është formuar trajta e fushëgropës, ndërsa përkundrazi shpatet kufizuese të fushëgropës, u nënshtrohen veprimtarisë morfologjike erozive të rrjedhjeve ujore. Në raport me shpatet kufizuese afërsisht vertikale dhe me vlera të larta të pjerrësisë së kurrizit malor të Shebenikut në veri, të kurrizeve kodrinorë të Reshtanit e Qukësit, në perëndim, të Katjelit e të Kotodeshit në jug dhe të pragut strukturor të Qafës së Thanës në lindje, fundi i fushëgropës së Përrenjasit është i përgjithësisht i sheshtë. Në pjesën më të madhe, shpatet që kufizojnë fushëgropën e Përrenjasit, paraqesin format e rrëpirës së linjës së shkëputjes, veçanërisht gjatë kontaktit tektonik të shkëmbinjve ultrabazikë e gëlqerorë me depozitimet kuaternare. Këto shpate kufizuese ruajnë tiparet e faqeve trapezoidale, duke paraqitur për pasojë një nga tiparet më të dallueshme në kuadër të elementëve morfologjikë të trajtave të relievit strukturor. Në pjesën më të madhe, shpatet kufizuese të kurrizeve malorë e kodrinorë në kontakt me fushëgropën e Përrenjasit, janë krijuar në sajë të pranisë së theksuar të intensitetit të lartë të shkëputjeve tektonike normale. Shpati verior gjatë segmentit Rajcë-Qendër - Ballolorvë, paraqitet me tipare të theksuara morfologjike, që shpjegohet jo vetëm me përbërjen e larmishme të shkëmbinjve, por edhe me shkallën më të madhe të intensitetit të lëvizjeve tektonike ngritëse që ka pësuar struktura horstike e Shebenikut në veri të strukturës grabenore të Përrenjasit. Shpati verilindor formohet gjatë shkëputjes tektonike normale, gjatë kontaktit të depozitimeve kuaternare me shkëmbinj të ultrabazikë që ndërtojnë kurrizin malor të Shebenikut, në segmentin Rajcë-Qendër - Kostriçan. Plani i shkëputjes tektonike që kufizon në lindje, fushëgropën e Përrenjasit me pragun strukturor të Qafës së Thanës karakterizohet për pjerrësi shumë të madhe, duke formuar për pasojë rrëpirën e linjës së shkëputjes, në Urakë e Kostriçan me gjatësi 700-800m. Në vazhdim, drejt skajit juglindor të fushëgropës, shpatet paraqesin rrëpira të linjës së shkëputjes gjatë kontaktit të shkëmbinjve ultrabazikë me ato gëlqerorë e flişoidalë, duke mundësuar zhvillimin e erozionit selektiv, nëpërmjet përrenjve të Krastës, Gurit të Zi dhe të Kotodeshit. Gjatë këtij fragmenti formohen disa lugje të thellë dhe me përmasa të vogla, duke ndikuar në shtimin e vlerave të copëtimit vertikal të shpateve. Ky fragment dallohet për

një rrjet më të dendur të përroskave, që karakterizohen për shtim të sipërfaqes së pellgjeve ujëmbledhëse që shtrihen në kuota më të mëdha të lartësisë absolute, rreth 750-800metra. Në jugperëndim të fshatit Kotodesh, ku bashkohen përrenjtë e Gurit të Zi, Shkallës e të Qytezës, shkëputja tektonike tërthore lokale me drejtim veriperëndim-juglindje, ka krijuar një brez të gjerë të shkatërrimit, ku për pasojë, aktivizohen vazhdimisht proceset shpatore, të tilla si rrëshqitjet, veçanërisht në sektorët Urakë, Krastë e Kotodesh. Shpati kufizues i kodrës së Katjelit, karakterizohet për vlera të vogla të pjerrësisë, për në drejtim të skajit jugor të fushëgropës së Përrenjasit. Në fragmentin ndërmjet rrugës automobilistike midis Urakës e Katjelit, shpati karakterizohet për vlerë më të madhe të gjerësisë, për shkak të pranisë së grykëderdhjes së disa prej përroskave, që ndërpresin këtë shpat, i cili ruan formën e glacisit të depozitimit. Fushëgropa grabenore e Përrenjasit ka kaluar etapën e kushteve liqenore, kjo për shkak se edhe një pjesë e depozitimeve kuaternare, që kanë mbathur fundin e saj, janë me origjinë liqenore, si dhe për faktin se fragmenti i Domosdovës, deri në mesin e viteve 50' të shekullit 20, ka qenë kënetë me zhvillim të plotë, e cila në vazhdim, j'u nënshtrua procesit të bonifikimit dhe tharjes së plotë. Depozitimet që kanë transportuar pellgjet ujëmbledhëse të përroit të Kotodeshit e Katjelit, për në drejtim të fushëgropës, kanë mundur që të kompensojnë përmasat e lëvizjeve tektonike ulëse të strukturës grabenore, ku për pasojë është zhvilluar procesi i akumulimit dhe i krijimit përfundimtar të fushëgropës me fund përgjithësisht të rrafshët.

## 6. Sektori i sipërm i luginës së Shkumbinit (Gradishë-Qukës)

Brenda territorit në studim, në kuadër të sektorit të sipërm të luginës së Shkumbinit, përfshihet segmenti nga Gradisha e Rrashtanit pranë Dritanajt, deri në grykëderdhjen e lumit të Bushticës për në Shkumbin. Kufijtë e luginës me ato të kurrizëve përreth, janë të tipit morfologjik e morfogjenetik, ku në lindje kufizohet me kurrizin kodrinor të Reshtanit dhe në perëndim me kurrizin kodrinor të Bërzështës. Kjo luginë është formuar mbi strukturën sinklinale me përbërje nga shkëmbinjte molasikë të tortonianit. Gjatë itinerarit të luginës, shfaqen mjaft kontraste të theksuara morfologjike, të cilat pasqyrojnë ndikimin e shkëputjeve tektonike lokale gjatësore e tërthore, si dhe të kontaktit litologjik ndërmjet molasave me fliшет, gëlqerorët e ultrabazikët, me të cilët lidhet ngushtë, prania e disa zgjerimeve morfologjike. Kurse ngushtimet morfologjike në formën e grykave e kanioneve lumore, janë pasojë e ngushtimit të theksuar të boshtit të strukturës sinklinale të Librazhdit, veçanërisht në segmentin Qukës - Qukës-Skënderbej. Vlera më e madhe e amplitudës së ngritjeve tektonike, që ka pësuar struktura sinklinale e Polisit si dhe prania më e dendur e rrjetit të shkëputjeve tektonike gjatësore, në raport me strukturat rrudhosëse dytësore

të Skroskës e të Reshtanit, ka shkaktuar një asimetri të theksuar strukturore. Për pasojë shpatet perëndimore gjatë segmentit Qukës-Skënderbej - Qukës, dallohen për vlerë më të madhe të pjerrësisë e lartësisë në raport me shpatet lindore nga Karkaveci deri në grykëderdhjen e lumit të Bushticës për në Shkumbin. Tarracat lumore të nivelit të parë e të dytë, gjatë shpatit perëndimor të luginës paraqiten në formë fragmentare, nga fshati Manastirec deri në Gurrë. Shkalla e lartë e copëtimit horizontal të relievit të luginës, është pasojë e shkëmbinjve molasikë e pjesërisht flishorë, duke arritur vlerën  $250-350\text{m}/\text{km}^2$ , veçanërisht ku shfaqet kontakti i molasave me ultrabazikët e me gëlqerorët. Gjatë fundit të luginës së Shkumbinit, lumi qarkullon në një shtrat me pjerrësi shumë të vogël dhe karakterizohet për disa meandrimë, për shkak të konfluencës, pas derdhjes në krahun e djathtë, të disa përrrenjve të tillë si ai i Reshtanit, Lekës, Xhagorit, Karkavecit dhe Lingajcës, të cilët më prurjen e ngurtë masive, kanë formuar disa kone të depozitimit, në kontakt me zallishtoren e Shkumbinit. Shtrati i lumit, dallohet për përmasa të vogla të gjerësisë, sidomos nga Gradisha deri në fshatin Goc dhe lagjia e poshtme e Bërzeshës deri në hyrje të Karkavecit. Forma e gërshetuar e shtratit të lumit shfaqet në afërsi të Dritanjit dhe në ish-stallat e fshatit Karkavec, ku për pasojë formohen disa ledhe aluvialë mbi nivelin e lumit. Lumi ka ndërprerë fundin e luginës, ku në sipërfaqe dalin shkëmbinjte e fortë ranorë të çimentuar dhe kompakte. Shpatet perëndimore të luginës paraqesin rrëpira të linjës së shkëputjes, gjatë kontaktit tektonik të molasave me gëlqerorët, ultrabazikët e flishet, të cilat gjatë rrëzës më të poshtme, kufizohen me shkallë strukturore me kontraste morfologjike. Shpatet perëndimore të luginës ndërmjet nivelit të dytë të tarracës lumore dhe shkallës strukturore të Bërzeshës, si dhe në juglindje të fshatit Qukës-Skënderbej, janë përfshirë nga proceset e shpatit, veçanërisht nga rrëzimet e shëmbjete, ku dallohet kontakti i molasave me gëlqerorët e kretakut, ku këto të fundit, ndërtojnë krahun lindor të strukturës sinklinale të Polisit. Përmasat e lartësisë relative të nivelit të parë të tarracës lumore në raport me shtratin e Shkumbinit janë 6-12m, ndërsa shtrirja gjatësore e tyre arrin deri në 90-200m.

### 7. Kurrizi malor i Shebenikut

Kurrizi malor i Shebenikut shtrihet në pjesën lindore të territorit të Bashkisë së Përrenjasit, i cili karakterizohet për elementë të spikatur morfologjikë e morfotektonikë, për shkak të formimit mbi një strukturë horstike dhe pranisë së gjerë të shkëputjeve tektonike, që ndërpresin shkëmbinjte ultrabazikë. Ai kufizohet në verilindje me kurrizet malorë të Jabllanicës e të Belicës, ndërsa në jug me fushëgropën grabenore të Përrenjasit dhe qafën e Rajcës. Gjatë shtrirjes së përgjithshme, kurrizi ka një gjatësi rreth 34.5km dhe gjerësi nga 15-19km. Vlerat me-

satare të lartësisë absolute të relievit janë rreth 900-1100m, ndërsa majat më të larta janë ajo e Pllozishitës 1595.6m, e Rujanit 1594.4m dhe ajo e Maliqit 1711.7m. Shkëputjet tektonike që kufizojnë strukturën horstike, kanë përcaktuar kontrastet morfologjike të kurrizit të Shebenikut me kurrizet kufizuese përreth. Shpatet lindore të kurrizit të Shebenikut paraqesin rrëpira të linjës shkëputjes, gjatë kontaktit tektonik të ultrabazikëve me ato të gëlqerorëve. Shkëputja tektonike gjatë kontaktit të këtyre shkëmbinjve ka formuar një sipërfaqe të brezit të shkatërrimit, duke ndikuar në aktivizimin e shpeshtë të proceseve shpatore, si psh të rrëzimeve e shëmbjeve masive. Në fragmentet më kulmore të Shebenikut janë formuar disa cirqe akullnajore, ndonëse shfaqen dhe disa depozitime të imëta të solifluksionit, gjatë pjesës më të sipërme të shpateve përkatëse. Depozitime të morenave fundore shfaqen në afërsi të Rajcës e në Shkallën e Pulës. Sektorët në Skënderbej, Sorrën e Gjonit, në Liko-Potra, deri në Bërdhet e Serovë, paraqiten mjaft të copëtuar nga përrenjtë e Govatës, Shapkës, Kumbullës e të Moravës, të cilët janë degë të djathta të lumit të Bushtricës. Sipërfaqet e penepenave me përmasa të vogla shfaqen në Bregun e Shapkës, Gropën e Gulës dhe në Faqen e Serovës. Fragmente të izoluar të shkëmbinjve gëlqerorë të kretakut të sipërm shfaqen në pjesën jugore e juglindore të kurrizit të Shebenikut, të cilat përfaqësojnë mbetje të erozionit tepër intensiv, të zhvilluar në fazat më të hershme të evolucionit morfotektonik. Ndërmjet Skroskës dhe Gurit të Pishkashit ndodhet një shpellë karstike. Prania e disa shkëputjeve tektonike u ka siguruar kushte rrjedhjes lumore të Bushtricës, që të formojë një grykë të ngushtë, të tipit të linjës së shkëputjes me karakter gjatësor në sektorin e poshtëm, gjatë kontaktit të shkëmbinjve ultrabazikë me ato sedimentarë. Lumi i Bushtricës, ka thelluar fundin e luginës e cila dallohet për asimetri strukturore të shpateve kufizuese. Lugina paraqitet në formën e grykës, për shkak të erozionit në thellësi, të shkaktuar nga aktiviteti intensiv i lumit të Bushtricës, si në Shkallën e Skënderbeut, Basanën e Madhe, Skroskë, Xixillas, Peshtan dhe deri pranë grykëderdhjes së Bushtricës për në lumin e Shkumbinit, prane Vehçanit në të djathtë dhe Qukësit në të majtë të lumit. Shpatet perëndimore të luginës paraqiten me pjerësi më të madhe sesa ato lindore, për shkak se në këto të fundit, shfaqet prania e dendur e përrenjve të tillë si ai i Kumbullës, Shapkës, Govatës, Kunjës së Skroskës, Trestenikut, Varrit të Plakës dhe Peshtanit. Kjo ka kushtëzuar për pasojë dukurinë e asimetrisë strukturore të shpateve kufizuese të luginës së Bushtricës, gjatë sektorit të mesëm dhe të poshtëm.

## 8. Kurrizet malore të Jabllanicës dhe të Belicës

Kurrizi malor i Jabllanicës, shtrihet pranë kufirit shtetëror me Republikën e Maqedonisë Veriore, i cili formohet mbi strukturën horstike, ndonëse përbëhet kryesisht nga shkëmbinj të gëlqerorë dhe ato të flishoideve, të cilët

karakterizohen për një rënie monoklinale. Në perëndim, kurrizi malor Jabllanicës kufizohet me kurrizin e Shebenikut, nëpërmjet shkëputjes tektonike gjatësore, gjatë të cilës, qarkullon lumi i Bushtricës. Vlerat mesatare të lartësisë absolute janë 1300-1400m, kurse majat më të larta janë ajo e Pëllumbave 2029.6m, e Koklit 1975m dhe e Shurit të Zi 1800m. Shpati perëndimor i kurrizit të Jabllanicës ka pjerrësi më të madhe sesa ai lindor, duke kushtëzuar asimetrinë strukturore të shpateve kufizuese. Disa fragmente të rrafshët shfaqen në Qafën e Qenit, Faqen e Shurit të Zi dhe në Fushën e Koklit, ku janë formuar disa dolina e hinka karstike. Krahas gëlqerorëve shfaqen dhe shkëmbinj të efuzivë, ku gjatë kontaktit të tyre me gëlqerorët, vepron intensivisht erozioni selektiv. Drejt skajit juglindor, kurrizi i Jabllanicës, vazhdon me kurrizin e Belicës, ku dallohen maja e Kurorës 1945m, e Shqipes 1886.5m, Belicës 1886m dhe e Bahçallëkut 1862m. Kreshta monoklinale e Retit të Kurorës me lartësi 1945.1m, vjen duke u ngushtuar së tepërmi, drejt juglindjes për në majën e Belicës. Në sektorin e Gropave të Belicës, shfaqet një prani e dendur e lapiezeve, hinkave e dolinave karstike, ndonëse vepron aktivisht dhe proceset e ngricave, duke u dhënë trajtave, një origjinë të dyfishtë. Sipërfaqja gëlqerore e karstifikuar, karakterizohet për mungesë të rrjedhjeve ujore, ku takohen disa burime karstike si ai i Bahçallëkut, Maliqit dhe i Korit të Kuq. Akullzimi i kuaternarit ka vepruar intensivisht gjatë epokës së vyrmit, ku për pasojë në majat më të larta si në Shurin e Zi, Qafën e Koklit e në majën e Retit e Kurores shfaqen disa cirqe, prej nga i kanë burimet, disa prej përrenjve që derdhen për në lumin e Bushtricës. Në tiparet mjaft të shprehura morfologjike të rrëpirave me pjerrësi vertikale, ka ndikuar jo vetëm prania e shkëputjeve tektonike lokale, por edhe përbërja nga shkëmbinj të fortë gëlqerorë dhe aktiviteti intensiv i ngricave dhe i akullzimit gjatë epokës akullnajore.

### 9. Kurrizi i Bërzeshtës

Kurrizi i Bërzeshtës shtrihet në pjesën perëndimore të territorit të Bashkisë së Përrenjasit dhe ai shërben si sektor ndërmjetës midis sektorit të sipërm të luginës së Shkumbinit në lindje, luginës së Radiçinës në jug dhe kurrizit të Polisit dhe të Buzashtës në perëndim. Pjesa perëndimore e qëndrore e kurrizit, paraqitet me tipare të ndryshme morfologjike, në sajë të ndërtimit tërësisht gëlqeror. Në Qukës-Skënderbej, gjatë rrëzës së rrëpirës tektonike, shfaqet shkalla strukturore midis kontaktit të molasave me gëlqerorët. Shkalla strukturore kufizohet në lindje me një rrëpirë litologjike, në kontaktin e gëlqerorëve me molasat. Në lartësinë absolute 1004.6m shfaqet kulmi i kreshtës monoklinale, e cila zbret në drejtim të lindjes në afërsi të Qukës-Skënderbeut. Përthyerjet e shpeshta në shtrirje të rrëpirave tektonike kufizuese, sidomos nga Frashëri deri

në Qukës-Skënderbej, paraqesin kontraste të spikatura në relief, ku shfaqen vlera të mëdha të lartësisë relative të tyre nga 290-320m në raport me sektorin e sipërm të luginës së Shkumbinit. Faktorët morfostrukturorë kanë influencuar në ruajtjen e kufizuar të mbetjeve të sipërfaqes së sheshimit, midis Qukës-Skënderbej dhe Bërzeshtës, kryesisht në lartësitë absolute 750-800m. Ndërmjet Shqiponjës dhe Gurit të Mekut, shfaqet një rrëpirë litologjike me lartësi relative 100-130m, që ndërpritet nga përroskat erozive. Gjatë skajit më jugperëndimor të kurrizit shfaqet një glacis-kon me gjatësi 600-650m dhe gjerësi 450-500m, derisa përfundon në rrjedhjen e sipërme të përroit të Gjigjiromës.

### 10. Ndikimi human në territorin e Bashkisë së Përrenjasit

Ndërhyrja humane, nëpërmjet zhvillimit industrisë, infrastrukturës urbane, rurale, bujqësore e turistike, kërkon zbatimin e kriterëve shkencore, veçanërisht duke shfrytëzuar njohuritë themelore në fushën e gjeomorfologjisë së aplikuar. Aktiviteti human ka sjellë pasoja negative në mjedisin natyror dhe në migrimin e popullsisë rurale. Në zhvillimin e strukturës bujqësore, rol kanë luajtur faktorët natyrorë, ekonomikë dhe ato socialë. Relievi kryesisht malor ka krijuar kushte për mbjelljen e kulturave të patates, fasules dhe të bazës së pjesshme ushqimore për bagëtinë e imët. Ekonomia pyjore ka luajtur një rol të rëndësishëm në fshatrat Stravaj, Gafer, Rajcë e Sopot. Administrimi i lëndës drusore është drejtuar nga ndërmarrjet e shfrytëzimit, nëpërmjet sektorit të sharrave dhe hapjes së rrugëve pyjore, pranë stabilimenteve përkatëse. Fondi i pasur pyjor, çoi në krijimin e infrastrukturës rrugore për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe transportimin e saj nga sektorët e lartë malorë për në qendrat urbane të Përrenjasit e Librazhdit, ku deri në vitin 1990, ishin në funksion objektet e industrisë së drurit, që prodhonin lëndë drusore e ndërtimore, mobilje etj. Zhvillimi i industrisë nxjerrëse, gjatë periudhës socialiste, lidhej ngushte me praninë e minierave të hekur-nikelit e të kromit.



Foto Nr.1. Sektori i sipërm i luginës së lumit të Bushtricës

Vendburimet kryesore të mineralit të hekur-nikelit që janë shfrytëzuar ndodhen në Përrenjas, Pishkash, Bushtricë, Golem, Xixillas, Skroskë etj. Minerali i hekur-nikelit, ndodhet edhe në vendburime të tjera si në Breshkë, Gafer, Bërzeshtë dhe Farret. Minerali i hekur-nikelit është shfrytëzuar që prej 60 vitesh, i cili ka përhapje të gjerë në shkëmbinjtë ultrabazikë, ndërsa ka përmbajtje të lartë rreth 42-58%. Shfrytëzimi i mineralit të hekur-nikelit ka filluar që në vitin 1958, ku në vitin 1960, prodhimi arriti 175.000 tonë. Qendra kryesore minerare ishte në Përrenjas, që u konsiderua si qyteti i minatorëve, ndërsa shfrytëzimi i mineralit të hekur-nikelit u realizua në vitin 1963.

Në vitet 1969-1970, u zbuluan vendburime të tjera të mineralit të hekur-nikelit, duke patur një fuqi punëtore prej rreth 2700 persona, ndërsa në vitin 1989, prodhimi ishte 680000 tonë.

Pas rënies së sistemit socialist dhe vendosjes së sistemit pluralist, numri i punëtorëve u zvogëluar së tepërmi, duke arritur deri në 25-40 persona në vit, për shkak të zvogëlimit të kapacitetit nxjerrës e përpunues të mineralit të hekur-nikelit. Prodhimi vjetor i hekurit në vitet 2010-2013 ishte 500000 tonë dhe ai i nikelit e silicit rreth 10-12000 tonë.

Në Debrovë pranë sektorit të Aliajt, firma Bello shfrytëzon në sipërfaqe mineralin e hekur-nikelit, i cili më pas përpunohet në Katjel.

Minerali i kromit ndodhet në Katjel. Nxjerrja e kromit ka filluar në vitin 1982, ku për pasojë në sajë të rritjes së prodhimit dhe të numrit të fuqisë punëtore, në qytetin e Përrenjasit, në vitin 1988 u ndërtua fabrika e përpunimit të kromit, duke patur një filial në lagjen Govatë, pranë tij. Prodhimi vjetor përpara viteve 90', ka qenë rreth 11-12000 tonë, duke patur një përmbajtje prej 40% C<sub>r</sub>O. Rezervat e mineralit të kromit janë rreth 29-32000 tonë në Katjel, ndërsa në vendburimin e Govatës ato janë rreth 22-23000 tonë me përmbajtje prej 37% C<sub>r</sub>O.

Një pjesë e madhe e lëndës minerale me vlerë të lartë të përqindjes së mineralit është eksportuar në shtetet e Europës, ndërsa në raste të tjera është dërguar për përpunim në uzinën e ferrokromit në Elbasan, ku si mjet transporti ka shërbyer stacioni hekurudhor i mallrave në Përrenjas. Vendburimet e boksiteve ndodhen në Pishkash, Stravaj e Farret, të cilat karakterizohen për rezerva të mëdha. Vendburimet e argjilave betonike ndodhen në Domosdovë, të cilat kanë trashësi 1-5 metra, kurse argjilat e tipit të përzier ndodhen në Përrenjas, Urakë, Katjel, Rajcë, Skënderbej etj, të cilat paraqiten të përziara me masën e rërës dhe me zhavorr. Këto argjila shfrytëzohen për prodhimin e tullave, ndërsa në Urakë shfaqen argjila për prodhimin e tjegullave, si dhe gëlqerorë të mermerizuar. Gurë me rëndësi ekonomike për ndërtim janë gëlqerorët triasikë e

kretakë, kurse me vlera dekorative janë dunitet e gëlqerorët konglomeratike në Stravaj. Materiale ndërtimore të gëlqerorëve të triasit ndodhen në Qafë-Thanë si dhe gëlqerorët e kretakut në Qukës. Disa punishte për prodhimet artizanale, funksionojnë në qytetin e Përrenjasit dhe në fshatrat Stravaj, Qukës, Urakë, Rajcë, Katjel e Bërzeshtë, të cilat sigurojnë cilësi të lartë për tulla, tjegulla, lëndë të gëlqerës e të blloqeve të betonit. Depozitimet lumore përbëjnë një rezervë të rëndësishme veçanërisht zajat e zhavorret me përbërje ultrabazike, gëlqerore e ranore kryesisht në shtratin e lumit të Shkumbinit, Bushtricës, Radiçinës etj.

Mjedisi natyror karakterizohet për një evolucion mjaft të ndërlikuar të komplekseve gjenetike të relievit, shoqëruar me pasoja të mëdha ekologjike, që shfaqen në sektorë të ndryshëm. Në kuadër të monumenteve të natyrës, rëndësi paraqesin, pozita gjeografike, karakteri, origjina e formimit, vlerat dhe kushtet aktuale të monumenteve ekzistuese të natyrës. Zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë së Përrenjasit, janë Parku Kombëtar 'Shebenik-Jabllanicë, Rezervati Natyror i Menaxhuar Dardhë-Xhyrë me sipërfaqe 400ha dhe Rezervati Natyror i Sopotit me sipërfaqe 300ha. Monumente të natyrës janë dhe shpella e Pishkashit, Sofra e Skënderbeut, shpella e Shkëmbit të Bletës, Pylli i Stravajit, Rrapi i Bërzeshtës dhe Guri i Pishkashit. Monumente të kulturës janë Kalaja e Rajcës, Kisha në Shpellën e Qafës së Thanës, Muret e Kalasë në Qafën e Kalit të Gjergjit (Bërzeshtë), Kompleksi i 7 çezmave të Moisi Golemit dhe Ura e Gurit në Qukës. Komplekset gjenetike të relievit, përbëjnë një potencial të rëndësishëm turistik, në sajë të elementëve specifikë të mikroklimës morfologjisë hidrografisë, bimësisë, botës shtazore etj. Qëndrimi i shkurtër kohor i turistëve është tregues i karakterit tranzit të disa prej vëndbanimeve, ndonëse në Rajcë, krahas funksionit shëndetsor zhvillohet dhe ai sportiv. Oferta natyrore turistike përbëhet nga elementët fiziko-gjeografikë, si trajtat e relievit, kushtet mikroklimatike e hidrologjike, bota bimore e shtazore dhe monumentet e natyrës. Qarkullimi turistik dimëror me shfrytëzim deri në 90-100 ditë do të ofrojë forma të tilla si turizmi sportiv, kurse gjatë sezonit pranveror e veror, sektori Bërzeshtë-Sopot dallohet për përqëndrim më të madh të turistëve, me kohëzgjatje më të shkurtër. Llojet kryesore të turizmit sipas kriterëve vlerësimit të elementëve geomorfologjikë fiziko-gjeografikë dhe kulturorë, kanë shërbyer si bazë e qëndrueshme për përcaktimin e formave të lëvizjes turistike, te tilla si: turizmi sportiv, kurativ, aventuresk, speleologjik si dhe ekoturizmi.

### REKOMANDIME

Përpara zhvillimit të infrastrukturës rurale dhe urbane, të ndërmerren studime geomorfologjike e gjeologo-inxhinjerie.

Duke studiuar dukuritë karstike, mund të përcaktohen kushtet hidrologjike dhe lokalizimi i horizontit të ujërave nëntokësore.

Ndërtimi i disa veprave hidroteknike dhe ekonomike, duhet të realizohet në sektorët ku nuk shfaqen hapësira boshe nëntokësore, pasi krijojnë probleme serioze për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pasurive minerale, në varësi të shtresëzimit, përshkueshmërisë, çarshmërisë dhe orientimit të tyre.

Për mënjanimin e përmbytjeve duhet të ndërtohen kanale e argjinatura mbrojtëse shoqëruar me ndalimin e shfrytëzimit të lëndëve inerte nga lumenjtë e Shkumbinit, Bushtricës, etj.

Në të ardhmen e afërt duhet të intensifikohen kërkimet gjeologjike për zbulimin e rezervave të lëndëve të para për ndërtim e të mineraleve metalore dhe të përcaktohen saktë kushtet litologo-tektonike në funksion të veprave hidro-tektonike dhe të vënies në shfrytëzim të plote të minierave së hekur-nikelit e të kromit.

Të gjithë elementët fiziko-gjeografikë duhet të vlerësohen dhe të përshtaten me mjedisin human në funksion të zhvillimit të turizmit.

### **Burimet e shfrytëzuara:**

1. Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. (AIDA). Manual, Tiranë 2016.
2. Aleks. P. Dode. L. Tomini. D. Hidrologjia e lumit Shkumbin dhe degëve kryesore të tij. 1969.
3. Aliaj.Sh. Neotectonic structure of Albania. The Journal of natural and Technical Sciences. Academy of Sciences of Albania.Nr.4.1988
4. Aliaj.Sh, Melo.V. etj. Struktura neotektonike e Shqipërisë dhe evolucioni gjeodinamik i saj. Kap.3. Instituti i Sizmologjisë, Tiranë.1996
5. Bashkia Përrenjas.  
Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Përrenjas 2015.
6. Bashkia Përrenjas. Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të territorit. 2016
7. Bashkia Përrenjas. Manuali Teknik i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Shqipëri. 2014.
8. Bashkia Përrenjas. Zyra e Gjendjes Civile. Përrenjas 2017.

9. Bashkia Përrenjas. Lista e monumenteve të natyrës dhe të kulturës. Manual. 2015.
10. ECCAL. Raporti “Politika për sektorin minerar në Shqipëri” Tiranë 2016.
11. Fletore Zyrtare. Nr.8. Për minierat. 26 Korrik 2014. Tiranë.
12. Kolektiv autoresh. Harta administrative e Bashkisë së Përrenjasit. 2015.
13. Kolektiv autorësh. Harta gjeologjike e Shqipërisë. Shk 1:200000. 2002.
14. Kolektiv autorësh. Harta tektonike e Shqipërisë. Shk. 1:200000. 2002.
15. Kolektiv autorësh. Buletini hidrologjik Instituti Hidro-Meteorologjik, Tiranë 1983.
16. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës. Reforma në sektorin minerar në Shqipëri. Seksioni i Naftës, Gazit dhe Minierave. Industria minerare në Shqipëri. Tiranë 2017.
17. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës. Invest in Albanian Natural Resources. 2013
18. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës. Drejtoria e Përgjithshme e Minierave. Perspektivat e rezervave të metaleve në Shqipëri. Aktiviteti minerar i shfrytëzimit për një zhvillim të qëndrueshëm. Raport teknik. Tiranë 2015.

## IMPACT OF GEOMORPHOLOGIC CHARACTERISTICS IN HUMAN DEVELOPMENT OF PËRRENJAS MUNICIPALITY

### Summary

*The Përrenjas municipality lies in the eastern part of the Republic of Albania and has a surface area of 307.9 km<sup>2</sup>. The central and main morphological sub-unit is the Përrenjas plain of graben origin, which serves as the most important environment for human development on the territory of the municipality due to the wide presence of quaternary deposits. Due to the diversified lithologic content of ultrabasics, cretaceous and triassic limestones, neogenic molasses and quaternary deposits, as well as highly complex, fault and fold tectonic intensities, structural forms of structural relief have developed, featuring the tectonic scarps, especially those stretching along the narrow slopes of the Shkumbin valley and the Përrenjas graben-plain. In the limestone sectors, densely developed, karstic processes, especially in the southern section of the Bërzeshta ridge. Thanks to the active development of rural infrastructure, Shkumbin Valley has intensively reactivated the mass wasting processes, especially slides and sheet-wash. Due to favorable physical and geographical conditions, including biodiversity elements, some sectors have the status of the protected area, such as in Shebenik-Jabllanica, Stravaj and Sopot. Administrative part of the municipality of Përrenjas includes the town of Përrenjas, as well as the administrative units Stravaj, Qukës and Rajca. Lithologic content of limestone has affected the massive reserves of iron-nickel ore, while the ultrabasic rocks that lie on Mount Shebenik are resource of the chromium ore. The main rural settlements are built on the Përrenjas graben-plain, in the upper section of the valley of Shkumbin and Bushtrica, Radiçina Lingajca valleys.*

**Keywords:** relief, mass wasting processes, minerals, biodiversity, settlements.

## POTENCIALET URBANE DHE QASJA KRIJUESE SI NXITËSE E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM RAJONAL

Msc. VIOLETA ALIAJ  
Prof.asc.Dr. Merita KOKA KARAGUNI

### Përmbledhje

Qytetet janë konsideruar kurdoherë si promotorrë të zhvillimit. Suksesi i një qyteti përbën njëkohësisht edhe suksesin e zonave apo rajoneve të tëra të afërta apo të largëta të lidhura ngushtësisht me të. Ai lidhet vecanërisht me përdorimin në mënyrë krijuese të potencialeve urbane, që nënkupton qasje të re, ndaj problemeve të hershme, duke tërhequr vazhdimisht investime në të gjithë sektorët e ekonomisë, vecanërisht në atë turistik, dhe sidomos duke tërhequr dhe zhvilluar mendimin intelektual për të qenë në pararojë të zhvillimeve lokale, rajonale apo globale. Këtë potencial krijues e mbartin të gjithë qytetet por diku ai është aktivizuar e diku ende nuk është “zgjuar”. Në Shqipëri ka qytete që kanë mbetur periferikë në terma të zhvillimit, stimuluar kjo, jo vetëm nga lokalizimi i tyre por edhe nga politikat e ndjekura. Në planet e zhvillimit kombëtar disa prej tyre konsiderohen pjesë e rajoneve ndërkuftare për të cilët janë përcaktuar prioritetet zhvillimi. Qytetet e Korçës, Pogradecit, Sarandës si pjesë e këtyre rajoneve kanë filluar prej kohësh të “zgjojnë” e shfrytëzojnë potencialet e tyre duke u bërë gjithnjë e më të sukseshëm. Qytete të tjerë si Kukësi, Bajram Curri, Peshkopia ashtu si qytetet e Koplikut, Krumës, Bilishtit, Ersekës, Leskovikut, Përmetit etj., mbartin potenciale të cilat presin të shfrytëzohen edhe pse janë lënë prej kohësh jashtë vëmendjes së politikave të zhvillimit. Bazuar në konceptin e “qytetit kreativ” dhe në problemet me të cilat përballen disa prej qyteteve në afërsi të kufirit lindor të vendit, artikulli rreket të tërheqë vëmendjen mbi domosdshmërinë e vënies në shfrytëzim të potencialeve krijuese të tyre në të mirë të zhvillimit lokal e rajonal. Gjetjet mund të shërbejnë si bazë për kërkime të tjera të thelluara në lidhje me atë cka mund të bëhet për t’i shndërruar ata në nxitës të zhvillimit rajonal e më gjerë.

*Fjalë kyc: qytet kreativ, atraktivitet, asete, rajone ndërkuftare, zhvillim i qëndrueshëm*

### 1. Domethënia e konceptit "qytet krijues"

Të jesh krijues nuk do të thotë detyrimisht dhe vetëm të bësh diçka të re, por gjithashtu edhe të rivlerësosh situatat në këndvështrime të reja, duke qenë gjithmonë fleksibël. Përdorimi i këtij termi në kontekstin e zhvillimeve urbane, ka të bëjë pikërisht me ndryshimin e situatës ekonomike globale në një moment të caktuar dhe me përpjekjet e qyteteve për të qenë pjesë e rëndësishme e këtyre zhvillimeve, duke u përshatur me to nëpërmjet transformimit. Ideja dhe koncepti mbi qytetet kreative, i ka fillesat në fund të viteve '80 të shekullit XX dhe lindi për të inkurajuar të vepruarit mendjehapur dhe imagjinatën me synimin për ta vënë atë më pas në shërbim të zhvillimeve të reja, në kontekstin e ri zhvillimor global. Ky kontekst nënkuptonte transformimin e ekonomive më të zhvilluara në rang global, transformim i cili lehtësohej vecanërisht në kushtet e përdorimit gjithnjë e më shumë të internetit. Rrjedhimisht, u vu re, një zhvendosje e fokusimit nga puna fizike tek ajo mendore, gjë që përbën një vlerë të shtuar për qytetet dhe i transformon ata në përputhje me këto zhvillime të reja.<sup>1</sup>

Filozofia që e përshkon këtë koncept, bazohet në faktin se gjithmonë në cdo qytet ka shumë më tepër potenciale zhvillimi nga c'mund të shihen e perceptohen në pamje të parë. Ajo që duhet bërë për të nxjerrë në pah këto potenciale dhe për t'i përdorur ato, është nxitja e individëve për të qenë krijues në zgjidhjen e problemeve ekonomike, sociale e mjedisore urbane. Kjo ide ose filozofi mund të përfaqësohet fare mirë nga thënia: "Njerëzit e zakonshëm mund të bëjnë vepra të jashtëzakonshme në se atyre u jepet një shans për këtë...".<sup>2</sup> Fillimisht ky koncept i referohej potencialit të industrive kulturore, sepse në përputhje me filozofinë e kreativitetit, qytetet duhej të evidonin atë cka i bënte ata unikë dhe specialë, duke u fokusuar më së shumti tek trashëgimia kulturore e vecanërisht tek ndërtesat e vjetra dhe ripërdorimi i tyre. Por, më pas koncepti u zgjerua duke përfshirë edhe rritjen e produktivitetit, novacionet dhe rritjen e cilësisë së jetesës urbane për t'u zgjeruar edhe më shumë akoma, në mes të viteve 1990, ku në këtë koncept u përfshi edhe kreativiteti shkencor, teknologjik dhe inxhinjerik dhe jo vetëm ai kulturor. Në këtë këndvështrim, qytetet duhet të rregullonin apo përshatnin prioritetet e tyre duke kaluar nga paradigma inxhinjere urbane, në kombinimin e infrastrukturës së rëndë e të lehtë urbane.

Ky fokusim i ri, ka të bëjë më së shumti me tre aspekte kryesore, në se i referohemi cilësisë së të jetuarit në qytet, dhe rrjedhimisht individëve kreativë që i japin formë dhe e zhvillojnë qytetin: me mjedisin e ndërtuar, atë natyror dhe kombinimin e tyre; me aspektet e jetës sociale, vecanërisht ndërveprimin dhe diversitetin njerëzor dhe mundësitë që ai ofron për të bërë një jetë aktive dhe të larmishme sociale.<sup>3</sup> Pra, në analizë të fundit kjo ka të bëjë me faktin se sa i aftë është një qytet që ta mbajë apo ta tërheqë shtresën më kreative të popullsisë dhe profesionistëve tek të cilët mbështetet e ardhmja e qytetit.

1 Florida. R., *The creative city*, 2002

2 Hubbard.P., *City*, 2008

3. Florida. R., *The creative city*, 2002

## 2. Kreativiteti dhe qyteti

Kreativiteti, përveçse konsiderohet një filozofi mendimi dhe veprimi në lidhje me zhvillimet urbane, konsiderohet gjithashtu edhe si një metodë e eksplorimit të resurseve urbane dhe e përdorimit të tyre në të mirë të zhvillimit. Përgjithësisht, studjuesit që janë marrë me këtë problem, evidentojnë faktin se qytetet kultivojnë aftësinë krijuese më shumë se vendbanimet rurale pasi, jeta urbane, për shkak të intensitetit dhe larmishmërisë së saj funksionale e shoqërore, shtron vazhdimisht probleme për zgjidhje që, nga ana e tyre, nxisin kreativitetin. Natyrisht që pa një bazë të mirë financiare apo mundësi financimi nuk mund të flitet për kreativitet. Historikisht është vërtetuar marëdhënia e ngushtë e kreativitetit me qytetërimet duke iu referuar Athinës në shekullin e pestë para erës sonë, Londrës së shekullit XVI, Vjenës së shekullit XVIII dhe XIX apo Parisit dhe Londrës të fund shekullit XX. Në veprën e tij “*Cities and civilization*”, Peter Hall vlerëson se “.....Athina e Platonit, Firence e Mikelanxhelos, Londra e Shekspirit, Viena e Moxartit janë të gjithë qytete- lidera ekonomike, qytete që kanë qenë në zemër të perandorive të mëdha, qytete-magnet për njerëz të talentuar në kërkim të famës dhe fatit. Imigrantët apo të ardhurit i bënë këta vende ata që ata janë sot.....”<sup>4</sup>. Kjo thënie mbështet idenë se diversiteti demografik dhe kulturor urban, përbën një indikator që dëshmon për potencial krijues të një qyteti.

Rajonet dhe qytetet i përdorin dhe i konsolidojnë përparësitë e tyre bazuar në aftësinë për të patur ide të reja biznesi të finalizuara në produkte. Kjo gjë, varet edhe nga përqëndrimi i individëve të shkolluar dhe kualifikuar në nivele të larta dhe me natyrë kozmopolitane. Studimet e Floridës, mbi indeksin e talenteve evidentojnë një korrelacion të drejtë të këtij indeksi me funksionimin e qytetit si qendër industriale dhe e teknologjisë së avancuar, gjë që reflektohet në ritmet e larta të rritjes ekonomike dhe sipërmarrjeve<sup>5</sup>. Duke qenë se studimi i tij u referohet zhvillimeve urbane në SHBA, kuptohet, që bëhet fjalë për qytete që ofrojnë cilësi shumë të mirë jetese, gjë që tërheq individët me potencial dhe aftësi krijuese të cilët nëpërmjet këtyre aftësive, i bëjnë qytetet edhe më kreativë. Po nga i njëjti studim, rezulton se diversiteti në qytete, bëhet atraktiv për lokalizimin e individëve me potencial dhe aftësi krijuese në ta. Kjo gjetje përputhet edhe me vëzhgimet e Peter Hall, sipas të cilit kreativiteti ndikohet si nga mënyra se si është ndërtuar dhe organizuar qyteti (e ashtuquajtura “infrastrukturë e rëndë”), ashtu edhe nga fakti në se ka një organizim të tillë të jetës urbane, ku individëve me përkatësi të ndryshme kulturore e demografike, u krijohen mundësi të kontaktojnë me njëri-tjetrin, të shkëmbejnë idetë dhe të krijojnë marrëdhënie shumëplanëshe. Kjo mundësohet dhe favorizohet nga ekzistenca në qytet e të ashtuquajturve “vende të treta”. Ky term i referohet ekzistencës së hapësirave që mundësojnë kontakte njerëzore informale, që janë të ndryshme nga ato që krijohen dhe zhvillohen në banesë dhe në vendet e punës. Kjo gjë, lidhet me faktin se këto

<sup>4</sup> Hall P. *Cities and civilization*, 1998

<sup>5</sup> Hubbard.P., *City*, 2008

kontakte, krijohen tashmë me persona të ndryshëm në rrethana të ndryshme, duke ndikuar në funksionimin e individit si qenie kreative. Krahas ekzistencës së këtyre hapsirave studimi vecon edhe faktin se, për nxitjen e kreativitetit, është shumë e rëndësishme ekzistenca e infrastrukturës intelektuale, qoftë ajo formale (universitete) apo informale.

Ka patur edhe ide krejtësisht të ndryshme prej ideve që e vecojnë qytetin nga vendbanimet rurale, për sa i takon stimulimit të kreativitetit. Kështu, De Vries<sup>6</sup>, në shkrimin e tij: “Big city, great art : a myth about art production”, duke e konsideruar një mit, mardhënien midis qytetit dhe kreativitetit thekson se arti nuk është një ekskluzivitet i qyteteve e aq më tepër qyteteve të mëdha. Sipas tij, në kohën e internetit dhe hipermobilitetit që ne jetojmë, nuk ka më arsye që individët kreativë të preferojnë domosdoshmërisht qytetin për të komunikuar me individët e tjerë krijues apo kreativë, duke zbehur kështu disi, bashkëshoqërimin ekskluziv të qytetit me kreativitetin.

### 3. Kreativiteti urban dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Tërësia e asetëve urbane që i shërbejnë kreativitetit duke bërë pjesë në potencialin kreativ të një qyteti grupohet në 4 kategori, si më poshtë:

- Asete materiale: karakteristikat natyrore dhe rajonale që lidhen me lokalizimin; resurset natyrore; historia; trashëgimia; mënyra e ndërtimit; infrastruktura fizike dhe ajo teknologjike e dixhitale.
- Asete që lidhen me sjelljet: respektimi ose jo i mjedisit; menaxhimi i mbetjeve; përkujdesja sociale; traditat; prezenca e industrive dhe shërbimeve; ekzistenca e mjeshtërive dhe talenteve; shumëllojshmëria e aktiviteteve që nga ato tregtare deri tek ato sportive, artistike e deri tek festivalet me bazë komunitare dhe evenimentet e ndryshme.
- Asete që lidhen me perceptimin: toleranca, reagimi qytetar, kohezioni social, iniciativa për sipërmarrje, kurioziteti, kreativiteti dhe kompetenca.
- Asete që lidhen me organizimin e jetës dhe vendbanimit: menaxhimi dhe partnershipi, rregullimi i territorit dhe vendimmarrja komunitare.<sup>7</sup>

Baza e zhvillimeve pozitive nëpërmjet stimulimit të kreativitetit, është ekonomia kreative e cila përfaqësohet kryesisht nga e ashtuquajtura “industri kreative” që, sipas përcaktimit britanik është ajo industri që e ka origjinën në talentin dhe aftësinë krijuese të individëve me potencial për krijimin e pasurisë dhe vendeve të punës, nëpërmjet përdorimit të pronësisë intelektuale. Si pjesë e kësaj industrie konsiderohet p.sh.: industria e reklamave, arkitektura, tregu i antikuarëve ose objekteve të vjetra, artizanati, moda, filmi, programet interaktive argëtuese, muzika, artet performuese, publikimet, televizioni, radio etj.<sup>8</sup>

6 Hubbard.P., *City*, 2008

7 Florida. R., *The creative city*, 2002

8 Hubbard.P., *City*, 2008

Në antitezë me faktorët që e bëjnë atraktiv dhe kreativ një qytet, ekzistojnë faktorët që e frenojnë kreativitetin si: peisazhe të mërzhitshme, të degraduara, të ndotura; arritshmëri jo e mirë; mungesë alternativave për transport, infrastrukturë e vjetëruar, nivel i ulët arsimor, stres shoqëror, nivele të ulëta të aktiviteteve kulturore dhe argëtuese, që përcaktojnë kulturën e një qyteti.

Orientimi drejt përdorimit në mënyrë kreative të potencialeve që përmbajnë qytetet, për t'i udhëhequr ata drejt të qenit konkurrues dhe të sukseshëm, rezulton të përputhet më së miri me vizionin për zhvillim të qëndrueshëm urban në disa drejtime. Mardhënia midis tyre evidentohet nëpërmjet kontributit që kreativiteti jep në drejtim të respektimit të parimeve të Melbournit (2002), për qytete të qëndrueshëm<sup>9</sup>. Kreativiteti kontribuon: në të paturit të një vizioni të qartë bazuar në qëndrueshmëri, në barazi ndërajonale sociale, ekonomike e politike dhe në individualitetin e tyre; në stabilitet ekonomik dhe social afatgjatë përsa kohë që e bëjnë qytetin konkurrues dhe ofrojnë oportunitete punësimi; në njohjen dhe ruajtjen e vlerave të biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore; në minimizimin e gjurmës ekologjike; në krijimin dhe ruajtjen e qyteteve të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm; në njohjen dhe krijimin e tipareve dalluese **të qyteteve, duke përfshirë vlerat e tyre humane e kulturore, historinë dhe ekosistemet natyrore**; në fuqizimin e individit dhe komuniteteve **nëpërmjet pjesëmarrjes**; në zgjerimin dhe mirëfunksionimin e rrjeteve të bashkëpunimit për një të ardhme të përbashkët të qëndrueshme ; në promovimin e prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit sic duhet të teknologjive miqësore me mjedisin dhe në përputhje me **kërkesat duke i menaxhuar ato dhe** në përmirësimin e vazhdueshëm bazuar në transparencë dhe mirëqeverisje.

#### 4. Perspektiva e zhvillimeve rajonale dhe kreativiteti urban si domosdoshmëri

Bashkëpunimi rajonal konsiderohet si një mundësi e mirë që qytetet të orientohen drejt zhvillimit ekonomik e të qëndrueshëm, duke përdorur mundësitë apo asetet që ata zotërojnë. Në sajë të këtrij bashkëpunimi edhe qytete të lënë pas dore mund të orientohen në rrugët apo shtigjet e reja të zhvillimit të ndikuar nga një kontekst rajonal zhvillimor. Në strategjitë dhe planet e zhvillimit të vendit që prej vitit 2013, të gjithë vendbanimet urbane kanë marrë vëmendje të shtuar nga organet e qeverisjes qendrore, e finalizuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030, të miratuar nga Këshilli i Ministrave në dhjetor të vitit 2016. Ky plan ka orientuar zhvillimin e vendit me qëllimin e sigurimit të zhvillimit të balancuar ekonomik e social; menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij; mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës. Pjesë e politikave për të realizuar qëllimet kryesore të planit, është edhe zhvillimi i një sistemi urban kombëtar policentrik, të balancuar i mbështetur nga zhvillimi i integruar i flukseve shpërndarës

<sup>9</sup> Newman.P.,Jennings.I, Cities as sustainable ecosystems, 2008.

e ndërlidhës të komunikimit, transportit, ushqimit, energjisë dhe nga menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore, duke riaktivizuar asetet nëpërmjet përmirësimit të arritshmërisë së tyre. Reforma administrative- territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 siguron koherencën e planifikimit nga niveli kombëtar në nivel vendor.

Për të realizuar një zhvillim inteligjent e gjithëpërfshirës e për të zbutur pabarazitë, sistemi urban sipas këtij plani, përbëhet nga 9 qendra primare, 10 qendra të specializuara dhe 11 rajone ekonomike ( 4 të specializuara dhe 7 me profil më të gjerë zhvillimi). Një ndër kategoritë e përcaktuara të rajoneve, janë edhe rajonet ndërkufitare ku bëjnë pjesë një sërë qytetesh të përmasave të vogla dhe mestare. Bëhet fjalë për rajonet Shkodër-Podgoricë, Gjakovë-Has-Tropojë dhe Kukës-Prizeren, Shkup –Dibër, Pogradec-Strugë; Korçë –Selanik, Gjirokastrë –Janinë dhe Sarandë-Korfuz<sup>10</sup>.

Duke qenë se në përgjithësi, zonat dhe qendrat urbane në kufi të territorit janë konsideruar ndryshe “zona periferike”, kooperimi apo bashkëpunimi funksional midis qendrave urbane pranë kufijve me qendrat urbane të vendeve fqinjë siguron realizimin e këtij vizioni dhe rrit rëndësinë kombëtare të këtyre qyteteve periferike. Qytetet “periferikë” (veçanërisht ata të pjesës lindore të vendit) në aspektin ndërkufitar, vishen me rol qendror në zhvillimin e rajoneve dhe mund të udhëheqin zhvillimin e zonës lindore të vendit në fushën e sipërmarrjes, turizmit, bujqësisë, energjitikës apo industrisë minerare.<sup>11</sup>

Për nga numri i popullsisë, qytetet e lokalizuara pranë kufirit lindor (që konsiderohen si periferikë) janë të përmasave të ndryshme. Korça dhe Pogradeci, edhe pse dukshëm të ndryshëm për nga numri i popullsisë, janë të mirëorientuar drejt zhvillimit, duke përdorur në mënyrë kreative, asetet e tyre materiale të tilla si resurset natyrore; historia; trashëgimia; mënyra e ndërtimit, apo ato që lidhen me mënyrën e sjelljes si ekzistenca e mjeshtërive dhe talenteve apo edhe festat e ndryshme që lidhen me specifikat e tyre funksionale. Në dokumentat e PPK, Korça dhe Peshkopia konsiderohen si qendra primare. Ndërkohë që Pogradeci së bashku me qytetin e Bajram Currit dhe atë të Bulqizës, konsiderohen si qendra sekondare të specializuara dhe si qytete të talentuara pasi karakterizohen nga një drejtim unik i ekonomisë së tyre dhe lokalizohen në një distancë kohore prej 30 minutash nga qendra më e afërt primare. Të tjerë qytete që ndodhen pranë kufijve të pjesës lindore të vendit, duket të jenë ende larg zhvillimit për shkak të specifikave të tyre të lokalizimit dhe kontekstit rajonal zhvillimor në rang kombëtar. Qytetet e Prrenjasit, Ersekës, Bilishtit, Krumës, në PPK konsiderohen qendra terciare urbane vetëm falë funksioneve që kryejnë si qendra bashkish, pas Reformës Territoriale, ndërsa Leskoviku cilësohet si qender

10 Plan i Përgjithshëm Kombëtar – dokumenti i parë kombëtar për planifikimin e territorit 2015-2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, dhjetor 2016

11 Po aty

lokale e specializuar, pra si qendër urbane e një niveli më të ulët hierarkik.<sup>12</sup>

Duke gjykuar mbi ritmet e ndryshimit të popullsisë të përlogaritur për periudhën 2001-2011, vërehet se ecuria e popullsisë nuk është e njëjtë për të gjithë këta qytete. Kjo natyrisht, në analizë të fundit reflekton edhe ecurinë dhe prirjet e tyre zhvillimore. Referuar përlogaritjeve, qytezat e Krumës, Prrenjasit dhe qyteti i Kukësit reflektojnë rritje të popullsisë gjatë periudhës 2001-2011. Shquhet vecanërisht qyteza e Krumës, gjë që mund të lidhet edhe me treguesin e shtimit natyror, ashtu si edhe me migrimin e brendshëm nga zonat rurale drejt tij, por gjithsesi kjo hipotezë kërkon një thellim në arsyetim, fakte e faktorë.

Tabela 1. Ritmi mesatar vjetor i ndryshimit të popullsisë 2001-2011

Qytetet	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Ritmi mesatar vjetor i ndryshimit 2001-2011 (në %)
Bajram Curri	6546	5340	-2.03
Krumë	3215	6006	6.2
Kukës	16621	16719	0.06
Peshkopi	14017	13251	-0.56
Bulqizë	8780	8177	-0.71
Prrenjas	4334	5847	2.99
Pogradec	23762	20848	-1.30
Korcë	55017	51152	-0.72
Bilisht	6729	6250	-0.74
Ersekë	5499	3746	-3.83
Leskovik	1991	1525	-2.66
Përmet	7726	5945	-2.62

Burimi: INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, KUKES, DIBËR, ELBASAN, KORCË, GJIROKASTËR 2011/2004

INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, KUKES, DIBËR, ELBASAN, KORCË, GJIROKASTËR 2011/2013

Ka një kategori tjetër në tërësinë e këtyre qyteteve që edhe pse karakterizohen nga ritme negative të ndryshimit të popullsisë, nuk e kanë këtë tregues në nivele shqetësuese. Ndërkaq, për rënie më intensive të popullsisë dallohet vecanërisht qyteti i Ersekës dhe po ashtu edhe si i Leskovikut, Përmetit dhe Bajram Currit. Këto ritme shqetësuese rënieje të popullsisë bëjnë apel për ndërhyrje emergjente me politika zhvillimi, ku kreativiteti mund të shihet si alternativë efikase. Vëmendja e shtuar ndaj oportuniteteve zhvillimore (në terma asetesh) dhe vënies në funksionim të tyre, do të mundësonte edhe një ecuri ndryshe të numrit të popullsisë, përkundrejt ritmeve mesatare vjetore negative të ndryshimit të popullsisë.

Një faktor shumë i rëndësishëm në integrimin rajonal është infrastruktura

<sup>12</sup> Po aty

rrugore që shkurton distancat në kohë duke intensifikuar njëkohësisht komunikimin me qendra të tjera brenda dhe jashtë territorit. Duke gjykuar në lidhje me mundësitë që infrastruktura rrugore ofron për integrim në zhvillimet rajonale ndërkufitare, evidentohet se distanca kohore (në rrugë tokësore me mjete motorike) midis qyteteve pranë kufijve lindorë dhe vendbanimeve urbane më të afërta në vendet fqinje, është e ndryshme. Ajo luhet nga 34 minuta në rastin e distancës Prrenjas – Strugë, në 1 orë e 55 minuta në rastin Ersekë-Konicë. Përgjithësisht situata në lidhje me mundësitë e komunikimit duket e mirë, që që dëshmohet nga koha e shkurtër që nevojitet për të frekuentuar e bashkëpunuar qytetet me njëri-tjetrin. Rasti më evident që bën apel për ndërhyrje është ai i Ersekës. Edhe pse në vijë ajrore largësia e Ersekës me Kosturin është pothuajse sa dyfishi i largësisë Ersekë-Konicë, me situatën aktuale të rrugëve, largësia në kohë e Ersekës nga të dy qendrat urbane më të afërta kufitare është e njëjtë, duke ulur shanset për integrim efikas të qytetit në rajonin ndërkufitar përkatës. ( tabela 2)

Sa më sipër, vlerësohet se një ndërhyrje në infrastrukturën rrugore do të ishte shumë emergjente për integrimin e qytetit të Ersekës në sistemin urban kombëtar dhe rajonin ndërkufitar pjesë e të cilit ai është. Nëpërmjet zhvillimit të rajoneve ndërkufitare pretendohet të nxitet bashkëpunimi ndërajonal në fushën ekonomike, të infrastrukturës rrugore, trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore, shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe më gjerë.<sup>13</sup>

Në pritje të stimujve të zhvillimit që mund të vijnë nga bashkëpunimi ndërkufitar si pjesë e politikave të zhvillimit kombëtar, organet e qeverisjes vendore duhet të jenë më vizionare dhe nxitëse të kreativitetit si një mundësi e mirë për të stimuluar lokalisht rritjen e zhvillimin. Bazuar në asetet e tyre materiale, të sjelljeve, të perceptimit dhe organizimit të jetës ata mund t’ia dalin të jenë të suksesshëm në kontekstin e synuar zhvillimor, qoftë ai lokal apo vecanërisht rajonal. Kreativiteti duhet të jetë vazhdimisht në vëmendje të qeverisjes vendore edhe në një situatë ideale bashkëpunimi ndërkufitar, pasi sërisht këtyre qyteteve do t’u duhet të përdorin kreativitetin në funksion të zhvillimit për të qenë sa bashkëpunues aq edhe konkurrues me qytetet e tjerë të rajoneve ndërkufitare ku ata do të bëjnë pjesë.

Tabela 2. Distanca në kohë midis qyteteve kufitare shqiptarë dhe qyteteve më të afërt në shtetet kufitare

Qytetet shqiptare	Qytetet më të afërt në shtetet kufitare	Distanca kohore (në rrugë automobilistike)
Bajram Curri	Gjakovë	50 minuta
Krumë	Gjakovë	44 minuta

13 Plani i Përgjithshëm Kombëtar – dokumenti i parë kombëtar për planifikimin e territorit 2015-2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, dhjetor 2016

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

Kukës	Prizren	39 minuta
Peshkopi	Debar	39 minuta
Bulqizë	Debar	50 minuta
Prrenjas	Strugë	34 minuta
Pogradec	Ohër	58 minuta
Bilisht	Kostur	39 minuta
Ersekë	Kostur/Konicë	1 orë e 53 minuta/1 orë e 55 minuta
Leskovik	Konicë	42 minuta

Burimi: Google maps, 2017

Edhe pse kohët e fundit janë bërë disa ndërhyrje në aspektin urbanistik dhe estetik të qyteteve të këtyre përmasave dhe jo vetëm, ende mbetet shumë për të bërë në drejtime të tjera, vecanërisht në politikat e zhvillimit ekonomik. Vëmendje e shtuar vecanërisht kërkohet ndaj qyteteve që paraqesin trende të theksuara negative në ndryshimin e numrit të popullsisë apo që kanë arritshmëri jot ë mirë dhe infrastrukturë rrugore që lë shumë për të dëshiruar si qyteti i Bajram Currit, Leskovikut, Përmetit dhe vecanërisht ai i Ersekës.

Disa prej qyteteve kanë shansin tashmë që duke qenë të integruar në rajonë të caktuar zhvillimi t'u kushtojnë rëndësinë e vëmendjen e duhur aseteve materiale, të cilat janë gjithmonë prezente për shkak të specifikave fiziko gjeografike të territorit por edhe për shkak të historisë së Shqipërisë.

Referuar aseteve të evidentuar si potenciale kreative për zhvillimin urban, këta qytete mund të shfrytëzojnë resurset kulturore që nga historitë njerëzore, zakonet, të kaluarën e tyre, simbolet që lidhen me historinë e qytetit, veshjet karakteristike, traditat intelektuale, artin, artizanatin e deri tek kulinaria. Këto janë pjesë e të ashtuquajturave astet materiale dhe të sjelljes. Në librin e tij “The art of city making” C. Landry, ndërmjet parimeve që një qytet duhet të respektojë për të qenë krijues, shprehet: “Një qytet nuk duhet të përpiqet që të jetë qyteti më krijues në botë, rajon apo në shtetin ku bën pjesë, por duhet të përpiqet të jetë më krijues për botën, rajonin apo shtetin ku bën pjesë. Kjo do të thotë që cdo vendbanim ka dicka të vecantë për të ofruar.”<sup>14</sup>

Përdorimi në mënyrën e duhur i të gjithë aseteve, mundësohet nga tre faktorë kryesorë që janë:

- Një sistem cilësor edukimi, që nxit pavarësinë dhe praktikitetin në mendim.
- Motivimi i individëve, nëpërmjet përfshirjes në iniciativat nga poshtë – lart.
- Mirëqeverisja, ku vlen të theksohet fakti se përdorimi i duhur i aseteve për kreativitet, duke minimizuar apo shmangur problematikën që e

<sup>14</sup> Newman. P., Jennings. I., *Cities as sustainable ecosystems, principles and practices*, 2008

frenon kreativitetin, ka të bëjë me kompetencën dhe aftësinë e lidërshpirt që konsiderohet si “aseti i aseteve”.

Një lidërshpirt efektiv në kreativitetin e tij, duhet të karakterizohet nga aftësia parashikuese; aftësia për të përcaktuar drejt strategjitë e zhvillimit; nga të kuptuarit e urbanizimit dhe dinamikës së qytetit në një mënyrë holistike, pra në raport me të tjerët dhe si pjesë e së tërës; nga mundësitë që ofron për krijimin e kulturës së kuriozitetit dhe mendimit kritik; nga fleksibiliteti organizues dhe nga vendosmëria dhe motivimi për të realizuar planet e hartuara<sup>15</sup>.

### Burimet e shfrytëzuara:

1. Florida. R., *The creative city*, 2002
2. Hall P. *Cities and civilization*, 1998
3. Hubard P., *City*, 2008
4. INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, DIBËR 2011/2013,
5. INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, ELBASAN 2011/2013
6. INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, GJIROKASTËR 2011/2013
7. INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, KORCË 2011-2013
8. INSTAT- Censusi i popullsisë dhe i banesave, KUKES 2011/2013 ,
9. INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, DIBËR 2001/2004,
10. INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, ELBASAN 2001/2004,
11. INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, GJIROKASTËR 2001/2004
12. INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, KORCË 2001/2004,
13. INSTAT- Rregjistrimi i popullsisë dhe banesave, KUKES 2001/2004
14. Newman. P.,Jennings.I., *Cities as sustainable ecosystems, principles and practices*, 2008
15. MZHU, Plani i Përgjithshëm Kombëtar – dokumenti i parë kombëtar për planifikimin e territorit 2015-2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, dhjetor 2016

<sup>15</sup> Florida. R., *The creative city*, 2002

## URBAN POTENTIALS AND CREATIVE APPROACHES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE REGIONAL DEVELOPMENT

Msc. VIOLETA ALIAJ  
Prof.asc.Dr. MeritA KOKA KARAGUNI

Cities are always considered as promoters of development. The success of a city is at the same time the success of close or remote areas or regions closely related to it. It is particularly related to the creative use of urban potentials, which implies a new approach to early problems by constantly attracting investment in all sectors of the economy, especially in the tourist sector, and in particular by attracting and developing intellectual thinking to be at the forefront of local, regional or global developments. This creative potential carries all the cities but somewhere he is activated and somewhere is not “awake” yet. In Albania, there are cities that have remained peripheral in terms of development, stimulated not only by their localization but also by the policies pursued. In the national development plans some of them are considered part of the cross-border regions for which development priorities have been defined. The cities of Korca, Pogradec and Saranda as part of these regions have long begun to “awaken” and exploit their potentials by becoming more and more successful. Other cities like Kukws, Bajram Curri, Peshkopia or Koplik, Krumw, Bilisht, Ersekw, Leskovik, Pwrmet etc., carry potentials that are expected to be utilized even though they have long been out of the attention of development policies. Based on the concept of “creative city” and the problems faced by some of the cities near the eastern border of the country, the article seeks to draw attention to the necessity of utilizing their creative potentials for the benefit of local and regional development. Findings can serve as a basis for further in-depth research about what can be done to turn them into regional development promoters and beyond.

**Key words:** creative city, attractiveness, assets, cross-border regions, sustainable development

## HAPËSIRA “NDËRKUFITARE” MES IRANIT DHE SHQIPËRISË: TË JETOSH NË DY SHOQËRI

**Msc. Ornela Hasrama**

*Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Tiranës [hasramaornela@yahoo.com](mailto:hasramaornela@yahoo.com)*

### **Shkurtesë**

Tematikat ndërkufitare mbeten prioriteti më i lartë i çdo kombi. Politika që mbështetin marrëdhëniet bashkëpunuese mes dy apo më shumë shteteve dhe sfida e përfshirjes së tyre në marrëveshje ndërkombëtare, sot po i kalon kufinj të territorial. Hapësirat ndërkufitare, në kontekstin e bashkëpunimit mes tyre, kanë një trend drejt kompleksitetit si rezultat i përfshirjes së shumë aktorëve në grupin e interesit.

Përfshirja në shkallë të lartë në projektet ndërkombëtare mes shteteve, me marrëveshje zyrtare, jo vetëm që është bërë e zakonshme, por është edhe shumë e suksesshme. Me një rast të tillë konkret kemi të bëjmë me marrëveshjen diplomatike, të vitit 2013, mes SHBA-së dhe Shqipërisë. Një marrëveshje e cila sot, në 2017, ka arritur të krijojë brenda vendit tonë “hapësira ndërkufitare” virtuale, marrëveshje që në thelb ka sigurinë globale. Kjo sfidë përfshin jo vetëm Shqipërinë, SHBA, por edhe Iranin dhe vendet e Kombeve të Bashkuara, sepse bazohet në vendosjen e një grupi të madh social dhe shumë specifik të shtetasve Iranian në territorin tonë, konkretisht në periferi të kryeqytetit. Luftëtarët për liri (mojahedin) pas rikthimit në atdheun e tyre dëshirojnë që në shoqërinë shqiptare të lënë gjurmë pozitive.

Punimi ka si qëllim studimin e këtij grupi dinamik social, në kontekstin e integritetit dhe mosintegritetit të tyre në shoqërinë shqiptare, si refugjatë politik të përkohshëm në vendin tonë. Studimi i konceptuar në dy këndvështrime, mes shtetasve Iranian dhe shoqërisë shqiptare, nxjerr në pah dallime sociale në aspektin konceptual të dy grupeve, këtej dhe andej vijës “kufitare” virtuale: raportet që kanë krijuar me familjet shqiptare dhe anasjelltas, bëjnë të lindin perceptime të reja për të dy grupet sociale. Mes të drejtave të njeriut dhe në kushtet e një sigurie të lartë, ata kanë krijuar hapësira të vogla ndërkufitare virtuale, të cilat mbajnë larg këtij

kufiri këdo që nuk është i autorizuar të jetë në kontakt me këta shtetas. Hapësira të cilat u krijuan si rezultat i bashkëpunimit vullnetar mes vendit tonë dhe SHBA-së.

**Fjalë kyçe:** *marrëveshje diplomatike, integrim, shtetas iranian, marrëdhënie sociale.*

## Ndikimi ndërkombëtar në çështjen e shtetasve iranian

### *1.1. Tipare të përgjithshme të lëvizjes për liri dhe shpërndarja e tyre gjeografike*


Lëvizja për liri është themeluar nga tre student inxhinjer në vitin 1965, periudhë kur vendi i tyre ishte në tranzicion politik, ata punuan së bashku në mënyrë që të kishte një bashkëpunim popullor më të gjërë. Kjo lëvizje u mbajt e fshehtë për gjashtë vite deri në momentin kur dy nga themeluesit kryesorë u ekzekutuan nga misioni sekret “sovac”, i përkrahur nga regjimi diktatorial i Shahut të vitit 1971. Themeluesi i tretë, Muhamed Ali, i ka mbijetuar sulmeve Iraniane nga kampet e qëndrimit në Irak dhe tani ndodhet në Shqipëri për qëllimin e tyre të vetëm, përmbysja e regjimit diktatorial të Iranit dhe vendosja e demokracisë në vend.

Regjimi iranian ka arritur shpesh herë të shkatërroi organizatën, me anë të ekzekutimeve ç'njerëzore, por forca e vogël e kundërshtimit ishte më e fuqishme se këto sulme terroriste masive qeveritare. Organizata rritej në numër çdo ditë e më shumë, kjo si rezultat edhe i mbështetjes së SHBA dhe shteteve Europiane, e cila solli revolucionin popullor të qytetarëve në vitin 1979. Kundërshtimi ndaj grushtit qeveritar vjen si rezultat i rritjes së ekzekutimeve nga regjimi Iranian duke u konsideruar si mbajtës i rekordit botëror për ekzekutime. Forumi për të Drejtat e Njeriut “Mos e prek Kainin” (NRCI) shprehet: “Për të kuptuar natyrën e regjimit iranian, është e rëndësishme të përmendim masakrën e 30,000 të burgosurve politikë në vitin 1988 në Iran dhe se qeveria aktuale po vazhdon me vrasje në ngjashme”. Në bazë të një dekreti të lëshuar nga Khomeini, për vitin 2017, numri i të burgosurve të ekzekutuar vetëm në muajin gusht ka arritur mbi 50.

MEK, lëvizja për liri, iu përkushtua përgatitjes ushtarake duke u shndërruar në grupin më të madh dhe më të fuqishëm militant kundër regjimit iranian. Pas pushtimit të Irakut, forcat amerikane negociuan një pakt paqeje, në bazë të të cilit ata dorëzuan armët dhe premtuan t'i ktheheshin jetesës paqësore. Rreth

3 mijë muxhahedinëve që jetonin në Ashraf iu dha statusi i civilëve të mbrojtur nën Konventën e Gjenezës dhe ushtria amerikane mori përsipër sigurinë e Qytetit të Ashrafit. Ndaj, një nga vendimet e fundit të SHBA, në mënyrë që t'i krijojë sigurinë e jetës, këtë grup social të shoqërisë Iraniane, vendosi që t'a strehoi në vendin tonë.

Skica 1. Shpërndarja gjeografike



Punoi: Ornela Hasrama

Ky grup social është vendosur në tre qendra banimi në periferi të kryeqytetit, Vorë (Bërxullë, Gjakaj) dhe Yzberisht. Ata kanë krijuar vendet e tyre sociale të cilët kryejnë të gjitha aktivitetet e domosdoshme për një jetesë normale, vende sociale të shërbimeve si: spital, menza kyesore, vendi i takimeve dhe konferencave, ushtrimit të aktiviteteve fizike, etj. Në këto hapësira ku ata anagzhohen gjatë ditës nuk lejojnë askënd të kalojë “kufirin”, ruhen në kushte të një sigurie të lartë si nga instancat përkatëse ashtu edhe nga kompani private sigurie. Kjo ka bërë që të krijojnë një hapësirë “ndërkufitare” virtuale<sup>82</sup> mes vendeve sociale të tyre dhe shoqërisë shqiptare brënda territorit të vendit tonë. Një kufi i padukshëm vizualisht, por askush i pa autorizuar nuk mundet të depërtojë në këto hapësira. Në të ardhmen mendohet të krijohen kushtet e ushtrimit të aktiviteteve për të gjithë këtë grup social në të njëjtin territor. Me anë të finacimeve Europiane parashikohet të krijohet një hapësirë sociale në periferi të kryeqytetit me qëllim jetesën e tyre të pa fragmentarizuar nga njëri-tjetri.

82. Teoria e hapësirës virtuale u zhvillua për herë të parë nga Dr. Or Ettliger, Universiteti i Lubjanës, në librin Arkitektura e hapësirës virtual, me krijimin e artit të tij, ku dukshëm shpreh këto hapësira virtuale nëpërmjet pikturave të cilat të krijojnë idenë e një hapësire tjetër në sfond por që nuk ishte qëllimi i punimit.

### 1.2. Marrëveshja ndërkombëtare diplomatike

Shtetet të cilat dolën në mbrojtje të qytetarëve Iranian, me kauzën e mos respektimit të të drejtave të njeriut, sot jo vetëm që i kanë premtuar sigurinë e jetës së tyre, por edhe i financojnë me projekte të ndryshme. Rolin dhe kontributin kryesor për këtë iniciativë e mbajnë SHBA-të<sup>83</sup>, të cilat duan t'a përmbysin regjimin diktatorial Iranian për disa arsye: Së *pari*, Irani shtyp të drejtat e njeriut brënda territorit duke shkaktuar panik dhe tragjedi tek qytetarët, ku në këtë mënyrë SHBA kundërshton Iranin me anë të opozitës së tij. Së *dyti*, Irani është mbështetësi më i madh financiar dhe ushtarak i Sirisë, vend mbështetës i terrorizmit. Interesat ideologjike dhe gjeopolitike, veçanërisht aleanca e njohur si "boshti i rezistencës, përbëjnë arsyet kryesore pse republika islamike mbron dhe financon regjimin sirian. Regjimi i Assadit është veçse një zgjatim i politikave të Teheranit, të cilat i mundësojnë republikës islamike të manovrojë në një plan global kundër interesave të SHBA dhe në plan rajonal kundër Arabisë Saudite<sup>84</sup>. Së *treti*, Irani është shtet superfuqi në armët bërthamore i cili ka deklaruar se pas arritjes së objektivave të tij, fillimisht do të pushtoi Botën Arabe dhe më pas vendet demokratike si: SHBA, Angli, Francë, etj.

Në mënyrë që Irani të mos arrij objektivat e tij, vendet demokratike duhet të qëndrojnë të bashkuara dhe të marrin vendime politike në favor të tyre, kështu SHBA preferoi që në ndihmë të kësaj çështje krahas saj duhet të qëndroi aleati i besuar i saj, Shqipëria. Një marrëdhënie diplomatike e cila ka marrë jetë që në tetor të vitit 1991<sup>85</sup> pas një shkëputje 52 vjeçare. Ndaj, Shqipëria ka disa arsye përse pranon strehimin e shtetasve Iranian: *fillimisht*, nuk mund të kundërshtoi aleatin e saj më të mirë, SHBA. Së *dyti*, ne jemi një popull që e mbështesim demokracinë në vend për shkak të përvojës tonë të mëparshme; së *treti*, duhet të mbështesim luftën kundër terrorizmit dhe së *katërti*, Shqipëria përfiton ekonomikisht si rezultat i jo vetëm financimeve të huaja për këtë projekt, por edhe nga qëndrimi i këtij grupi social në vendin tonë.

## II. Integrimi i shtetasve iranian në shoqërinë shqiptare

### 2.1. Qasjet e shoqërisë iraniane

Muxhahedinët janë një grup social dinamik i shoqërisë më të kualifikuar Iraniane të cilët duan të realizojnë planin e tyre me dhjetë pika në rrugë

83. <https://www.nytimes.com/2017/05/17/world/middleeast/iran-presidential-election-democracy.html>

84. Agolli.R, Interesat e Iranit në Siri, <http://gazeta55.al/interesat-e-iranit-ne-siri/>

85. US & Albania, our relationship, history & policy <https://al.usembassy.gov/>

paqësore dhe demokratike. Plani i tyre përmban: kërkesën e një sistemi pluralist; konceptimin e kutisë së votimit si të vetmin kriter për legjitimitetin; heqjen e dënimit me vdekje; ndarjen e fesë nga shteti; barazi të plotë gjinore në fushen politike, sociale dhe ekonomike; shtet ligjor dhe të së drejtës; respektimi i të drejtave të njeriut; lejimi i pronës private, investimeve private dhe ekonomisë së tregut; bashkëjetesë paqësore, paqe dhe bashkëpunim ndërkombëtarë/rajonat; Iran jo-bërthamor, të lirë nga armët e shkatërrimit në masë<sup>86</sup>. Kritere të cilat çdo vend demokratik kërkon t'i arrij nëpërmjet politikave të ndryshme. Në rastin konkret konstatojmë se kjo shoqëri është e prekur nga shumë elementë cënues të një jetë demokratike qytetare.

Për të arritur qëllimet e lëvizjes së tyre, jetojnë të ndarë meshkujt nga femrat dhe nëse dy persona në lidhje martesore kishin menduar të krijonin të ardhmen së bashku, ata janë divorcuar në emër të lirisë. Anëtarët e këtij grupi social trajtohen si refugjatë politik nga shteti ynë dhe të gjitha veprimtaritë në lidhje me legjislacionin ata i drejtohen zyrës së azil kërkesve (Drejtoria e Azilantëve) në Ministrinë e Brendshme. Shpesh herë nuk preferojnë që ne t'i drejtohem si persona të cilët kërkojnë azil politik, por t'i referohemi si një lëvizje popullore me qëndrim të përkohshëm në vendin tonë, pavarësisht se nga ligji nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"<sup>87</sup>, kanë fituar leje qëndrimi deri në momentin kur ata të jenë të sigurtë për t'u rikthyer në vendin e tyre.

Muxhahedinët nuk kishin dëgjuar asnjëherë më parë për një vend të quajtur *Shqipëri*, për gjuhën apo kulturën e këtij populli, por ishte SHBA e cila vendosi që kjo popullsi të priste këtë grup social. Ata vijnë brënda kufijëve territorial Shqipëtar vetëm në rrugë ajrore dhe në kushte sigurie shumë të lartë. Ky grup social ndihet i sigurtë në Shqipëri, megjithatë ata kanë një armik të cilët duhet të përballen dhe motivohen ditë pas dite për këtë objektiv. Për të qëndruar në formë dhe gjithmonë gati për misionet që i cakton lideri ata kryejnë aktivitete sportive, informohen rreth të rejave më të fundit nga vendi origjinës, lexojnë studime dhe analiza rreth lëvizjes së tyre Mojahedin-e Khalq (MEK), marrin mësimet e gjuhës shqipe për katër orë në ditë nga mësues shqipëtar, etj.

Nëpërmjet komunikimit kupton se ata do dëshironin që këtu në Shqipëri të kishte rritje të ndërgjegjimit të popullsisë Shqiptare në lidhje me kushtet që gjendet populli Iranian dhe qëllimet reale të këtij grupi të vendosur në vendin tonë. Kjo do t'i ndihmonte që të kishin më shumë mbështetës nga popullsia Shqiptare, sepse shumë herë ndeshen me individë të cilët nuk kanë informacion konkret për shtetin e Iranit dhe kushtet sociale e ekonomike që ndodhet ky vend. Megjithatë, ata ndihen mirë në Shqipëri, kjo për arsye se: shqiptarët

86. <http://ncr-iran.org/al/>, Cilët janë muxhahedinët Iranian?, PDF, fq. 2

87. [https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj\\_nr\\_121\\_dt\\_18\\_9\\_2014](https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014), fq.2

janë një popull tolerant ndaj feve të secilit individ duke respektuar qasjet fetare të gjithkujt, ideologjitë kryesore janë të ngjashme (paqja, demokracia, të drejtat e njeriut, respekti ndaj gjinisë tjetër, etj), të ndjenjës së lartë të humanizmit që gjendet në familjet shqiptare, etj.

Për të arritur në fakte më konkrete në lidhje me qëndrimin e tyre në Shqipëri, kontaktet me ata, më kanë mundësuar realizimin e një pyetësori të thjeshtë, të cilët nga 14 pyetje kanë dëshiruar t'i përgjigjen vetëm 7 prej tyre. Pyetjet konsistojnë nga informacione të përgjithshme të tyre deri në pyetje konkrete në lidhje me raportet dhe marrëdhëniet që kanë krijuar me familjet shqiptare. Pyetjet që refuzuan t'i përgjigjeshin ishin rreth tematikave në lidhje me: të dhënat personale (gjendja civile, nëse mbajnë kontakte me familjarët e tyre, punësimi në Iran dhe Shqipëri), të dhëna nëse do të pëlqenin të ndaheshin nga grupi i MEK dhe të emigronin në një shtet tjetër (pët të krijuar një jetë familjare të qetë), apo në lidhje me avantazhet dhe disavantazhet e vendit tonë. Pyetjet e drejtuara të cilat morën përgjigje ishin:

*Nëse kishin dëgjuar më parë për Shqipërinë dhe referuar të dhënave sasore vetëm 10% prej tyre kishin njohuri rreth Shqipërisë si rezultat i studimeve të tyre universitare me karakter gjeografik dhe përqindja më e lartë e këtij grupi social, 90% prej tyre, nuk kishin dëgjuar për këtë shtet përveçse disa njohurive sipërfaqësore duke e cilësuar si pjesë e vendeve të ballkanit.*

Ndërkohë, kontrastet mes dy shoqërive janë më të dukshme në të dhënat e mbledhura në pyetjen e dytë, nëse *kultura Shqiptare është e njëjtë me kulturën Iraniane*, konstatime të cilat rezultuan në vetëm 10% prej tyre mendonin se është e njëjtë sepse të dyja shoqëritë kanë në thelb familjen, ndërsa 90% prej tyre mendonin se janë dy shoqëri të ndryshme sepse Shqipëria është një vend me përqindje të lartë të popullsisë ateiste dhe Irani është një shtet i përbërë me 100% të popullsisë myslimane dhe individët me përkatësi tjetër fetare nuk pranohen.

Në vazhdim 100% prej tyre kanë pohuar se i mungon familja e tyre, megjithatë nuk do të dëshironin që ata të vinin në Shqipëri por kërkojnë që problemet politike në Iran të zgjidhen sa më shpejt me qëllim bashkimin me familjarët e tyre. Ndërkohë, gjatë jetesës në Shqipëri ata kanë demonstruar se i pëlqen të kenë shoqëri me shqiptarët dhe 100% prej tyre kanë krijuar kontakte me këtë popullsi duke vizituar familjet shqiptare në raste festash dhe njëkohesisht duke dhuruar ndihma për familjet në varfëri ekstreme.

Pyetjes së shtatë, nëse ndihen të paragjykuar nga popullsia shqiptare ata janë përgjigjur 100% jo, duke argumentuar se në këtë aspekt ndihen mirë në këtë mjedis social, madje do të dëshironin që të krijonin më shumë hapësira rreth integritit të tyre në këtë shoqëri.

## 2.2. Qasjet e popullsisë shqiptare ndaj shtetasve iranian

Në këtë studim janë bërë përpjekje për të vlerësuar dy këndvështrimet e shoqërive të ndryshme në raport me njëra-tjetrën. Megjithatë, kjo tematikë delikate ka përfshirë grupe të ndryshme sociale, duke iu referuar jo vetëm opinionit publik por edhe politikbërësve, të cilët herë kanë zgjedhur të mos prononcohen dhe herë e kanë “zbutur” situatën për të shmangur reagimet negative popullore. Ndër titujt më të spikatur nga mass-media mund të veçojmë disa deklarata të figurave politike të huaja dhe shqiptare, të cilët përpiqen të japin qëndrimet e tyre nëpërmjet të folurës në publik. Ndër to përmendim: “Ish Kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko: -Unë jam Mojahed-“ ; “Rama: Obama na falenderoi për Muxhahedinët” (Ora neës); “Muxhahedinët pritën si hero Berishën dhe Majkon -Ish kryeministri: Unë ju admiroj” (Gazeta Shqiptare); “John Kerry: Mirënjohje Shqipërisë për Muxhahedinët” (Gazeta Shqip); “Muxhahedin në Shqipëri, Mac Kainnit: Testament i vërtetë për vlerat e popullit shqiptar” (Gazeta Shqip); etj.

Megjithatë, pyetjet që shtrohen pas të gjitha debateve është: *A jemi ne të rrezikuar nga qëndrimi i shtetasve Iranian në vendin tonë?* Fillimisht, perceptimi negativ vjen si rezultat i përfytyrimit të situatës së luftës që gjendet në vende të tilla si Pakistan, Iran, apo Siri, dhe së dyti keqinterpretimi apo transformimi me nocion negativ i lajmeve nga mass-media rreth koncepteve muxhahedin, xhihadistë apo organizatë terroriste<sup>88</sup>. Megjithatë për të qënë sa më pranë realitetit është realizuar një pyetësor me 20 pjesëmarrës, shtetas shqipëtar, të cilët jetojnë pranë zonave ku është vendosur ky grup social apo që ndeshen më shpesh me këtë grup individësh duke ndarë disa vende të përbashkëta sociale.

Në anketim morën pjesë 50% meshkuj dhe 50% femra, ku rreth 10% i përkasin arsimimit 8-vjeçar, 30% me arsim të mesëm dhe 60% me arsim të lartë. Pyetjes *nëse kishin kontakte me refugjatët Iranian* ata u përgjigjën 40% jo, nuk kanë kontakte me këtë grup social dhe 60% kishin kontakte. Raportet ndryshojnë shumë pak në pyetjen e dytë, *nëse i pëlqen kultura e tyre*, të anketuarit përgjigjën me 30% jo sepse shumë element i kanë të detyruar në shoqërinë e tyre dhe 70% përgjigjën se i pëlqen kultura e këtij grupi social sepse nuk kanë shumë dallime nga kultura jonë.

Pavarsisht kushteve sociale e ekonomike, shqiptarët kanë gëzuar gjithmonë vlerat e mikëpritjes, ndaj pyetjes së tretë *se si e vlerësojnë qëndrimin e tyre në Shqipëri* ata mbajnë 90% qëndrim pozitiv me arsyetimin se edhe ata duhet të gëzojnë të drejtat e njeriut dhe vetëm 10% qëndrim negativ ndikuar nga pasiguria që mund t'i krijojë kjo situatë. Këto përqindje janë evidente në rezultatet e


88. Hoxha.D, IBNA Analysis/Do mujahedeens in Tirana pose a threat, <http://www.balkan.eu.com>,

marra nga pyetja: *A ndihen shqiptarët të rrezikuar nga sulmet e jashme si rezultat i qëndrimit të refugjatëve Iranian në Shqipëri?* Të anketuarit janë përgjigjur 55% jo, 40% po, ndihen të rrezikuar nga sulmet e jashtme që mund t'i pësojnë nga veprimet e jashtme të Iranit dhe 5% prej tyre shprehen asnjëanës.

Megjithatë, ata janë pothuajse të bindur se *nëse fëmijët e këtij grupi social do të vendoseshin në Shqipëri dhe do të vazhdonin edukimin në shkollat shqiptare, ata nuk do t'a kishin problem që fëmijët të shoqëroheshin me moshatar të këtij grupi social*, ku 90% prej të anketuarve nuk e shohin si problem këtë situatë duke vërtetuar se nuk ekzistojnë paragjykime ndaj këtij grupi dhe vetëm 1% prej tyre nuk do e pranonte. Pyetjes se: *Nëse refugjatët Iranian do të zgjidhnin të integroheshin në Shqipëri cili do ishte reagimi juaj?* Pjesa më e madhe e të anketuarve, 93% prej tyre, shprehen mbështetës, rreth 1% kundra dhe 6% qëndrim asnjëanës. Kontrasti vihet re në pyetjen pasuese nëse *do të ishin pro lidhjeve martesore me këto refugjatë?*, ku 98% përgjigjen jo sepse nuk duan të krijojnë "minoritete" të tjera në Shqipëri por edhe përkatësisë së kulturave të ndryshme dhe

vetëm 2% përgjigjen mbase po në varësi të rrethanave. Këto shifra nënkuptojnë se shoqëria shqiptare tregohet mbështetëse ndaj këtij grupi social dhe shprehen të gatshëm për të kontribuar në aspektin social që ky grup të ndihet i barabartë me shoqërinë tonë.

1.A kishit dëgjuar më parë për Shqipërinë?



### Sfidat e lëvizjes për liri në të ardhmen

Grupi social i shtetasve Iranian paraqitet shumë dinamik për faktin se ata po rriten në numër nga viti në vit. Fillimisht u vendosën në Shqipëri me mbi 200 anëtar<sup>89</sup> të lëvizjes dhe në ditët e sotme, pas 4 vitesh, mendohet se numri total i tyre arrin deri në 4000 persona. Fakti që ata trajtohen si refugjatë politik nuk kanë të drejtën e punësimit në Shqipëri, ndryshe nga azil kërkuarit të cilët përveç dokumentave që i paraqet kontrolleve të shtetit (aplikimit për azil, lejen e përkohshme të qëndrimit) paraqesin edhe lejen e punësimit<sup>90</sup>. Megjithatë një nga sfidat bazike të tyre mbetet akoma *anëtarësimi i sa më shumë shtetasve Iranian në lëvizjen* e tyre në mënyrë që të kenë më shumë forcë kundërshtimi. Ata po bëjnë përpjekje që të bindin shoqërinë e tyre për t'u

89. <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-continues-to-accept-iranian-mujahedins-08-26-2016>

90. [https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj\\_nr\\_121\\_dt\\_18\\_9\\_2014](https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014), fq.2

përfshirë sa më shumë anëtar në këtë grup me qëllim *përmysjen e regjimit të Rohan dhe vendosjen e demokracisë në vend.*

Qëllimet e tyre dëshirojnë t'i arrijnë me anë të dy politikave që ata po ndjekin aktualisht të cilat kanë të bëjnë me *zgjerimin e parametrave ndërkombëtar të çështjes së tyre në mënyrë që të kenë fuqi të mëdha mbështetëse dhe të jenë më të fuqishëm kundër atij regjimi; së dyti, politikbërja me raportuesit që jetojnë në Iran në mënyrë që t'a përcjellin informacionin tek një masë më e madhe popullsie, në këtë mënyrë ata do të jenë të gatshëm për të realizuar demonstrata me përmasa të mëdha kundër qeverisë Iraniane. Gjatë kësaj periudhe ata po përgatiten të realizojnë lëvizjen e tyre në momentin kur të gjitha kushtet politike të jenë në favor, në mënyrë që objektivi të realizohet me sukses.*

### 7. A ndiheni të paragjykuar nga



## PËRFUNDIME

Hapësirat ndërkufitare nuk janë gjithmonë vendimtare për bashkëpunim mes shteteve. Rast konkret është marrëveshja diplomatike SHBA-Shqipëri, e cila jo vetëm që ka ndikim të lartë në aspektin politik, ekonomik dhe social, por ka arritur të krijoj hapësira “ndërkufitare” virtuale brenda vendit tonë. Strehimi i refugjatëve politik Iranian nuk është vetëm një sfidë lokale por edhe sfidë rajonale, ndërkombëtare, globale, kjo për shkak të rëndësisë së paqes dhe sigurisë botëore që kjo çështje posedon.

Lëvizja për liri përfshin individë të kualifikuar profesionalisht, ndër to ndeshemi me doktorë, inxhinjerë apo mësues, të cilët në raste të veçanta janë arsimuar edhe në vende perëndimore, ndaj me eksperiencën e fituar në ato vende ku kanë studjuar dëshirojnë që të arrihen të njëjta kushte sociale e ekonomike edhe në vendin e tyre të origjinës. Si refugjatë politik, megjithëse janë paisur me leje qëndrimi të përhershme, dëshirojnë që të rikthehen në vendin e tyre të lindjes për të kontribuar në krijimin e një shteti demokratik me popullsi të lirë. Ndaj, kërkesa e tyre është për strehim të përkohëshëm në Shqipëri.

Komuniteti i shtetasve iranian është shumë aktiv me grupin social të tyre dhe më të tërhequr me shoqërinë shqiptare. Ata kryejnë aktivitete të ndryshme brenda grupit si: aktivitete sportive, lexojnë studime dhe analiza rreth lëvizjes

së tyre, studjojnë gjuhën shqipe, etj. Ndërsa me grupin social të shoqërisë shqiptare ata japin ndihma ekonomike dhe vizitojnë familjet shqiptare në raste festash fetare, por nuk integrohen më tej edhe pse popullsia shqiptare paraqitet aspak paragjykuese duke i pranuar këto individë me kulturën dhe ideologjitë e tyre. Megjithatë nuk do të dëshironin që raportet mes tyre të shkonin deri në lidhje martesore.

Qëllimet që ky grup social dëshiron të realizoi kërkojnë kohë dhe qëndrimi i tyre në Shqipëri mund të zgjasë deri në disa vjet. Megjithatë, shoqëria shqiptare shprehet e gatshme për të kontribuar në aspektin social për këtë grup individësh duke i menjanuar paragjykimet që mund të ekzistojnë midis dy shoqërive të ndryshme. Ndaj, do të rekomandohej që të ndërtohen politika sociale me qëllim integrimin e mëtejshëm të shoqërisë iraniane në shoqërinë shqiptare, duke ndikuar pozitivisht në bashkëjetesën midis tyre.

### LITERATURA

Agolli.R, Interesat e Iranit në Siri, [www.http://gazeta55.al/interesat-e-iranit-ne-siri/](http://gazeta55.al/interesat-e-iranit-ne-siri/)

Hoxha.D, IBNA Analysis/Do mujahedeens in Tirana pose a threat,<http://www.balkaneu.com>,

<https://al.usembassy.gov/>, US & Albania, our relationship, history& policy

<http://ncr-iran.org/al/>, Cilët janë muxhahedinët Iranian?, PDF

<http://www.balkaneu.com/ibna-analysisdo-mujahedeens-tirana-pose-threat/>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-continues-to-accept-iranian-mujahedins-08-26-2016>

<http://www.exit.al/top-channel.tv>

<https://www.nytimes.com/2017/05/17/world/middleeast/iran-presidential-election-democracy.html>

[https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj\\_nr\\_121\\_dt\\_18\\_9\\_2014](https://www.parlament.al/uploads/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014)

**“TRANSBOUNDARY” SPACE BETWEEN IRAN  
AND ALBANIA: LIVING IN TWO SOCIETIES**

***MSc. Ornela HASRAMA***

*Departament of Geography, University of Tirana*

**Abstract**

*International bordering issues are the main priorities of every nation. Policies that support collaborative relationships between two or more countries and the challenges of their involvement in international agreements, nowadays are overcoming the territorial boundaries. Transboundary spaces in collaborative context, have a trend toward complexity as a result of more actors on stakeholders.*

*Involvement in high rate in international projects between countries, by diplomacy agreement, is not only a common thing but it is also very successful. A very important diplomatic agreement was made between USA and Albania, in 2013, which today after 4 years (2017), has created virtual transboundary spaces inside our country. The essential subject of this agreement is global security. This challenge involves not only Albanian country but USA, Iran and United Nations, as well. This agreement was created in order to place a large specific Iranian social group in Albania, specifically in the suburbs of the capital city. Freedom fighters (mojahedin) after returning to their home would like to make positive impression to us.*

*The goal is to study this dynamic social group in de-integration context in Albania society, as temporarily political refugees. This study is conceived in two views, between Iranian and Albanian society seemingly social difference in conceptual aspect of two groups, hither and thither virtual “transboundary” line: relationship with Albanian families. Between human rights and in high security conditions, they have created small virtual transboundary spaces, which do not allow anyone that is unauthorized to keep in touch with them. Virtual spaces were created as a result of voluntary collaboration between Albania and USA.*

**Key words:** *diplomacy agreement, integration, Iranian citizen, social relation, MEK.*

## OPOJA DHE GORA VEND I HAPUR PËR TURIZËM NDËRKUFITAR

Mr.sc. Vloran CENA<sup>91</sup>

### Shkurtesë

*Në këtë punim do t'i analizojmë kriteret natyrore në Opojë dhe Gorë si një potencial i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në këto rajone të cilët si faktorë kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit ndërkufitar. Opoja dhe Gora si zona të veçanta gjeografike, shtrihen në skajin jugor të Dukagjinit, të dyja së bashku formojnë komunën e Dragashit oazë e bukurisë së paprekur natyrore që pozicionohet në mes të dy kufinjëve atij të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Theks i veçantë në këtë punim i vihet rolit të natyrës në Opojë dhe Gorë ku klientelës turistike i ofron shumëçka, sidomos Liqeni relik i Breznes i krijuar në kohën e neogjenit i cili me pozitën e tij përballë bjeshkëve të Sharrit është peizazh i lakmueshëm për çdo vizitor, gjithashtu mjaft atraktive janë ecjet malore, pushtimi i majave malore deri 2522m, eksplorimet në natyrë, ekskursionet ditore dhe pushimet gjatë vikendeve, kampingjet, aventurat e ndryshme, skijimi pranë qendrës skijuese Arxhena afër fshatit Brod, malet e larta të Sharrit dhe fushat e vazhdueshme alpine, të cilat me cilësitë që i posedojnë e bëjnë pejzazhin shumë tërheqës, të pazëvendësueshëm dhe shumë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për pushim dhe çlodhje.*

*Fjalët kyçe: Opoja, Gora, turizëm ndërkufitar, ecje në natyrë,*

### Faktorët natyrorë

Opoja dhe Gora janë të vendosura në pjesën më jugore të Kosovës. Pozita e këtillë ka rëndësi të posaçme për zhvillimin turistik, aq më shumë kur dimë se Opoja dhe Gora shtrihet në kryqëzimin e Kosovës, Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Kjo hapësirë e cila gjatë shekujve ka qenë e pushtuar nga romakë, otomanë, sllavë, ka ndikimin e këtyre kulturave por duke ruajtur gjenezën shqiptare është motiv mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit.

91. Master i shkencave të Gjeografisë UP. vlorancenaj@gmail.com

Opoja është njëra nga tërsitë territorial malore të Dukagjinit. Depërton thellë në brigjet e Koretnikut dhe Sharrit dhe shtrihet në tërë ujëmbledhësin e Lumit të Pllavës ku bashkë me Gorën përfshijnë skajin jugor të Dukagjinit<sup>92</sup> ka lartësi mbidetare 600-1050 metra, me një sipërfaqe rreth 126 km<sup>2</sup>.

Gora shtrihet në male të larta dhe fusha të vazhdueshme alpine të Sharrit, është mbresëlënëse për nga mungesa gati e tërësishme e druve, trungjeve, ka një sipërfaqe rreth 308 km<sup>2</sup><sup>93</sup> dhe lartësi mbidetare prej 1050-2550 metra.

Pozita gjeografike e Opojës dhe Gorës, lartësia mbidetare (600-2550m) klima supmalore dhe malore, bukuritë e rralla natyrore, Liqeni i Breznes, malet e larta dhe të pasura me kullota, drujt të llojlojshëm, flora dhe fauna, lumenjtë e vegjël e të shpejtë, e bëjnë peizazhin në këtë regjion tepër atraktiv dhe të gjitha këto mundësojnë shëndrrimin e këtyre trevave në zona të përshtatshme për zhvillimin e turizmit.

Faktorët e përmendur kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit malor, turizmit dimëror dhe turizmit shëndetësor.

Komunikacioni dhe lidhjet si kriter për zhvillimin e turizmit

Shkalla e zhvillimit të komunikacionit ka ndikuar shumë në zhvillimin e turizmit, para se gjithash mendoj në funksionin e komunikacionit automobilistik. Komunikacioni është një faktor mjaft i rëndësishëm ekonomik dhe turistik. Rol të rëndësishëm në bartjen e turistëve në këtë regjion luan transporti automobilistik ngase ai merr pjesë 100% të bartjes së përgjithshme të turistëve. Dihet se gjendja e rrugëve shfaqet si faktor me rëndësi i cili ndikon në rolin se si dhe sa do të vijë në shprehje ky lloj transporti për këtë nga organet kompetente si në Dragash dhe në Kosovë është kushtuar një kujdes i posaçëm ndërtimit të rrugëve në drejtimet e qarkullimit. Opoja dhe Gora ka lidhje të drejtpërdrejta në të gjitha bashkësitë lokale, me lokalitete turistike, qytetin e Prizrenit, Shishtavecën në Republikën e Shqipërisë dhe rruga në drejtim të rajonit të Gorna Rekës në Maqedoni në kalimin malor të Lukovo Poles (1500m).

### **Përbërja litologjike**

Opoja dhe Gora janë pjesë e kompleksit malor të Maleve të Sharrit dhe si tërësi janë formuar në të njëjtën fazë gjeologjike me Alpet dhe Dinariket. Bazuar në origjinën e formimit të këtyre maleve dhe proceseve të më vonshme natyrore, janë formuar edhe lloje të ndryshme të shkëmbinjve, mineraleve dhe tokave.

Gjysma e territorit të Opojës dhe Gorës formohet nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve metamorfik. Dy zona janë të dominuara nga lloje të ndryshme të gurëve

92. Riza Çavolli, Dukagjini, Prishtinë, 1977, fq. 15

93. Hajriz Meleqi, Komuna e Dragashit, Veshtrim gjeografik, Dragash 1994, fq. 17

gëlqeror që i janë nështruar proceseve metamorfike. Këto zona janë Mali Koritnik dhe pjesë të maleve rreth Brodit dhe Restelicës. Ndërsa, ndërhyrje të magmatiteve gjenden kryesisht në pjesën qendrore të komunës së Dragashit në vendbanimet ndërmjet Kërstecit, Dragashit, Pllajnikut, Brodit, Zlipotokut dhe Krushevës. Zona më të mëdha të gurit ranor mund të gjenden në jugperëndim të largët të maleve (Kësula e Priftit), derisa zona më të vogla janë të shpërndara kudo. Afërsisht 20% e territorit formohet nga sedimente kuaternare të origjinës fluviale ose glaciale. Opoja dhe Gora ka 8 vende me depozita minerare: 3 depozita të xehes së hekurit mund të gjenden rreth Zlipotokut, 1 depozitë me bakër dhe merkur gjendet afër Mlikës, 1 depozitë me bakër, plumb dhe kallaj gjendet afër Dikancës, 1 depozitë me bakër, plumb dhe kallaj, molidben, volfram dhe arsenik afër Backës, 2 zona gërmimi afër Restelicës dhe Lubovishtës, të dyja gjenden në shistë të gurëve të sedimentuar.<sup>94</sup>

Në vendbanimet e Opojës dhe Gorës sipas hartës së tokës bujqësore ekzistojnë 8 klasa të bonitetit të tokës. Klasa e parë dhe e dytë nuk ekziston fare, sepse kjo klasë llogaritet të jetë me bonitet të madh dhe se kushtet fizike-gjeografike nuk e kanë mundësuar zhvillim e këtyre klasave.

Klasa 3 dhe 4 e tokës bujqësore konsiderohen si tokë mjaft pjellore dhe e përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore. Ky tip i tokës shtrihet kryesisht përgjatë luginës lumore të lumit të Pllavës, aty ku pothuajse shumica e vendbanime të Opojës janë të shtrira. Toka bujqësore e klasit 6 e që është më pak pjellore, shtrihet kryesisht në pjesën kufitare me Shqipërinë në pjesë ku bashkohen lumi i Pllavës dhe lumi Brodit, vendbanimet e të cilit i takojnë dy regjioneve Opojës dhe Gorës. Gjithashtu, kjo tokë përfshinë hapësirën ku këta dy lumenj dalin në pjesën e Shqipërisë. Edhe pjesa e rrjedhës së poshtme të lumit të Restelicës në kufi me Shqipërinë është tokë e klasës 6. Klasa 7 e bonitetit të tokës përfshin pjesën veri perëndimore, kryesisht terren karsitk në afërsi të fshatrave Brezne, Buçe, Rapq dhe Kërstec. Pjesa më e madhe e territorit në Opojë dhe Gorë është tokë e klasit 8 që konsiderohet si tokë me bonitet të ulët. Ajo shtrihet kryesisht në pjesët e larta malore ku dominojnë kullosat.

Bazuar në tipet e tokave, bonitetit dhe karakteristikat e tyre, kemi edhe shpërndarjen dhe vendosjen e popullsisë dhe vendbanimeve. Krahas rrethanave relievo, klimatike dhe hidrografike janë krijuar edhe llojet e tokave. Pjesët më të ulëta të Opojës dhe Gorës të cilat njëherit kanë edhe klimë më të butë dhe rrjedhat ujore kanë krijuar luginat të përshtatshme, kanë ndikuar në koncentrimin e popullsisë dhe vendbanimeve të kësaj komune.

### Relievi

Opoja dhe Gora kanë relief kodrinoro-malor, me Shqipërinë dhe Ma-

94. Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëllimi 2 *Bazat*, UNDP, Qershor 2012, fq 14.

qedoninë e ndajnë kurorat e larta malore, gryka të thella lumore, të papërshtatshme për kalim e lidhin me Shqipërinë por viteve të fundit janë shfrytëzuar terrenet kodrinore në mes të Gllboqicës në Kosovë dhe Shishtavecit në Shqipëri për t'i lidhur këto dy pjesë. Nga vëzhgimi i relievit në Opojë dhe Gorë vërejmë qartë se pjesa më e madhe e terrenit është tipik malor. Lartësia e këtyre trevave ndryshon nga 750-2550 metra mbi nivelin e detit, me një lartësi mesatare mbidetare rreth 1620 metra. Pjesa më e madhe e territorit rreth 41% klasifikohen si male të larta, me lartësi mbidetare nga 1450-2050 metra. Një pjesë me rreth 22% e territorit ka tipare alpine dhe shtrihet në lartësitë 2050-2550 metra mbi nivelin e detit. 31% e hapësirës ka lartësinë 1050-1450 metra mbi nivelin e detit. Vetëm 6 % e territorit ka lartësinë 750-1050 metra mbi nivelin e detit<sup>95</sup> që ndodhet në pjesën e poshtme të luginave lumore të lumit të Pllavës, Brodit dhe Restelicës. Forma relievore të Opojës dhe Gorës janë një ofertë e rëndësishme turistike duke u bazuar në: Peizazhet shumë tërheqse, grykat dhe luginat lumore, terrene për skijim, ecjet në natyrë, vegjetacioni i pasur dhe i llojllojshëm, natyra dhe ajri i pastërt, hapësira të përshtatshme për sporte të ndryshme dimërore dhe verore, burime ujore, liqene akullnajore etj.

### Kushtet klimatike

Klima në këtë region është specifike. Këtu mbizotëron klima submalore dhe malore. Largësia e vogël nga deti Adriatik 100km, hapja nga rrafshi i Dukagjinit ka bërë që të ndihet edhe ndikimi i klimës së ndryshueshme mesdhetare dhe asaj kontinentale, gjë që dëshmon edhe rritja e disa pemëve në Orqushë e Kërstec si rrushi, limoni etj. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet edhe ndikimi i Maleve të Sharrit dhe Koretnikut që pjesës dërmuese i japin karakter të klimës malore e cila ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e turizmit dimëror.

Temperatura - Për sa i përket temperaturës duhet cekur se ajo varet nga struktura e relievit të një regjioni, largësia nga deti, ujërat, vegjetacioni, reshjeve, pozitës gjeografike etj. Të gjithë këta faktorë, së bashku me temperaturën, veprojnë në një mënyrë përtëritëse në shëndetin e njeriut, sidomos këto kanë ndikim të veçantë në shërimin e disa sëmundjeve të organeve të frymëmarrjes, sëmundjeve të gjakut, prandaj nëse pranohet teza se klima është faktor për zhvillimin e turizmit atëherë s' duhet habitur se Opoja dhe Gora do bëhet qendër e njohur turistike.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në regjionin e Opojës dhe Gorës sillet rreth 5.6-9.2°C<sup>96</sup>. Verat janë të shkurta dhe të freskëta me temperaturë

95. UNDP, Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 – 2023, Dragash 2013, fq. 19.

96. Ruzhdi Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, fq 267.

mesatare prej 18.1° C, me dimra të gjatë dhe relativisht të ftohtë (temperaturë mesatare -0.4°C). Temperatura më të larta përjetohen në lugina, ku është afërsisht 10°C më nxehtë se sa në majat malore, dhe pikërisht në këto zona gjenden edhe shumica e vendbanimeve apo fshatrave. Temperatura mesatare gjatë periudhës së vegjetacionit nga prilli-shtator është 15°C<sup>97</sup>. Temperaturat maksimale të regjistruara janë 36.5° C në korrik dhe -21.5° C në janar<sup>98</sup>.

Malet e larta që i rrethojnë vendbanimet e komunës së Dragashit, i mbrojnë këto vendbanime nga kushtet ekstreme klimatike dhe krijojnë mikroklima të buta. Në Opojë dhe në Gorë mbizotron drejtimi meridional i rrymimeve të ajrit nga veriu (N) me 274‰ dhe jugu (S) me 166‰. Pas veriut dhe jugut rastisje mesatare më të shprehur ka era nga kahu i lindjes (E) me rastisje 95‰. Opoja dhe Gora cilësohet si vend i rrahur nga erërat gjatë tërë vitit, por me rastisje më të madhe gjatë muajit prill dhe maj. Qetësia (calm) ka rastisje mesatare të vogël prej rreth 220‰ dhe si muaj më të qetë dallohen shtatori dhe janari. Shpejtësia mesatare maksimale e erës përputhet me kahun e rastisjeve më të nadhe, kështu që erërat nga jugu kanë shpejtësi mesatare prej 3.7 m/s, kurse në verë 3.5 m/s.<sup>99</sup> Nga kjo që u përmend më lartë konstatojmë se malet e larta të maleve të Sharrit dhe Koretnikut ndikojnë drejtëpërdrejt në ruajtjen dhe mbrojtjen e kushteve ekstreme klimatike dhe janë katalizator të mirë të ndikimit pozitiv të kushteve klimatike për vendbanimet e Opojës dhe Gorës. Lagështia vjetore relative e ajrit është 74.4%, që arrin kulmin më të lartë në dhjetorë me 80.7% dhe më të ulët në korrik 68.6%<sup>100</sup>.

Reshjet- Gjatë vitit në këtë rajon bien reshje rreth 850deri 950mm<sup>101</sup>. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ndryshon mjaft sipas muajve (maksimumi në muajin qershor, nëntor, maj). Reshjet bien në formë të borës dhe të shiut, por më së shumti dominojnë reshjet në formë të shiut. Në viset malore bora merr pjesë me 50% të reshjeve të përgjithshme, prandaj në kohët e fundit po bëhet përpjekje për shfrytëziminë saj në zhvillimin e turizmit dimëror. Bora në male paraqitet prej fillimit të nëntorit dhe është e pranishme deri në muajin prill.

### Kushtet hidrografike

Territori i Opojës dhe Gorës ka një rrjet mjaft të dendur me rrjedha ujore. Pos lumenjve kryesor, nëpër vendbanimet e komunës rrjedhin edhe shumë

97. UNDP, Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013–2023, Dragash 2013, fq. 21.

98. Po aty, fq. 21.

99. Ruzhdi Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, fq. 97

100. Po aty, fq. 172.

101. Ruzhdi Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, fq. 270.

lumenj më të vegjël, prroje dhe prrocka që e begatojnë edhe më shumë hidrografinë e kësaj komune. Të gjitha këto burime ujore dhe rrjedhje lumore fillojnë nga Sharri dhe vazhdojnë nëpër vendbanimet e komunës së Dragashit dhe përfundojnë në vendet fqinje Shqipëri dhe Maqedoni. Lumenjt kryesor të komunës së Dragashit janë: Lumi i Pllavës, Brod dhe Restelicë. Lumi i Pllavës me degët e veta formon sistemin më të madh lumor dhe përfshin rreth 63 % të territorit të komunës.

Opoja dhe Gora janë territore mjaft të pasur edhe me liqenj. Në malet e këtyre trevave ekzistojnë një numër i madh i liqeneve që janë krijuar në lartësi të mëdha mbidetare nga cirqet dhe quhen si sytë e maleve. Shumica e liqenive gjinden në brendësi të territorit të Sharrit në lartësitë mbidetare mbi 1700m, në përjashtim të Liqenit të Breznës që shtrihet në trevën e Opojës.



Foto1. Terreni i skijimit në Brod

### Liqeni relikt i Breznës

Me mënyrën e formimit, pastërtinë, tejdukshmërinë, bregun e rregulluar, efektet koloristike me florën dhe faunën e vet karakteristike si dhe me shumë vlera të tjera e bëjnë peizazhin shumë më tërheqës të pazëvendësueshëm dhe shumë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për pushim dhe çlodhje, për të gjithë shfrytëzuesit e çfardolloj moshe qofshin, sipas ekspertëve shkencor paraqet një zonë atraktive turistike.

Ndodhet pranë rrzës perëndimore të gropës së Llopushnikut, ka mbetur nga koha e neogjenit.<sup>102</sup>Rreth liqenit është krijuar një ujëndarës i veçantë 20,2 km<sup>2</sup> i cili përkufizon edhe ujëmbledhësin e liqenit.<sup>103</sup> Është i gjatë 250 metra dhe i gjerë 150 metra. Ka formë gjysmërrethi dhe thellësi rreth 12 metra, kurse në brigjet e tij rriteshin shevari i cili gjatë rritjes së nivelit të liqenit në muajt e lagësht të vjeshtës dhe pranverës përmythen nga uji i liqenit, tani bregu i liqenit është rregulluar. Ushqehet nga Prroni i liqenit, por sipas të gjitha gjasave edhe nga ujërat nëntokësor që krijohen në aluvione dhe sedimente liqenore që përbëjnë fundin e liqenit. Gjatë nivelit të lartë derdhet në lum derdhës i cili rrjedh ka JP, bashkohet me Lumin e Fushës, dhe së bashku humbin nën tokë nëpër

102. Asllan Pushka, Gjeografia, Libri shkollor, Prishtinë 2013, fq.28.

103. M. Ocokolic, V. Jovanovic, M Bemic, M Radovanovic, Vodni resursi i rezime voda sarplaninskih zupa, SANU, knj. 401 Beograd 1994 ,fq200.

humbellat që ndodhin në rrëzë të prerjës gëlqerore të Koritnikut. Gjatë verës në të freskohen banorët e kësaj ane dhe u jepet ujë bagëtive. Temperatura e ujit të liqenit sillet rreth 11°C. Ky liqe është krijuar në sedimentë liqenor joujëlëshues pas brezit shistor, i cili rrethon gëlqerorët e Malit Koritnik dhe i ndanë ata nga gropa pikërisht fundi i saj. Bazeni i tij paraqet pikën më të ulët të Gropës së Llopushnikut dhe është formuar padyshim me shkarje dhe zbritje të mëvonshme në fund të gropës dhe në luginën e cekët të prronit, i cili tani është shëndrruar në degë ushqyese dhe derdhëse të liqenit<sup>104</sup>. Humbellat që ndodhin në rrëzë të prerjës gëlqerore të Koritnikut e humbin ujin i cili vjen nga lumi i fushës edhe dega rrjedhëse e liqenit dhe këtë ujë e derdh në Gurrën e Poslishtit në distancë drejtvizore 6 km pas 6 h, Gurrën e Vërmicës dhe të Shkozës në distancë 6.5 km pas 12 h, Kjo është vërtetuar nga ekipi për kërkime në lidhshmëri me ndërtimin e akumulimit të Llapushës për nevoja të hidrocentralit “Zhur” me 26.06.1975.

### **Bota bimore dhe shtazore**

Dimrat e gjatë dhe të ashpër dhe verërat e shkurta dhe të freskëta ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e botës bimore apo të vegjetacionit në këto treva. Bota bimore dhe shtazore dhe vlerat tjera të natyrës në përgjithësi në Opojë dhe Gorë paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-arsimore-shkencore dhe kërkimore-hulumtuese për vizitorët e ndryshëm. Opoja dhe Gora mburret me trashëgimi të pasur të kafshëve të egra, me 1500 specie të bimëve vaskulare me 150 specie endemike. Kjo përbënë rreth 20% të florës në Ballkan. Ekzistojnë rreth 730 specie vaskulare në lartësi përmbi 1500 metra. Në tërë Malin e Sharrit kombinimi i mikroklimeve malore dhe supmalore rezulton në një larmi të elementeve floristike, me 40 elemente anktartiko-alpin të florës që kanë mbetur si relikte kryesisht nga periudha e akullnajave. Ekzistojnë 92 elemente boreale dhe nënboreale të florës, 57 nga Evropa e Mesme (Nordiko-Alpikë), 67 Euroaziatike (Karpato-Ballkanike), dhe 151 nga Evropa Jugore (Ballkaniko-Apenine)<sup>105</sup>. Pjesa e maleve e cila lidhet me Koritnikun paraqet një zonë me vlera të rralla natyrore dhe konsiderohet si rezervat për disa lloje të bimëve. Këto treva janë të njohura edhe për grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekuese, gjithashtu kultivimin e patateve, frutave, mjaltit, mishit dhe qumështit bio. Hapësirat e maleve të Opojës dhe Gorës janë shtëpi për qenin Ilir, dhinë e egër, deleve, kuajve dhe gjedhave që i janë përshtatur mirë klimës dhe relievit të këtyre anëve, duke mos harruar edhe kafshët e egra si ujku, dhelpra, derri i egër, kaprolli, lepuri, dhe rrëqebulli (*Lynx lynx*) një specie në zhdukje që arealin e ka në malin e Koretnikut. Gjithashtu lumenjtë e këtyre trevave posedojnë me peshkun trofta e proskave (*Salmo trutta m.faro L.*), mustaku i proskave

104. Ruzhdi Pllana, Ligjerata nga lënda e Hidrogeografisë, Tetor- Qershor, 2006-07.

105. UNDP, Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 – 2023, Dragash 2013, fq. 115

(Barbus fluviatilis Ag.), ngjala (Anguilla vulgaris), mlyshi (Esox lucius), krapu-  
liqi, krapu (Cyprinus carpio), perka (Perca fluviatilis)<sup>106</sup>.

### Malet e larta të Sharrit

Shumica e territorit të Opo-  
jës dhe Gorës, në dhjetor të vitit 2012  
janë përfshirë në kuadër të zgjerimit  
të Parkut Nacional<sup>107</sup> “Sharri”. Ne kete  
hapësir mund te krijohet ndërkuftarja  
sipërfaqe e mbrojtur “Sharr - Korabit -  
Deshatit” pasi qe kjo zonë e mbrojtur  
është e vendosur në zonat kufitare të  
Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë  
dhe përfshinë peizazhe unike naty-  
rore. Ky rajon trepalësh kufit-



Foto 2 Liqeni relik i Breznës

ar përfshin një numër të konsiderueshëm të habitateve natyrore dhe endemike  
dhe relikte të florës dhe faunës të rralla dhe të kërcënuara përfshirë specie të  
rëndësisë së përbashkët evropiane, si të ariut të murrme dhe rrëqebullit të Ball-  
kanit<sup>108</sup> dhe llogaritet si parku më i madh koherent në Evropë.


### Rëndësia turistike e Parkut Kombëtar “Sharri”

Njëri ndër rolet më të rëndësishëm i Parkut nacional është vlera e tij  
turistike-rekreative. Atraksionet natyrore (flora dhe fauna e pasur, vegjetacio-  
net pyjore dhe barishtore, rrjedhjet ujore dhe liqenet e shumtë, klima, peisazhet  
e bukura, terrenet për skijim dhe rekreacion) dhe pozita e gjeokomunikacionit  
japin mundësi që në këtë territor të zhvillohen të tri mënyrat themelore të turizmit  
(turizmi stacionar, uikendo-piknik dhe transit) gjatë gjithë vitit.

106. MMPH-IPH, Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri”, Prishtinë 2012, fq. 39

107. Parqet Nacionale janë zona të mëdha natyrore apo gati natyrore të veçuara me qëllim të mbro-  
jtjes së proceseve të mëdha ekologjike, së bashku me gamën e specieve dhe ekosistemeve që janë  
karakteristike për atë zonë, e cila gjithashtu ofron bazament për mundësi që janë të përputhshme me  
mjedisin, kulturën, anën shpirtërore, shkenëcore arsimore rekreative dhe të mundësinë e vizitorëve.

108. MMPH, Raport për gjendjen e natyrës 2010 - 2014, Prishtinë, 2015, fq. 110



Harta 1. Parku Kombëtar “Sharri” dhe tri zonat e mbrojtjes<sup>109</sup>

Kushtet e volitshme natyrore mundësojnë zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit stacionar siç janë: turizmi sportiv-dimëror, turizmi veror, turizmi shëndetësor, turizmi i gjuetisë, turizmi rural, pushimi dhe rekreacioni i punëtorëve, përgatitjet fizike dhe psikike të ekipeve sportive, ekskursionet edukativo-arsimore, simpoziumet dhe manifestimet, hulumtimet shkencore, alpinizëm etj. Zhvillimi i turizmit në PN duhet të përputhet me kriteret e caktuara të mbrojtjes dhe ruajtjes së veçorive burimore të natyrës.

## Ecjet malore në malin Koritnik

Koritniku me lartësinë mbi 2350m, ku relievi përreth nuk e pengon shikimin, nga pika më e lartë e të cilit mund të shihet larg deri në 175 km, me biodiversitetin e pasur me pamjet mahnihtëse të Maleve të Sharrit në lindje dhe të bjeshkëve të Nemuna dhe Qytetit të Kukësit në drejtim të perëndimit është një destinacion shumë i kërkuar nga vizitorët. Mali me pyje të dendura përfundon me vijë të përkufizuar të kufirit të rritjes së drunjëve për të vazhduar me kullotat alpine.

## Ecjet malore Brod- Liqeni i Shutmanit

Një prej ecjeve më të njohura në rajonin e Gorës është Brodi, me një shteg të frekuentuar shumë dhe me pamje mahnitëse brenda Grykës së Brodit

109. Po aty, fq.57.

- drejt rrafshnaltave që shtrihen në jug, aty ku shtrihet edhe Liqeni Shutman në një zonë me ujë, ajër e tokë të pastërt por edhe me elemente tjera atraktive e me vlera rekreative turistike, si: peizazhe alpine, të përbëra nga relieve akullnajore, vegjetacioni i përfaqësuar nga dominimi me kullotat e lartësive . Ky liqe ndodhet në veri-perëndim të Tijavodës, në cirkun e përbërë prej gurësh në basenin shkëmbor në lartësi 2080 metra mbi nivelin e detit me gjatësi 160 metra dhe gjerësi 100 metra, dhe sipërfaqe 13101<sup>110</sup>. thëllsia e tij arrin 1.2 metra është i rrethuar me livadhe, ndërsa brigjet janë ranore. Në liqe derdhet përroska e anës jugore të cirkut ndërsa gjatë periudhave me reshje të shiut dhe shkrirjes së borës liqeni derdhet përmes rrjedhës veriore që konsiderohet edhe si burim i lumit të Majës. Është mjaft interesant në aspektin shkencor dhe edukativ, që interpreton krijimin dhe përfaqësojnë bukuri të rralla natyrore. Kjo shëtitje mund të kombinohet edhe me dy shëtitje të tjera në rajon, Mali Vracë ose shëtitja tek 3 Majat, të cilat fillojnë dhe përfundojnë te liqeni Shutman. Liqeni ofron gjithashtu një vend të mirë për kampim për ata që dëshirojnë të hulumtojnë me shumë pjesën jugore të Dragashit.

Kriteret natyrore si faktorë kanë mundësuar që në territorin e Opojës dhe të Gorës të sjellin turistë nga viset e ndryshme të botës, nga shënimet që posedojmë në vitin 1981 numri i turistëve ishte 1587, prej tyre të huaj vetëm 46, në vitin 1983 ky numër zvogëlohet në 896 turistë me vetëm 15 turistë të huaj, gjatë viteve të 90-ta numri i turistëve edhe më tepër zvogëlohet<sup>111</sup>për të patur një kthesë viteve të fundit me investimet dhe ofertat turistike që i ofron një dy njësi akomoduese ku numri i dhomave në këto njësi akomoduese është 85 dhe numri i shtretërve 180<sup>112</sup>.Këto dy njësi akomoduese janë Hotel Meka e cila ndodhet në qytetin e Dragashit përballë kuvendit komunal ose afër sheshit kryesor të qytetit, është hotel me katër yje dhe 34 dhoma. Shërbimet që i ofron ky hotel janë shumë korrekte dhe cilësore, hoteli posedon: restorant, kuzhinë të larmishme dhe supermaket . Posedon dhomat të cilat janë në formën e apartamenteve të pajisura me të gjithë pajisjet e duhura. Hoteli ka shërbim 24 orësh.

Hotel Arxhena ndodhet në fshatin Brod, 12 km larg qendrës komunale Dragashit. Ky hotel ka 51 dhoma (familjare, dyshe dhe tek) dhe është me katër yje. Hoteli posedon restorantin me kuzhinë tradicionale shqiptare, fitnesi, sauna dhe banjo turke (lligja), ofron teleferikun dhe pistën e skijimit. Një shtëpi private në Brod është konvertuar në akomodim për mysafir, ndonëse ka nevojë për renovim dhe prezantim të cilësisë më të lartë. Gjithashtu, restoranti i sapo ndërtuar (dhe së shpejti edhe hotel) në fshatin Restelicë kërkon avansime të mëtutjeshme për të pasur qasje në rrugë para se kjo të bëhet një lokacion i mirë turistik. Përveç kësaj,

110. Sipërfaqja dhe lartësia është nxjerrë nga matjet në hartën topografike me shkallë 1:25 000

111. H.Meleqi, Komuna e Dragashit, Vështrim gjeografik, Dragash1994, fq. 130.

112. ASK, Kapacitetet e turizmitne Kosove 2016, Prishtine, Korrik 2017, fq. 9.

mali ndërmjet qytetit të Dragashit dhe Prizrenit mund të jetë në gjendje që të ofrojë akomodim për personat që vijnë për kampim, ecje në natyrë dhe shetitësve.

### Përfundimet dhe rekomandimet

Përfundimi i projektit për zgjerimin dhe shkurtimin e rrugës magjistralen Prizren – Dragash dhe vazhdimi i punimeve për përfundimin e rrugës në drejtim të Maqedonisë në pjesën e Restelicës do ta shkurtonte distancën, do të mundësonte lëvizje më të shpejtë, shpenzime më të pakta dhe lëvizje tranzitore nga Prizreni në Dragash për të vazhduar në drejtim të Liqenit të Mavrovës në Maqedoni ose në drejtim të Shishtavecit në Shqipëri.



Foto 3. Liqeni i Shutmanit

Përfundimi i rregullimit të shtratit të liqenit të Breznes dhe rregullimi i shtegut për ecje dhe pushim rreth këtij liqeni, rregullimi i infrastrukturës që t'u mundësojë investitorëve hapjen e një hoteli dhe rregullimin e infrastrukturës për pritjen dhe akomodimin e turistëve.

Përmirësimi i shenjzimit të rrugëve kryesore dhe me theks të veçantë shenjzimi i shtigjeve për ecje do t'ju mundësonte vizitorëve të huaj çasjen më të lehtë në këto shtigje.

Vendosja e hartave tematike ku do të prezantohen zonat turistike, objektet kulturore dhe historike, shtigjet për ecje etj.

Përgaditja e një oferte turistike cilësore për një turizëm të organizuar në disa gjuhë të botës me anë të cilës do të bëhet promovimi i vlerave turistike që posedojnë Opoja dhe Gora.

Hapja e drejtimeve për hoteleri dhe turizëm në gjimnazin “Ruzhdi Berisha” në Dragash ku do të përgadiste kuadro për industrinë turistike do të krijojë aftësitë profesionale dhe burimet njerëzore të kualifikuara të cilat ndikojnë që turistët të jenë të kënaqur me shërbimet e ofruara dhe këto zona të jenë destinacione të preferuara të tyre.

Pastrimi i shtretërve të lumenjëve nga mbeturinat dhe menaxhimi më efikas i Ekoregjonit që në mënyrë të vazhdueshme të bëhet pastrimi i hapësirave të ndotura nga faktori njeri.

Krijimi i infrastrukturës për tërheqjen e investitorëve të huaj për investime.

### **Literatura**

ASK, Kapacitetet e turizmit në Kosovë 2016, Prishtinë, Korrik 2017

Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëllimi 2 *Bazat*, UNDP, Qershor 2012

H.Meleqi, Komuna e Dragashit, Vështrim gjeografik, Dragash 1994

M. Ockolic, V. Jovanovic, M Bemic, M Radovanovic, Vodni resursi i rezime voda sarplaninskih zupa, SANU, knj. 401 Beograd 1994

MMPH – IPH, Analiza hapësinore e komunës së Dragashit, Dragash nëntor 2006

MMPH, Raport për gjendjen e natyrës 2010 - 2014, Prishtinë, 2015.

MMPH-IPH, Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri”, Prishtinë 2012.

Musa Gashi, Bazat e turizmit, ETMM, Prishtinë, 1986

Riza Çavolli, Dukagjini, Prishtinë, 1977

Ruzhdi Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015

Udhërrëfytyesi Komunal i Dragashit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2013-2016

UNDP, Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 – 2023

**OPOJA AND GORA OPEN PLACE FOR TRANSBOUNDARY TOURISM**

*MSc. Vloran CENAJ*

**Abstract**

*In this paper we will analyze the natural criteria in Opoja and Gora, which as factors have special importance for the development of transboundary tourism in these regions. Opoja and Gora as separate geographic areas, lie on the southern edge of Dukagjini, both together form the municipality of Dragash. Particular emphasis is placed on nature's work in Opoja and Gora, which the tourist clientele offers many things, especially the relict lake of the Brezna created in the neogene time, which with its position in front of the Sharri Mountains is a delightful landscape for every visitor, also walking on the mountains, mountainbikes up to 2522m, outdoor explorations, day trips and weekends, campings, various adventures, skiing near the Arxhena Ski Center near the Brod village, the Sharri Mountains and the continuous fields alpine mountains, which with the qualities they possess make the landscape very attractive, indispensable and very necessary and necessary for rest and relaxation.*

**Key words:** *Opoja, Gora, transboundary tourism, outdoor walking.*

**KUFIRI I HAPËSIRËS GJEOGRAFIKE TË KOSOVËS,  
SIPAS JURIDIKSIONIT ADMINISTRATIV E POLITIK  
NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XX DHE NË FILLIM TË SHEK. XXI**

*Dr. Sc. Tomor Çela, Dr. Sc. Hazer Dana,  
Msc. Bajram Kafexholli, Msc. Florend Krasniqi*

**Abstrakt**

*Konsolidimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës ka historinë e vet të zhvillimit, e cila përfshinë një periudhë të gjatë kohore, me sakrificë të mëdha. Kufijtë e hapësirës gjeografike shqiptare kishin dinamikë të theksuar zhvillimi, fatkeqësisht në dëm të konsolidimit të shtetit shqiptar në kufijtë etnikë.*

*Megjithatë, fundi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI kanë shënuar progres solid në avancimin e administrimit të trojeve shqiptare, edhe pse në dy shtete të ndara. Gjithashtu, pozita politike e popullsisë shqiptare që jeton në trojet etnike ka shënuar një përmirësim, jo të kënaqshëm, por gjithsesi pozitiv, të pozitës politike dhe administrative në Luginën e Preshevës, në Maqedoni dhe në Mal të Zi.*

*Hapësira gjeografike e Kosovës është përcjellë me aktivitete të ndryshme politike dhe administrative të përcaktuara nga vendimet politike të fuqive të mëdha. Ajo është sfiduar me vendime politike, luftëra dhe persekutime të vazhdueshme gjatë gjysmës së parë të shek. XX, për të vazhduar me aktivitetet administrative e politike që kanë avancuar në shkallë të ulët juridiksionin politik e administrativ në gjysmën e dytë të shek. XX, dhe së fundi verifikimin e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës përmes procesit të delimitacionit, demarkacionit dhe administrimit të kufirit me të gjitha shtetet fqinj.*

*Pavarësimi i Republikës së Kosovës kërkon konsolidimin e shtetit dhe avancin perspektivën e integriteteve euro-atlantike, prandaj është i domosdoshëm edhe konfirmimi i vijës administrative të kufirit, me qëllim të forcimit të sovranitetit territorial dhe administrativ të Republikës së Kosovës.*

*Fjalë çelës: kufij, delimitacion, demarkacion, administrim, Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi*

### Hyrje

Procesi i përcaktimit të vijës kufitare të Kosovës gjatë shekullit XX, me vështirësi i ka mbijetuar sfidave të kohës, nën presionin e luftërave dhe përndjekjeve të popullatës nga agresionet barbare të pushtueseve sllavë. Kjo ka bërë që vija kufitare e Shqipërisë etnike të pësoj ndryshime gjatë shekullit XX. Me themelimin e Jugosllavisë së Vjetër, janë vendosur edhe kufijtë e hapësirës gjeografike të Kosovës, e cila në disa variante ka pësuar ndryshime për qëllime politike dhe demografike. Kështu në vitin 1958 territorit të Kosovës i bashkëngjitet hapësira gjeografike e Leposaviqit me Leshak. Më pas, në vitin 1971 me amendamentet kushtetuese, përkatësisht me ligjin për themelimin e Zyrës gjeodezike të Kosovës, ligjin për matjen e tokave dhe ligjin për administrimin e tokave, qartësohet hapësira gjeografike e Krahinës Socialiste të Kosovës si pjesë përbërëse e RSFJ-së, e cila përbëhet nga 1300 zona kadastrale të administruara nga 22 komuna. Në vitin 1974 behët zyrtare kjo hapësirë gjeografike me anë të juridiksionit kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Niveli i ultë i arsimimit profesional dhe qasja e munguar e ekspertëve shqiptar të kohës në institucionet gjeodezike gjatë viteve të '30 deri '70ta, të shekullit XX, si dhe paraqitja hartografike mbi bazën e të dhënave të vitit 1925, ka ndikuar që edhe sot në disa lloje të hartave të evidentohen disa probleme periferike përgjatë brezit kufitar të R. Kosovës, të cilat në shumicën e rasteve janë të pa arsyeshme. Kjo si pasojë e ndryshimit të pozicionit politik, rendit kushtetues, avancimit të legjislacionit dhe përdorimit në vazhdimësi të pajisjeve teknologjike të kohës.

27 gushti i vitit 1991 ishte vendimtar në përcaktimin e kufirit administrativ-shtetëror të njësisë juridike (Republikave dhe Krahinave të RSFJ-së), kjo për faktin se me fillimin e luftës në mes të Jugosllavisë së Re (Serbia dhe M. i Zi) dhe Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnje Hercegovinës, Komuniteti Evropian (Franca, Gjermania, Italia, Spanja dhe Belgjika) vendosin të themelojnë komisionin e Badinterit, i cili kishte për detyrë të bëjë përcaktimin e rregullave dhe kriterëve për shënjimin e vijës kufitare në mes të shteteve të dala nga RSFJ. Konkluzionet e raportit të këtij komisioni, kishin të bënin me dy parime themelore: krijimin e kufijve të shteteve mbi bazën e gjendjes administrative të para 25 qershorit të vitit 1991, dhe përdorimin e kriterit administrativ e kadastral për shënjimin e vijës kufitare tokësore.

Këto parime janë përdorur edhe gjatë negociatave për statutin juridik të Kosovës në Vjenë, dhe janë evidentuar në kapitullin VIII, neni 3, pika 2, të pakos gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit.

Procesi i shënjimit të vijës kufitare të Republikës së Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë me 17 shkurt 2008, është përcjelle me probleme të brendshme politike, të cilat shpeshherë e kanë vënë në pikëpyetje procesin e konsolidimit të shtetit. Ky problem vazhdon të jetë në agjendën e politikës së brendshme në Kosovë edhe sot (nëntor 2017), pasi që ende nuk është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, marrëveshja për kufirin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar me 25 qershor 2015.

Kjo kauzë politike e ndërtuar nga disa ekspert dhe e mbështetur nga politikan të caktuar, është bazuar në vijën administrative të kufirit të Kosovës të evidentuar në hartat topografike 1:25000 dhe 1:50000 të cilat bazën hartografike e kanë nga viti 1925 (periudhë kohore e cila njihet si periudhë jashtë juridiksionit politik e administrativ të KSAK-së). Rrjedhimisht kjo vijë e kufirit pretendon se ka devijime nga kufiri administrativ në zonën e Çakorrit dhe Kullës (dy formacione gjeografike në afërsi me komunën administrative të Pejës).

### **Baza Ligjore dhe statistikore që përcaktojnë hapësirën gjeografike të Kosovës**

Marrëveshjet për vijën kufitare të Kosovës me shtetet e reja (ish-republikat socialiste) bazohen në dokumentet ndërkombëtare, për të cilat institucionet e Republikës së Kosovës janë zotuar se do t'i zbatojnë (*Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 e OKB-së e 10 qershorit 1999; Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e Kumanovës më 10 qershor 1999*, ku në pikën 5 thuhet se "Zona tokësore e sigurisë (ZTS) është përcaktuar si një zonë 5 kilometërshe që zgjatet jashtë territorit të Kosovës, në vazhdim të territorit të RFJ-së. Kjo përfshinë terrenin brenda atyre 5 kilometrave"; *Harta precize e KFOR-it për këtë vijë tokësore të sigurisë prej 5 km në brendi të territorit të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi); Plani Gjithëpërfshirës i Presidentit M. Ahtisari i 2 shkurtit 2007 sipas gjendjes së 31 Dhjetorit 1988 (Aneksi VIII)*, ku në nenin 3.2, precizohet se "Territori i Kosovës do të definohet nga vijat kufitare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt

2001<sup>113</sup>”; *pastaj Rregullorja e UNMIK-ut mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave, nr. 43/27 korrik 2000 etj.*

Baza ligjore për vijën kufitare të Republikës së Kosovës është e bazuar në këto ligje, si më poshtë:

- Ligja për matjen e kadastrën e tokave, KSAK 1973,
- Ligji për organizimin territorial të komunave, KSAK 1975,
- Ligji i matjes dhe kadastri i tokave, KSAK 1980,
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/43 Mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave të Kosovës, 2000,
- Ligji për kufijtë administrativ të komunave Nr. 03/L-041, Republika e Kosovës 2008,
- Ligji për kadastër Nr. 04/-L-013, Republika e Kosovës 2011,
- Vjetarët statistikorë për periudhën kohore 1955-2017
- Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500, të KSA të Kosovës viti 1973,
- Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500 të KSA të Kosovës, 1974,
- Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500 të KSA të Kosovës, 1979,
- Harta me zonat kadastrale të Kosovës, 2015,
- Harta me zonat kadastrale të Kosovës, 2017,

---

113. Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007

**SHTRIRJA E AKTIVITETEVE TË AGJENCIVE  
(ORGANIZATAVE) SHTETËRORE NË TERRITORIN E KSAK-SË, GJATË  
GJYSMËS SË DYTË TË SHEKULLIT XX.**

Organizatave shtetërore të KSAK-së, gjatë tri dekadave të fundit të shek. XX, por edhe tash të Republikës së Kosovës, kanë shtrirë aktivitetin e tyre shërbyes e operativ në tërë territorin e Kosovës. Prandaj, analizimi i këtyre aktiviteteve për nga aspekti hapësinor e operativ, argumenton hapësirën gjeografike operacionale, rrjedhimisht edhe vijën e kufirit të Kosovës.

Të gjitha materialet e publikuara në gazetata zyrtare, raportet profesionale, projektet zhvillimore dhe publikime shkencore, tregojnë se aktivitetet operative, administrative, hulumtuese dhe shkencore të institucioneve të KSAK-së, gjatë periudhës kohore 1974 - 1988, kanë qenë të shtrira brenda segmentit të kufirit administrativ me gjatësi prej 741km, rrjedhimisht hapësirën gjeografike prej 10905km<sup>2</sup>.

Institucionet më të rëndësishme të kohës – Enti Gjeozodik i KSAK (Agjencia Kadastrale e Kosovës), tregon qartë se aktivitetin e saj profesional e administrative e mbështetë në ligjet dhe aktet nënligjore me bazë funksionale nga viti 1932. Funkzioni juridikë e kadastral është ndërtuar duke realizuar matjet kadastrale, dhe krijuar rrjetin trigonometrik të hapësirës gjeografike të Kosovës. Të dhënat zyrtare janë të klasifikuara në katër grupe: juridike, tekstuale, statistikore dhe hartografike. Dokumentacioni është i karakterit juridik, dhe i përbërë nga akte juridike që kanë burimin nga amendamentet kushtetuese të vitit 1971, dhe DEKRETIN PËR SHPALLJEN E LIGJËS MBI MATJEN E KADASTRËN E TOKAVE - LIGJA (Ligji) për matjen e kadastrën e tokave v.1973.

Në bazë të nenit 116 të Ligjës Kushtetuese të  
Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

**DEKRET**

**PER SHPALLJEN E LIGJES MBI MATJEN E KADASTRËN E TOKAVE**

Shpallët Ligja mbi matjen e kadastrën e tokave, të cilën e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e Dhomës Krahinore më 13 prill 1973. dhe mbledhjen e Dhomës organizative-politike më 13 prill 1973.

KK Nr. 95-2  
Prishtinë, 13 prill 1973

Kryetari i Kuvendit,  
Hijaz Kurteshi, d. v.

**LIGJA**


**MBI MATJEN E KADASTRËN E TOKËVE  
I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**



Të dhënat kadastrale, sigurojnë vazhdimësi të pandryshueshme administrative e juridike të hapësirës gjeografike të KSAK-së, prej themelimit të saj, e deri tek R. e Kosovës, në historinë më të re të saj. Krijimi i Zyrës Gjeodezike, ka ndihmuar në konsolidimin e kufijve të parcelave kadastrale (me bazë tekstuale dhe vektoriale të të dhënave), zonave kadastrale dhe komunave administrative, ku rrjedhimisht është përcaktuar edhe

hapësira/sipërfaqja gjeografike e KSAK-së. Dokumentacioni administrativ, pronësor, kadastral dhe hartografik në vazhdimësi evidenton ndryshimet e organizimit të brendshëm hapësinor të Kosovës, bazuar në ligjet dhe aktet ligjore të nxjerra nga institucionet kompetente të KSAK-së. P.sh. ligji mbi matjen e kadastrën e tokave (v. 1973), theksohet qartësisht se *“.....matja e tokës bëhet për të gjetur shënimet e nevojshme për pasqyrën horizontale e vertikale të terrenit të territorit të KSAK-së, - me qëllim shfrytëzimi të këtyre shënimeve për qëllime ekonomike, shkencore dhe administrative....”*. Ndërsa në Ligjin “mbi organizimin territorial të komunave” v. 1975, hapësira gjeografike e Kosovës paraqitet në 22 komuna administrative dhe 1300 zona kadastrale. Edhe sipas Ligjit të vitit 1989, organizimi hapësinor dhe administrativ i Kosovës përbëhet nga 30 komuna administrative dhe 1300 zona kadastrale, rrjedhimisht me sipërfaqe të matur prej 10908km<sup>2</sup> (baza tekstuale).

Dokumentacioni kadastral tekstual 10908km<sup>2</sup> dhe vektorial 10906km<sup>2</sup>, tregon se sipërfaqja totale e Kosovës është e pandryshueshme prej periudhës së matjeve të para gjeodezike në territorin e Kosovës në v. 1929 e deri më sot. Me përjashtim të segmentit të kufirit Kosovë-Maqedoni, në zonën kadastrale Debëllde dhe Restelicë, e cila ka qenë e definuar me Marrëveshjen për kufirin në mes të R. së Serbisë dhe R. së Maqedonisë, e aprovuar nga UNMIKU dhe Kombet e Bashkuara në v. 2001, si dhe e përcaktuar qartë në Pakon Gjithëpërfshirëse të M. Ahtisarit, kapitulli VIII, pika 3, paragrafi 2. Enti Gjeodezik i Kosovës ka përgatitur hartat pasqyruese të fletëve për hartën 1:2500 të KSAK-së, për periudhën kohore 1973, 1979, 2015, 2017, të cilat evidentojnë vijën kufitare të pandryshueshme nga vitet ‘30ta të shekullit XX e deri me sot.



Harta 1. v. 1973



Harta 2. v. 1979

Pas shpalljes së pavarësisë, sipas ligjit të vitit 2008 mbi decentralizimin e komunave administrative të R. së Kosovës, hapësira gjeografike e saj përbëhet nga 38 komuna administrative dhe 1305 zona kadastrale. Ndërsa, të dhënat statistikore për zonat kadastrale dhe komunat administrative të Kosovës janë të pandryshueshme dhe kanë përputhshmëri të plotë me të dhënat vektoriale e tekstuale (me nuanca të vogla ndryshimi) të cilat janë të lejueshme nga aspekti profesional. Korrigjimi i këtyre gabimeve minore, bëhet në vazhdimësi, varësisht nga niveli dhe përdorimi i teknologjisë informative. Paraqitja e hartave të zonave kadastrale për vitin 2015 dhe 2017, tregojnë se kufiri i jashtëm i zonave kadastrale, rrjedhimisht i komunave administrative dhe kufiri shtetëror është i pa ndryshueshëm për periudhën kohore kur territori i Kosovës kishte juridiksion administrativ dhe politik (1974 – 2008).




Harta 3. Zonat kadastrale, v. 2015



Harta 4. Zonat kadastrale v. 2017


Përputhja e vijës së kufirit në mes të shteteve fqinje duke argumentuar harmoninë e të dhënave kadastrale të prezantuara në mes tyre, tregon për saktësinë maksimale të vijës kufitare në mes të vendeve respektive. Argument shumë i rëndësishëm në këtë proces është edhe krahasimi i përputhshmërisë së planeve kadastrale në mes të dy shteteve, rasti i kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Malit të Zi. Në një rën anë nomenklatura e hartave blloqeve kadastrale të brezit kufitar nga ana e Malit të Zi, e cila kufizohet me kufirin perëndimor të komunës së Pejës (R. Kosovës) fillon me planin kadastral Përnjavor, Velikë, pastaj vazhdon në drejtim të veriut me zonën kadastrale Shekullar, Kalludra, Prilloq, Dacic (Dacaj), Balotic, etj. Në anën tjetër, indeksi i planeve kadastrale për brezin kufitarë të Kosovës është në përputhje të plotë me vijën kufitare të planeve kadastral nga ana e shteteve fqinjë. Sipas nomenklaturës së hartave të blloqeve kadastrale (nga ana e Malit të Zi) dhe Planeve Kasastral (nga ana e Republikës së Kosovës), të prodhuara në vitin 1972/73 nga Instituti hartografik (Zavod za Kartografiju) "GEOKARTA" Beograd, si në hartën nr. 10 tregohet qartësisht përputhëria e kufirit në mes të shteteve respektive.




Harta 6. Mbulueshmëria me të dhëna kadastrale në pjesën e brezit kufitar<sup>114</sup>.

114 Agjencia Kadastrale e Kosovës, 2017

INDEX OF CADASTRAL PLANS (SCALE 1: 2500),  
WHICH COVER REPUBLIC OF KOSOVO BORDERS.






**Të dhënat e rrjetit energjetik** - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës, duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110kV. Ky operator ka trashëguar hapësirën operative nga organizata “Elektro Ekonomia e Kosovës”, e cila funksiononte në kuadër të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës deri në v. 1988. Pas çlirimit të Kosovës dhe themelimit të institucioneve të saj, kjo hapësirë gjeografike e rrjetit energjetik bartet në kompetencën e Korporatës Energ-

jetike të Kosovës. Sot, sistemit të transmisionit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/ 35/10kV dhe 110/35/10(20)kV, i cili lidhet me shtetet fqinje përmes shtatë linjave ndërkufitare.

Falë pozitës qendrore gjeografike që ka R. e Kosovës, sistemi i transmisionit edhe pse i vogël, me gjithsej katër linja ajrore 400kv, dy linja 220kV dhe 2 linja 110kV, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmisionit në Evropën Juglindore. Linjat kryesore ndërkufitare shtrihen në katër drejtime: drejtimin e Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë.

- Linja ajrore 400 kV, sipas numrit dhe drejtimit:
- Linja nr. 437/2 NS Peja 3-NS Ribarevina / Mali i Zi
- Linja nr. 400 kV Tirana 2-Kosova B / R. e Shqipërisë
- Linja nr. 420/2 NS Ferizaj 2-NS Shkupi 5 / R e Maqedonisë
- Linja nr. 407 NS Kosova B-NS Nishi / Serbi
- Linja ajrore 220 kV.
- Linja nr. 2303 NS Prizreni 2-NS Fierza / R. e Shqipërisë
- Linja nr. 205/2 NS Podujeva-NS Krushevcu / R e Serbisë.
- Linja ajrore 110 kV.
- Linja nr. 1140/2 NS Berivojca -NS Bujanovci / R. e Serbisë
- Linja nr. 155/2 NS Vallaqi - NS N Pazari / R e Serbisë.




Harta 5. Linjat ndërkufitare

Elaboratet dhe mikroprojektet tekniko-profesionale të shtrirjes së rrjetit energjetik të Kosovës, në drejtim të republikave dhe shteteve fqinje tregojnë se aktiviteti operativ i organizatës Elektro-ekonomia e Kosovës, shtrihet deri në kufijtë administrative të KSAK-së. Njeri nga elaboratet më të rëndësishme është edhe mikro-projekti i punuar nga ELEKTROPRIVREDA, Beograd, për linjën 380kV “Kosova B – Titograd”, ku janë të evidentuara detajet teknike të shtrirjes së këtij rrjeti. Sipas këtij raportit LP me nr. 437/2 shtrihet nga Kosova B, përmes të NS Peja 3 deri tek NS Ribarevina (Mali i Zi). Gjatësia e linjës në mes të nënstacioneve Kosova B – Ribarevinë, është 123,08 km, ndërsa në territorin e Kosovës gjatësia e kësaj linje mes NS Peja 3 deri në kufirin me Malin e Zi është 29.34 km. Sipas këtij raporti gjatësia totale e kësaj linje në territorin e Kosovës nga Kosova B - kufiri me Malin e Zi është 70,95 km, e cila përbëhet nga gjithsej 192 shtylla (86 në mes NS Peja 3 - kufiri i R. së Kosovës dhe 106 shtylla Kosova B - Peja 3 ). Kjo linjë është ndërtuar në vitin 1977/78 dhe përmban nivel të tensionit prej 400 kV. Në këtë raport janë prezantuar dhe skicat e linjës në të cilën janë prezantuar edhe koordinatat e terrenit, të cilat tregojnë vendndodhjen hapësinore të tyre në territorin e Kosovës. Në hartën e prezantuar në raportin e shënimeve teknike të viti 1977/78, është punuar edhe harta e shtyllave të fundit në kufirin Kosovë – Mali i Zi, më ç ‘rast kanë shënuar edhe vijën kufitare, dhe tregohet se malet e Zhlebit gjenden jashtë territorit të Kosovës.

Për t’i verifikuar këto të dhëna në terren, ekipet e terrenit të Komisionit për Matjen e Territorit të Kosovës, kanë piketuar (koordinata Y-7439960.66, X-4738395.32) shtyllën e fundit (192) në territorin e Republikës së Kosovës, dhe distanca në mes të kufirit të Kosovës dhe kësaj shtylle është 107 m. Këto piketime kanë vertetuar se të dhënat nga raporti i lartshënuar janë ta sakta, përputhen në plotni me gjendjen reale në terren dhe argumentojnë se kufiri i KSAK (tash Republika e Kosovës) është i pa ndryshueshëm nga viti 1974 deri me sot.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se edhe në drejtim të Serbisë ekzistojnë shënime teknike të linjës (400kV), nr. 407 NS Kosova B-NS Nish (Serbi), në të cilën shpjegohet se gjatësia e përgjithshme e linjës është 124,38 km, ndërsa në territorin e Kosovës janë të vendosura 105 shtylla (19 sh. këndore dhe 86 bartëse), që përbëjnë 39,55 km të kësaj linje.



Ortoharta 1. Linjat ndërkufitare – drejtimi i R. së Malit të Zi




Harta 7. Linjat ndërkufitare – drejtimi i Malit të Zi



ngastrave pyjore. Në tabelën 4 zhvillimi i sipërfaqes totale sipas klasave të përdorimit të tokës, jepen informacione rreth sipërfaqes së përgjithshme sipas klasave të përdorimit të tyre<sup>115</sup>. Tetë ngastrat pyjore 34-44 dhe 56-62, në Njësinë Menaxhuese “ZHLEB” me sipërfaqe të përgjithshme prej 614,70 ha, e cila shkruhet brenda kufijve të Komunës së Pejës, dokumentuar në Planin Afatgjatë (10-vjeçar) të Menaxhimit me vlefshmëri për periudhën 1997-2006, i miratuar nga „Zyra për planifikim dhe projektim për pyjet, me seli në Beograd në vitin 1997”.


Sipas dokumentit “Posebna Osnova Gazdovanja Šumama G. J. Žleb”, v. 1997-2006, Beograd 1997, tabela 1.1.3. sipërfaqet e pjesës menaxhuese “Zhljeb”, shpjegohet se territori i kësaj njësie shtrihet në zonat kadastrale sipas sipërfaqeve: Novo Sellë (937 ha, 29 ar dhe 06 m<sup>2</sup>), Jabllanicë e Madhe (2660ha, 34ar dhe 21m<sup>2</sup>), Jabllanicë e Vogël (807ha, 47ar dhe 88m<sup>2</sup>), Radovc (159ha, 66ar dhe 74m<sup>2</sup>), Lipë (70ha, 10ar dhe 00m<sup>2</sup>) dhe Dačići (614ha, 74ar). Sipërfaqja totale e kësaj pjese menaxhuese është e përshkruar në tabelën 5249ha, 62ar, dhe 89m<sup>2</sup>. Në bazë të mbulushmërisë administrative të Republikës së Kosovës vërtetohet se zona kadastrale Daçiq, nuk është pjesë administrative e komunës së Pejës, prandaj kjo sipërfaqe (614ha, 74ar) edhe pse është menaxhuar nga njësi menaxhuese “ZHLJEB”, nga aspekti administrativ i takon Malit të Zi. Në këtë pjesë janë evidentuar edhe parcelat kadastrale kontestuese nga kjo Agjenci. Parcelat kadastrale të kontestuara nga APK janë: 62,61,60,59,57,58 (pjesërisht), 57, 56 (pjesërisht), 44 (pjesërisht) 43, 41, 42,40, 39,38,37,36,35 dhe 34, të zonës kadastrale Dačići me sipërfaqe prej 614ha, 74 ar, 00m (sipas dokumentin nr. 026-11/2017, data 31.01.2017).

Komuna e Pejës - ka dorëzuar listën e sipërfaqeve të zonave kadastrave për komunën administrative, por për shkak se të dhënat janë të njëjta me ato të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, janë prezantuar në pjesën e të dhënave nga AKK.



Harta 9. Sqarimi i pozitës gjeografike të parcelave të lartshënuara

Në hartën e prezantuar në këtë material, vërehet se në këtë pjesë të njësisë menaxhuese Zhleb, ekziston një vijë e cila përputhet plotësisht me kufirin aktual të Republikës së Kosovës, por në mungesë të deshifrimit të legjendës (për shkak të kualitetit të dobët të hartës) nuk mund të konsiderohet si valide. Gjithsesi kjo vijë mund të ndihmojë në krahasimin e të dhënave dhe vërtetimin e mbulueshmërisë administrative me dokumentacion. Është me rëndësi të përmendet se vija në këtë hartë përputhet plotësisht me të dhënat e dorëzuara dhe verifikuara nga KOSTT (shtylla 192 e linjës 400 kv).



Rast tjetër i ngjashëm është edhe pjesa pyjore e ashtuquajtur “Pas Hajle”, e cila i takon zonës kadastrale Koshutan me sipërfaqe prej 650ha, dhe e cila nuk është e evidentuar në raportin e menaxhimit të Agjencisë Pyjore të Kosovës, sepse kjo pjesë e territorit të Kosovës deri në vitin 1999 është menaxhuar nga Agjencia Pyjore e Rozhajës (Mali i Zi), ndërsa në aspektin administrativ i takon Republikës së Kosovës.



**Departamenti i Ujërave** – në Sekretarinë e Qeverisë së Kosovës, ka dorëzuar atllasin e botuar nga Energoprojekt “Vodoprivredno Rešenje Metohije”, botuar nga “Sekretarijat za poljoprivredu, šumarstvo i vodoprivredu Prishtina”, v. 1974. Në këtë atlas janë gjithsej 38 harta me tematika të ndryshme. Këto harta mbajnë Legjendën e cila shpjegon tri lloje të kufijve: a) Kufirin Shtetëror (Državna granica), Kufirin e Krahinës së Kosovës (Granica Područja Mtohije i opština unutar područja), dhe Kufirin e ujëmbledhësit të Drinit të Bardhë dhe Plavës (Granica Sliva Reke Beli Drim i Plavske).


Pas gjeoreferencimit të hartave nga ky atlas, është vërejtur se kufiri administrativ i KSAK, është i njëjti me kufirin aktual të Republikës së Kosovës. Gjithashtu të dhënat vektoriale të pellgjeve ujëmbledhëse të Kosovës, përputhen në plotësi me kufirin administrativ/shtetëror të R. së Kosovës.

Kufiri shtetëror paraqitet në mes të Republikës së Shqipërisë dhe kufirit të ish-Jugosllavisë dhe ka përputhshmëri me kufirin zyrtar të Republikës së Kosovës, kufiri i territorit të "Metohisë" dhe komunave brenda territorit të saj ka përputhshmëri me kufirin zyrtar të Republikës së Kosovës, kurse kufiri i trete është kufiri i shtrirjes së ujëmbledhësit të lumit Drini dhe lumi të Plavës. Në hartën nr 12. Tregohet së pjesa e lumit Bjelluha dhe Çakorri, evidentohen si territor i Malit të Zi dhe nga aspekti gjeografik është jashtë territorit të Kosovës.

***Të dhënat statistikore*** - Agjencia e Statistikave të Kosovës – është institucion shtetëror, i cili ka trashëguar veprimtarinë e Entit të statistikave të KSAK. Për të analizuar dhe krahasuar të dhënat për sipërfaqen e Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek. XX janë krahasuar edhe të dhënat statistikore nga Vjetarët Statistikor për periudhën kohore 1955-1988 të cilët kanë qenë të botuar nga: Enti Statistikor Federativ i ish Jugosllavisë, Enti i Statistikave të Serbisë dhe Enti Krahinor i Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna tregojnë



Harta 10. Pellgu i ujëmbledhësit të Drinit, legjenda shpjeguese e vijave të kufijve



Harta 12. Harta hidrologjike

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

kronologjinë e zhvillimit të hapësirës gjeografike të Kosovës, në dy nivele: atë nacional dhe lokal.

Burim i të dhënave për sipërfaqen e Kosovës në Vjetarët Statistikorë të asaj kohe kanë qenë Institucionet për Gjeodezi në ish RFSJ, ndërsa sa i përket të dhënave pas luftës së fundit në Kosovë burim kryesor është Agjencia Kadastrale e Kosovës. Gjithashtu burim i të dhënave hartografike për kufijve, të cilat nevojiten për krijimin e Hartave në Agjencinë e Statistikës së Kosovës me produkte statistikore është Agjencia Kadastrale e Kosovës - AKK.

Në Vjetarin Statistikor të vitit 1955, sipërfaqja e Kosovës ishte raportuar me 10 690 km<sup>2</sup>, dhe ka vazhduar deri në Vjetarin Statistikor të vitit 1959. Kjo për faktin se hapësira gjeografike e komunës së Leposaviqit me Leshak (197km<sup>2</sup>) i është bashkangjitur Kosovës në vitin 1958.


Ndërsa, prej vitit 1961 deri në vitin 1981, sipërfaqja e KSAK-së ishte prezantuar me 10 887 km<sup>2</sup>, ndërsa pas vitit 1982 KSAK prezantohet me 10 908 km<sup>2</sup>.

Shifrat për sipërfaqen e KSAK/R. së Kosovës, të shpërndara sipas komunave administrative për periudhën kohore 1974 dhe 1975 janë nxjerrë nga Vjetarët Statistikor të ish Jugosllavisë, ndërsa për periudhën kohore 1976 – 1988, këto të dhëna janë nxjerrë nga Vjetarët Statistikor të Entit Krahinor të Statistikës të Kosovës.



Me rëndësi të veçantë është të përmendet se në Vjetarin Statistikor të vitit 1955, sipërfaqja totale e Kosovës ishte prezantuar me 10 690 km<sup>2</sup>, ndërsa

sa i përket sipërfaqes së komunave ajo ka ndryshuar, varësisht nga organizimi i brendshëm administrativ.



Sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës në Vjetarët Statistikor ishte e raportuar në mënyra të ndryshme. Nga viti 1974 deri në vitin 1981 ajo ishte 10887 km<sup>2</sup> në total. Mirëpo kur mbledhim sipërfaqet e komunave, rezultati është i ndryshëm 10907 km<sup>2</sup> kjo ka ndodhur si pasojë e gabimeve teknike të asaj kohe.

Nga viti 1982 e deri në vitin 1985 sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës në Vjetarët Statistikorë ishte e raportuar e njëjta si në nivel të Kosovës po ashtu edhe nga mbledhja e sipërfaqeve totale të komunave (10908 km<sup>2</sup>).

Vjetari stat.	Sipërfaqja e Republikës së Kosovës në km <sup>2</sup>	Viti i publikimit	Botuesi	Emri i publikimit
1974	10 887	1974	Zyra statistikore e Ish Jugosllavisë	Vjetari Statistikor i Ish Jugosllavisë
1975	10 887	1975	Zyra statistikore e Ish Jugosllavisë	Vjetari Statistikor i Ish Jugosllavisë
1976	10 887	1976	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1977	10 887	1977	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1978	10 887	1978	Zyra statistikore e Ish Jugosllavisë	Vjetari Statistikor i Ish Jugosllavisë
			Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1979	10 887	1979	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1980	10 887	1980	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1981	10 887	1981	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1982	10 908	1982	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1983	10 908	1983	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1984	10 908	1984	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1985	10 908	1985	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1986	10 908	1986	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1987	10 908	1987	Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës
1988	10 887	1988	Zyra statistikore e Ish Jugosllavisë	Vjetari Statistikor i Ish Jugosllavisë
	10 908		Enti Krahinor i Statistikës	Vjetari Statistikor i Kosovës

## STUDIME GJEOGRAFIKE 22

Në vitin 2007 Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka pranuar listën e komunave me sipërfaqe zyrtare nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Sipas kësaj liste nga baza e të dhënave grafike Kosova kishte 10 907 km<sup>2</sup>, ndërsa sipas bazës së të dhënave tekstuale Kosova kishte 10 908 km<sup>2</sup>. Në këtë listë sipërfaqja e komunës së Pejës është raportuar me 602.58 km<sup>2</sup>.

ATLASI STATISTIKOR 2011 – i publikuar në vitin 2013



01 Degan	13 Lipjan	25 Ferizaj
02 Gjakovë	14 Novobërdë	26 Vite
03 Glogoc	15 Obiliq	27 Vushtrri
04 Gjiçan	16 Rahovec	28 Zubin Potok
05 Dragash	17 Prizren	29 Zveçan
06 Istog	18 Prishtinë	30 Malishevë
07 Kaçanak	19 Prishtinë	31 Junik
08 Klinë	20 Prizren	32 Mamushë
09 Fushë Kosovë	21 Shtëriç	33 Hani i Elezit
10 Kamennë	22 Shitoc	34 Graçanik
11 Mitrovicë	23 Shtëriç	35 Ranilug
12 Leposaviq	24 Suharekë	36 Prahon
		37 Klloko

Sipërfaqja e Republikës së Kosovës 10 906 km<sup>2</sup>

Sipërfaqja e komunës së Pejës 603 km<sup>2</sup>

Burimi i të dhënave: Agjencia Kadastrale e Kosovës

Kodi i komunës Municipal code	Emri i komunës Name of municipality	Sipërfaqja në km <sup>2</sup> Area in km <sup>2</sup>
01	Degan	294
02	Gjakovë	587
03	Glogoc	276
04	Gjiçan	392
05	Dragash	434
06	Istog	454
07	Kaçanak	211
08	Klinë	309
09	Fushë Kosovë	84
10	Kamennë	417
11	Mitrovicë	356
12	Leposaviq	559
13	Lipjan	358
14	Novobërdë	204
15	Obiliq	105
16	Rahovec	276
17	Pejë	603
18	Podujevë	633
19	Prishtinë	523
20	Prispen	627
21	Skenderaj	374
22	Shitoc	134
23	Shtëriç	248
24	Suharekë	361
25	Ferizaj	345
26	Vite	270
27	Vushtrri	345
28	Zubin Potok	334
29	Zveçan	123
30	Malishevë	306
31	Junik	78
32	Mamushë	11
33	Hani i Elezit	83
34	Graçanik	122
35	Ranilug	78
36	Prahon	29
37	Klloko	25
	Kosovë	10906

Sipërfaqja e Kosovës sipas Atlasit të Regjistrimit të popullsisë 2011

### Hapësira gjeografike dhe kufiri administrativ i Republikës së Kosovës

Vija e kufirit të Republikës së Kosovës i përgjigjet kriterit kadastral (sipas komisionit të Badinterit), dhe përputhet plotësisht me kufirin e parcelave kadastrale, zonave kadastrale, kufirin e komunave administrative dhe kufirin shtetëror.

Gjatësia e vijës së kufirit të Kosovës është 741km, përderisa poligoni i mbyllur i këtij segmenti jep sipërfaqen prej 10905.25km<sup>2</sup>. Gjithashtu totali i sipërfaqes së komunave administrative dhe zonave kadastrale, përputhet plotësisht me sipërfaqe e Kosovës. Komuna administrative të prekura nga vija e kufirit të shtetit janë gjithsejtë 19, ndërsa zona kadastrale të cilat e përbejnë brezin kufitar 168, si në tabelën nr. 1. Zonat kadastrale që marrin pjesë në vijën më të gjatë të kufirit shtetëror është Podujevë më 96.01km, e përcjelle nga Leposaviqi

me 86.52km, pastaj Dragashi me 75.59, etj., ndërsa me vijën më të shkurtër të pjesëmarrjes në kufirin shtetëror është Zveçani me 3.12km.

Nr.r	Komuna	Gjatësia e kufirit të komunës km	Nr. Z_kadastrale
1	Dragash	75.59	15
2	Prizren	40.99	12
3	Gjakovë	51.46	11
4	Junik	14.09	1
5	Deçan	10.44	2
6	Peje	61.19	14
7	Istog	21.84	7
8	Zubin Potok	39.03	7
9	Zveçan	3.12	1
10	Leposaviq	86.52	17
11	Podujeve	96.1	24
12	Prishtine	13.45	4
13	Kamenice	71.61	16
14	Ranillug	8.3	4
15	Gjilan	57.81	12
16	Viti	21.18	6
17	Kaçanik	18.85	2
18	Hani i Elezit	34.74	6
19	Shtërpca	15	7
Total		741.31	168

### Konkluzione

Duke u bazuar në të dhënat të prezantuara më lart, del së sipërfaqja e KSAK-së, për periudhën kohore 1974-1988 ishte 10908 km<sup>2</sup>, ndërsa pas ratifikimit të marrëveshjes në mes të Republikës së Serbisë dhe Maqedonisë e nënshkruar në vitin 2001, e cila është evidentuar edhe në projekt propozimin gjithëpërfshirës të Marti Ahrisarit në vitin 2007, është vertetuar se sipërfaqja e Republikës së Kosovës është 10905.25km<sup>2</sup>. Rrjedhimisht del se vija e kufirit të Kosovës është e pa ndryshuar nga viti 1932 e deri më sot.

Nga kjo mund të rekomandojmë se institucionet e Republikës së Kosovës, duhet që sa më shpejtë:

1. Të bëjnë ratifikimin e marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi,

2. Të fillojnë negociatat politike për fillimin e procesit të shënimit të kufirit të Kosovës me Serbinë.
3. Të miratohet një rezolutë nga Parlamenti i Kosovës, e cila do të rekomandon që kriterin administrativ dhe kadastral të vendos si parim bazë të marrëveshjes për shënjimin e kufirit me Republikën e Serbisë.

### REFERENCA

1. Agjencia Kadastrale për territorin e Kosovës në periudhën 1974-2017
2. Ligja për matjen e kadastrën e tokave, KSAK 1973,
3. Ligji i matjes dhe kadastrin e tokave, KSAK 1980,
4. Ligji për kadastrë Nr. 04/-L-013, Republika e Kosovës 2011,
5. Ligji për organizimin territorial të komunave, KSAK 1975
6. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/43 Mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave të Kosovës, 2000,
7. Ligji për kufijtë administrativ të komunave Nr. 03/L-041, Republika e Kosovës 2008,
8. Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500, të KSA të Kosovës viti 1973,
9. Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500 të KSA të Kosovës, 1974,
10. Harta pasqyruese e fletëve të hartës 1:2500 të KSA të Kosovës, 1979,
11. Harta me zonat kadastrale të Kosovës, 2015,
12. Harta me zonat kadastrale të Kosovës, 2017,
13. Disa fletë (shembuj) të hartës 1:2500, përgjat kufirit me sicilin shtet fqinj të Kosovës,
14. Statistika të sipërfaqes tekstuale të komunave dhe të territorit të Kosovës në vitet 1983/88, 2003, 2013, Dhjetor 2015 dhe Janar 2017 dhe grafike,
15. Statistika të sipërfaqes tekstuale të zonave kadastrale, të komunave të Kosovës në vitet 1983/88, 2003, 2013, Dhjetor 2015 dhe Janar 2017 dhe grafike,
16. Raportet dhe statistikat e lëshuara nga AKK për institucione,
17. Regjistri i sipërfaqeve dhe harta e zonave kadastrale komunës së Pejës, përgatitur nga Abdurrahman Kuleta, Drejtori i Kadastrit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Maj 2015,
18. Statistikat e sipërfaqes për territorin e Kosovës, përgatitur nga Përparim Ahmeti, Kryeshef i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Maj 2007.

**KOSOVO GEOGRAPHICAL AREA BORDER ACCORDING  
TO ADMINISTRATIVE AND POLITICAL JURISDICTION IN THE SECOND  
HALF OF THE 20TH AND THE START OF THE 21ST CENTURY**

Dr. Tomor ÇELA<sup>1</sup>, Dr. Hazer DANA,

Msc. Bajram KAFEXHOLLI & Msc. Florend KRASNIQI

**Abstrakt**

*Consolidation of the statehood of the Republic of Kosovo has its own development history, which includes a long period of time, with great sacrifices. The boundaries of the Albanian geographic area had a strong dynamics of development, unfortunately to the detriment of the consolidation of the Albanian state in the ethnic boundaries. However, in the 20<sup>th</sup> century and beginning of the 21<sup>st</sup> century a solid progress was made in advancing the administration of Albanian territory, though in two separate states. Also, the political position of the Albanian population living in ethnic areas has marked an unsatisfactory, but still positive, political and administrative position in the Presheva Valley, Macedonia and Montenegro.*

*Kosovo's geographic area has been followed by various political and administrative activities determined by political decisions of major powers. Kosovo was challenged with political decisions, wars, and persecutions during the first half of the 20th century, to continue with the administrative and political activities that have gradually advanced the political and administrative jurisdiction in the second half of the 20th century, and finally the verification of the state border of the Republic of Kosovo through the delimitation, demarcation and border management process with all neighboring countries.*

*Independence of the Republic of Kosovo represents the need for consolidation of the state and advances the prospect of Euro-Atlantic integration, so it is also necessary to confirm the administrative line of the border in order to strengthen the territorial and administrative sovereignty of the Republic of Kosovo.*

**Key words:** *Borders, delimitation, demarcation, administration, Kosovo, Albania, Montenegro.*